

**PËRGJEGJËSIA CIVILE PËR DËMIN JASHTË  
KONTRAKTOR TË SHKAKTUAR NGATË TRETËT NË  
LEGJISLACIONIN SHQIPTAR**

Doktoranti  
Anita Bardhi

Dorëzuar  
Universitetit Europian të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në  
SHKENCA JURIDIKE, me profil E DREJTËCIVILE, për marrjen e  
Grades shkencore “*Doktor*”

Udhëheqës shkencor  
Prof. Dr. KESTRIN KATRO

Numri i fjalëve:63989

Tiranë, 2016

---

## **DEKLARATA E AUTORESISE**

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky disertacion është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë më parë përpara një institucioni tjetër për vlerësim, si dhe nuk është botuar as si i tërë, as pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, me përjashtim të rasteve të cituara dhe të referuara. Ky punim shkencor është realizuar mbi bazën e kërkesave të “Rregullores për organizimin e programeve të studimit të doktoratave” së hartuar nga Universiteti Europian i Tiranës.

## ABSTRAKTI

Përgjegjësia për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët është konfiguruar së fundmi nga doktrina edhe praktika gjyqësore si një figurë autonome dëmi, në kategorinë e dëmit jashtë-kontraktor. Shfaqja e kësaj figure të posaçme është fryt i evolucionit dhe dimensioneve të reja që ka fituar kategoria e dëmit jashtë-kontraktor si rezultat edhe i zhvillimit të konceptit “*jashtë-kontraktor*”.

Tema “*Përgjegjësia për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët*”, është propozuar si një domosdoshmëri e thellimit jo vetëm të aspektit teorik, por edhe atij praktik, për t’u ardhur në ndihmë sistemit të drejtësisë, të gjitha grupeve të interesit në Republikën e Shqipërisë, por edhe më gjerë, duke u gjendur kështu edhe përballë shumë rasteve dhe praktikave gjyqësore të cilat kanë spikatur në vendin tonë.

Studimi është konceptuar në mënyrë të tillë që të sjellë si risi, për herë të parë në Republikën e Shqipërisë, implikime në tre aspekte kryesore: *Së pari*: studimi trajton rishikimin e literaturës së autorëve më bashkëkohorë të fushës së përgjegjësive për dëmin jashtë-kontraktor; *Së dyti*: studimi prezanton implikimet metodologjike të kërkimit në praktikë, e lidhur kjo me shpërblimin e dëmit jashtë-kontraktor, *Së treti*: ky i fundit ofron implikime për zbatimin në praktikë të studimit të propozuar.

Tema e prezantuar bazohet plotësisht mbi parimet e shkrimit akademik, dhe përbën një strukturë solide akademike, të mbështetur në përgjigjen e disa pyetjeve kyçe dhe vërtetimin e hipotezave fillestare, duke implikuar më pas metodologjinë e mbështetur në vërtetimet në praktikë, dhe me pas duke kaluar në gjetjen, argumentimet dhe diskutimet, si dhe konkluzionet e arritura. Në bazë të studimit të literaturës, konkludohet se format e zbatimit në praktikë të koncepteve teorike, krahasuar edhe me literaturën bashkëkohore.

**Fjalët kyçe:** *përgjegjësi, dëm, dëm-jashtëkontraktor, faj, shpërblim.*

## ***ABSTRACT***

Responsibility for non-contractual damage caused by third parties is set up recently by the case law doctrine as an autonomous figure damage, in the category of non-contractual damage. The appearance of this particular figure is the result of evolution and new dimensions that has won the category of non-contractual damage as a result of the development of the concept of "non-contractual"

The theme "Responsibility for out-contactors damage caused by third parties", it is proposed as a necessity of deepening not only the theoretical aspect, but also the practical, to assist the judicial system, all stakeholders in Republic of Albania, and beyond, being assembled so much in the face of court cases and practices which have been distinguished in our countr

The study is conceived in such a way as to bring innovation, for the first time in Albania, implications on three main aspects: First, the study deals with review of the literature of authors contemporary area of responsibility for the damage out-contracting; Secondly, the study presents a methodological implications of research in practice, which relates to compensation for damage outside-contactors, Third: the latter offers implications for the practical implementation of the proposed study

The theme presented is based entirely on the principles of academic writing, and constitutes a solid structure academic support to answer some key questions and confirmation of the initial hypothesis, implying then methodology based on observations in practice, and then passing finding, arguments and discussions and conclusions. Based on the study of literature, concluded that the format of practical implementation of the theoretical concepts, compared with contemporary literature.

***Keywords:*** liability, damage, non-contractual damage, fault, remuneration.

## **FALENDERIME DHE MIRENJOHJE**

*Shpreh mirënjohjen time të sinqertë për të gjithë ata që më kanë përkrahur e ndihmuar, së afërmi a së largu, në kryerjen e këtij punimi.*

*Falënderoj veçanërisht udhëheqësin tim Prof. Dr. Kestrin Katro, që pranoi të më udhëhiqte në këtë ndërmarrje vendimtare të formimit tim, pa kursyer ndihmën, mbështetjen, besimin, si dhe mbi të gjitha këshillat e saj me vlerë për realizimin e këtij punimi, si dhe në veçanti për motivimin e lartë dhe kurajon në nivel personal për finalizimin e këtij disertacioni.*

*Falënderoj miqtë për sugjerimet, vërejtjet dhe mirëkuptimin, edhe kur unë nuk kisha mundësi t'i takoja, për shkak të orareve të zgjatura dhe netëve të kaluara mbi kompjuter. Gjithashtu nuk do mundesha kurrësesi të lija pa falënderuar kolegët e punës për mbështetjen e vazhdueshme dhe tolerimit ndaj meje, gjatë punës për arritjen e objektivave të kompanisë.*

*Në mbyllje, falënderimi më i madh shkon për familjen time, nënën, motrën, vëllanë dhe gjyshen time, të cilët më kanë qëndruar pranë me devotshmëri, më kanë dhënë mbështetjen e tyre maksimale, duke ma lehtësuar punën akademike përmes sakrificës dhe mirëkuptimit.*

*Për kohën dhe vëmendjen e munguar, për durimin dhe mirëkuptimin e vazhdueshëm, këtë punim ia dedikoj, mbi të gjithë e mbi të gjitha, familjes sime të dashur.*

*Faleminderit!*

*Anita Bardhi*

*Tiranë, 2016*

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

ABSTRAKT .....	3
FALËNDERIM DHE MIRËNJOHJE .....	5

### **KAPITULLI I**

#### **HYRJE**

### **KAPITULLI II**

#### **METODOLOGJIA E APLIKUAR NË STUDIM**

2.1. Hipoteza dhe pyetjet hulumtuese .....	4
2.2. Qëllimi i studimit .....	7
2.3. Objektivat e punimit .....	7
2.4. Metoda dhe metodologjia e kërkimit .....	8
2.5. Rëndësia e studimit .....	10
2.6. Kontributi i studimit .....	12
2.7. Kufizimet e studimit .....	12
2.8. Përcaktimi i termave kyçe .....	13

### **KAPITULLI III**

#### **HISTORIKU DHE SFONDI LIGJOR I RREGULLIMIT TË PËRGJEGJËSISË JASHTË-KONTRAKTORE TË PERSONAVE TË TRETË**

3.1. Aspekti historik i përgjegjësive civile në periudha të ndryshme kohore .....	15
3.2. Kodi Civil i vitit 1929 .....	20
3.4. Kodi Civil i vitit 1982 .....	25

3.5.	Elementët e marrëdhënies së shkaktimit të dëmit jashtë-kontraktor .....	26
3.5.1.	<i>Shkaktimi i dëmit</i> .....	26
3.5.2.	<i>Veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm</i> .....	28
3.5.3.	<i>Fajësia</i> .....	45
3.5.4.	<i>Lidhja shkakësore</i> .....	47
3.6.	Rastet e ndryshme të përgjegjësisë .....	55
3.6.1.	<i>Përgjegjësia me faj e vetë personit i cili ka shkaktuar dëmin</i> .....	55
3.6.2.	<i>Përgjegjësia për të tjerët.</i> .....	57

## KAPITULLI IV

### BAZAT E PËRGJEGJËSISË

4.	Baza juridike e përgjegjësisë sipas llojit të dëmit jashtëkontraktor .....	61
4.1.	Përgjegjësia e prindërve për dëmin e shkaktuar nga fëmijët e tyre të mitur. ....	62
4.2.	Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga i mituri mbi katërbëdhjetë vjeç dhe personi me zotësi të kufizuar për të vepruar .....	67
4.3.	Përgjegjësia e punëdhënësit për dëmet e shkaktuara të tretëve nga punëmarrësit e tyre.....	72
4.4.	Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga personat nën mbikëqyrje. ....	93
4.5.	Përgjegjësia e përfaqësuesit. ....	95
4.6.	Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm ose ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme.....	98
4.7.	Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar ndaj mjedisit.....	102
4.8.	Përgjegjësia për reklamë mashtruese.....	10104
4.9.	Publikimi mashtrues .....	11
4.10	Përgjegjësia për mjetet motorike në lëvizje.....	107
4.11.	Përgjegjësia nga të metat e produkteve.....	113

4.12. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët. ....	119
--	-----

## KAPITULLI V

### FAJI SI BAZË E PËRGJEGJËSISË

5. Faji si bazë e përgjegjësise civile .....	136
5.1. Baza juridike e <i>përgjegjësise për dëmin sipas fajit</i> në qarkullimin juridik. ....	139
5.2. Fusha e zbatimit të kësaj baze juridike të përgjegjësise për dëmin e shkaktuar. ....	141
5.3. Llojet e fajit në fushën e të drejtës Civile. ....	144

## KAPITULLI VI

### PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN MATERIAL DHE ATË MORAL

6.1. Shpërblimi i dëmit material dhe atij moral. ....	148
6.2. Dëmi material, kuptimi, llojet dhe shpërblimi i tij.....	151
6.3. Dëmi jo material (moral) .....	157
6.4. Mënyra e shpërblimit të dëmit. ....	160
6.5. A duhet trajtuar dëmi ekzistencial, si dëm jopasuror i pavarur në legjislacionin tonë	
6.6. Trajtimii dëmit jopasuror në këndvështrim krahasues.....	162
6.7. Dëmi jopasuror dhe shpërblimi i tij sipas praktikës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.....	164

## KAPITULLI I VII

### VËSHTRIM KRAHASUES NË DISA NGA VENDET E BASHKIMIT EUROPIAN MBI PËRGJEGJËSINË E DËMIN JASHTË-KONTRAKTOR TË SHKATUAR NGA TË TRETËT

7.1. Legjislacioni francez.....	177
---------------------------------	-----



7.2.	Legjislacioni italian.....	173
7.3.	Legjislacioni Gjerman.....	175
7.4	Kuptimi i dëmit jashtëkontraktor dhe përgjegjesisë që rrjedh prej tij në Shqipëri, Itali dhe Francë.....	184

## **KAPITULLI VIII**

### **KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME**

<b>KONKLUSIONE.....</b>	<b>184</b>
<b>REKOMANDIME.....</b>	<b>194</b>
<b>BIBLIOGRAFIA.....</b>	<b>198</b>

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

<b>KRSH</b>	<b>Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë</b>
<b>KLD</b>	<b>Kanuni i Lekë Dukagjinit</b>
<b>KEDNJ</b>	<b>Konventa Europiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore</b>
<b>DUDNJ</b>	<b>Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut</b>
<b>GJEDNJ</b>	<b>Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.</b>

## KAPITULLI I

### HYRJE

*“Përgjegjësia për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët”* është një temë, e cila nuk ka gjetur shtjellim të gjerë në radhët e juristëve apo akademikëve të tjerë dhe që rrjedhimisht ka një zhvillim të pakët si në koncept, ashtu edhe në praktikë. Ishte kjo një nga arsyet që më nxiti ta zgjedhja objekt shtjellimi të disertacionit tim. Ajo që dua të theksoj është fakti se kur e konsultoja zgjedhjen e kësaj teme me kolegët e mi juristë vazhdimisht hasja në një reagim të tyre sa entuziast, aq edhe të stepur për shkak të kompleksitetit që ajo mbart. Vështirësia më e madhe qëndronte në ekzistencën e burimeve të pakta në gjuhën amë, si dhe mungesën e literaturës dhe të praktikës gjyqësore përkatëse.

Në çdo reagim të tyre gjeja edhe përgjigjen e asaj, që më shtyu vërtetë për të zgjedhur këtë temë. Ishte pikërisht fakti që kisha të bëja me një fushë të patrajtuar në mënyrë të zgjeruar më parë nga kolegët e mi, pra një *“tokë të pashkelur”*, ajo që më tërhoqi akoma edhe më shumë në lidhje me të, pra përbënte një sfidë në vetvete. Madje, marr guximin të them se ky punim vjen në një kohë tepër të volitshme, atëherë kur trajtimi i zgjeruar i saj duket të jetë shumë i nevojshëm, jo vetëm në aspektin studimor, por dhe për t’iu ardhur në ndihmë kolegëve të mi.

Duhet thënë se në kohët e sotme, si dhe në kushtet e një shoqërie e cila konsiderohet më tepër si një shoqëri e përgjegjshme, përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga të tretët është një nga aspektet më të rëndësishme të institutit të shkaktimit të dëmit jashtë-kontraktor.

Sa herë diskutohet mbi përgjegjësinë civile që rrjedh nga dëmi i shkaktuar nga të tretët, me të drejtë, juristët i referohen aty për aty, fillimisht përgjegjësisë për të tretët, duke përfshirë në të, të gjitha shkaqet e lindjes së kësaj përgjegjësie. Diskutimi shtrihet në analizën

e elementëve të përgjegjësisë dhe dallimet e saj në krahasim me institutet e tjera të së drejtës të ngjashme me të.

Ky punim është strukturuar në 8 (tetë) kapituj, ku në përmbajtjen e të cilëve jam munduar të paraqes në mënyrë të detajuar çdo element përbërës, duke filluar që nga instituti i shkaktimit të dëmit, pjesë e së cilës është edhe kjo lloj përgjegjësie, deri në fazën e fundit të këtij instituti, gjithmonë duke i trajtuar në kuadër të përgjegjësise për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët. Një rëndësi të veçantë i është kushtuar edhe aspektit historik të zhvillimit të këtyre instituteve në Shqipëri, si një element të nevojshëm për të kuptuar ecurinë e zhvillimit të tyre.

Jam ndalur kryesisht në trajtimin e dispozitave që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e personave për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët. Kjo, me qëllim për të sqaruar të gjitha ato momente të cilat mund të shoqërohen me debate juridike, si një mënyrë për të shmangur krijimin e përplasjeve ndërmjet normave ligjore gjatë gjyqimit të çështjeve të tilla.

Në kapitullin ku kam trajtuar elementët përbërës të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga të tretët jam ndalur gjerësisht në trajtimin e të gjitha rasteve të mundshme, të cilat i kam hasur jo vetëm gjatë studimit të praktikës, por dhe të doktrinës, për të cilën duhet të them që ka qënë kryesisht e huaj.

E kam parë të arsyeshme që të pasqyroj në një kapitull të posaçëm, trajtimin që i bëhet kësaj përgjegjësie në legjislacionet e shteteve më të zhvilluara anëtare në Bashkimin Europian, dhe konkretisht në atë Italian, Francez, Anglez, Gjerman etj., si edhe trajtimin në kuadër të direktivave Europiane. Ky shtjellim është bërë me qëllim që përdoruesit e këtij materiali të kenë mundësi t'i referohen këtij të fundit, edhe për sa i përket shembujve që vijnë nga këto vende dhe jurisprudenca e tyre. Kjo, për shkak të mungesës së rasteve praktike nga gjykatat tona. Mendoj se mënyra se si i kanë trajtuar këto vende, si edhe shembujt që janë sjellë në lidhje me raste konkrete përgjatë viteve, do të shërbejnë edhe si modele referimi për

përsonat e interesuar në këtë studim. Krahas shembujve të ndryshëm që kryesisht janë marrë nga rastet e Gjykatave Italiane dhe Gjykatës Europiane të Drejtësisë, e kam parë me interes dhe trajtimin e një prej çështjeve që ka ngjallur më tepër debat, si dhe që është tepër aktuale për përgjegjësinë që mbartin subjektet e ndryshme si pasojë e lidhjes me shkaktuesit e dëmit jashtë-kontraktor. Në mënyrë të përmbledhur në këtë punim trajtohen rastet me interesante dhe vendimet që janë dhënë kryesisht nga gjykatat italiane për këtë çështje.

Shqyrtimit të këtyre padive, si dhe shqyrtimit të problematikës së hasur gjatë studimit të rasteve praktike i është kushtuar një kapitull i veçantë. Duhet theksuar se gjatë gjithë këtij punimi janë ngritur çështje e problematika të ndryshme me natyrë juridike, të cilave është synuar t'u jepet një përgjigje sa më e drejtë dhe e bazuar ligjore.

Shpresoj që ky punim të paraqesë jo vetëm një interes të përgjithshëm, por edhe të jetë objekt i vazhdueshëm i diskutimeve jo vetëm në radhët e juristëve në rrethet akademike, por dhe të vetë gjyqtarëve të cilët janë edhe pjesa zbatuese e këtyre dispozitave ligjore. Në përfundim, me këtë punim nuk pretendohet të shterohen të gjitha problematikat me natyrë juridike që mbart kjo temë, por shpresoj që të shërbejë si një fillesë e mirë për të nxitur diskutimet dhe debatet e mëtejshme në literaturën tonë juridike.

## KAPITULLI II

### METODOLOGJIA E APLIKUAR NË STUDIM

#### 2.1. Hipoteza dhe pyetjet hulumtuese

Në kapitullin e dytë të disertacionit kam paraqitur në mënyrë panoramike mënyrën se si është realizuar studimi.

Ky punim doktoral i përket fushës së studimeve të së drejtës civile dhe nëpërmjet tij jam përpjekur të analizoj veçoritë e rëndësishme të përgjegjesisë për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët.

Qëllimi i temës është që të analizohen dhe shpjegohen elementët e përgjegjesisë që kanë personat e tretë për dëmin e shkaktuar, sidomos elementin “*faj*”. Që të realizohet kjo është e rëndësishme që përgjegjësinë ta studjoj në të gjitha format dhe kompleksitetin e saj.

Duke qenë një temë interdisiplinare, shumë komplekse dhe me shumë diskutime, studimi i përgjegjesisë për të tretët për shkaktimin e dëmit jashtë-kontraktor të krijon hapësirë për analizë nga disa këndvështrime, si dhe për përdorimin e metodave të ndryshme hulumtuese.

Gjatë kryerjes së këtij hulumtimi u paraqit nevoja e zgjedhjes së metodave të përshtatshme të analizës dhe të trajtimit teorik, që do të kontribuonin në trajtimin empirik dhe interpretimin e llojt të përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar nga të tretët.

Për të pasqyruar sa më saktë llojin e përgjegjesisë që mbajnë personat e ndryshëm për dëmin e shkaktuar të tretëve, u ngritën disa pyetje kryesore kërkimore, të cilat orientuan kryerjen e këtij studimi.

Më poshtë po paraqes pyetjet kërkimore dhe bazën teoriko-empirike nga e cila ato kanë lindur:

- Sa e rëndësishme është përqasja edhe në rrugë institucionale e praktikave dhe legjislacionit vendas me mentalitetin dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, në lidhje me përgjegjësinë e dëmit jashtë-kontraktor?
- Cilat janë mënyrat e llogaritjes së dëmshpërblimit të dëmit jashtë-kontraktor në doktrinën dhe praktikën gjyqësore?
- Faji, në format e tij të shfaqjes, a konsiderohet element kryesor i përgjegjësisë civile në detyrimet jashtë-kontraktore?

Përgjegjësia civile bazohet në principin e fajit dhe faji është element i anës subjektive.

Dëmi është pasojë e aktivitetit të personit të caktuar: përgjegjësia në bazë të fajit nënkupton që secili duhet të përgjigjet për veprimet e veta. Në drejtësi, në parim, secili është përgjegjës për veprimet e veta lidhur me dëmin e shkaktuar. Mirëpo, e drejta ka edhe përjashtime. Parimi “*përgjegjësia për tjetrin*” ka për qëllim rritjen e mbrojtjes juridike për dëmin e shkaktuar eventualisht. Ky parim nënkupton se personi, i cili e ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet vetë për të, por në vendin e tyre, në bazë të ligjit, përgjigjet dikush tjetër.

Ky studim fokusohet në ngritjen e hipotezes, si edhe në analizën e disa problematikave kryesore. Ngritja e hipotezes është bërë në funksion të dhënies së përgjigjeve ndaj çështjeve të mësipërme, me qëllim për t’iu dhënë zgjidhje shumë elementëve dhe problematikave të hasura. Çështjet që janë trajtuar në këtë studim përmbajnë koncepte të dala nga pyetjet e hulumtuara nga ana teorike, si edhe nga ajo praktike. Në këtë studim trajtohet përgjegjësia për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët.

I gjithë punimi, duke përfshirë këtu çështjet e kërkimit të evidentuara dhe të shtjelluara tek paraqitja e rezultateve, si dhe diskutimi i tyre, orientohen dhe nxisin lindjen e hipotezës:

**Hipoteza : Përgjegjësia për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga të tretët është përgjegjësi me faj dhe e kushtëzuar. Vërtëtimi i kushtit ligjor është obligim për shkarkimin nga kjo lloj përgjegjësie.**

Rastet e përgjegjësise për dëmet jashtëkontraktore të njohura në legjislacionin tonë janë si më poshtë vijon:

1. Përgjegjësia për persona të mitur;
2. Përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga persona të pazotë;
3. Përgjegjësia punëdhënesit;
4. Përgjegjësia e përfaqësuesit;
5. Përgjegjësia nga përdorimi i kafshëve;
6. Përgjegjësia për ushtrimin e një veprimtarie te rrezikshme;
7. Përgjegjësia për dëmtimin e mjedisit;
8. Përgjegjësia për publikimet mashtruese;
9. Përgjegjësia për dëmin që rrjedh nga produktet.

Gjatë analizës dhe hulumtimit jam munduar të përcaktoj përgjegjësinë jashtëkontraktore në secilin rast, llojn e përgjegjësise për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar të tretëve, lidhjen shkakësore *materiale* ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) të paligjshëm e me faj dhe dëmit të shkaktuar.

Nëpërmjet kësaj të fundit synoj të vërtetoj se cili është personi përgjegjës (subjekti aktiv) dhe lidhja ndërmjet tre elementëve objektivë e subjektive të faktit të paligjshëm (shkaktimit të dëmit): sjelljes së paligjshme (objektiv) e me faj (subjektiv) dhe pasojës së ardhur prej tyre, pra dëmtimit të një tjetri në personin a pasurinë e tij (objektiv).



## 2.2. Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij punimi doktrature është mundësimi i një panorame teorike, konkrete edhe analitike të përgjegjësive për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët, në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi, si edhe duke iu referuar praktikës edhe legjislacionit të vendeve komunitare. Për të eksploruar këtë marrëdhënie, secili nga dimensionet e mësipërme do të trajtohet teorikisht, si edhe në mënyrë krahasuese me vendet e tjera të Bashkimit Europian siç janë: Italia, Franca dhe Gjermania.

Ky punim ka tri qëllime kryesore, në vetvete të ndërlidhura me njëra-tjetrën, të cilat janë si më poshtë:

**Së pari:** punimi synon të trajtojë më gjerë përgjegjësinë për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët.

**Së dyti:** synon të paraqesë një vështim më të thelluar teorik dhe praktik të kërkimeve dhe gjetjeve të studiuesve shqiptarë dhe atyre të huaj mbi përgjegjësinë e dëmit jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët.

**Së treti:** synon gjithashtu të parashtojë një analizë më të thelluar dhe të paraqesë disa përfundime duke u nisur nga një vështrim krahasues mbi dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët midis vendeve anëtare të Bashkimit Europian si, Franca, Italiadhe Gjermania, duke sjellënë këtë mënyrë një ndihmesë për studiuesit e ardhshëm.

## 2.3. Objektivat e punimit

Nëpërmjet këtij punimi në fushën e së drejtës civile/ private unë synoj të studioj dhe të analizoj në mënyrë të detajuar e të thelluar përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga personat e tretë.

Jam përpjekur të nxjerr në pah faktin se përgjegjësia për dëmin jashtë-kontraktor ekziston atëherë kur dëmi i është shkaktuar një subjekti me të cilin nuk ekzistojnë marrëdhënie kontraktore, si dhe fakton se çdokush që shkakton një dëm do të përgjigjet për të. Megjithatë, ekzistojnë edhe raste kur një person mund të ngarkohet me detyrimin për shpërblimin e një dëmi të cilin nuk e ka shkaktuar personalisht. Pra, përgjegjësia civile mund të lindë dhe për dëmin e shkaktuar nga të tjerët.

Sipas kësaj qasjeje, objektivat kryesore të këtij punimi janë:

- Të analizohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga të tretët.
- Të studiohen mënyrat dhe format e dëmshpërblimit të dëmit.
- Të vlerësohet lloji i përgjegjesisë për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar të tretëve.

#### **2.4. Metoda dhe metodologjia e kërkimit**

Në këtë punim do të përdoren disa metoda të kërkimit shkencor, të cilat do t'i analizojmë si më poshtë vijon:

*Kërkimi doktrinar* (mbledhja dhe përpunimi i literaturës). Ky hap konsiston në kërkimin e literaturës në lidhje me objektin e studimit. Ai përfshin identifikimin, mbledhjen si edhe sistemimin e librave, monografive, artikujve shkencorë, kumtesave të konferencave kombëtare edhe ndërkombëtare në fushën ligjore. Zgjedhja e literaturës është shtrirë mbi një numër relativisht të konsiderueshëm autorësh të huaj, si edhe disa vendas. Në këtë drejtim një ndihmesë të madhe më ka dhënë edhe kërkimi shkencor, të cilin e kam realizuar në

Bibliotekën e Universitetit European të Tiranese cila më dha mundësinë për t'u konsultuar me një literaturë të gjerë, si në kuadrin kombëtar, europian ashtu edhe atë ndërkombëtar, në fushën detyrimeve jashtë-kontraktore. Gjithashtu, kërkimi shkencor është shtrirë edhe në analizën e literaturës shqiptare të fushës civile. Për realizimin e citimeve gjatë punimit dhe për hartimin e Bibliografisë është përdorur stili **APA**.

*Analiza e legjislacionit.* Për realizimin me sukses të objektivave të caktuara në këtë studim jam mbështetur në metodën e analizës edhe të sintezës. Kjo metodë konsiston në nxjerrjen e rasteve tipike ligjore nëpërmjet analizës së legjislacionit. Në sistemin tonë juridik normat ligjore gjenden të sistemuara në kode, ligje, si edhe akte të tjera nënligjore. Duke qenë se normat rregullojnë situata të përgjithshme, metoda e analizës ligjore shërben për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të teorisë, si edhe të praktikës rast pas rasti, nëpërmjet interpretimit të këtyre normave. Gjithashtu, kjo metodë shërben për të sqaruar paqartësinë e normave, vendosjen e tyre në një rend logjik dhe koherent dhe për të analizuar ndërveprimin e tyre me norma të tjera.

*Metoda krahasuese.* Pavarësisht se studimi nuk realizohet në kuadrin e së drejtës së krahasuar, për një kuptim edhe interpretim më të mirë të normave të brendshme ligjore është menduar realizimi i analizës krahasuese të parashikimit të legjislacionit vendas në lidhje me dëmin jashtë-kontraktor dhe legjislacioneve të atyre vendeve (legjislacioni Italian, Francez e më gjerë), të cilat kanë shërbyer si një model për hartimin e të drejtës së detyrimeve.

Nëpërmjet këtij krahasimi kërkohet të evidentohen divergjencat që këto shtete kanë në lidhje me përgjegjësinë e dëmit të shkaktuar nga të tretët. Studimit në planin krahasues, dëmit jashtë-kontraktor, si edhe përgjegjësisë që mbajnë të tretët i ka ardhur në ndihmë literatura e pasur që kam gjetur në Bibliotekën e MPI-së. Studimi krahasues në këtë punim ka si qëllim arritjen e një interpretimi sa më të mirë të normave të Kodit të Civil, duke iu referuar dhe mendimit doktrinal European.

*Metoda e analizës së praktikës gjyqësore.* Kjo është gjithashtu një metodë mjaft e rëndësishme dhe e spikatur, e cila në radhë të parë shërben për të parë mënyrën e interpretimit, qëndrimin që kanë mbajtur dhe zgjidhjet që kanë dhënë gjykatat shqiptare dhe ato të huaja lidhur me shpërblimin e dëmit jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët. Në këtë kuadër, duke patur parasysh faktin që praktika gjyqësore shqiptare në fushën e dëmit jashtë-kontraktor është akoma shumë e varfër (kam arritur të gjej shumë pak vendime), janë analizuar vendime të gjykatave të huaja, si ato të Gjykatës Italiane të Kasacionit, Gjykatës Franceze të Kasacionit, Gjykatës Kushtetuese Gjermane, Spanjolle, Gjykatës Supreme Angleze etj. Analiza e praktikës së gjykatave të huaja shërben më së shumti për të parë mënyrën e interpretimit edhe zbatimit praktik që i është bërë dëmit jashtë-kontraktor nga këto të fundit, në funksion të një kuptimi sa më të mirë të dispozitave ligjore përkatëse.

## **2.5. Rëndësia e studimit.**

Rëndësia e këtij studimi mendojse qëndron më së shumti në faktin se në vendin tonë nuk ka ende ndonjë praktikë të gjerë dhe të zhvilluar në lidhje me objektin në fjalë. Kjo është edhe arsyeja kryesore e zgjedhjes së kësaj teme doktorature. Nëpërmjet saj kërkohet të pasqyrohet dhe të jepet një kontributi vlefshëm në njohuritë praktike, duke u nisur edhe nga përvojat e vendeve të rajonit mbi përgjegjësinë e dëmit jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët. Ajo gjithashtu mund të ndihmojë në kryerjen e veprimeve të ndërlikuara në rrethana shpeshherë të pavolitshme.

Gjithashtu, në këtë punim bëhet një studim i thelluar i përgjegjësisë së dëmit jashtë-kontraktor nëpërmjet analizave krahasuese, me qëllimin që t'u vijë në ndihmë të gjithë studentëve të Fakultetit të Drejtësisë, Departamentit të së Drejtës Civile, si edhe sistemit të drejtësisë në përgjithësi, kryesisht subjekteve që bëjnë përcaktimin e përgjegjësisë për

dëmin e shkaktuar nga të tretët. Ai do të ndihmojë gjithashtu në kryerjen e vlerësimeve më reale të burimeve të nevojshme, gjë që nuk është bërë më parë nga autorë të tjerë.

Një nga kontributet kryesore të këtij punimi është edhe pasqyrimi i njohurive të sintetizuara mbi dëmin jashtë-kontraktor, të grumbulluara duke iu referuar edhe parashikimeve të bëra nga vendet komunitare.

Pra, mund të them se ky punim paraqet një rëndësi të veçantë studimore.

*Së pari*, ai do të sjellë një kontribut të veçantë në fushën e së Drejtës Civile në Shqipëri, duke qenë se eksploron marrëdhëniet ndërmjet dëmit jashtë-kontraktor dhe përgjegjësisë për të tretët.

*Së dyti*, studimi shërben në njohjen e mëtejshme të përgjegjësisë për këtë lloj dëmi, llojn e përgjegjësisë me apo pa faj, si dhe lidhjen shkakësore mes fajt dhe dëmit të shkaktuar, përcaktimi i së cilës mbart problematika të ndryshme dhe kërkon një vëmendje të veçantë studimore.

*Së treti*, ky punim studimor bashkërendon kërkime dhe gjetje të studiuesve shqiptarë e të huaj në fushën e së Drejtës Civile, në veçanti të detyrimeve jashtë-kontraktore. Një bashkërendim i tillë vë përballë këndvështrime dhe qëndrime alternative, duke dhënë një tablo më të qartë të çështjeve dhe problematikave që rrjedhin nga përgjegjësia që mbartin personat e tretë për dëmin e shkaktuar.

*Së katërti*, nëpërmjet ndërthurjes së aspektit teorik me atë empirik, ky punim studimor paraqet një analizë origjinale të problematikës, duke shërbyer si kontribut në fushën e së Drejtës Civile, dhe si nismë për studime të tjera në të ardhmen.

*Së pesti*, rezultatet e këtij hulumtimi janë të vlefshme sepse bazohen në një analizë empirike të informacionit, të mbledhur përmes metodave të ndryshme shkencore.

*Së gjashti*, ky studim krijon horizonte të reja për studime të mëtejshme në të ardhmen mbi fushën e zgjedhur.

## **2.6. Kontributi i studimit.**

Përveç rëndësisë që mbart kjo punë kërkimore-shkencore, në këtë seksion do të trajtojnë kohësisht edhe kontributet që mendoj se do të sjellë kjo e fundit, duke i parshtruar si më poshtë vijon:

- Hulumtimi, grumbullimi dhe përzgjedhja e literaturave të ndryshme, studimeve, si edhe të kërkimeve të kryera në lidhje me dëmin jashtë-kontraktor, të aplikuar në faza të ndryshme të zhvillimit të shtetit, në Shqipëri dhe në shtetet anëtare të Bashkimit Europian si Italia, Franca, Gjermania, etj.
- Pasurimi i literaturës shqiptare, e cila është shumë e varfër në lidhje me këtë objekt studimi.
- Paraqitja e gjëndjes aktuale të përgjegjësisë për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët, duke bërë të mundur vendosjen e bazave krahasuese për studimet e mëtejshme në lidhje me këtë fushë.

Mendoj që rezultatet e këtij studimi mund të paraqesin interes për:

- Stafin akademik dhe atë studentor: si literaturë apo një mendim plotësues në kuadrin e përmirësimit të kurikulave në lëndët e së Drejtës Civile (veçanërisht në të Drejtën e Detyrimeve dhe Kontratave, si pjesë e posaçme në fushën e së Drejtës Civile).

## **2.7. Kufizimet e studimit**

Cilido që do të përfshihet në një trajtim shkencor të përgjegjësisë për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët, do të ishte i detyruar të trajtonte në mënyrë të përgjithshme, paraprakisht, kuptimin e dëmit jashtë-kontraktor në përgjithësi, si edhe të analizonte në mënyrë të detajuar kuptimin e detyrimeve në përgjithësi sipas parashikimeve në

legjislaionin vendas dhe atë të huaj, si edhe të praktikave gjyqësore, të cilat janë të pakta për shkak të mungesës së rasteve, në vendin tonë.

Me synimin për të mos realizuar një punim tërësisht doktrinor, në mungesë të praktikës gjyqësore shqiptare, i jam referuar edhe rasteve praktike të GJED-së, duke më shërbyer si mjet në funksion të sqarimit të koncepteve dhe aspekteve problematike të përgjegjësisë për dëmin jashtë-kontraktor, duke i dhënë një koncept më të gjërë zgjidhjes së rasteve analoge, si dhe qëndrimeve të mbajtura rast pas rasti.

Në përfundim, studimi ofron konkluzione dhe rekomandime të vlefshme e të dobishme jo vetëm për studiuesit e së drejtës, por ndihmon njëkohësisht për t'i dhënë një shtrirje sa më të gjerë konceptit të përgjegjësisë për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët.

## **2.8. Përcaktimi i termave kyçe**

Gjatë studimit të çështjeve specifike që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e dëmit jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët është e rëndësishme të përcaktohet terminologjia e përdorur. Janë përdorur një sërë termash të cilat janë vënë në qendër të zhvillimit të punimit, terma të cilët kanë edhe një përdorim të gjerë. Për to është e nevojshme të jepet një shpjegim përpara se të vazhdohet me punimin.

*Dëmshpërblim.* Termat “dëmshpërblim,” “kthim i dëmit,” “kthim” dhe “zhdëmtim” shpesh përdoren për koncepte të cilat janë të njëjta ose shumë të afërta, d.m.th., “të ndreqësh

*diçka për dikë për humbjen, dëmtimin, veprimin e padrejtë, veçanërisht nëpërmjet pagesës së përshtatshme.”<sup>1</sup>*

*Dëm material.* “*Dëmi material*” i referohet humbjes financiare ose monetare, p.sh., shpenzimet mjekësore, të shtrimit në spital ose të varrimit, humbja e të ardhurave të pritshme edhe përfitimeve që rrjedhin nga punësimi, pagat e papaguara, si edhe kostot e dëmtimeve ndaj pronës. Përkufizimi dhe fusha e zbatimit të dëmeve materiale në kontekstin kombëtar përcaktohet në legjislacion (ose nëpërmjet precedentëve në vendet *Common Laë* të traditës anglo-saksone) dhe ndryshon nga vendi në vend. Disa mekanizma dëmshpërblimi mundësojnë që të jepet pagesa e të gjitha formave të dëmit material, ndërsa të tjera mundësojnë vetëm kategoritë e kufizuara.

*Dëm mora.* “*Dëmi moral*” u referohet humbjeve të tjera jo-financiare ose jo-monetare p.sh., vuajtjeve emocionale, cënimit të nderit ose emrit të mirë, “*dhimbjes dhe vuajtjes,*” shqetësimit, humbjes së kënaqësisë së jetës, humbjes së shoqërisë edhe të miqësisë. Sërish, përkufizimi edhe fusha e zbatimit të dëmit moral në kontekstin kombëtar përcaktohet në legjislacion (ose nëpërmjet precedentëve në vendet *Common Laë* të traditës anglo-saksone), e cila ndryshon nga vendi në vend. Disa mekanizma dëmshpërblimi lejojnë që të kërkohen të gjitha format e dëmit moral, disa të tjerë lejojnë vetëm llojë të caktuara të dëmit moral, ndërsadisa të tjerë nuk e lejojnë fare paraqitjen e kërkesës në lidhje me dëmin moral.

---

<sup>1</sup>*Përkufizimi i dëmshpërblimit (compensation) në Chambers 21st Century Dictionary (Fjalori Chambers i Shekullit të 21-të), 2004.*



## KAPITULLI III

### HISTORIKU DHE SFONDI LIGJOR I RREGULLIMIT TË PËRGJEGJËSISË JASHTË-KONTRAKTORE TË PERSONAVE TË TRETË

#### 3.1. Aspekti historik i përgjegjësisë civile në periudha të ndryshme kohore

Koncepti dhe interpretimi i përgjegjësisë civile në rastin e shkaktimit të dëmit jashtë-kontraktor nga të tretët ka qenë i njohur që në kohërat e lashta, duke u shfaqur në forma të caktuara gjatë rrjedhës historike. Sa herë që paraqitet fakti i shkaktimit të dëmit jashtë-kontraktor nga të tretët, për subjektin në fjalë, edhe pse në mënyrë indirekte, lind përgjegjësiadhe detyrimi për shpërblimin e tij. Dëmtimi si koncept paraqet dëmin e shkaktuar nga një person ndaj një personi tjetër, apo ndaj pasurisë e tij, qoftë kjo me paramendim në formën e dashjes apo edhe nga pakujdesia, apo nga rrethana aksidentale.<sup>2</sup> Bazuar në “*Parimet Europiane të shkaktimit të dëmit*”, vërejmë se dëmi dhe lidhja shkakësore merren për bazë me rastin e lindjes së përgjegjësisë civile, kurse veprimi i kundërligjshëm nuk përmendet fare.<sup>3</sup>

Rregullat mbi marrëdhëniet detyrimore janë zhvilluar që në kohët e hershme. Ato dallojnë shumë nga rregullat e përgjegjësisë juridiko-civile në të drejtën e sotme Civile, qoftë për nga forma, qoftë për nga përmbajtja dhe mënyra e dëmshpërblimit apo ngarkimit të përgjegjësisë. Në përgjithësi, rregullat e shkaktimit të dëmit, nga karakteri primitiv, konservativ dhe abstrakt që kanë patur, kanë pësuar një zhvillim të dukshëm, duke u përsosur, me qëllim që të jenë sa më të përshtatshme dhe të zbatueshmeduke iu referuar raporteve konkrete në shoqëritë e sotme.

---

<sup>2</sup><http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/damage>

<sup>3</sup>*Principles of European Tort Law*, e hartuar nga “*European Group on Tort Law*”, paraqet përmbledhje të rregullave civile, përmes të cilave synohet që të unifikohet dhe harmonizohet “*E drejta deliktore europiane*”.

Në shoqëritë e hershme mund të themi se nuk kishte një ndarje të qartë në rastin e shkaktimit të dëmit ndërmjet rregullave të përgjegjësive penale dhe asaj civile, pasi për subjektin që shkaktonte dëmin zbatoheshin sanksionet e njëjtë. Nëse i referohemi të drejtave të aplikuara në periudhat e hershme, sidomos asaj antiko-romake, sanksionet që zbatoheshin ndaj shkeljeve ligjore (dëmeve) publike dhe atyre private nuk ishin monopol vetëm i shtetit. Kjo gjë shpjegohet me faktin se "*masa ndëshkuese*" ndaj këtyre dëmeve ndërmerreshin edhe nga vetë personi i dëmtuar apo nga familjarët e tij.<sup>4</sup> Njëkohësisht, me rastin e shkaktimit të dëmit nga ndonjë person, për dëmin e shkaktuar do të përgjigjej jo vetëm ky i fundit, por e gjithë familja, që do të thotë se përgjegjësia për shkaktimin e dëmit në fillim ishte kolektive dhe jo individuale, pra nuk i drejtohej vetëm personit që shkaktonte dëmin.

Kjo gjë ishte tipike kryesisht në shoqëritë ku raportet shoqërore rregulloheshin përmes zakoneve, ku zhdëmtimi për kryerjen e ndonjë padrejtësie konsiderohej më tepër një çështje që i përkiste së drejtës zakonore.

Në Babiloninë e hershme, sipas ligjit të Hamurabit, autorit të një veprimi të kundërligjshëm duhet t'i shkaktohesh po ai dëm dhe po ajo plagë siç i ishte shkaktuar viktimës (parimi i Talionit "*Sy për sy e dhëmb për dhëmb*")<sup>5</sup>. Edhe rregullat e hershme të hebrenjve bazoheshin në parimin "*një sy për një sy*", rregull i cili është nxjerrë nga fragmentet e Biblës hebraike. Sipas kësaj rregulle: në qoftë se një person i lëndon syrin tjetrit, si dënim edhe këtij do t'i dëmtohej syri. I njëjti parim zbatohesh edhe me rastin e aplikimit të sanksioneve në marrëdhëniet civile që krijoheshin nga shkaktimi i dëmit.

Në të drejtën Romake në rastin e shkaktimit të dëmit civil, për shkaktuesin lindte detyrimi i shpërblimit të dëmit apo shpërblimit të shumëfishtë. Megjithatë, kompensimi në shoqërinë e lashtë romake nuk ka patur qëllimin e shpërblimit të dëmit, por qëllimin për

---

<sup>4</sup> Vukovic, M. (1971) "*Përgjegjësia Për Dëmin*", Zagreb, fq 42.

<sup>5</sup> Olldashi, E. (2011) "*E drejta Romake*", Mediaprint, Tiranë, fq 241.

pajtim të palës dëmtuese me palën e dëmtuar, me qëllim që kjo e fundit të mos hakmerrej ndaj të parës. Romakët përpara nxjerrjes së ligjit të XII tabelave, çështjen e shpërblimit të dëmit e rregullonin në bazë të rregullave zakonore, sipas të cilave pala e dëmtuar fitonte të drejtën e hakmarrjes ndaj shkaktuesit të dëmit, apo anëtarëve të familjes së tij.

Në të drejtën Romake, ishte gjithashtu i njohur edhe institucioni i skllavërisë debitoare, sipas të cilit personat të cilët kishin ndonjë detyrim civil dhe ishin në pamundësi që të shlyenin borxhin apo përmbushnin detyrimin, duhej që, ose vullnetarisht, ose duke të detyruar nga një vendim gjykate, borxhin ta shlyenin duke punuar tek kreditori. Ky sanksion edhe pse kishte për qëllim shlyerjen e borxhit, megjithatë kishte edhe efekte të ndërkohshme personal, pasi personiqë mbarte borxhin ishte njëkohësisht me status të skllavit, dhe gjatë gjithë kësaj periudhe i humbiste dhe të drejtat civile që i gëzonte si qytetar romak, deri në momentin e shlyerjes së detyrimit.

Më vonë me zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve shoqërore dhe ekonomike, romakët meqë krijonin tepriçë të përhershme të prodhimeve, kërkonin që t'i iknin rrezikut të hakmarrjes duke insistuar në kompensimin e dëmit me ndonjë lloj tjetër shpërblimi me vlerë pasurore në dobi të palës së dëmtuar. Kjo bëhej pasi rregullat e shpërblimit të dëmit kishin edhe karakter ndëshkues. Si rezultat i kësaj lindën marrëveshjet për pajtim në formën e kontratave, marrëveshjeve të cilat bëheshin ndërmjet anëtarëve të grupit/familjes që kishte shkaktuar dëmin dhe anëtarëve të grupit/familjes të personit të dëmtuar, ku në bazë të këtyre të fundit anëtarët e familjes së personit të dëmtuar merrnin përsipër që të tërhiqeshin nga e drejta për hakmarrje, apo ndërkohë trupore ndaj personit që kishte shkaktuar dëmin kundrejt shpërblimit që do të merrnin nga anëtarët e grupit/familjes të këtij të fundit. Marrëveshjet e kësaj lloji ishin me natyrë fakultative, duke qenë se liheshin në vullnetin e palëve,

veçanërisht në atë të palëssë dëmtuar nëse do të ishte dakord të hiqte dorë nga e drejta për hakmarrje.<sup>6</sup>

Duke hedhur një vështrim në rregullat e mëvonshme mbi shkaktimin e dëmit, vëmë re gjithmonë e më shumë një tendencë për të përjashtuar nga parashikimet e tyre frymëne parimit të Talionit dhe zëvendësimine tij me detyrimin për shpërblim në të holla. Kështu, sipas ndarjeve që bëri *Gaius* në institucionet e tij, si veprime të paligjshme që kishin për pasojë shpërblimin e dëmit civil mbetën katër: *injuria* (paraqiste çdo cënim të vlerave materiale dhe personale të personit tjetër, duke mos patur kurrëfarë dobie materiale për shkaktuesin e dëmit), *furtum* (vjedhja), *rapina* (grabitja) dhe *damnum injuria datum* (përfshinte dëmtimin e pasurisë së huaj pa përfitime personale për shkaktuesin e dëmit).<sup>7</sup>

Në periudhën postklasike, Justiniani, përveç detyrimeve kontraktore, njohu edhe detyrimet që buronin nga deliktet, kuazideliktet dhe kuazikontratat. Dallimi ndërmjet delikteve edhe kuazidelikteve qëndronte në faktinse deliktet nuk ekzistonin pa ardhjen e pasojës së dëmshme, kurse kuazideliktet ekzistonin dhe pa shfaqjen e pasojës.<sup>8</sup> Delikti nuk ekzistonte në qoftë se shkaktuesi i dëmit nuk ishte fajtor apo nuk ishte përgjegjës i drejtëpërdrejtë i shkaktimit të dëmit (*animus nocendi*), me faj në formën e dashjes direkte, ndërsa kuazidelikti ekzistonte edhe pa fajin e kryerësit. Kurse, me rastin e nxjerrjes së *Lex Aquilia* u abroguan të gjitha dispozitat e mëhershme për shpërblimin e dëmit, dhe të gjitha rastet e kompensimit të dëmit jashtë-kontraktor ishin të parashtruara në tre kapituj. Në *Kapitullin e Parë* parashikohej që: nëse dikush në mënyrë të padrejtë vriste skllavin e huaj apo kafshën katërkëmbëshe, ishte i detyruar që të shpërblente dëmin në vlerën më të lartë që këto të fundit kishin patur gjatë vitit të fundit. Në *Kapitullin e Dytë* parashikohej dënimi për dorëzanin, i cili kishte mashtruar dhe nuk përmbushte detyrimin ndaj kreditorit kryesor. Në

---

<sup>6</sup> *Po aty*, fq 95.

<sup>7</sup> *Hetemi, M. (1998) "Detyrimet dhe kontratat", Tiranë, fq 8.*

<sup>8</sup> *Reinhard, Z. (1996) "The law of obligations: Roman Foundations of the Civilian Tradition", Published in the United States by Oxford University Press Inc, New York, pg 245.*

*Kapitullin e Tretë* parashikohet që: ai, i cili në çfarëdolloj mënyre, të padrejtë, plagostesklavin apo kafshën, respektivisht zhdukte apo dëmtonte ndonjë send të huaj, ishte i detyruar ta shpërblentedëmin në çmimin më të lartë, që ka patur sendi në tridhjetë ditët e fundit.<sup>9</sup>

Shtirija dhe zgjerimi i *Lex Aquilia* (Ligji i parë i shkruar për kompensimin për pronarët e dëmtuar me faj të dikujt në Shek. III p.e.s) me përfshirjen në të edhe të më shumë rasteve, u bë gjatë interpretimit që bënin pretorët me rastin e aplikimit të dispozitave të saj. Sa i përket dëmit që shkaktohet nga kafshët, romakët përdornin termin e posaçëm: *pauperies*. Kjo vlente kryesisht për dëmin që shkaktonin kafshët shtëpiake katërkëmbëshe (quadrupes).

E drejta Civile bashkëkohore është shkëputur qartazi nga ndikimi i parimit të Talionit në parashikimet e saj. Ky fakt reflektohet në faktin se sot në rastin e shkakimit të një dëmi civil apo mospërbushjes së kontratës, shkakuesi i dëmit kurrsesi nuk mund t'iu nënshtrohet ndëshkimeve fizike apo privimit të lirisë. Edhe neni 11 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike thotë shprehimisht që “*askush nuk mund të burgoset për të vetmen arsye se nuk është në gjendje të shlyejë një detyrim që rrjedh nga kontrata*”.<sup>10</sup>

Në bazë të interpretimit të dispozitave të këtij pakti por shihet qartë se detyrimi për shpërblim të dëmit nuk ka për qëllim hakmarrjen ndaj shkaktesit të dëmit apo sanksionimin penal të tij, por vetëm ngarkimin e tij me përgjegjësi civile, gjë e cila nënkupton kompensimin material në masën e vlerave të dëmtuara. Njëkohësishtnëse hedhim sytë nga legjislacionet bashkëkohore, vërejmë se sot në pjesën më të madhe të tyre sanksionipër shkelje të një detyrimi civil nuk drejtohet kundrejt personalitetit të personit që e shkakton atë, por vetëm kundrejt pasurisë së tij.

---

<sup>9</sup> Po aty fq 250.

<sup>10</sup> Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i miratuar dhe i hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 2200 A (XXI), të datës 16 dhjetor, 1966, ka hyrë në fuqi më 23 mars, 1976.

### 3.2. Kodi Civil i vitit 1929

Vështrimin historik të Institutit të Shkaktimit të Dëmit dhe Mbajtjes së Përgjegjësisë nga Personat e Tretë do ta kufizojmë shtrirje, duke e trajtuar në mënyrë të përgjithshme, që prej krijimit të shtetit të ri shqiptar në vitin 1912 deri në vitin 1994, vit në të cilin hyri në fuqi Kodi Civil aktual.

Në fillim të vitit 1912 rregullimet ligjore, midis të cilave e drejta e Detyrimeve në përgjithësi dhe përgjegjësia që rrjedh nga shkaktimi i dëmit në veçanti, ishin të organizuara nën Kodin Civil Otoman (Mexheleja). Gjendja e legjislacionit asokohe ishte në kontradiktë të fortë me zhvillimet shoqërore, situatë kjo që, në vitin 1929 solli domosdoshmërisht edhe hartimin dhe miratimin e një Kodi Civil tëvetë shtetit shqiptar.<sup>11</sup> Hartimi i tij u bë nën frymën moderne të së drejtës civile franceze dhe asaj italiane.

Kodi Civil i vitit 1929 i rregullon detyrimet juridiko-civile në Titullin e Dytë të librit të Katërt të tij. Në të parashikohen si burime të detyrimeve juridiko-civile: kontrata, premtimi i njëanshëm, gjerimi i punëve, pagimi i padetyruar, begatimi pa shkak, si dhe veprimet e paligjshme.

Në nenin 1149/l të Kodit Civil jepet kuptimi i përgjegjësisë që rrjedh nga veprimet e paligjshme, duke iu referuar elementëve të domosdoshëm përngarkimin me përgjegjësi civile jashtë-kontraktore, të cilat janë: dëmi, faji dhe lidhja shkakësore. Sipas tij “*çdo faj që i shkakton tjetrit një dam, obligon damtuesin me shpërblye këtë.*”<sup>12</sup>

Dallohet qartë që Kodi Civil në fjalë parashikon si bazë të përgjegjësisë që rrjedh nga veprimet e paligjshme, fajin e autorit të dëmit. Faji duhet të provohet nga i dëmtuari. Në

---

<sup>11</sup> Kodi Civil, viti 1929.

<sup>12</sup> Neni 1149/l i Kodit Civil, viti 1929.

rast se ky i fundit nuk është në gjendje të provojë se personi që ka shkaktuar dëmin ka vepruar me faj, atëherë ai nuk mund të pretendojë shpërblimin e tij.<sup>13</sup>

Përveç parimit të përgjithshëm sipas të cilit dëmi i shkaktuar duhej shpërblyer, Kodi Civil parashikonte gjithashtu edhe rastet e kufizimit të kësaj përgjegjësie apo përjashtimit prej saj.

### **3.3. Ligji Nr. 2359, Datë 15. 11. 1956 “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”**

Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore dhe me vendosjen në Shqipëri të një pushteti tërësisht të centralizuar, legjislacioni mori një tjetër drejtim. Mungesa e ekonomisë së tregut, mungesa e pronës private dhe krijimi i një ekonomie të centralizuar ndikuan drejtpërdrejt në zhvillimin e sferës ekonomike dhe sociale të vendit. Marrëdhëniet juridiko-civile të kohës rregulloheshin nga ligji Nr. 2359, Datë 15.11.1956 “Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”<sup>14</sup>. Për shkak të aspektit të kufizuar të punimit do të bëjmë në mënyrë të përmbledhur një analizë të këtij ligji vetëm përsa i përket pjesës së shpërblimit të dëmit nga personat e tretë. Në ligjin “Mbi veprimet dhe detyrimet juridike” përveç të tjerash, është parashikuar në veçantë shpërblimi i dëmit në rastin e shkaktimit të vdekjes, plagosjes, në rastin e cenimit të nderit e dinjitetit të një personi apo familjes së tij, në rastin e dhunimit të një personi apo banesës së tij, si dhe në rastin e cenimit të jetës private.

Për herë të parë në legjislacionin material parashikoheshin rastet e shpërblimit të dëmit moral, siç ishte dëmi i shkaktuar si pasojë e vuajtjeve shpirtërore të ardhura nga vdekja e një personi të afërt.

Ligji Nr.2359, Datë 15.11.1956 “Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet” ishte një përpjekje për të bërë plotësimin e legjislacionit me norma të reja, që i përkisnin një regjimi të ndryshëm politik dhe ekonomik. Ky ligj veproi deri në vitin 1981, kur edhe doli Kodi Civil, i

---

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Ligji është botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Popullore të Shqipërisë, nr. 1, datë 10 Janar 1957.

cili përmbloodhi në parashikimet e tij edhe pjesën e përgjithshme të rregullimit të marrëdhënieve juridiko-civile.<sup>15</sup>

Në nenin 472 të ligjit specifikohet parimi i përgjegjësisë që rrjedh nga shkaktimi i dëmit: *“Personi që me faj (me dashje ose nga pakujdesia) i shkakton dëm në mënyrë të paligjshme, një tjetri në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.”*

Elementet e përgjegjësisë që rrjedh nga shkaktimi i dëmit dhe baza e përgjegjësisë civile dallohen në ekzistencën e dëmit, paligjshmërinë e veprimit, lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit dhe pasojës së ardhur, si dhe fajin e autorit të dëmit, që përbën dhe bazën e kësaj përgjegjësie.

Kusht i domosdoshëm për lindjen e përgjegjësisë civile sipas ligjit *“Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”* është ekzistenca e dëmit. Me dëm në përgjithësi, kuptohet si dëmi material, ashtu edhe dëmi jo-material. Dëmi material, i cili shkakton pakësimin e të mirave të të dëmtuarit, mund të shpërblehet në të holla. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për dëmin jo-material, siç mund të jetë dëmi që i shkaktohet personit në jetën, shëndetin, nderin dhe dinjitetin e tij, i cili sipas ligjit *“Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”* nuk mund të vlerësohet në të holla.<sup>16</sup>

Për këtë arsye ligji *“Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”* nuk pranon shpërblimin e dëmit jo-material, apo si quhet ndryshe të dëmit moral. Në rast se është shkaktuar një dëm me natyrë jo-materiale, siç mund të jetë shkaktimi i vdekjes së një personi, do të shpërblehen vetëm dëmet pasurore që mund të jenë shkaktuar, dhe jo ato të një lloji tjetër.

Në detyrimet që lindnin nga shkaktimi i dëmit, siç parashikohet dhe në nenin 472 të ligjit, në dallim me Kodin Civil të vitit 1929, pranohet prezumimi i fajësisë.<sup>17</sup> Kjo është

---

<sup>15</sup>Ligji Nr.2359, datë 15.11.1956 *“Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”*.

<sup>16</sup>Sallabanda, A. (1962) *“E drejta e detyrimeve”*, Tiranë, fq 82.

<sup>17</sup>Kodi Civil i vitit 1929, dispozitat mbi detyrimet.



rrjedhojë e drejtpërdrejtë e pranimit të fajësisë si element i domosdoshëm i përgjegjësisë. I dëmtuari nuk është i detyruar të vërtetojë fajësinë e autorit të dëmit, për arsye se ky i fundit prezumohet fajtor. Paragrafi i II-të i dispozitës së mësipërme parashikon se, personi i cili ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Kjo do të thotë që barra e provës bie mbi autorin e dëmit, të cilit i takon të vërtetojë se nuk ka patur faj në ardhjen e këtij dëmi.<sup>18</sup>

Ashtu sikurse ndodhte me legjislacionin e mëparshëm, edhe në ligjin “*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*” parashikohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga të miturit nën dhe mbi 14 vjeç. Këtu parashikohet gjithashtu edhe përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga personi pa zotësi për të vepruar, apo përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga organet e një personi juridik, nga nëpunësit dhe nga punëtorët.

Ndërkohë, përgjegjësia e personit juridik shtetëror për dëmin e shkaktuar nga personat zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave të administrimit shtetëror, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga një veprimtari që përbën burim rreziku të shtuar, apo përgjegjësia solidare kanë gjetur një trajtim fillestar në këtë ligj.<sup>19</sup>

Në nenin 484 të ligjit “*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*” parashikohet **shpërblimi i dëmit** me këtë rregullim: “*Për shpërblimin e dëmit, gjykata sipas rrethanave të çështjes, mund të vendosë detyrimin e personit që ka shkaktuar dëmin ose me ekzekutimin në natyrë ose me shpërblimin e humbjeve, duke përfshirë në këtë, kur është rasti, edhe fitimin e munguar*”.<sup>20</sup>

Pra, sipas rregullimit ligjor të sipërcituar shpërblimi i dëmit përbëhet nga humbjet dhe fitimi i munguar, duke zbatuar parimin e shpërblimit të plotë të dëmit. Megjithatë, në nenin 486/1 të ligjit “*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*” parashikohet një përjashtim nga ky parim. Ky ka të bëjë me faktin se masa e shpërblimit të dëmit do të caktohet duke

<sup>18</sup> Neni 472 i Ligjit Nr.2359, datë 15.11.1956 “*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*”.

<sup>19</sup> Sallabanda, A. (1962) “*E drejta e detyrimeve*”, Tiranë, fq 88.

<sup>20</sup> Neni 484 i Ligjit Nr.2359, datë 15.11.1956 “*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*”.

mbajturparasysh gjendjen pasurore të të dëmtuarit dhe atë të autorit të dëmit. Por edhe nga ky përjashtim, ka një përjashtim tjetër, i cili ka të bëjë me rastin kur i dëmtuari është një organizatë shtetërore, kooperativiste ose shoqërore.<sup>21</sup>

Ndërkohë, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në rastin e vdekjes, apo të dëmtimit të shëndetit të një personi gjen rregullim në nenin 490 të ligjit “*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*”, në të cilin parashikohet shprehimisht se, në rastin kur personi i dëmtuar përfiton nga sigurimet shoqërore, atëherë dëmi do të shpërblehet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ndërsa, kur i dëmtuari nuk e ka përfituar të gjithë shpërblimin nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ky i fundit ka të drejtë që të kërkojë nga personi përgjegjës dëmin pjesën e mbetur të pa dëmshpërblyer. Nga ana tjetër, edhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore shtetërore ka të drejtë të kërkojë nga autori i dëmit kthimin e asaj çka ky institut i ka paguar të dëmtuarit.<sup>22</sup>

Në rastin e shkaktimit të vdekjes, neni 489 i ligjit mbi “*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*” ka parashikuar personat të cilët kanë të drejtë të kërkojnë shpërblimin e dëmit. Aty thuhet: “*Kur shkaktohet vdekja, shpërblehet dëmi që kanë pësuar personat e mitur dhe të paaftë për punë, të cilët kanë qenë në ngarkim të të vdekurit plotësisht ose pjesërisht, si dhe personat që kishin të drejtën e ushqimit prej tij.*”<sup>23</sup>

Nga sa më lart rezulton se kusht për t’u dëmshpërblyer personat e mitur dhe të paaftë për punë, është të qënurit e tyre në ngarkim të të vdekurit në kohën e vdekjes. Ndërsa, personat që gëzonin të drejtën e ushqimit nga i vdekuri, kanë të drejtën e shpërblimit për dëmin e pësuar, pavarësisht nga fakti nëse ata kanë qenë apo jo në ngarkim të të vdekurit si kujdestar ligjor.

---

<sup>21</sup> Neni 486/1 i Ligjit Nr.2359, datë 15.11.1956 “*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*”.

<sup>22</sup> Neni 490 i Ligjit Nr.2359, datë 15.11.1956 “*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*”.

<sup>23</sup> Neni 489 i Ligjit Nr.2359, datë 15.11.1956 “*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*”.

Ligji “Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet” parashikon dhe përgjegjësinë në rastin e dëmtimit të shëndetit të një personi. Dëmet që mund të vijnë janë ato që kanë të bëjnë me shpenzimet për mjekim, dhe të tjera të shkaktuara nga humbja ose pakësimi i aftësisë për punët e personit të dëmtuar. Shpërblimi i dëmit, i caktuar si pasojë e pakësimit të aftësisë për punë mund të ndryshojë në çdo kohë, mbi bazën e kërkesës së të dëmtuarit, për shkak të ndryshimit të rrethanave shëndetësore, si rezultat i përmirësimit apo keqësimit të gjendjes shëndetësore të këtij të fundit.

Pas shkaktimit në mënyrë të paligjshme të një dëmi, personi i dëmtuar legjitimohet të ngrejë **padi për shpërblimin e këtij dëmi**. Ligji parashikon rregullin e përgjithshëm se parashkrimi i padisë fillon nga çasti që lind e drejta për ta ngritur atë. Kurse për detyrimet që ekzekutohen me kërkesën e kreditorit, parashkrimi fillon që kur lind detyrimi.

Në ndryshim nga ky rregull i përgjithshëm, afati i parashkrimit të padisë që rrjedh nga shkaktimi i dëmit, fillon nga dita që i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin dhe për autorin e tij. Pra, fillimi i afatit lidhet kështu, me marrjen dijeni për dëmin e shkaktuar dhe për identitetin e subjektit që e ka shkaktuar.<sup>24</sup>

### **3.4. Kodi Civil i vitit 1982**

Kodi Civil i cili u hartua dhe miratua në vitin 1981, por hyri në fuqi me 1 janar 1982, përbën aktin e parë të unifikuar që rregullon të gjitha marrëdhëniet juridiko-civile të kohës.<sup>25</sup> Fryma e këtij Kodi pasqyrohet qysh në nenet e para të tij, të cilat përcaktojnë parimet bazë të

---

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Me hyrjen e tij në fuqi, ky Kod shfuqizoi ligjin nr. 2022, datë 2.4.1955 “Mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Civil”; ligjin nr. 2023, datë 2.4.1955 “Mbi zbatimin e ligjit mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Civil”; ligjin nr. 2359, datë 15.11.1956 “Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”; ligjin nr. 2360, datë 15.11.1956 “Mbi zbatimin e ligjit mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”; ligjin nr. 4408, datë 3.10.1969 “Mbi të drejtën e autorit” dhe një sërë dekretesh që rregullonin pronësinë, trashëgiminë apo shpikjet dhe racionalizimet. Ajo që të bie në sy është se çdo ligj ose dekret shoqërohet nga një akt me të njëjtën fuqi juridike, që synon të rregullojë zbatimin e tij.

legjislacionit civil të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Ky akt rregullon marrëdhëniet pasurore dhe ato personale jopasurore ndërmjet ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave bujqësore, organizatave shoqërore, midis tyre dhe shtetasve, si dhe ndërmjet vetë shtetasve. Parimi i bazë i rregullimit të këtyre marrëdhënieve është parimi i centralizimit demokratik, mungesa e klasës shfrytëzuese dhe zhdukja e pronës private.<sup>26</sup>

Baza e të gjithë rendit ekonomik dhe shoqëror është prona socialiste. Të gjitha figurat e përgjegjësive sidomos për dëmin jashtë-kontaktor janë të rregulluara mbi bazën e këtyre parimeve.

### **3.5. Elementët e marrëdhënies së shkaktimit të dëmit jashtë-kontraktor**

#### *3.5.1. Shkaktimi i dëmit*

Ardhja e dëmit është kushti më me rëndësi për lindjen e detyrimeve nga shkaktimi i këtij të fundit. Ai përbën elementin themelor për përcaktimin dhe për krijimin e përgjegjësisë juridiko-civile, sepse prej tij rrjedhin të gjitha kushtet e tjera që kanë të bëjnë me këtë përgjegjësi. Shkaktimi i dëmit, si element apo fakt juridik, paraqet një rrethanë të caktuar, e cila mund të çojë deri tek krijimi, ndryshimi apo ndërprerja e marrëdhënies së detyrimeve, sipas rastit.

Termi "*dëm*" përdoret si për të treguar dëmin që i shkaktohet pasurisë, ashtuedhe për të treguar dëmin që mund t'u shkaktohet personave nëshëndet, dinjitet, apo nderin e tyre.<sup>27</sup>Dëmi paraqitet si fakt juridik dhe njëkohësisht si një kusht kryesor për lindjen e marrëdhënies detyrimore. Përmenda se dëmi në radhë të parë paraqet humbjen e masës

---

<sup>26</sup> E vetmja pronësi që i njihej subjekteve të asaj kohe është pronësia vetjake, e cila rregullohet në nenet 77 – 79.

<sup>27</sup>Sallabanda, A. (1961) "E drejta e detyrimeve", Tiranë, fq.301.

pasurore të të dëmtuarit. Që të konsiderohet i dëmshëm veprimi i një subjekti të caktuar, nuk mjafton të ndodhë vetëm cënimi i së drejtës, por njëkohësisht duhet të cënohet edhe ndonjë e mirë materiale apo personale nga veprimi i këtij të fundit. Nga ana tjetër, edhe pakësimi i vlerës së sendeve mbi të cilat, personi i dëmtuar ende nuk gëzon ndonjë të drejtë, por paraqesin interes për t'u mbrojtur me ligj, përbën dëm. Kuptimin e dëmit e gjejmë të përkufizuar edhe në shumë legjislacione civile të huaja. Sipas Kodit Civil Francez neni 372/1: "*Dëmi është zvogëlim i pasurisë së personit (dëm real), pengim i rritjes së saj (fitim i munguar), si edhe shkaktimi i ndonjë dhimbjeje fizike apo shpirtërore apo frike (dëm jomaterial)*".<sup>28</sup> Nga ky përkufizim dalin dy kuptime për dëmin: kuptimi ekonomik dhe kuptimi juridik. Në kuptimin ekonomik, me "dëm" kuptohet humbja e pasurisë, pavarësisht nga rrethanat që kanë çuar tek kjo humbje, ndërsa në kuptimin juridik, me "dëm" kuptohet humbja e ndonjë të drejte subjektive apo ndonjë interesi juridik të mbrojtura nga legjislacioni në fuqi. Pra, në të dyja kuptimet bëhet fjalë për humbje. Humbja mund të qëndrojë në pakësimin e një vlere materiale që bën pjesë në pasurinë e një personi, dhe ky quhet dëm pozitiv.<sup>29</sup> Humbja mund të qëndrojë, gjithashtu, dhe në mosrealizimin nga ana e të dëmtuarit të një interesi pasuror, të cilin do të mund ta realizonte sikur të mos ishte kryer veprimi i kundërligjshëm nga shkaktuesi i dëmit, dhe kjo paraqet fitimin e munguar. Po të njëjtat koncepte lidhur me "*humbjen*", por me emërtime të tjera, i gjejmë të trajtuara edhe në veprat e autorëve të tjerë.<sup>30</sup>

Dëmi, si kusht i përgjithshëm, është në marrëdhënie korrelative me veprimin e dëmshëm, pasi në marrëdhënien detyrimore si shkak paraqitet veprimi i dëmshëm, kurse fakti i dëmit paraqitet si pasojë e ardhur prej tij. Pala e dëmtuar, që nga momenti i shkaktimit të

---

<sup>28</sup> Neni 372/1 I Kodit Civil Francez.

<sup>29</sup> Sallabanda, A. (1961) "E drejta e detyrimeve", Tiranë, fq. 302.

<sup>30</sup> Pop Georgiev, D. (1985) "E drejta e detyrimeve", Shkup, fq. 42.

dëmit, fiton të drejtën e shpërblimit nga pala dëmtuese, si pasojë eshkeljessë një të drejte subjektive. Ndërsa, autori i dëmit ëshë pala mbi të cilën rëndon detyrimi për zhdëmtim.

### 3.5.2. *Veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm*

Akti i paligjshëm nënkupton veprimin ose mosveprimin që është kryer në kundërshtim me rendin juridik ose zakonet e mira, prej të cilit është shkaktuar një dëm. Kjo rrjedh në bazë të nenit 608/1 sipas të cilit: *“Personi që në mënyrë të paligjshmedhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.”* Apo neni 608/2 Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. *“Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira”*<sup>31</sup>

Akti i paligjshëm, pra, konsiston në kryerjen e një *veprimi* ose *mosveprimi* që bie ndesh me rendin juridik ose me zakonet e mira. (Nuk janë të pakta rastet kur dëmi mund të shkaktohet edhe si rezultat i mosveprimeve. Për ta ilustruar këtë po sjell një shembull konkret: Gjykata Italiane e Kasacionit në bazë të vendimit Nr. 7713 të vitit 2000 ka arritur në konkluzionin se “sjellja e babait, që konsistonte në mosveprimin dhe neglizhencëne këtij të fundit, kishte shkaktuar një dëm ekzistencial në të drejtat dhe jetëne fëmijës së mitur.)<sup>32</sup> Veprimi ose mosveprimi i paligjshëm përbën një akt të vullnetshëm dhe të vetëdijshëm tëpersonit. Paligjshmëria është një kategori objektive.<sup>33</sup> Mosnjohja e ligjeve nga një person, i cili kryen një veprim që vjen në kundërshtim me këto të fundit, nuk e përjashton atë nga përgjegjësia civile.Kodi Civil ka sanksionuar *“shkeljen ose cënimin e interesave dhe të*

---

<sup>31</sup> Neni 608/1 dhe neni 608/2 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërise.

<sup>32</sup> Vendimi Nr. 7713 të vitit 2000 Gjykata e Kasacionit Itali.

<sup>33</sup> Semini, M. (1998) *“E drejta e detyrimeve dhe e kontratave”*, pjesa e përgjithshme, Tiranë, fq 135.

*drejtave që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira*” duke mos kufizuar në këtë mënyrë përgjegjësinë civile vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.

*Kuptimi i veprimit të kundërligjshëm.* Veprimi i kundërligjshëm paraqet kushtin e domosdoshëm për lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile. Veprimi i kundërligjshëm do të konsiderohet ai veprim apo mosveprim i individit, me anë të të cilit çënohen normat juridike të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni apo rregullat e moralit, në një shoqëri të caktuar<sup>34</sup>. Nga një veprim apo mosveprim i kundërligjshëm mund të çënohen interesat enjë karakteri material, ashtu edhe interesat enjë karakteri personal, dhe kjo mund të ndodhë si te personat fizikë, ashtu edhe tek ata juridikë. Pra, veprim i kundërligjshëm do të konsiderohet ai veprim i individit që është në kundërshtim me të drejtën e mbrojtur nga ligji, që rrjedhimisht përbën një veprim të ndaluar për t’u kryer, për shkakun se prej tij personave të tjerë në komunikimin juridik mund t’iu shkaktohet dëm. Njëkohësisht për dëmin e shkaktuar parashikohet sanksioni përkatës për zhdëmtimin e palës së dëmtuar. Nuk është domosdoshmërisht e përcaktuar se ky ndalim duhet të jetë patjetër penalo-juridik dhe përgjithësisht publiko- juridik, mjafton që të jetë një veprim apo mosveprimi ndaluar qoftë edhe vetëm nga pikëpamja e së drejtës Civile, në qoftë se me këtë të fundit mund të arrihet në shkaktimin e një dëmi apo rritjen e pasojave të një dëmi të shkaktuar më parë.<sup>35</sup>

Gjatë marrëveshjeve apo veprimeve juridike, si dhe komunikimit ndërmjet subjekteve, këto të fundit janë të detyruara që të mos kryejnë veprime të kundërligjshme, prej të cilave subjektetve të tjera u shkaktohet një dëm i caktuar, pasi kryerja veprimeve të tilla nënkupton rrjedhimisht shkeljen e dispozitave ligjore dhe logjikisht secili është i detyruar që të përmbahet nga këto veprime.

Kjo nënkupton dhe detyron në vetëvepersoninqë të përmbahet dhe të mos ndërmarrë veprime aktive, por njëkohësisht të përmbahet edhe nga qëndrimi pasiv (mosveprimi) sipas

---

<sup>34</sup> Nuni, A., Mustafaj, I., Vokshi, A. (2008) “E drejta e detyrimeve I”, Tiranë, fq.100.

<sup>35</sup> Vukovic, M. (1971) “Përgjegjësia Për Dëmin”, Zagrep, fq.29.

rastit, nëqoftëse me këtë mosveprim mund të kontribuojë në shkaktimin e një dëmi apo rritjen e pasojave të një dëmitë shkaktuar më parë.

Disa autorë i përfshijnë në të njëjtin kusht edhe fajin, edhe veprimin e kundërligjshëm, duke e llogaritur fajin si pjesë përbërëse të kundërligjshmërisë. Sipas doktrinës juridike, saherë që personi kryen një veprim të kundërligjshëm ai konsiderohet gjithmonë si i kryer me faj. Kështu që, sipas tyre, nuk ka nevojë që këto dy elemente të trajtohen si dy kushte të veçanta, pasi i kundërligjshëm konsiderohet vetëm ai veprim që mund t'i përshkruhet fajit të dëmtuesit.<sup>36</sup> Disa autorë të tjerë mendojnë se duhet të ndahet elementi faj nga kundërligjshmëria, si dy kushte të posaçme për lindjen e përgjegjësisë deliktore. Kjo për faktin se në praktikë mund të ndodhë që një individ të ketë kryer një veprim anti-juridik, por nuk do të thotë që domosdoshmërisht të jetë me faj.<sup>37</sup>

Faj është një nga elementet e rëndësishëm në cilësimin ligjor të përgjegjshmërisë dhe riparimin e dëmit.<sup>38</sup>

Veprim të kundërligjshëm kemi edhe në ato raste kur një person gjatë drejtimit të automjetit futet në një drejtim të ndaluar, por nuk shkakton ndonjë aksident me pasoja. Për këtë veprim, edhe pse kemi shkelje të të drejtës objektive apo të normave juridike, për personin në fjalë do të lindëpërgjegjësia administrative për kundërvajtje, por jo edhe përgjegjësia deliktore për shpërblimin e dëmit.

Sikurse në shkencën e së drejtës Krahasuese, edhe në të drejtën tonë, dallohen pikëpamje të ndryshme përsa i përket kuptimit të veprimit anti-juridik. Të gjitha pikëpamjet për veprimin e kundërligjshëm ndahen në dy teori të mëdha:

- në teorinë objektive të kundërligjshmërisë dhe

---

<sup>36</sup>Sallabanda, A. (1962) "E Drejta e Detyrimeve", pjesa e përgjithshme, Tiranë, fq. 81.

<sup>37</sup>Ponzanelli, G. (2009) "Danno e Responsabilità", Casa editrice IPSOA., Roma, fq. 194.

<sup>38</sup>A factual assesement of the draft common frame of reference Edited by Luisa Antonioll Franceska fiorentini Prepared by the Common core evaluation group 'Legally Relevant Damage' and a Priori Limits to Non-Contractual Liability in the DCFR pp 27.



- në teorinë subjektive të kundërligjshmërisë.<sup>39</sup>

Sipas teorisë objektive, si veprim i kundërligjshëm do të kuptohet ai veprim që është në kundërshtim me normat juridike të rendit pozitiv. Kjo teori nuk merr për bazë sjelljen apo gjendjen e brendshme shpirtërore të autorit të shkaktuesit të dëmit, por ajo bazohet vetëm me faktin e shkeljes së normës juridike. Po sipas kësaj teorie, që të cilësohet veprimi si i kundërligjshëm, mjafton që veprimi i personit të jetë në kundërshtim me dispozitat dhe normat juridike të së drejtës objektive. Sa herë që kemi shkeljen e ndonjë norme apo akti juridik, në fakt kemi për pasojë edhe shkeljen e ndonjë të drejte subjektive apo ndonjë interesi tjetër të mbrojtur juridikisht.

Sipas teorisë subjektive, veprim i kundërligjshëm është ai veprim i individitit me të cilin subjektit të caktuar i cënohet ndonjë e drejtë materiale apo jomateriale, apo i cënohet ndonjë interes tjetër i mbrojtur nga normat e së drejtës, me fajin e shkaktuesit të dëmit. Sipas kësaj teorie faji paraqitet si një element i anës subjektive, pjesë përbërëse e veprimit të kundërligjshëm. Pikërisht, në bazë të kësaj teorie ngatërrohet veprimi i kundërligjshëm me fajin si kategori subjektive.<sup>40</sup> Por, veprimi i kundërligjshëm është veprim i jashtëm, që shfaqet duke cënuar marrëdhëniet juridike, kurse faji si fenomen psikik, është kategori e brendshme, subjektive, që varet si nga vetëdija, ashtu edhe nga vullneti i personit gjatë shkaktimit të dëmit. Faji paraqet raportin subjektiv të palës që shkakton dëmin ndaj veprimit të kryer dhe pasojës së ardhur. Veprimi i kundërligjshëm si koncept i përgjithshëm, ekziston gjithmonë, kur ka shkelje të normave juridike, siedhe kur cënohen dispozitat e një kontrate nga palët pjesëmarrëse në të.<sup>41</sup>

Ka autorë që përveç këtyre dy teorive mbrojnë dhe teorinë e kombinuar, midis asaj objektive dhe asaj subjektive, duke vlerësuar se kjo sjell garanci dhe qartësi më të madhe në

---

<sup>39</sup>Dordević, Ž. (1974) “E drejta e detyrimeve”, Beograd, fq.311.

<sup>40</sup>Dauti, N. (2001) “E drejta e detyrimeve”, Prishtinë, fq.49.

<sup>41</sup>Nuni, A, Mustafaj, I, Vokshi, A. (2008) “E Drejta e Detyrimeve II,” Tiranë, fq.145.

përcaktimin e veprimit të kundërligjshëm si kusht i përgjithshëm për lindjen e përgjegjesisë për shkaktimin e dëmit. Po sipas kësaj teorie, veprimi i kundërligjshëm ekziston atëherë kur çënohet marrëdhënia apo norma juridike me të cilën mbrohet interesi i përgjithshëm, si dhe kur çënohen dispozitat e një ligji të caktuar me të cilat mbrohet interesi individual i subjekteve të së drejtës (me faj të autorit të dëmit). Prandaj, mund të thuhet se veprimi i kundërligjshëm ekziston gjithmonë kur kemi një dëmtë shkaktuar në kundërshtim me të drejtën objektive, sipas të cilës ndalohet shprehimisht shkaktimi i dëmit, duke parashikuar edhe dënimin e palës përkatëse për këtë veprim, si dhe shpërblimin e dëmit. Kur flasim për tëdrejtën objektive duhet mbajtur parasysh se në këtë nuk përfshihen vetëm normat ligjore, por edhe të gjitha ato norma të karakterit moral dhe zakonor të cilat gëzojnë mbrojtje përmes sanksionimit nga vet ligji i posaçshëm i shtetit.<sup>42</sup> Këtu duhet të bëjmë disa dallime, pasi jo çdo shkelje e normave juridike ka për pasojë lindjen e përgjegjesisë civile. Për shembull, nëse dikush drejton me shpejtësi të madhe, përtej normave të lejuara, automjetin e tij nëpër rrugët brenda qytetit, në këtë rast edhe pse kemi shkelje të normave juridiko-administrative sipas Kodit Rrugor, nuk kemi lindjen e përgjegjesisë civile, por vetëm të asaj administrative (kundërvajtëse).<sup>43</sup> Prandaj, që të kemi përgjegjësi civile duhet që përveç veprimit të kundërligjshëm të personit prej të cilit çënohet norma juridike, duhet të realizohet edhe çënimi i ndonjë të mire pasurore dhe personale të mbrojtur juridikisht nga ligji.

*Dëmi i shkaktuar nga Mbrojtja e Nevojshme.* Mbrojtja e Nevojshme paraqet njërin nga rastet e përjashtimit nga përgjegjësia për shkaktimin e dëmit. Për shkak të natyrës së saj të veçantë, Mbrojtja e Nevojshme, më së shumti gjen praktikë dhe zbatim në të drejtën Penale. Ai, i cili në kushtet e Mbrojtjes së Nevojshme do t'i shkaktojë dëm sulmuesit, nuk është i detyruar që t'ia kompensojë, përveç rasteve kur kemi Tejkallim të Mbrojtjes së Nevojshme. Këtu, në mënyrë analoge sikurse parashikohet edhe në dispozitat penale, përmendet

<sup>42</sup>Gale, G., Jadranka, E. (2004) "E drejta e detyrimeve", Pjesa e përgjithshme, Beograd, fq 247.

<sup>43</sup> Jaffey, A.E. "Volenti Non Fit Injuria", The Cambridge Law Journal, Volume 44, fq. 89.

Mbrojtja e Nevojshme me qëllim që të përjashtohet çdo lloj përgjegjësie për personin që ka kryer apo vepruar i ndodhur në kushtet e kësaj të fundit. Edhe neni 611 i Kodit Civil parashikon se: *“Nuk është përgjegjës ai që i shkakton dëm tjetrit për Mbrojtjen e Nevojshme të tij ose të një të treti”*.

Meqë kjo dispozitë e Kodit nuk i përkufizon kufijtë se deri ku mund të shtrihet Mbrojtja e Nevojshme, autorë të ndryshëm dhe praktika gjyqësore shpeshherë këtë çështje mundohen ta zgjidhin në kuadër të nenit 19 të Kodit Penal, i cili më përparësisht përcakton kuptimin e Mbrojtjes së Nevojshme dhe shprehet se: *“Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprë duke qenë i detyruar të mbrojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri, nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion (përpjestim) me rrezikshmërinë e sulmit. Mospërputhja haptasi ndërmjet tyre përbën kapërcim të Mbrojtjes së Nevojshme”*.<sup>44</sup>

Që të kualifikohet Mbrojtja e Nevojshme si e tillë, kërkon ekzistencën e disa elementëve të domosdoshëm. Ajo duhet që të jetë e drejtuar ndaj një sulmi real, pasi nëse ndodh që pala të veprojë në hamendje ndaj një sulmi të imagjinuar, duke supozuar se po sulmohet, atëherë mbrojtja është fiktive (ndryshe quhet mbrojtje e nevojshme putative). Në këtë rast personi nuk përjashtohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, si i ndodhur në kushtete Mbrojtjes së Nevojshme.<sup>45</sup> Gjithashtu, që të jemi në kushtet e Mbrojtjes së Nevojshme duhet që sulmi të jetë i kundërligjshëm (i padrejtë) dhe i çastit.

Pra, është i drejtë konstatimi se personi që kryen sulm i pari sillet në kundërshtim me të drejtën, në dallim nga ai që zbraps sulmin, i cili konsiderohet se sillet në përputhje me normat e së drejtës. Sa herë që personi ka vepruar në kushtet e Mbrojtjes së Nevojshme, pasojat e sjella nga dëmi i shkaktuar janë barrë e atij personi me fajin e të cilit është shkaktuar gjendja e mësipërme.

---

<sup>44</sup> Dimitar, G. (1985) *“E drejta e detyrimeve”*, Shkup, fq 68.

<sup>45</sup> Tutulani-Semini, M. (2006) *“E drejta e detyrimeve dhe e kontratave”*, pjesa e përgjithëshme, Tiranë , fq145.

Në disa raste, personi që ka vepruar në kushtet e Mbrojtjes së Nevojshme për të mënjanuar një sulm të çastit, të vërtetë dhe të kundërligjshëm të dikujt tjetër, mund të kërkojë zhdëmtim të dëmit, qoftë nga personi që ka provokuar sulmin, qoftë nga personat e tretë nga të cilët ka shmangur pasojën e dëmit. Personi që vepron në kushtet e Mbrojtjes së Nevojshme duhet të ketë parasysh, që të mos tejkalojë intensitetin e sulmit duke i shkaktuar dëm sulmuesit më shumë se sa ka mundur t'i shkaktojë ai.<sup>46</sup>

Çdo tejkallim do të lindte detyrimin e shpërblimit të dëmit nga personi që është sjellë në kushtet e Mbrojtjes së Nevojshme, pra do të përgjigjej ai që mbrohet. Në praktikë kur ndodhemi përballë Mbrojtjes së Nevojshme mund të ndodhë që personi të ketë zbrapsur një sulm, i cili mund të jetë një veprim që përmban elemente edhe të veprës penale edhe të deliktit civil. Në këto raste gjykatësi civil nuk duhet ndikohet nga vendimi i gjykatës penale. Në qoftë se i padituri shpallet i pafajshëm nga gjykata penale gjykata civile duhet ta shqyrtojë çështjen vetëm në kuadër të shkaktimit të dëmit civil. Nëse kjo e fundit konstaton se ka tejkallim të kufijve të Mbrojtjes së Nevojshme, duhet që ta shpallë përgjegjës personin.<sup>47</sup>

*Dëmi i shkaktuar nga "mbrojtja e nevojshme".* Kundrejt faktit të shkaktimit të dëmit, në rastet kur personi vepron për t'u mbrojtur, ai nuk do të përgjigjet për pasojat e dëmit. Çdo subjekt i së drejtës në rastin e një veprimi të kundërligjshëm apo cënimit të ndonjë të drejte subjektive, duhet të kërkojë mbrojtje nga organet kompetente dhe jo të mbrohet me anë të vetëgjyqësisë. Sa herë që mbrojtja ose realizimi i të drejtave subjektive kryhet me forcat dhe mjetet vetjake apo personale të vetë personit, pa ndihmën e organeve kompetente të pushtetit publik, quhet vetëndihmë.<sup>48</sup>

Rastet e "vetëndihmës së lejuar" si term janë shumë të rralla, dhe ato aplikohen vetëm përjashtimisht, pasi për shtetet ku mbizotëron zbatimi i ligjit dhe i së drejtës, realizimi i

---

<sup>46</sup> Sallabanda, A. (1962) "E drejta e detyrimeve", Tiranë, fq. 85.

<sup>47</sup> Živković, S, Shpërblimi i dëmit material dhe jomaterial, Beograd, fq.22.

<sup>48</sup> Gjata, R. *vep.e cit.*, f.61-62.

sanksionit mbetet detyrim i organeve shtetërore. Me “*Mbrojtje të nevojshme*” nënkuptojmë të drejtën e çdo personi për të shmangur cënimin e një të drejte të tij, kur i kanoset një rreziki drejtëpërdrejtë dhe i atypëratyshëm, në qoftë se kjo mbrojtje është e domosdoshme, dhe në qoftë se mënyra e shmangies së cënimit të së drejtës i përgjigjet rrethanave në të cilat është paraqitur rreziku i atëçastshëm.

Këtë fakt e ka sanksionuar edhe legjislacioni civil, i cilinë fakt nuk e ka parashikuar në mënyrë të shprehur çështjen e “*mbrojtjes së nevojshme*”, edhe pse në disa situata mund edhe të nënkuptohet. Kështu, Kodi Civil në nenin 310 parashikon situatën ku poseduesi i një sendi të mund të kundërshtojë aty për aty, duke përdorur një mbrojtje të përshtatshme, çdo veprim që ka për qëllim cënimin ose zhveshjen nga posedimi i së drejtës së tij. Po sipas këtij neni, kur sendi është marrë me dhunë ose fshehurazi në kundërshtim me ligjin, poseduesi ka të drejtë ta marrë atë menjëherë ose në ndjekje e sipër, por duke evituar veprimet e dhunës, që nuk pajtohen me rrethanat e ngjarjes.<sup>49</sup> Për të qënë në kushtet e “*mbrojtjes së nevojshme*” duhet të plotësohen këto kushte:

1. Të ekzistojë kërkesa e personit, të cilit i cënohet një e drejtë subjektive.
2. Masa e sigurimit të kërkesës të mos ketë mundësi që të realizohet nëpërmjet organit kompetent apo do realizohet me vonesë.
3. Veprimi i vetëndihmës të ndërmerret nga kreditori, i cili i drejtohet debitorit të vet.
4. Rreziku i drejtëpërdrejtë të jetë evident, saqë e bën të pamundur që pala e dëmtuar të presë reagimin e organeve shtetërore.
5. Mënyra e ndalimit të cënimit kërkohet që të jetë në përputhje me rrethanat nga të cilat ka gjeneruar rreziku.
6. Mbrojtja e nevojshme të jetë e lejuar dhe të ndërmerret nga personi i autorizuar.

---

<sup>49</sup> Neni 310 i Kodit Civil.

Në rast se nuk plotësohen kushtet e lartpërmendura në mënyrë kumulative, personi nuk do mund të lirohet nga detyrimi për zhdëmtim. Kështu po parashtroj një rast të “mbrojtjes se nevojshme” si më poshtë: Një person, pa patur asnjë bazë juridike (vendim të organit kompetent shtetëror, kontratë apo ndonjë akt tjetër juridik) futet në një banesë të huaj duke thyer bravën dhe duke e zëvendësuar atë me një tjetër. Ai fillon të ndërmarrë veprime konkrete brenda banesës për ta përshtatur atë për vete. Kur pronari i ligjshëm vjen në dijeni të faktit të paligjshëm ndërmerr masa për kthimin e posedimit të banesës. Në këtë rast, veprimet e pronarit të cilit në mënyrë të kundërligjshme i janë futur në banesë, pa lejen apo pëlqimin e tij, do të konsiderohen të ligjshme. Pronari i ligjshëm në këtë rast duhet që të ndërmarrë veprime ligjore për kthimin e banesës. Por, shpeshherë në praktikë veprimet e organeve shtetërore janë të vonuara, ndërkohë që çdo vonesë pronarit mund t’i kushtojë shpenzime shtesë të konsiderueshme. Në këtë rast, pronari mund ta gjejë veten të detyruar qoftë edhe të thyejë bravën e sapovendosur dhe ta zëvendësojë atë me një tjetër, duke nxjerrë nga banesa edhe të gjitha mjetet e futura nga banori i paligjshëm.

Duhet thënë se edhe te “*mbrojtja e nevojshme*” duhet të ekzistojë reciprociteti i vlerave të dëmtuara, të cilat duhet të trajtohen rast pas rasti.

Së fundmi, duhet bërë dallimi ndërmjet “*mbrojtjes së nevojshme*” dhe “*Nevojës ekstreme*”. Tek “*mbrojtja e nevojshme*” pas rrezikut që e shkakton këtë gjithmonë qëndron një individ. Ndërsa, tek “*nevoja ekstreme*” jo gjithmonë pas shkaktimit të dëmit qëndron ndonjë veprim njerëzor, pasi mund të paraqiten edhe faktorë të tjerë të jashtëm të shkaktuar nga fuqia madhore (zjarre, tërmete, vërshime etj).<sup>50</sup>

*Dëmi i shkaktuar me pëlqimin e të dëmtuarit.* Nisur nga parimi i disponimit të lirë të drejtave pasurore dhe atyre personale në marrëdhëniet juridico-civile, sa herë që personit i shkaktohet dëm me pranimin nga ana e këtij të fundit, shkaktuesi i dëmit nuk do të përgjigjet

---

<sup>50</sup> Alajdin, A. (2001) “*Studime nga e drejta e detyrimeve I*”, Prishtinë, fq. 34.

për dëmin e shkaktuar. Ky rregull njihet që nga e drejta Romake. Sipas Ulpianit: «*Quia nulla est iniuria, quae in volentam fiat*», që do të thotë se “nuk ka padrejtësi kundër atij që pranon shkaktimin e dëmit”.<sup>51</sup>Pra, sipas këtij parimi, kur ndodhemi përballë një rasti të tillë kemi përjashtim nga përgjegjësia. Kështu që, ai i cili në dëm të vetin do t’i lejonte tjetrit të ndërmerre ndonjë veprim, nuk mund të kërkojë nga ai shpërblim të dëmit të shkaktuar nga ai veprim. Sipas këtij rregulli, detyrimi për shpërblimin e dëmit bie mbi të dëmtuarin. Në të kundërt, sikur të mos kishte ekzistuar pëlqimi i të dëmtuarit, ky detyrim do ta ngarkonte dëmtuesin për zhdëmtim. Vetë pëlqimi i palës së dëmtuar i eliminon kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë së dëmit, atë të kundërligjshmërisë dhe të fajit të dëmtuesit, bazuar dhe në sentencën latine “*volonti non fit iniuria*”, nuk ka dëm me vullnetin e të dëmtuarit.<sup>52</sup> Edhe në legjislacionin tonë është sanksionuar kurrregull. Sipas doktrinës juridiko-civile, sa herë që një person me vetëdije dhe dëshirë e vë veten në pozitë të rrezikshme, nuk mund të padisë dikë tjetër për pasojat e dëmit. Në këto raste, palët nuk mund të bëjnë ndonjë marrëveshje formale apo deklaratë, pasi të gjitha këto janë të pavlefshme. Pra, nuk mund të prodhojnë asnjë efekt juridik, sepse si të tilla, janë të ndaluara dhe nga dispozitat ligjore. Raste të tilla në praktikë më së shumti paraqiten në rrethanat e disa ndërhyrjeve specifike mjekësore, ku pacienti paraprakisht pajtohet me pasojat eventuale që mund të vijnë nga ndërhyrja e mjekut. Kështu ndodh, p. sh., edhe kur dikush me pëlqimin e tij bie dakord që t’i hiqet ndonjë organ i sëmurë nga trupi, apo kur ndonjë i afërm i familjes jep pëlqimin që t’i hiqet njëra veshkë, për ta transplantuar atë tek personi i afërm që gjendet në dializë, për shkak të mosfunksionimit të asnjërës veshkë të tij. Në këto raste, edhe pse personit që i është shkaktuar dëm nga mjeku, ky i fundit nuk ka të drejtë të kërkojë zhdëmtimin e pasojave, pasi ka dhënë pëlqimin për kryerjen e veprimeve të sipërpërmendura duke marrë parasysh edhe

---

<sup>51</sup><http://www.scribd.com/doc/92816462/Latinski-citati>.

<sup>52</sup>Jaffey, A. (1985) “*Volenti Non Fit Injuria*”, *The Cambridge Law Journal*, Volume 44, Published by Cambridge University Press, March, fq.87.

pasojat që mund të vinin. Që të përjashtohet nga përgjegjësia shkaktuesi i dëmit, duhet që veprimet që do të ndërmerren të jenë në kuadër të asaj që është marrë vesh me palën që do t'i shkaktohet dëmi, duke mos i kaluar kufijtë e marrëveshjes.

Që pëlqimi të përbëjë fakt juridik, personi që e ka dhënë atë, duhet që të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar, si edhe të jetë i aftë dhe i vetëdijshëm për të gjykuar pasojat që do të shkaktohen nga veprimi i shkaktuesit të dëmit. Kështu p.sh., gjatë pjesëmarrjes në sportet luftarake, si boksi, karateja, etj., sa herë që ndodh që ndonjëra nga palët të lëndohet apo dëmtohet, ajo nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblim të dëmit, nëse pala tjetër ka vepruar tërësisht në kuadër të rregullave të lojës.

*Dëmi i shkaktuar duke ushtruar të drejtën vetjake.* Nuk do të konsiderohet veprim i kundërligjshëm nëse një subjekt i shkakton dëm tjetrit duke ushtruar të drejtat e veta në kuadër të parashikimeve të ligjit.<sup>53</sup> Kur flasim për realizim dhe ushtrim të të drejtave që gëzon personi, kemi parasysh realizimin e të drejtave subjektive që janë në përputhje me dispozitat ligjore pozitive. Sa herë që një person duke vepruar brenda kornizave ligjore dhe zakoneve të mira, realizon të drejtën e vet, por si pasojë e këtij veprimi i shkaktohet dëm dikujt tjetër, ai nuk do të jetë përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Personi nuk do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar për faktin se veprimi i tij nuk çënon dispozitat ligjore dhe nuk prek kufijtë e ligjit. Si i tillë, ai nuk është i kundërligjshëm, kusht pa të cilin nuk lind përgjegjësia juridiko-civile. Edhe në parashikimet e së drejtës Romake gjejmë një rregullim të tillë, sipas të cilit “ai që sillet në përputhje me të drejtat e tij ligjore, askujt nuk i shkakton padrejtësi “*qui jure suo*

---

<sup>53</sup>Dauti, N. *vep.e cit.*, fq.16.3 .



*utitur, nemini facit injuriam*".<sup>54</sup> Pra, parimisht ndalohej çdo keqpërdorim i të drejtave: "*maleenim nostro jure uti non debemus.*"<sup>55</sup>

Megjithatë, duhet patur parasysh fakti se raportet shoqërore janë të ndërvarura, dhe se të drejtat e një personi janë të kufizuara nga të drejtat e personvetë tjerë apo shoqërisë në përgjithësi. Nisur nga ky fakt, sa herë që një individ realizon një të drejtë subjektive, duhet të mbajë parasysh e të ketë kujdes që të mos i tejkalojë kufijtë ligjorë duke rrezikuar cënimin e të drejtave të personave të tjerë. Prandaj, e drejta e një individi për të ushtruar të drejtat e tij subjektive nuk duhet kuptuar si absolute. Ajo duhet të bëhet gjithmonë duke respektuar plotësisht të drejtat që gëzojnë individët e tjerë, të parashikuara këto shprehimisht edhe nga ligji.

Në të drejtën e sotme kufizimi i ushtrimit të të drejtave është parashikuar në shumë fusha, pasi edhe mundësia e abuzimit me këto është rritur mjaft. Sa herë që një person vepron në kundërshtim me të drejtën e vet dhe ka për qëllim që t'i shkaktojë dëm një personi tjetër, kemi situatën e keqpërdorimit të së drejtës.<sup>56</sup>

*Dëmi i shkaktuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.* Gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre, personatqë ushtrojnë një detyrë zyrtare, shpeshherë mund të sjellin shkaktimine një dëmi, por kur këta kanë vepruar në respekt të kornizave të ligjit dhe autorizimeve zyrtare, për këta të fundit nuk lind përgjegjësia për shpërblimin e dëmit. Rastet e këtilla janë të shpeshta në praktikë. Kështu ndodh, p.sh., kur Inspektoriat Sanitar zhduk disa artikuj ushqimorë për shkak të skadimit të afatit të përdorimit të këtyre të fundit; kur Inspektoriat i Ndërtimit rrezon një objekt pa leje; kur zjarrëfikësi thyen derën e banesës, me qëllim që të futet brenda

---

<sup>54</sup>William Waller H "*Maxims in Law and Equity - comprising Noy's maxims, Francis's maxims, and Branch's Principia legis et æquitatis, with a translation of the Latin maxims and references to modern authorities both British and American, Volumes 1-3, The author is Counsellor at Law (Author of the Virginia Justice, The Lawyer's Guide, Editor of the Statutes at Large of Virginia), Richmond, 1824.*

<sup>55</sup>Pierre Larouche Tilburg Law and Economics Center (TILEC), College of Europe – Bruges, Tilburg University - Tilburg Law School, Center on Regulation in Europe (CERRE) December 1, 2008 pp 14.

<sup>56</sup>Zimmermann, R. (1996) "*THE LAW OF OBLIGATIONS: Roman Foundations of the Civilian Tradition*", Published in the United States by Oxford University Press Inc, New York, fq. 285.

për të lokalizuar dhe shuar zjarrin; kur Policia gjatë shpërndarjes së turmës të protestuesve lëndon ndonjërin prej tyre; apo kur polici kufitar plagos ndonjë person që në mënyrë ilegale tenton të kalojë kufirin.<sup>57</sup>

Dëmi duhet të jetë pasojë e drejtëpërdrejtë e veprimtarisë së lejuar të personit zyrtar.<sup>58</sup> Në të gjitha rastet e sipërcituara personi që është duke kryer detyrën zyrtare, pavarësisht faktit të shkaktimit të dëmit, nuk do të përgjigjet për të. Në qoftë se një veprim i tillë kryhet nga një person jo-zyrtar apo i paautorizuar, padyshim që për këtë të fundit do të lindte përgjegjësia dhe detyrimi për kompensim. Në të gjitha rastet, veprimet e kryera nga njëperson zyrtar duhet të jenë në kuadër të atyre të parashikuara e të lejuara nga ligji dhe të autorizuara nga organi përkatës zyrtar. Në të kundërt, do të lindë detyrimi për zhdëmtim, sepse veprimi i tij do të kualifikohet si i kundërligjshëm.<sup>59</sup>

*Dëmi i shkaktuar në kushtet e Nevojës Ekstreme.* Në jetën e përditshme mund të ndodhë që të paraqitet nevoja e patjetërsueshme që një individ t'i shkaktojë dëm dikujt tjetër, me qëllim që të mbrojë një të drejtë të vetën personale apo ndonjë të drejtë të dikujt tjetër. Në të tilla raste mund të jemi edhe në kushtet e Nevojës Ekstreme. Por, që të ndodhë kjo duhen plotësuar disa kushte bazike, që lidhen me ekzistencën një rreziku të përnjëhershëm, i cili nuk mund të shmanget në asnjë mënyrë tjetër në ato momente. Veprimi i personit në këtë rast nuk do të konsiderohetsi i kryer me faj, për faktin se si i tillë lejohet nga dispozitat e ligjit, por megjithatë pala e dëmtuar duhet të shpërblehet mbi bazën e përgjegjësisë objektive apo subjektive.<sup>60</sup>

Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes, mund ta shkarkojë plotësisht ose pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të dëmit. Vlen për t'u theksuar

---

<sup>57</sup> *Current Legal Problems, 2009, volume 62, edited by COLM O'CONNOR, ON BEHALF OF THE FACULTY OF LAWS UNIVERSITY COLLEGE LONDON, Oxford university press, pp 162.*

<sup>58</sup> *Vukovic, M. (1971) "Pergjegjesia Per Demin", Zagreb, fq. 95.*

<sup>59</sup> *Deakin, S, Johnston, A, Basil, M. (2008) "Markesinis and Deakin's Tort Law, 6th ed", Oxford, Clarendon Press, fq.99.*

<sup>60</sup> *Georgiev, D. (1985) "E drejta e detyrimeve", Shkup, fq. 204.*

se do të ishte i padrejtë qëndrimi i skajshëm që lejohet që dikush të pësojë dëm, vetëm me arsyetimin për të shpëtuar ndonjë të mirë materiale apo personale të dikujt tjetër. Nevoja Ekstreme (Skajshme), sikurse edhe Mbrojtja e Nevojshme, gjen zbatim më të zgjeruar në të drejtën Penale, dhe kryesisht e hasim në rastet e përjashtimit nga përgjegjësia penale. Legjislacioni ynë nuk e përcakton qartë, dhe shpeshherë është e vështirë të bëhet dallimi mes Mbrojtjes së Nevojshme dhe Nevojës Ekstreme. Megjithatë, një dallim shumë i rëndësishëm qëndron në atë se, që të jemi në kushtet e Mbrojtjes së Nevojshme duhet gjithmonë që kundërveprimi të jetë i atëçastshëm dhe i provokuar nga sulmi i dikujt tjetër, konkretisht i një njeriu, dhe që ky i fundit të ketë për qëllim zbrapsjen e këtij sulmi.<sup>61</sup>

Kurse, kundërveprimi i një individi në kushtet e Nevojës Ekstreme, mund të jetë i provokuar përveçse nga njeriu apo kafsha, edhe nga ngjarjet natyrore ose nga rrethana të tjera. Dallimi tjetër qëndron në faktin se në rastin e Mbrojtjes së Nevojshme kemi konflikt mes një veprimi të drejtë me një të padrejtë, kurse në Nevojën Ekstreme kemi konflikt ndërmjet dy të drejtave, ku edhe pasojat në të dyja rastet e përmendura janë të ndryshme njëra nga tjetra.<sup>62</sup>

Personi që sillet në kushtet e Nevojës Ekstreme për të larguar rrezikun e shkaktimit të dëmit nga ndonjë person tjetër, duhet që të dëmtojë ndonjë të mirë materiale apo ndonjë person të tretë, e jo atë që ka shkaktuar rrezikun, pasi në këtë rast do të ishim në kushtet e Mbrojtjes së Nevojshme.

Që të konsiderohet një veprim i një individi, si veprim i kryer në kushtet e Nevojës Ekstreme, duhet të plotësojë disa kushte:

- veprimi për shmangien e rrezikut duhet të ndodhë në të njëjtën kohë kur paraqitet dhe rreziku i shkaktimit të dëmit;

---

<sup>61</sup> Dordević, Ž., Stanković, V. (1974) “E drejta e detyrimeve”, Beograd, fq.343.

<sup>62</sup> Elezi, I. (2007) “E Drejta Penale” (Pjesa e Posacme), ERIK, Tirane, fq. 165-167

- të mos ketë mënyrë tjetër për të eliminuar atë rrezik në atë çast;
- vlera e të mirave materiale apo personale të shpëtuara, të jenë më të mëdha sesa dëmi që do të mund të shkaktohet nga veprimi i ndërmarrë në kushtet e Nevojës Ekstreme.

Nga ky fakt konstatojmë se, që të ekzistojë Nevoja Ekstre meduhet të kemi elementin e domosdoshëm të shfaqjes së rrezikut të shkaktimit të dëmit, si dhe detyrimin që të ndërmerren veprime për shmangien e këtij rreziku në të njëjtën kohë.<sup>63</sup> Në të kundërt nuk do të gjendeshim në kushtet e Nevojës Ekstreme. Në rast se ndodh që personi ndërmerr veprime, veç pas shkaktimit të pasojave, atëherë nuk mund të themi se personi ka vepruar në kushtet e Nevojës Ekstreme.

Dhe nëse lind detyrimi për palën përkatëse për shpërblimin e këtij dëmi, nuk do zbatohet rregulli për situatën e Nevojës Ekstreme, por rregullat e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Të ngjashme e kemi situatën edhe kur ekziston mundësia që rreziku i dëmit të mund të shmanget me veprime të tjera, pa qenë nevoja t'i shkaktohet dëm palës tjetër. Edhe në këtë rast nuk do të jemi në kushtet e Nevojës Ekstreme, prandaj do të zbatohen rregullat e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit.<sup>64</sup>

Pyetja që shtrohet këtu është se cilit i ngarkohet shpërblimi i pasojave të dëmit që i shkaktohen personit që ka vepruar në kushtet e Nevojës Ekstreme. Në këto raste, personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga personi i cili me veprimet e tij ka sjellë lindjen e dëmit, nga pronari i sendit nga i cili ka ardhur rreziku, ose nga personi që merret me llojin e veprimtarisë që përbën burim rreziku.

Kur dëmi i shkaktohet një personi apo pale të tretë, atëherë shpërblimin e dëmit konkretisht pala e tretë mund ta kërkojë nga personi që ka vepruar në kushtet e Nevojës

<sup>63</sup> Tutulani-Semini, M. (2006a) "E drejta e detyrimeve dhe e kontratave", pjesa e përgjithshme, Tiranë, fq 205.

<sup>64</sup> Tutulani-Semini, M. (2006b) "E drejta e detyrimeve dhe e kontratave", pjesa e përgjithshme, Tiranë, fq 68.

Ekstreme, ndërkohëqë ky i fundit pastaj mund të kërkojë zhdëmtim nga pala të mirat materiale apo personale të të cilit janë shpëtuar, mbi bazën e të drejtës së regresit.<sup>65</sup>

Në nenin 612 të Kodit Civil sanksionohet se: *“Personi që ka shkaktuar dëmin duke qenë i shtrënguar nga nevoja për të shpëtuar veten ose të tjerët nga rreziku i atëçastëm i një dëmi të rëndë, rrezik i cili nuk ka qenë shkaktuar dhe as mund të mënjanohej prej tij, detyrohet të shpërblejë dëmin”*.<sup>66</sup> Gjatë realizimit të mbrojtjes në kushtet e Nevojës Ekstreme, mund të ndodhë që dëm të pësojë pikërisht subjekti nga i cili tentohet të shmanget shkaktimi i dëmit. Në këtë rast, personi që ka vepruar në kushtet e Nevojës Ekstreme nuk do të përgjigjet.

Nga kjo nënkuptojmë se përgjegjësia për shpërblimin e dëmit të personit që ka vepruar në kushtet e nevojës ekstreme, mund të jetë me bazë subjektive dhe me bazë objektive. Në praktikë mund të themi se shpesh ndodh që mbrojtja në kushtet e Nevojës Ekstreme të kryhet me përdorimin e sendeve apo nga ndonjë veprimtari që paraqet burimrreziku të shtuar për mjedisin. Në një rast të tillë subjekti përgjegjës do të përgjigjet në bazë të rregullave të përgjegjësisë objektive.

Nevojë Ekstreme do të kemi, për shembull, kur dikush transporton mall me anije dhe nga ngarkesa e tepërt, jashtë fuqisë mbajtëse, anija fillon të mbushet me ujë. Transportuesi, me qëllim që të shpëtojë sasinë me vlerën më të madhe të mallit, hedh nga anija disa sende të një vlere më të vogël të dikujt tjetër; apo kur nga kopshti zoologjik ikin kafshët e egra dhe shpërndahen nëpër qytet dhe qytetarët për të shpëtuar jetën, si edhe shëndetin e tyre, thyejnë dyert e banesave ku të munden.<sup>67</sup>

Mirëpo, që të konsiderohet si veprim legal (i ligjshëm), mbrojtja e realizuar në kushtet e Nevojës Ekstreme, duhet që rreziku që kërkohet të sprapset, të jetë real dhe i çastit, si dhe vlera e pasurisë që mbrohet të jetë më e madhe se sa ajo që sakrifikohet. Midis dëmit, si fakt

---

<sup>65</sup> Elezi, I. (2007a) “ E Drejta Penale “ , Pjesa e Posacme , ERIK, Tirane , fq 167

<sup>66</sup> Neni 612 i Kodit Civil.

<sup>67</sup> Elezi, I. ( 2007b ) “ E Drejta Penale ” , Pjesa e Posacme , ERIK, Tirane, fq 163

dhe shkakut që ka determinuar pasojën e dëmtiduhet të ekzistojë lidhja kauzale. Ekzistojnë raste kur dëmi ka ardhur si rezultat i shkakut të parë (Ai, që në mungesë të pronarit, hyn në banesën e të tjerëve për të shuar zjarrin në ballkonin e komshiut i cili nuk gjendet në shtëpi në momentin e shëndijes elektrike), apo pasoja është rezultat i shkakut të dytë (thyerja e derës së komshiut, ose demtimi i oriendive shtëpiake), i cili ka ardhur si rezultat i shkakut të parë (nevojës ekstreme për të fikur zjarrin i cili po të përhapej do sillte demtime të mëdha në pronën fqinje), duke patur shpeshherë konkurimin e më shumë shkaqeve, të cilat kanë lidhje natyrore njëri me tjetrin. Për të zbatuar këtë parim përdoret kriteri i të ashtuquajturit rregullim statistikor. Një fakt i caktuar juridikisht konsiderohet si shkak i një njiçjarjeje në qoftë se kjo e fundit, mbi bazën e një gjykimi probabiliteti, mund të shfaqet si rezultat i parashikueshëm dhe i paevitueshëm i këtij fakti.<sup>68</sup>

Nuk do të përbënte sens dhe nuk mund të thuhet se ka vepruar në rrethana të Nevojës Ekstreme personi që dëmton të mirat materiale të një vlere më të madhe të dikujt tjetër, për të shpëtuar të mirat e veta materiale, apo edhe ato personale, të një vlere më të vogël. Në teorinë juridike ka dilema në lidhje me atë se sa duhet të jetë diferenca midis vlerave që sakrifikohen dhe atyre që shpëtohen, por kjo i mbetet për detyrë gjykatës që ta vlerësojë në bazë të rrethanave të rastit.

Nga kjo konstatojmë se secili ka të drejtë të kërkojë nga tjetri që të shmangë kryerjen e veprimeve që mund të përbëjnë burim rreziku, nga i cili i kërcënohet të vijë një dëm i konsiderueshëm ndaj atij apo personave të tretë. Gjykata, me kërkesë të personit të interesuar, do të urdhërojë që të ndërmerren masa të përshtatshme për pengimin e shkakimit të dëmit apo shqetësimit, apo të kërkojë largimin e burimit të rrezikut nga personi që posedon apo është pronar i sendit që paraqet burim të rrezikut, nëse ai vetë nuk do të pranojë ta bëjë këtë, përveç rasteve kur dëmi shkaktohet gjatë kryerjes së veprimtarive me interes të përgjithshëm

---

<sup>68</sup> Galgano, F. (2003) "E drejta private" Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë.

për të cilën është marrë leje nga organi kompetent. Në këtë rast mund të kërkohet vetëm kompensimi i dëmit që i kalon kufijtë normal.<sup>69</sup>

### 3.5.3. Faji

E drejta civile ka pranuar si bazë të përgjegjësisë civile fajin e personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar. Në këtë mënyrë në rastin e shkaktimit të dëmit, nuk mjafton konstatimi i tre kushteve për të cilat u fol më sipër (dëmi, kundërligjshmëria e tij, lidhja shkakësore).

Neni 608 e parashikon fajin si një ndër kushtet e domosdoshme për të patur përgjegjësi civile për dëmin jopasuror. Faktikisht, në të drejtën Civile nuk janë dhënë definicione ligjore për fajin dhe format e tij.<sup>70</sup> Në lidhje me të është bërë referencë në doktrinën dhe të drejtën Penale. Në nenin 608/2 të Kodit Civil parashikohet që: *“Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj”*.<sup>71</sup> Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton që fajësia prezumohet. I takon palës dëmtuese barra e provës të vërtetë se nuk ka faj, sepse dëmtuesi më mirë se kushdo tjetër është në gjendje të provojë nëse pavarësisht se sjellja e tij mund të ketë qenë e paligjshme, ai ka qenë i ndodhur në rrethana të tilla të cilat i ka patur të pamundura për t’i mënjauar.

Dispozitat e ligjit nuk japin nëpërmjet një përkufizimi të qartë kuptimin e fajit, por këtë e bën doktrina juridike. Megjithatë, në Kodin Civil bëhet një parashikim i tillë në nenin 644 ku thuhet: *“Kur personi që ka kryer veprimin apo mosveprimin e paligjshëm krahas dëmit të shkaktuar, ka pasur edhe një përfitim të dukshëm, gjykata me kërkesën e palës së dëmtuar duke patur parasysh natyrën e dëmit, shkallën e fajësisë e rrethana të tjera të çështjes mund të llogarisë në shpërblimin e dëmit, tërësisht apo pjesërisht përfitimin.”*

---

<sup>69</sup>Paragrafi 1 dhe 2 i nenit 143 të Ligjit Nr.04/L-077 “Per Marrdheniet e Detyrimeve”, 10 Maj 2012, Kosove.

<sup>70</sup> Neni 608 i Kodit Civil.

<sup>71</sup> Neni 608/2 i Kodit Civil.

Lindja e përgjegjësisë civile për shpërblimin e dëmit, kërkon që dëmi të jetë shkaktuar në mënyrë të paligjshme. Kundërligjshmëria përbën një kategori objektive dhe ka të bëjë me faktin se akti që ka shkaktuar dëmin është kryer në kundërshtim me normat juridike të së drejtës objektive ( pra janë cënuar mardhëniet shoqërore të mbrojtura në Kodin Civil). Në fakt, individi që ka shkaktuar dëmin, duke kryer një veprim në kundërshtim me të drejtën objektive, ka cënuar në rastin konkret një të drejtë subjektive dhe të dallueshme të të dëmtuarit, për shembull në rastin e vjedhjes së një sendi është cënuar e drejta subjektive e pronësisë së të dëmtuarit.

Dëmi i shkaktuar në mënyrë të paligjshme, mund të vijë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të kundërligjshëm.

Veprimi do të konsiderohet i kundërligjshëm nëse në momentin e kryerjes së tijai konsiderohet si i tillë nga ligji. Ndërsa themi se personi ka sjellë një dëm me anë të mosveprimit, atëhere kur ky i fundit është i detyruar nga ligji të veprojë, ka mundësi reale për të vepruar, dhe në fakt nuk vepron. Detyrimi dhe mundësia për të vepruar duhet të konkurrojnë së bashku.

Bazuar ne dy nenet e sipërcituara por edhe në doktrinën juridike faji rezulton të jetëelementikyç, në sajë të vërtetimit të faktit nëse personi mbi të cilin bie përgjegjësia për një nga llojet e dëmeve jashtë-kontraktore ka marrë gjithë masat e nevojshme dhe të domosdoshme për shmangien e dëmit, ky i fundit do të shkarkohet nga përgjegjësia. Gjithashtu bazuar edhe në rrethanat në të cilat ka ndodhur veprimi i kundërligjshëm, pra është shkaktuar dëmi dhe mundësisë së personit mbi të cilin bie përgjegjësia për ta shmangur shkaktimin e këtij dëmi, gjykata përcakton masën e përgjegjësise.

Por, në mënyrë më të zgjeruar këtëçështje e kam trajtuar në kapitullin ku janë shtjelluar secili prej llojeve të dëmeve jashtëkontraktore.



#### 3.5.4. Lidhja shkakësore

Neni 609 i Kodit Civil parashikon shprehimisht se: “Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit,”<sup>72</sup> duke sanksionuar në këtë mënyrë lidhjen shkakësore si një ndër elementët e domosdoshëm, që duhet të ekzistojë i lidhur ngusht me tre elementët e tjerë për lindjen e përgjegjësisë civile për dëmin jopasuror.

Lidhja shkakësore është një kategori objektive, e cila përfaqëson pjesën e brendëshme të saj, atë që nuk duket. Ajo përmban dhe shpreh qëndrimin psikik të personit ndaj veprimit ose mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm dhe pasojave të ardhura ose që rrezikojnë të vijnë prej tyre në sjelljen e autorit, por pavarësisht kësaj, nuk mund të ndahet nga ana subjektive, kjo për faktin se ana subjektive zbulohet e qartësohet edhe nëpërmjet anës objektive të saj. Kjo, pasi proceset e brendëshme psikike dhe psikologjike, jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në shkaktimin e dëmit gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive.<sup>73</sup> Referuar dispozitës që ka të bëjë me lidhjen shkakësore, del se ajo duhet të jetë e çastit ose e menjëhershme dhe e drejtpërdrejtë.<sup>74</sup>

Lidhja shkakësore është *e drejtpërdrejtë* atëherë kur nuk vepron asnjë faktor tjetër i jashtëm apo i brëndshëm nga momenti i kryerjes së faktit të paligjshëm deri në momentin e shkaktimit të dëmit jopasuror. Lidhja shkakësore është *e menjëhershme* ose *e çastit* atëherë kur dëmi vjen pa vonesë.

Në rast se dëmi është shkaktuar nga kryerja e disa veprimeve apo mosveprimeve, atëherë do të duhet të përcaktohet nëpërmjet ekspertëve përkatës se cili ka qenë veprimi ose mosveprimi determinant në shkaktimin e dëmit. Për të ilustruar këtë po parashtoj si shembull

---

<sup>72</sup> Neni 609 i Kodit Civil.

<sup>73</sup> Elezi, I, KAÇUPI, S, Dr. HAXHIA, M. (2001) “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, shtëpia botuese “GEER”, Tiranë, fq 102.

<sup>74</sup> Pannet, A. (1995) “ Law of Torts 7<sup>th</sup> ed” ,London: TheM&E Hand Book Series, fq. 197.

një rast nga Gjykata e Apelit të Milanos: Gjykata e Apelit në Milano, në Seksionine 2-të Civil ka marrë një vendim, më 14 Shkurt 2003, ku ka mohuar ekzistencën e lidhjes shkakësore midis faktit të paligjshëm dhe dëmit të pretenduar prej të dëmtuarës. E dëmtuara kishte tentuar të vetëvritej duke pirë ilaçe gjumi në sasi mbi normën e lejuar nga mjekësia, për shkak të dëmit që pretendonte se i ishte shkaktuar nga zhurmat irrituese të një ndërmarrjeje që ishte ndërtuar afër banesës së saj. Gjykata nga shqyrtimi i rrethanave dhe provave shkresore të paraqitura në gjykim, arriti në përfundimin se dëmi që i ishte shkaktuar të dëmtuarës mund të ishte pasojë e faktorëve të tjerë, por jo e zhurmës së ndërmarrjes, duke evidentuar në këtë mënyrë mungesën e lidhjes shkakësore. Në këtë rast, gjykata konstatoi vetëm çënim në lidhje me të drejtën për të gëzuar qetësi familjare.<sup>75</sup>

Sipas Vendimit Unifikues Nr. 12 të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë<sup>76</sup>, në zbatim të nenit 609 të Kodit Civil për pranimin e përgjegjësisë civile si pasojë e dëmit jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore *materiale* ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) së paligjshme e me faj dhe dëmit të shkaktuar. Në vijim, për përcaktimin e dëmtimeve (çënimeve) konkrete që rrjedhin nga ky fakt i paligjshëm dhe caktimin e dëmshpërblimit përkatës, duhet të vërtetohet edhe lidhja shkakësore *juridike* ndërmjet tyre.<sup>77</sup>

Përsa i përket lidhjes shkakësore *juridike*, duhet të vërtetohet lidhja shkak-pasojë ndërmjet faktit të paligjshëm në tërësinë e tij dhe çënimeve konkrete të pësuar në të drejta dhe interesa të ligjshme, si të subjektit pasiv mbi të cilin ka vepruar direkt ky fakt i paligjshëm, ashtu dhe të personave të tretë të cilët rezultojnë të dëmtuar si rrjedhojë e pasojave që pranohet se vijnë zakonisht nga i njëjti fakt i paligjshëm, sipas parimeve të rregullshmërisë dhe eficencës së lidhjes shkakësore (*id quod plerumque accidit*).

---

<sup>75</sup> Vendim , 14 shkurt 2003, Gjykata e Apelit, Milano.

<sup>76</sup> Vendimi Unifikues nr. 12 i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë.

<sup>77</sup> Neni 609 i Kodit Civil.

Pra, sikurse u tha dhe më lart një ndër kushtet e përgjithshme dhe eventuale për lindjen e përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar, është edhe lidhja kauzale (shkakësore) që ekziston ndërmjet veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Lidhja kauzale (shkakësore) paraqet në fakt një rrethanë të komplikuar pasi në praktikë mund të ndodhë që një shkak i vetëm të sjellë ardhjen e disa pasojave të ndryshme, apo disa shkaqe të sjellin një pasojë të vetme. Lidhja kauzale (shkakësore) paraqet raportin e ndërsjelltë, ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e tij e ardhur nga veprimi.

Çdo ngjarje që është kusht për dëmin, d.m.th pa të cilin ky dëm nuk do të kishte ndodhur, konsiderohet si një shkak për ardhjen e pasojës, akti i cili e detyron autorin e saj të shpërblejë dëmin plotësisht.<sup>78</sup> Lidhja kauzale (shkakësore) si kusht i përgjithshëm për lindjen e përgjegjesisë për shpërblimin e dëmit duhet të ekzistojë sikurse tek detyrimet deliktore, ashtu edhe tek detyrimet kontraktore.

Tek përgjegjësia për të tretët, lidhja kauzale (shkakësore) paraqitet si kusht i domosdoshëm. Gjithashtu, edhe kur dëmi shkaktohet si rezultat i fuqisë madhore apo është i rastësishëm, përsëri lidhja kauzale (shkakësore) duhet të jetë prezent për lindjen e përgjegjesisë. Këtë çështje e gjejmë të rregulluar në doktrinat juridike, në ato vendase dhe ato të huaja, si edhe në praktikat gjyqësore të këtyre vendeve. Ndërkaq, Kodi ynë Civil në nenin 609, paragrafi 1 thotë: *“Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtëpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit”*, kurse paragrafi tjetër vazhdon: *“Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar”*.<sup>79</sup>

---

<sup>78</sup>Gérard, L. (2008) *“E Drejta Civile-Detyrimet,”* botimi i 19-të, fq. 158. Profesor në Universitetin “Paul-Cézanne” (Aix-Marseille III).

<sup>79</sup>Neni 609 i Kodit Civil.

Lidhja kauzale (shkakësore) jo gjithmonë mund të vërtetohet në mënyrë të lehtë dhe të qartë. Kështu, për gjykatat në raste të caktuara paraqiten situata të komplikuar, ku është shumë vështirë të mund të konstatohet dhe vërtetohet kjo lidhje ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe pasojës së krijuar. Ekzistenca e lidhjes kauzale (shkakësore) është e domosdoshme të konstatohet dhe vërtetohet në të gjitha rastet, qoftë tek përgjegjësia individuale, apo tek përgjegjësia për të tretët, ashtu edhe tek ajo për sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme. Në praktikën gjyqësore preferohet që gjykatat në rastet e shqyrtimit dhe vendimarrjes lidhur me çështjet për shpërblimin e dëmit, me qëllimin për të përcaktuar sa më saktë lidhjen kauzale (shkakësore), të shfrytëzojnë punën e ekspertëve të fushave të ndryshme, në mënyrë të atillë që edhe të marrë një vendim sa më të drejtë.<sup>80</sup>

Lidhja kauzale (shkakësore) paraqet një kategori objektive. Ajo duhet të jetë e atillë që të dëshmojë qartë për ngjarjen e cila ka ardhur si rezultat i pasojës së veprimit apo mosveprimit të personit. Pavarësisht se nga lind veprimi apo mosveprimi i personit, nga vetë iniciativa apo nga ndikimi i rrethanave të jashtme, e rëndësishme është që ky veprim të jetë i lidhur drejtpërdrejt me pasojën e krijuar.<sup>81</sup> Në lidhje me përcaktimin e lidhjes kauzale (shkakësore) në doktrinën juridike janë krijuar disa teori:

a) *Teoria e kushtit*. Sipas përfaqësuesve të kësaj teorie, shkaktimi i dëmit mund të vijë si nga veprimi, ashtu edhe nga mosveprimi i personit. Si veprim i dëmshëm i palës duhet marrë ai veprim pa të cilin nuk do mund të shfaqej pasoja e dëmshme. Kështu, p.sh., kur personi është nisur të shkojë me automjet për në aeroport për të shkuar jashtë shtetit dhe për fajin e një personi të tretë vjen deri tek aksidenti i komunikacionit. Si rezultat i vonës së shkaktuar, personi nuk e kryen fluturimin e tij me aeroplanin e prenotuar, por me një aeroplan tjetër më vonë. Por, ky aeroplan pëson një avari dhe rrëzohet. Nga ky aksident asnjëri nga

---

<sup>80</sup>Weir, T. (1996) "A Case Book on Tort, 8<sup>th</sup> Ed", London: Sweet and Maxwell, fq. 74

<sup>81</sup>Tutulani-Semini, M. (2006) "E drejta e detyrimeve dhe kontratave," Pjesa e Posaçme, Skanderbeg book, fq.145.

personat në avion nuk mbijeton. Tani, sipas teorisë së kushtit, për të realizuar të drejtën për zhdëmtim të dëmit jomaterial për shkak të humbjes së të afërmit, duhet të konstatohet elementi i lidhjes kauzale (shkakësore) midis veprimit apo mosveprimit që ka shkaktuar pasojën e vdekjes së personit dhe vetë pasojës.<sup>82</sup> Po sipas përfaqësuesve të kësaj teorie, përgjegjësia bie mbi personin e tretë me fajin e të cilit u shkaktua fillimisht aksidenti në komunikacion, dhe rrjedhimisht është pikërisht ai subjekti përgjegjës për shpërblimin e dëmit, pavarësisht se shkak kryesor i aksidentit dhe vdekjes së personave është defekti që pësoi aeroplani.

Sipas kësaj teorie, pasoja e dëmit vjen nga rrethana e parë (kushti fillestar), e cila në mënyrë të ndërlidhur ka ndikuar në rrethanat e tjera. Kjo teori nuk më duket shumë e saktësepse është i palogjikshëm arsyetimi që shkaktar për shkaktimin e vdekjes së personit, të merret personi që ka shkaktuar incidentin në komunikacion, pasi do të zgjerohej aq shumë përgjegjësia civile sa që do të tejkalonte kufijtë e asaj që në fakt mund të konstatohet saktë si përgjegjësi për dëmin e shkaktuar. Disa autorë këtë teori ndryshe e quajnë si *teori e kushtit fillestar*, pa të cilin nuk do të vinte shkaktimi i pasojës, duke i lënë mënjane të gjitha veprimet e tjera të mëvonshme që kanë ndikuar në shkaktimin e dëmit.<sup>83</sup>

Nga e gjithë kjo mund të arrijmë në përfundimin se lidhja kauzale (shkakësore), sipas kësaj teorie, paraqitet si raporti ndërmjet veprimit fillestar si shkak kryesor, i cili i përfshin të gjitha veprimet e mëvonshme, edhe dëmin e përgjithshëm si pasojë që shkaktohet që nga fillimi dhe deri në përfundimin e veprimeve. Kjo teori sot nuk pranohet në praktikatat gjyqësore të asnjërit vend dhe konsiderohet absurde për shkak të qasjes së saj.

*b) Teoria e kauzalitetit të drejtëpërdrejtë.* Sipas kësaj teorie, që të ekzistojë përgjegjësia civile në rastin e shkaktimit të dëmit, pasoja duhet të jetë shkaktuar nga veprimi i drejtëpërdrejtë i personit. Po sipas kësaj të fundit, rëndësi juridike ka vetëm veprimi i

---

<sup>82</sup>Sallabanda, A. (1962) "E Drejta e Detyrimeve", pjesa e përgjithshme, Tiranë, fq. 64.

<sup>83</sup>Dauti, N. (2001) "E drejta e detyrimeve", Prishtinë, fq. 184.

drejtëpërdrejtë që paraqitet si shkak i pasojës, duke mospërfshirë edhe veprimet e tjera të tërthorta. Këtë zgjidhje e përkrahin një pjesë e legjislacioneve dhe praktikave gjyqësore. Edhe Kodi Civil i Francës, në nenin 1151, parashikon se *“kur shkelja e detyrimeve kontraktore rezulton nga mashtrimi i debitorit, zhdëmtimi nuk do të përfshijë çdo humbje që ka pësuar kreditori dhe fitimin e munguar, por vetëm atë dëm që shkaktohet nga shkelja e menjëhershme dhe e drejtëpërdrejtë e marrëveshjes juridike.”*<sup>84</sup> Kështu, p.sh., në rast se dikush pengohet të udhëtojë me anijen e paracaktuar dhe udhëton më vonë me një anije tjetër, dhe këtij të fundit i vjen një pasojë e dëmshme, atëherë përgjegjësia për shpërblimin e dëmit do të bjerë mbi kompaninë e anijes së dytë, pronë e së cilës është.

Edhe kjo teori nuk i ka shpëtuar vërejtjeve duke qenë se përfshin vetëm dëmin e shkaktuar, por nuk përfshin fitimin e munguar dhe nuk merr parasysh as rrethanat e tërthorta që mund të ndikojnë në shkaktimin e pasojës së dëmshme. Kështu, p.sh.: nëse një tregtar i shet një kafshë të infektuar dikujt, dhe me këtë rast blerësit i infektohen edhe kafshët e tjera, të cilat më pas ngordhin, blerësi do fitojë të drejtën për kthimin e parave për kafshën e blerë që doli e infektuar dhe të drejtën për shpërblimin e dëmit për kafshët e ngordhura, por jo shpërblimin edhe për dëmin që rezulton nga pamundësia për të fituar (fitimin e munguar).

*c)Teoria e kauzalitetit adekuat.* Sipas kësaj teorie, në rastin e shkaktimit të dëmit merret për bazë raporti ndërmjet veprimit të dëmshëm, i cili duhet të jetë në proporcion me dëmin e shkaktuar, dhe përcaktohet se sa ajo pasojë është adekuate me veprimin e dëmshëm. Kjo teori për dallim nga dy të parat, merr parasysh të gjitha shkaqet që mund të kenë ndikuar në shkaktimin e dëmit. Për lidhjen kauzale, si element të përgjegjësisë civile, merret parasysh ajo rrethanë e cila sipas natyrës së vet dhe rrjedhës normale të funksionimit të gjërave, do të ndikojë që të shkaktohet dëmi.<sup>85</sup> Sipas saj, vlerësimi i të qenit adekuat ose jo, i rrethanave që shkaktojnë dëmin, varet nga kritere subjektive apo prej bindjes së brendshme të gjykatës. Kjo

---

<sup>84</sup>Neni 1151 i Kodit Civil Francez.

<sup>85</sup>Alajdin, A. (2001) *“Studime nga e drejta e detyrimeve I”*, Prishtinë, fq. 147.

teori më së shumti gjen zbatim në praktikën gjyqësore të Gjermanisë, Zvicrës, Austrisë, Francës, etj. Sipas teorisë gjermane, lidhja kauzale është adekuate, nëse veprimi i dëmshëm në përgjithësi është adekuat që të sjellë pasojën e dëmit, por jo në rastet kur pasoja mund të shkaktohet si rezultat i rrethanave specifike krejtësisht të paparashikuara më parë, për të cilat sipas rrjedhës së zakonshme të punëve nuk mbahet llogari.<sup>86</sup> Edhe Gjykata Federale e Zvicrës në lidhje me teorinë e shkakut adekuat ka dhënë këtë mendim: *“Lidhja kauzale adekuate ekziston vetëm atëherë kur shkak i dëmit, sipas rrjedhës së zakonshme të ngjarjeve dhe sipas përvojës së jetës, është adekuat për ardhjen e pasojës”*.<sup>87</sup>

Në disa raste iniciativa për veprimin e personit mund të lindë për fajin e personit të dëmtuar, apo edhe për fajin e personit të tretë. Ky fakt e komplikon përcaktimin e personit përgjegjës. Përveçse me veprim, personi dëmtuar mund ta shkaktojë edhe me mosveprim, siç mund të jetë, p.sh., rasti kur paraqitet ndonjë sëmundje infektive, me çka rrezikohet të infektohen dhe individë të tjerë në rast se nuk merren masat e duhura për kurimin apo vaksinime personave të infektuar. Në rastet kur dëmi shkaktohet me më shumë veprime apo me disa veprime anësore, atëherë paraqitet vështirësia që të përcaktohet saktë se cili ka qenë veprimi apo shkak i dëmit që ka përcaktuar ardhjen e pasojës.

Në doktrinë ka mjaft dilema në lidhje me faktin nëse mundet që mosveprimi apo sjellje të caktuara të paraqiten si shkak i ardhjes së dëmit. Përkundër kësaj dileme në praktikën gjyqësore ndodh shpeshherë që si shkak i dëmit të paraqitet mosveprimi i subjektit të caktuar. Këto raste më shpesh shfaqen tek mosplotësimi i detyrimeve kontraktore. Ndërmjet mosveprimit të palës në këtë rast dhe dëmit të shkaktuar ekziston edhe lidhja kauzale. Kjo pasi, nëse pala do ta plotësonte prestimin obligator, nuk do vinte as shkaktimi i dëmit, aslindja e përgjegjësisë juridiko-civile.

---

<sup>86</sup>Gale, G., Jadranka. (2004) *“E drejta e detyrimeve”*, pjesa e përgjithshme, Beograd, fq. 189.

<sup>87</sup>Grosse, M. (2010) *“Probleme und Lösungen der Schadenregulierung bei Massenkollisionen”*, Universität Basel, Juristische Fakultät, fq. 4.

Përgjegjësia civile lind vetëm nëse konstatohet lidhja kauzale ndërmjet veprimit apo mosveprimit të personit, ose zotërimit të sendeve të rrezikshme apo marrjes me veprimtari të rrezikshme dhe shkaktimit të dëmit, pa qenë nevoja që të ekzistojë faji i subjektit përgjegjës, për dallim nga përgjegjësia penale, e cila lind vetëm atëherë kur vërtetohet lidhja kauzale dhe fajësia e subjektit përgjegjës.

*Nevoja e konstatimit të lidhjes shkakësore.* Për të lindur përgjegjësia civile nuk mjafton konstatimi i një dëmi dhe kundërligjshmëria e tij. Duhet vendosur gjithashtu ndërmjet tyre një raport shkak-pasojë. Pra, duhet provuar që ky dëm e ka burimin në këtë fakt, domethënë në veprimin e autorit të dëmit. Ky kusht i përgjegjësive civile është së pari një kërkesë e arsyeshme dhe, së dyti është e imponuar nga ligji.<sup>88</sup>

Neni 608 i Kodit Civil detyron çdo person, i cili në mënyrë të paligjshme dhe me faj *shkakton* një dëm, me shpërblimin e këtij të fundit.<sup>89</sup>

Gjithashtu, edhe në parashikimet e neneve të tjera 621, 622, 623, 628, 636 gjejmë përdorimin e foljes "*shkakton*."<sup>90</sup> Jo vetëm kaq, por legjislatori, në ndryshim nga rregullimet e mëparshme ligjore, edhe në nenin 609/1 të Kodit Civil ka përcaktuar shprehimisht nevojën e konstatimit të lidhjes shkakësore duke parashikuar se: "*Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.*"<sup>91</sup>

Evidentimi i lidhjes shkakësore do të ishte relativisht i thjeshtë nëse dëmi do të kishte lidhje me një shkak të vetëm, lehtësisht të identifikueshëm. Por, në shumicën e rasteve një dëm është rezultat i shumë faktorëve, lidhja mes të cilëve është e domosdoshme për ardhjen e pasojës së dëmshme.<sup>92</sup>

---

<sup>88</sup>RFV Husten , Buckley RA, Salmond , Hustenon. (1992) " The Law of Torts 20<sup>th</sup>Ed ", London: Sweet and Makwell , fq.27.

<sup>89</sup>Neni 608 i Kodit Civil.

<sup>90</sup>Nenet 621, 622, 623, 628, 636 të Kodit Civil.

<sup>91</sup>Neni 609/1 i Kodit Civil.

<sup>92</sup>Corkin, J.(2008) "Science, Legitimacy and the Law: Regulating Risk Regulation Judiciously in the European Community", 33 ELRev 359.



Të gjithë këta faktorë çojnë drejt dëmit final si një zinxhir, dhesikur një hallkë të mungonte, pasoja nuk do të vinte. Atëherë lind pyetja nëse e drejta duhet t'i ketë parasysh të gjithë këta faktorë në përcaktimin e lidhjes shkakësore dhe raportit shkak-pasojë? Ndoshta përgjigjia do të ishte pozitive në rast se do të kishte barazi ndërmjet shkaqeve fizike dhe atyre juridike. Por, e drejta nuk mund të marrë në konsideratë çdo shkak i cili mund të përcaktohet nga një konstatim i thjeshtë, por do të veçojë vetëm ato shkaqe që përbëjnë *shkakun juridik* të dëmit.<sup>93</sup>

Përcaktimi i lidhjes shkakësore paraqet vështirësi në praktikë, duke përbërë një problem, që teorikisht nuk mund të thuhet se është zgjidhur. Ende ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me këtë çështje. Në fakt, është e vërtetë se për lidhjen shkakësore nuk është dhënë një përkufizim i saktë shkencor, duke ia lënë në këtë mënyrë vlerësimin e saj arsyes, përvojës praktike dhe çmimit të gjykatës.

### **3.6. Rastet e ndryshme të përgjegjësisë**

#### *3.6.1. Përgjegjësia me faj e vetë personit i cili ka shkaktuar dëmin*

*Përgjegjësia për faj të vetë personit për dëmin e shkaktuar në të drejtën e Detyrimeve dhe më gjerë.* Përgjegjësia për faj të vetë personit ka ekzistuar si në të drejtat më të vjetra, në të drejtat e mëvonshme, vazhdon të ekzistojë në të drejtën bashkëkohore dhe do të ekzistojë edhe në të ardhmen, sepse nuk mund të paramendohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar pa faj. Përgjegjësia sipas bazës së fajit është lloji më me rëndësi i përgjegjësisë civile (responsabilite civil, civil responsibility).

---

<sup>93</sup>RFV Husten , Buckley RA, Salmond , Hustenon. (1992) "The Law of Torts 20<sup>th</sup> Ed", London: Sweet and Makwell , pp 30.

Ajo përfaqëson një kulturë të lartë të trashëgimisë juridike, e cila është shprehje relative e sigurisë juridike pasi sanksionon rregullën: *“Kush në bazë të fajit të vet i shkakton dëm tjetrit, do të përgjigjet për të”*, si dhe paraqet afërsi më të madhe me parimin e drejtësisë (iustitia, aequitas) në qarkullimin juridik të njeriut ose të pjesëmarrësve të tjerë.

Kjo bazë juridike e përgjegjësisë për dëmin është civilizim juridik shekullor sepse ka krijuar rregullën shekullore sipas të cilës: *“Kush me fajin e vet ose me sjellje të fajshme i shkakton dëm tjetrit, ai sipas rregullës është i detyruar të shpërblejë dëmin.”* Kjo bazë e përgjegjësisë për dëmin e ka bazën juridike në rregullën morale, ngase konsiderohet se është morale që ai i cili i shkakton dëm tjetrit me dashje (dolus), ose nga pakujdesia e rëndë (culpa lata), ose me qëllim të dëmtimit (animus noncendi), duhet të përgjigjet për dëmin e shkaktuar. E gjitha kjo nënkupton se faji për dëmin është bazë e përgjegjësisë edhe sipas rregullave të drejtësisë (iustitia, aequitas) ngase konsiderohet se baza e përgjegjësisë sipas fajit gjen mbështetje edhe në rregullat e parimit të drejtësisë.<sup>94</sup>

Prandaj, me të drejtë thuhet se kjo bazë juridike e përgjegjësisë për dëmin përbënnjë bazë juridike të gjerë të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar sepse ka afirmuar rregullën e madhe të përgjegjësisë civile, ngase konsideron se nuk ka drejtësi më të lartë se sa të përgjigjet dëmtuesi për dëmin, duke qenë se dëmi është shkaktuar në bazë të fajit të tij. Për këtë arsye kjo bazë e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar gëzon mbështetjen më të fortë e më të madhe në këtë lëm dhe gëzon respektin e së drejtës, drejtësisë, moralit, politikës, pedagogjisë dhe filozofisë juridike.<sup>95</sup>

Ajo është shprehje e evoluimit në rezonimin juridik, sepse është imperative juridikisht dhe moralisht, që çdokush duhet të japë llogari për sjelljen e vet. Ndaj, duke marrë parasysh gjithë këtë, mësuesi i madh i shkencave juridike Prof. Dr. Mihailo Konstantinović ka thënë mes të tjerash: *“Kur dikush është fajtor për dëmin, atëherë ne jemi në kala”* qëdo të thotë se

---

<sup>94</sup> Biondi, A., Farley, M. (2009) *“The Right to Damages in European Law”*, Kluwer.

<sup>95</sup> Tutulani-Semini, M. (2006) *“E drejta e detyrimeve dhe e kontratave”*, pjesa e përgjithëshme, Tiranë, fq. 145.

*kemi një përgjegjës dhe si e tillë do kemi dhe një dëmshpërblyes*". Mjerisht në të kaluarën, por dhe në të drejtën bashkëkohore, në praktikën gjyqësore ka raste kur fajtori i ngarkuar me përgjegjësi deliktore dhe kontraktore për dëmin nuk përgjigjet për shkak të rrethanave të ndryshme.<sup>96</sup> Kjo përbën një aspekt negativ të kësaj baze të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar. Kuptohet që ky fakt nuk është dominues në këtë lëm, dhe as që është me efekt të veçantë, por në jetën e përditshme ky konstatim ekziston në marrëdhëniet e ndryshme të detyrimeve dhe më gjerë.

### 3.6.2. Përgjegjësia për të tjerët.

Doktrina juridike, praktika gjyqësore, si dhe legjislacionet e ndryshme nacionale, përveç përgjegjësisë subjektive dhe përgjegjësisë objektive, njohin edhe raste tjera të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, një ndër të cilat në terminologji njihet *sipërgjegjësia për të tjerët*. Kjo lloj përgjegjësie është krijuar me qëllimin që të mos kemi asnjë rast ku pala të cilës i është shkaktuar dëmi të ngelet e pazhdëmtuar.<sup>97</sup> Ky rregull i përgjegjësisë bën përjashtim nga rregullat tradicionale, ku specifikohet se çdokush përgjigjet vetëm për veprimet e veta, dhe se askush nuk përgjigjet për veprimet e të tjerëve. Te ky lloj i përgjegjësisë nuk përgjigjet shkaktuesi i dëmit, por personi tjetër që nuk e ka shkaktuar dëmin, por i cili gjendet në një raport të caktuar juridik me shkaktuesin e dëmit.<sup>98</sup>

Personat, të cilët mund të jenë në një raport të caktuar juridik me shkaktuesin e drejtpërdrejtë të dëmit dhe që ngarkohen ta shpërblejnë atë, mund të jenë në cilësinë e prindërve të shkaktuesit të dëmit, kujdestarit apo organit të kujdestarisë; personi juridik, kur dëmin e shkakton punëmarrësi në lidhje me punën që kryen tek punëdhënësi, etj.

---

<sup>96</sup> Vukovic, M. (1971) "Përgjegjësia për Dëmin", Zagrep, fq. 82.

<sup>97</sup> Dobbs, Dan B, Hayden, Paul T. (2001) "Torts and Compensation Personal Accountability and Responsibility for Injury 4<sup>th</sup> ed", St. Paul, Minn, West Group, fq 29.

<sup>98</sup> Harris, D. (1988) "Remedies in Contract and Tort", London, fq. 98.

Parashikimin e një përgjegjësie të tillë e kërkon mbrotja e interesit të subjekteve të dëmtuara.<sup>99</sup>

*Ku e ka bazën kjo lloj përgjegjësie?*

Përgjegjësia për të tjerët rrjedh nga lidhshmëria e veçantë apo nga raportet e veçanta juridike që ekzistojnë ndërmjet personave të cilët me veprimet e tyre kanë shkaktuar dëmin dhe personave që do të përgjegjigjen për të.

Për të ekzistuar përgjegjësia për të tjerët duhet të plotësohen këto kushte:

- të shkaktohet dëmi;
- dëmin ta shkaktojë personi që është në lidhje të veçantë juridike me personin përgjegjës;
- të ekzistoj lidhja kauzale midis veprimit që është ndërmarrë dhe dëmit të shkaktuar;
- dëmi të shkaktohet nga lëshimet eventuale të personit përgjegjës.<sup>100</sup>

Që pala e dëmtuar të realizojë të drejtën për kompensim, të katër kushtet e sipërcituara duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Kusht i përgjegjësive në këto raste është faj i supozuar. Ky faj në disa raste është relativ “*presumptio iuris tantum*”, që do të thotë se subjekti përgjegjës ka mundësi që përmes provave të vërtetojë pafajsinë e vet, ndërsa në disa raste të tjera ai është me karakter absolut “*presumptio iuris et de iure*”, që do të thotë se subjekti përgjegjës nuk është fajtor për dëmin e shkaktuar nga një subjekt tjetër.<sup>101</sup>

Ka mendime të ndryshme përse i përket bazës së përgjegjësive për të tretët. Sipas një mendimi, baza e kësaj përgjegjësie krijohet nga elementi i fajit tëpersonit përgjegjës, pasi ky i fundit nuk i ka marrë të gjitha masat që të mos vijë shkaktimi i dëmit, dhe prandaj, në këtë rast do të prezumohet fajësia e subjektit përgjegjës. Sipas një mendimi tjetër, baza e

---

<sup>99</sup> Tesfaye, N. (1996) “*Extra Contractual Liability and Unjust Enrichment*”, Artist Printing Press, Addis Ababa.

<sup>100</sup> Alishani, A. (2002) “*E drejta e detyrimeve*,” Prishtinë , fq. 487.

<sup>101</sup> Đorđević, Ž. , Stanković, V. (1974) “*E drejta e detyrimeve*,” Beograd, fq. 343.

përgjegjësisë për të tjerët nisët nga mbrojtja e interesit të palës së dëmtuar, pasi ndodh në disa raste, që dëmtuesi të jetë i paafët për të gjykuar,<sup>102</sup> si dhe subjekti përgjegjës të ketë një interes legjitim nga shkaktimi i dëmit, dhe si rezultat i kësaj, do të duhet që të përgjigjet subjekti përgjegjës. Prandaj, mund të themi se nuk ka bazë unike për këtë lloj të përgjegjësisë, por mund të aplikohet cilido prej kushteve të sipërcituara.

Shkaku kryesor i përgjegjësisë për të tjerët/tretët mbështetet në mungesën e mbikqyrjes së nevojshme të disa subjekteve (*culpa in inspiciendo*), në mungesën e instruksioneve të nevojshme (*culpa in instruendo*), si dhe në zgjedhjen e gabuar të personit tjetër ose të punëtorit (*culpa in eligendo*).<sup>103</sup>

Kështu, nga sa u tha më lart, individi i cili për shkak të një sëmundjeje mendore apo prapambetjes në zhvillimin mendor, apo çfarëdolloj rrethane tjetër, nuk është i aftë për gjykim, nuk përgjigjet për dëmin që u shkakton personave të tjerë,<sup>104</sup> pasi ky i fundit është i papërgjegjshëm. Në rastin konkret do të përgjigjet ai, i cili në bazë të ligjit apo vendimit të gjykatës është caktuar si kujdestar ligjor i tij dhe është i detyruar ta mbikqyrë atë. Sipas Kodit Civil, personi i mitur deri në moshën 7-vjeçare nuk përgjigjet fare për dëmin e shkaktuar, kurse nga shtatë deri në katërbëdhjetë vjeç, do përgjigjet vetëm në rastin kur vërtetohet se ka qenë i vetëdijshëm për shkaktimin e dëmit, pra pasojat e ardhura nga veprimi i tij i kundërligjshëm.

Në të gjitha këto raste detyrimi për shpërblimin e dëmit i kalon apo ngarkohet prindit, apo edhe kujdestarit ligjor të fëmijës si përfaqësues ligjor i tij.

Personat e mitur mbi katërbëdhjetë vjeç, të cilët kanë zotësi të kufizuar për të vepruar sipas legjislacionit tonë në fuqi, do të përgjigjen sipas rregullave të përgjithshme për shpërblimin e dëmit. Në qoftëse i shohim me kujdes situatat e lartpërmendura, vërejmë se

---

<sup>102</sup> Hervej, T. K., Kenner, J (eds). (2003) "Economic and Social Rights under the EU Charter of Fundamental Rights", *A Legal Perspective* Hart Publishing, fq. 105.

<sup>103</sup> Živković, S. "Shpërblimi i dëmit material dhe jomaterial," *Beograd*, fq. 22.

<sup>104</sup> Heukels, T., McDonnell, A. (1997) "The Action for Damages in Community Law", *The Hague/London/Boston*, fq. 40.

ligjvënësi ka bërë dallimin ndërmjet shkaktuesit faktik të dëmit dhe personit përgjegjës që paraqitet si shkaktues juridik i dëmit.<sup>105</sup> Personi përgjegjës përgjigjet për veprimet e tjetrit mbi bazën e fajit të supozuar, pasi besohet se nuk ka ushtruar mbikqyrjen e nevojshme ndaj fëmijës, personit nën kujdesuri apo punëtorit, etj.<sup>106</sup> Por, nëse dëshmon se i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për mbikqyrje, ai edhe mund të lirohet nga përgjegjësia, gjithmonë nëse vërtetohet se edhe përkundër këtyre masave dëmi do të shkaktohej gjithsesi.

---

<sup>105</sup> Pop Georgiev, D. (1985) "E drejta e detyrimeve", Shkup, fq. 85.

<sup>106</sup> Hodgson, J., Lewthwaite, J. (2004) "Tort Law", Oxford University Press, fq. 157.

## KAPITULLI I KATËRT

### BAZAT E PËRGJEGJËSISË

#### 4. Baza juridike e përgjegjësisë sipas llojit të dëmit jashtëkontraktor

Në të drejtën e Detyrimeve ekziston një rregull i përgjithshëm sipas të cilit, çdo njeri është përgjegjës për veprimet e tij dëmtuese lidhur me shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj një personi tjetër. Sipas Kodit Civil, çdo individ që i shkakton dëm tjetrit, është i detyruar ta dëmshpërblejë këtë të fundit për dëmin e shkaktuar, qoftë ai material apo moral. Me qëllim për të garantuar sigurinë juridike të individit të dëmtuar në lidhje me shpërblimin e tij përdëmine pësuar, në ligjinë sanksionuar edhe përjashtime nga ky rregull bazë. Këtu i referohemi rasteve kur për dëmin e shkaktuar nuk do të përgjigjet shkaktuesi i drejtpërdrejt i dëmit, por një person tjetër, si p.sh.: rasti i përgjegjësisë së prindit, përkatësisht kujdestarit për dëmin e shkaktuar nga ana e fëmijës së moshës jomadhore; rasti i përgjegjësisë së birësuesit për dëmin e shkaktuar nga i birësuari jomadhor; rasti i përgjegjësisë së ndërmarrjes, përkatësisht të personit juridik për dëmin e shkaktuar nga punëtori i tij.<sup>107</sup>

Në vijim do të trajtohen bazat e përgjegjësisë që rrjedh nga shkaktimi i një dëmi, por që nuk ka qenë rezultat i veprimeve të vetë personit përgjegjës. Në këto raste dëmi është shkaktuar nga një i tretë, për të cilin përgjigjet civilisht personi i përcaktuar sipas dispozitave të Kodit Civil.

Sipas Kodit tonë Civil, personi fiton zotësi të plotë për të vepruar në moshën 18-vjeçare. Në këtë moshë ai mund të fitojë të drejta, si edhe mund të marrë përsipër detyrime.

---

<sup>107</sup> Kondili, V. (2008) "E drejta civile", pjesa e përgjithëshme, Tiranë, fq. 266.

Ndërsa një i mitur që ka mbushur moshën 14-vjeçare ka zotësi të kufizuar për të vepruar. Siç mund të kuptohet, *zotësia për të vepruar* është gjithashtu kusht për ngarkimin e një individi me përgjegjësi civile si rezultat i shkaktimit të një dëmi.

Megjithatë, duke iu referuar Kodit Civil, i cili e ka lidhur përgjegjësinë e personit me aftësinë e tij për të kuptuar rëndësinë e veprimeve që kryen, në rastin kur dëmi është shkaktuar nga një person i cili nuk ka qenë i ndërgjegjshëm për veprimet e tij, ai gjithsesi do të përgjigjet civilisht për shpërblimin e dëmit.

Në këtë rast gjykata vetëm mund të marrë në konsideratë moshën, shkallën e ndërgjegjes dhe kushtet ekonomike të palëve. Ajo nuk mund ta bëjë këtë kur vetë autori i dëmit e ka sjellë veten në një gjendje të tillë. Kurse, parimi i përgjithshëm, sipas të cilit personat që nuk kanë zotësi për të vepruar nuk mbajnë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara, vepron për të miturit dhe personat që me vendim gjyqësor u është hequr kjo zotësi (apo u është kufizuar). Më tej do të trajtoj, si me një rëndësi të veçantë, ndër përgjegjësitë për veprimet e të tjerëve, pikërisht përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga të miturit dhe personat pa zotësi për të vepruar (ose me zotësi të kufizuar).

#### **4.1. Baza e përgjegjësive së prindërve për dëmin e shkaktuar nga fëmijët e tyre të mitur.**

Prindërit janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga fëmija i tyre deri në momentin që fëmijët në bazë të ligjit arrijnë të fitojnë zotësinë e plotë juridike dhe për të vepruar, pavarësisht se në shkaktimin e dëmit nuk kanë vepruar drejtpërdrejt. Nga kjo përgjegjësi mund të lirohen vetëm nëse provojnë se ekzistojnë arsye për përjashtimin e tyre prej saj sipas



rregullave të parashikuara për përgjegjësinë, pavarësisht nga fajti, kjo për shkak të moshës së mitur.<sup>108</sup>

Për veprimet dëmtuese të fëmijës mbi 7 vjeç, prindi dhe kujdestari përgjigjen sipas parimit të fajit të supozuar. Nga kjo përgjegjësi mund të lirohen vetëm kur provojnë se kanë ushtruar mbikqyrjen e nevojshme dhe se dëmi është shkaktuar pa fajin dhe vullnetin e tyre. Për dëmin e shkaktuar nga fëmija i moshës mbi 7 vjeç, përveç prindit, mund të përgjigjet edhe fëmija, në rast se provohet se në momentin e shkaktimit të dëmit, ai ka qenë i aftë për të gjykuar e për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të veta.<sup>109</sup>

Ndërsa, i mituri mbi 14 vjeç konsiderohet se posedon aftësi për të gjykuar, dhe do të jetë përgjegjës sipas bazës së fajësisë për veprimet që i atribuohen atij, sikurse edhe personi i moshës madhore. Ndaj personit të dëmtuar ekziston përgjegjësia solidare e të miturit dhe prindërve.

Për t'u ngarkuar me përgjegjësi prindërit për dëmin e shkaktuar nga fëmijët e tyre, duhet të përmbushen disa kushte. Në radhë të parë duhet të vijë një dëm konkret. Së dyti, dëmi duhet të jetë shkaktuar nga fëmija i mitur. Së treti, në momentin e shkaktimit të dëmit fëmija i mitur duhet të ketë jetuar së bashku me prindin. Dhe, së fundmi, fëmija duhet të mos jetë i vendosur nën mbikqyrjen e një personi tjetër.<sup>110</sup>

Në nenin 613 të Kodit Civil parashikohet shprehimisht: *“I mituri që nuk ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar. Prindërit, kujdestari, ose ata të cilëve u janë besuar ose kanë në mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të fëmijëve nën moshën katërbëdhjetë vjeç, të personave nën*

---

<sup>108</sup>Gate, G. (2010) “Where Are the Parents? Parental Criminal, Responsibility For the Acts of Children”, *University Law Review, Volume 30, Article 4, Lisa Lockwood.*

<sup>109</sup> CEZAR, J., S. SANGCO. (1994) “Filippine Law on torts and damages (revised edition)”, Vol 2, JMC PRESS, fq.157

<sup>110</sup> Wilson, H. (1980) “Parental supervision: A neglected aspect of delinquency”, *The British Journal of Criminology, fq.2.*

*kujdestarinë e tyre dhe të atyre që i kanë nën mbikëqyrje e me të cilët banojnë, por që nuk kanë zotësi për të vepruar, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.*"<sup>111</sup>

Kjo dispozitë ligjore ngarkon me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga fëmijët e mitur nën katërmbëdhjetë vjeç dhe personat që barazohen me ta (të pazotë për të vepruar), apo nga ata të cilëve u është hequr zotësia juridike për të vepruar, prindin apo kujdestarin. Bëhet fjalë kështu, për një dëm të shkaktuar nga një person, i cili nuk mund të jetë mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve. Në këtë rast nuk do të ishte e drejtë që personi i dëmtuar të mos kishte mundësi për të kërkuar shpërblimin e dëmit, vetëm për faktin se ky është shkaktuar nga një person i cili nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi civile. Për këtë arsye ligji ka parashikuar detyrimin e prindërve për shpërblimin e këtij dëmi. Këtu lind pyetja se me çfarë përgjegjësie kemi të bëjmë në këtë rast. Lidhur me këtë çështje ekzistojnë dy mendime.<sup>112</sup>

*Sipas mendimit të parë*, përgjegjësia e prindërve ka për bazë të saj në faktvetë fajin e tyre. Prezumimi i fajësisë në këtë rast lidhet me detyrimin e prindërve për edukim dhe mbikëqyrje të fëmijëve të tyre. Ky prezumim i fajësisë mund të kundërshtohet vetëm në rast se prindërit përgjegjës provojnë se nuk kanë mundur ta ndalojnë shkaktimin e dëmit.<sup>113</sup>

Ndërsa, *sipas mendimit të dytë*, përgjegjësia e prindërve nuk është një përgjegjësi për faj të tyre. Kjo lloj përgjegjësie shpjegohet me *idenë e solidaritetit familjar*, dhe nuk varet nga asnjë lloj faji që ka të bëjë me edukimin apo mbikëqyrjen e fëmijëve. Kështu, sipas kësaj ideje, familja është një grupim i lidhur nga interesa mjaft të gjera dhe nuk është aspak anormale që këto lidhje të arrijnë deri në atë masë që prindi të përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga fëmija i tij.<sup>114</sup> Mjafton të kujtojmë faktin që kur babai ose nëna është detyruar civilisht, e gjithë familja vuan si rezultat i kësaj, pasojat e këtij detyrimi, i cili mund të

---

<sup>111</sup>Neni 613 i Kodit Civil.

<sup>112</sup>Po aty.

<sup>113</sup> Raymond, A. (2005) "Punishing Parents for the Crimes of their Children", Lecturer in Law, The Centre for Law, The Open University, The Howard Journal, Vol 44, No 3. July, ISSN 0265-5527, fq.23.

<sup>114</sup> Kondili, V.(2008) "E drejta Civile", pjesa e përgjithëshme, Tiranë, fq. 266.

varfërojnë së tepërmi mjetet financiare të familjes. Përse atëherë, po sipas kësaj ideje, të mos jetë kështu edhe në rastin e dëmit të shkaktuar nga fëmijët?!<sup>115</sup>

Doktrina jonë juridike ka pranuar se përgjegjësia e prindërve ka si bazë të saj fajin e këtyre të fundit. Faji konsiston në mospërbushjen e detyrimit të tyre për edukimin e fëmijës dhe mbikëqyrjen e tyre. E njëjta situatë vlen edhe për personat të cilëve u është hequr zotësia juridike për të vepruar. Do të jetë kujdestari ligjor apo personi që është caktuar si mbikëqyrës i tij, i cili do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga personi të cilit i është hequr zotësia juridike për të vepruar.<sup>116</sup> Vetë gjendja e një të pazoti për të vepruar imponon një mbikëqyrje të vazhdueshme mbi të, dhe është detyrim i kujdestarit ta bëjë një gjë të tillë.<sup>117</sup>

*Personat përgjegjës.* Duke lexuar nenin 613 të Kodit Civil vëmë re se ligji parashikon që janë *prindërit* ata që do të përgjigjen civilisht. Me këtë formulim është mbajtur parasysht rasti i familjes legjitime, në të cilën babai dhe nëna përgjigjen së bashku për dëmin e shkaktuar nga fëmija i tyre.<sup>118</sup> Por, jo gjithmonë jemi para një fakti të tillë. Kështu, mund të kemi edhe rastin e një martese të zgjidhur nga gjykata, ku fëmija i është lënë për rritje dhe edukim njërit prej prindërve. Në këtë rast, përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga fëmija do të jetë prindi pranë të cilit ai banon, i cili është caktuar si prindi kujdestar për rritjen dhe edukimin e tij. Në rast se fëmija i është lënë për rritje dhe edukim një personi të tretë, pranuk i është caktuar asnjërit prej prindërve, do të jetë personi i tretë të cilit ai i është besuar, i cili do të përgjigjet.<sup>119</sup>

*Kushtet e përgjegjësisë.* Për të ngarkuar me përgjegjësi prindin e një fëmije të mitur nën moshën 14-vjeçare, apo kujdestarin ligjor të një të pazoti për të vepruar, duhet të

---

<sup>115</sup>The Parental Responsibility Act, Legislative Assembly of Manitoba. Winnipeg, MN: Queen's Printer fq. 98

<sup>116</sup>Bardhi, A. (2015) "Parental Liability for Damages Resulting from a Child's Acts", *Journal of Educational and Social Research*, MCSER Publishing, Rome-Italy Vol. 5 No.3, fq. 296.

<sup>117</sup> Geis, G., Binder, A. (2012) "Sins of Their Children: Parental Responsibility for Juvenile Delinquency", *Notre Dam Journal of Law, Ethic and Public policy*, Volume 5, fq.12.

<sup>118</sup>Neni 613 i Kodit Civil.

<sup>119</sup> Nuni, A. (2009) "E drejta Civile", pjesa e përgjithshme, Tiranë, fq. 59.

plotësohen disa kushte të parashikuara edhe nga neni 613 i Kodit Civil. Si të tilla mund të përmendim: moshën nën katërbëdhjetë vjeç apo pazotësinë për të vepruar; bashkëjetesën me prindin apo kujdestarin; ekzistencën e dëmit.<sup>120</sup>

*Mosha e fëmijës apo pazotësia për të vepruar e personit.* Përgjegjësia e prindërve për dëmin e shkaktuar nga fëmija i tyre, parashikuar nga neni 613 i Kodit Civil, ka të bëjë vetëm me dëmin e shkaktuar nga një i mitur nën moshën katërbëdhjetë vjeç. Përcaktimi i moshës së fëmijës do të bëhet lidhur me ditën e shkaktimit të dëmit. Kurse, përgjegjësia e kujdestarit sipas kësaj dispozite do të ketë vend vetëm për personat të cilëve u është hequr tërësisht zotësia për të vepruar.<sup>121</sup>

*Bashkëjetesa.* Paragrafi i dytë i nenit 613 të Kodit Civil parashikon si kusht të lindjes së përgjegjësisë së personit që ka shkaktuar dëmin faktin që ky i funditduhet të banojë me personin përgjegjës, pra ky është koncepti i bashkëjetesës. Nëse i mituri apo personi të cilit i është hequr zotësia juridike për të vepruar nuk banojnë me prindërit apo kujdestarin, atëherë kush do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar? Në këtë rast përgjegjësia do të bie konkretisht mbi personin që ushtron efektivisht dhe juridikisht mbikëqyrjen e të miturit ose të pazotit. Kështu p.sh., në rast se një i mitur ka shkuar me pushime verore tek gjyshërit e tij, do të jenë këta që do të përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga i mituri.<sup>122</sup>

*Shkaktimi i një dëmi.* Pa dyshim që duhet ekzistenca e një dëmi të shkaktuar nga i mituri ose personi të cilit i është hequr zotësia juridike për të vepruar, që të lindë përgjegjësia për prindërit ose kujdestarin ligjor. Por, lind pyetja nëse kërkohet që i mituri, ose personi të cilit i është hequr zotësia juridike për të vepruarthjesht të ketë shkaktuar një dëm, apo duhet gjithashtu që të ketë vepruar me faj? Mendoj se, në qoftë se i mituri ose personi të cilit i është hequr zotësia juridike për të vepruar nuk ka patur asnjë faj në shkaktimin e dëmit, atëherë nuk

---

<sup>120</sup>Michigan parents convicted for kid's crimes. (1996, May 10). American Civil Liberties Union News and Events.

<sup>121</sup>Po aty.

<sup>122</sup>Neni 613 i Kodit Civil.

do të përgjigjen as prindërit dhe as kujdestari ligjor për dëmin e shkaktuar. Kështu, nuk do të ishte e drejtë që të detyrohej prindi apo kujdestari ligjor për shpërblimin e një dëmi, të cilin i mituri ose personi që i është hequr zotësia për të vepruar e ka shkaktuar në rrethana të pavarura nga ai, të cilat nuk mund t'i ndalonte.<sup>123</sup> Në këtë mënyrë rezulton se prindërit apo kujdestarët ligjor, të cilët provojnë se dëmi është shkaktuar pa faj të të miturit apo personit që i është hequr zotësia për të vepruar, nuk do të përgjigjen për dëmin e ardhur.<sup>124</sup>

*Përfundimi i prindërve ose kujdestarit ligjor nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit.* Paragrafi i dytë i nenit 613 të Kodit Civil parashikon përgjegjësinë e prindërve ose kujdestarëve ligjor për dëmin e shkaktuar nga fëmijët ose nga personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar “*përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.*” Siç shihet, është pranuar se personat përgjegjës për shpërblimin e dëmit mund të përjashtohen prej saj, duke provuar se kanë ushtruar një mbikëqyrje të rregullt dhe se u kanë dhënë fëmijëve të tyre një edukim të mirë. Barra e provës për të rrëzuar prezumimin e fajësisë, sigurisht që bie mbi prindërit ose kujdestarin ligjor.<sup>125</sup>

#### **4.2. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga i mituri mbi katërbëdhjetë vjeç dhe personi me zotësi të kufizuar për të vepruar**

Kodi ynë Civil ka parashikuar përgjegjësinë lidhur me dëmin e shkaktuar nga të miturit në varësi të moshës së tyre. Ndërkohë që lidhur me dëmet e shkaktuara nga i mituri nën katërbëdhjetë vjeç ligji parashikon se ata vetë nuk përgjigjen për to, për dëmet e shkaktuara nga i mituri që ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç, parashikohet përgjegjësia e drejtpërdrejt e këtij të fundit. Neni 614/1 i Kodit Civil parashikon se: “*I mituri*

---

<sup>123</sup>Kidner, Richard. (2002) “*Case Book on Torts 7<sup>th</sup> ed*”, Oxford, New York: Oxford University Press, fq. 99.

<sup>124</sup>Nuni, A. (2009) “*E drejta Civile*”, pjesa e përgjithshme, Tiranë, fq. 65.

<sup>125</sup>Neni 614/1 i Kodit Civil.

*që ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç, përgjigjet për dëmin e paligjshëm të shkaktuar prej tij.*<sup>126</sup>

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për personat që kanë zotësi të kufizuar për të vepruar e që barazohen me të miturit mbi katërbëdhjetë vjeç, megjithëse neni 614/1 nuk e ka parashikuar këtë fakt shprehimisht si në rastin e personave të pazotë për të vepruar.

Një dallim i tillë ndërmjet përgjegjësisë së të miturve është pranuar me arsyetimin se i mituri me arritjen e moshës katërbëdhjetëvjeçare fillon të kuptojë dhe të perceptojë rëndësinë e veprimeve që kryen, dhe si rrjedhim duhet të përgjigjet për to. Megjithatë, ligji ka patur parasysh se i mituri në këtë moshë zakonisht nuk disponon të ardhura personale, dhe si rrjedhim i dëmtuari do të mbetet pa u dëmshpërblyer në rast insolvabiliteti të tij.<sup>127</sup>

Për këtë arsye neni 614/2 i Kodit Civil parashikon se në këto rrethana do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar, sipas rastit, prindi ose kujdestari ligjor.<sup>128</sup> Kjo është përsëri një përgjegjësi e kushtëzuar sepse ata mund të provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit, dhe përsëri në këtë rast, ligji i përjashton nga përgjegjësia. Kështu p.sh., një rast i tillë është ai kur paditësi ka kërkuar nga i padituri, i mitur mbi 14 vjeç, shpërblimin e dëmit që ky i fundit i ka shkaktuar autoveturës së tij. Pasi gjykata konstatoi se i mituri nuk dispononte të ardhura për të shpërblyer dëmin, ajo thirri si të paditur nënën e autorit të dëmit në bazë të nenit 614 të Kodit Civil, në cilësinë e prindit, pasi i mituri kishte zotësi të kufizuar për të vepruar. E paditura ka pretenduar se nuk ka mundur ta ndalonte shkaktimin e dëmit me argumentin e vetëm se nuk kishte qenë prezent në ngjarje në momentin e shkaktimit të dëmit.<sup>129</sup> Gjykata me të drejtë nuk e ka pranuar pretendimin e të paditurës, për arsye se pamundësia për të ndaluar ardhjen e pasojës nga një veprim i kundërligjshëm, nuk varet nga fakti i të qenit apo jo prezent në momentin e shkaktimit të tij. Përjashtimi nga përgjegjësia do

---

<sup>126</sup>Po aty.

<sup>127</sup>Wells, L, Rankin, J. (1988) "Direct parental controls and delinquency", *Criminology*, 26(2), pp 263- 285.

<sup>128</sup>Neni 614/2 i Kodit Civil

<sup>129</sup>neni 614 i Kodit Civil

të bëhej vetëm nëse e paditura do të provonte se e kishte mirëedukuar dhe mbikëqyrur si duhet fëmijën e saj.<sup>130</sup>

Gjithsesi, duhet patur parasysh se përgjegjësia prindërore është subsidiare, dhe do të hyjë në lojë në momentin kur i mituri nuk disponon të ardhura nga puna e tij ose nuk gëzon ndonjë pasuri tjetër çfarëdo. Nëse i mituri do të ishte në gjendje të shlyente këtë detyrim, atëherë nuk do të lindte fare përgjegjësia për prindërit apo kujdestarin ligjor për shpërblimin e dëmit.<sup>131</sup>

Ne legjislacione të vendeve të ndryshme fëmijet/ të rinjtë ngarkohen me përgjegjësi për veprimet e tyre kundrejt të tretëve në varësi të moshës në momentin e shkaktimit të dëmit<sup>132</sup>.

Për sa u tha më sipër mendoj se duhet venë në dukje fakti se në legjislacionin tonë rastet e përjashtimit nga përgjegjësia e prindit për dëmet e shkaktuara nga fëmijët e tyre nuk janë specifikuara të përcaktuara por në një rast të tillë gjykata merr për bazë rrethanat në të cilat është shkaktuar dëmi jashtëkontraktor dhe bazuar në to organi i drejtësisë merr një vendim për ngarkimin ose jo me përgjegjësi për dëmet e shkaktuara nga palët e treta.

Edhe në legjislacionet e vendeve të tjera nuk janë përcaktuar specifikuara të gjitha rastet e përjashtimit nga përgjegjësia të prindërve për dëmet e shkaktuara nga fëmijët e tyre pasi në fakt do të ishte e pamundur duke marrë parasysh morinë e rrethanave në të cilat mund të gjendet një person në një moment të caktuar, por akte të ndryshme ligjore dhe sidomos rregullore apo vendime të brendshme të institucioneve përkatëse duke qënë me në brendësi të çështjeve apo të realitetit që ato prekin, janë këto vendime, akte ose rregullore që përcaktojnë deri diku ato limite të nevojshme jo vetëm për personat përgjegjës por edhe për vetë gjykatën

---

<sup>130</sup> Chalmers, D , Davies, G , Monti, G. (2010) "European Union Law Cases and Materials 2nd edn" , Cambridge University Press , fq176.

<sup>131</sup> Parental responsibility young children and health care law, JO Bridgeman, Chambridge University Press. (2007), fq. 60.

<sup>132</sup> Van Dersmissen, B. "Legal Concepts related to youth responsibility", University of Journals, Vol. 13.3, fq.328

duke dhënë një ndihmese shumë të madhe në përcaktimin e përgjegjësise me faj apo jo, ngarkimin me përgjegjësi apo shkarkimin prej saj.<sup>133</sup>

Në përcaktimin e përgjegjësise legjislacione të ndryshme i kanë kushtuar vëmendje të vecantë kujdesit që duhet të kene personat mbi të cilët bie përgjegjësia në rrethana të ndryshme përsa i përket kohës por edhe vendodhjes, kështu duke pasur për qëllim shmangien e dëmeve që mund të shkaktojnë fëmijet/nxënësit apo dëmet që mund t'ju adresohen atyre prindrit, mësuesit, kujdestarët, administratorët duhet:

- Të jenë të vetëdijshëm se shumia e shkeljeve ndodhin në ambjentet të tilla si korridore të mbushura me njerëz, tualet, sheshe lojrash, autobuzët e shkollave; telefonave celularë, kompjutera ku mbikqyrja është e kufizuar ose mungon, për rrjedhojë kujdesi i tyre duhet të jetë më serioz dhe më i përqëndruar në këto vende. Nëse vërehen ngacmime apo sjellje të tjera që cojnë në cënim të të drejtave të personave nën përgjegjësi të tyre këta të fundit janë të detyruar të raportojnë menjëherë personat apo organet përkatëse për shmangien dhe parandalimin e dëmeve, që mund të jenë prindrit, psikologët apo çfarë do lloj strukture e ngritur posaçërisht për mbrojtjen e fëmijëve.
- Shkollat dhe institucionet e arsimit duhet t'ju ofrojnë nxënësve një ambient gjithmonë e më të sigurtë, t'ju kujtojnë gjithmone e me shpesh se cilat janë sjelljet që mund të sjellin pasoja negative si në jetën e tyre ashtu edhe në jetën e të tjerëve rreth tyre.
- Përpilimin e një dokumenti ku të specifikohen të gjitha veprimet të cilat nuk duhet të kryhen si në ambjentet e shkollës ashtu edhe jashtë saj, ripërsëritja sa më

---

<sup>133</sup> Janna Lahe, "Meaning of fault with regard to liability for damage caused by the unlawful action of another person", *judica International*, 2006, fq.5.



shumë të jetë e mundur e këtyre rregullave në mënyrë që fëmijët ti fiksojnë sa më mire ato që duhet dhe nuk duhet të bëjnë.

- Për atë kategori fëmijësh të cilët gjenden në pozitën e më të dobët duhet të ndërmerren dhe të nxiten politika të ndryshme nga shkolla në mënyrë që ata të jene sa më të angazhuar me punë në grup dhe sjellje pozitive për të ndihmuar në psikologjinë e tyre, duke ndikuar kështu jo vetëm në formimin e tyre personalisht por duke dhënë një hedhur një hap shumë të madh përpara edhe për mos cënimin e asaj që i përket tjetrit.
- Prindrit dhe vetë fëmijët mund të ndihmojnë në shmangien e dëmeve duke orientuar fëmijët drejt sjelljeve pozitive dhe në përvetësimin e aftësive për mos cënimin e të tjerëve qoftë nëpërmjet sjelljeve të tyre të përditshme qoftë nëpërmjet përdorimit të teknologjive të ndryshme pjesë e programit të studimit. Një sugjerim është edhe nxitja e nxënësve më të rritur për përkujdesjen, mbrojtjen dhe orientimin e duhur të atyre më të rinj në moshë.
- Prindi në rast të një problematike që mund të jetë duke ndodhur me fëmijën e vetë ka shumë mundësi për të shmangur dëmin e mundshëm pasi është personi më i afërt që vëren sjelljen e fëmijës në rast ngacmimi apo çfarëdolloj sjellje negative që mund të jetë duke ndodhur me të përshembull, kur fëmija heziton të dalë nga shtëpia apo sjellje të tjera jo të zakonshme. Në këtë rast mendoj se përgjegjësia për shkaktimin e një dëmi lidhet zinxhir me disa persona duke filluar që nga prindi i pari që është personi më i afërt me fëmijën dhe që njeh më së miri sjelljet e fëmijës së vet, mësuesit, kujdestarët, organet e caktuara për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla, etj.
- Dëmi i shkaktuar fëmijëve apo ai i shkaktuar nga fëmijët mund të jetë material por edhe moral si kërcënime nëpërmjet rrjeteve sociale që në ditët e sotme është

një fenomen shumë i përhapur dhe në forma nga më të ndryshmet për këtë arsye është akoma më e vështirë shmangia e tyre dhe kontrolli i drejtpërdrejt prind – fëmi, mësues – nxënës.

#### **4.3. Përgjegjësia e punëdhënësit për dëmet e shkaktuara të tretëve nga punëmarrësit e tyre.**

Marrdhënia e punës është një marrëdhënie shumë e hershme e cila lidhet në mënyrë shumë të ngushtë me me fusha të tjera në të cilat bazohet dhe zhvillohet shoqëria njerezore;

Në këtë punim do të bëj si fillim një analize të faktit se cili nga subjektet e marrdhënies së punës dhe konkretisht punëdhënësi apo punëmarresi do të ngarkohet me përgjegjësi në rast të shkaktimit të një dëmi të tretëve nga punëmarresi gjatë marrëdhënies së punës në legjislacionin shqiptar, pastaj do të analizoj mënyrën e trajtimit të kësaj përgjegjësie si pjesë të demit jashtëkontraktor në shqipëri por edhe më gjerë.

Nisur nga kendveshtrimi historik, deri nga fundi i shekullit XIX, në doktrinën juridike të vendeve me të industrializuara, ka qenë mbizotërues parimi i përgjegjësise me faj. Pas kësaj periudhe industria dhe marrdhëniet tregëtare pësuan një hov cilësor që nxorri në pah një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i përgjegjësise me faj. Deri në atë periudhe faji konsiderohej si shkaku kryesor dhe i vetëm që lejonte të dëmtuarin t’ia transferonte humbjen e tij, shkaktuesit të demit jashtëkontraktor.<sup>134</sup>

Rritja e ekonomisë, industrializimi, rritja e tregëtise dhe në përgjithësi e veprimtarive ekonomike bëri të nevojshme përpunimin e një sistemi të tillë që të lejoji një personi apo një entiteti ekonomik të përdore shërbimet e personave të tjerë për realizimin e interesave të veta

---

<sup>134</sup> Nuni, A., Mustafaj, I., Vokshi, A. (2008) “E Drejta e Detyrimeve I”, Tiranë, fq. 110.

ekonomike. Meqenëse këta persona apo entitete, punëdhënësit përfitojnë nga shërbimet e atyre që punojnë për punëmarresit, u pa si e natyrshme që të konsideroheshin përgjegjës për veprimet e dëmshme të punëtorëve të tyre.<sup>135</sup> Kjo edhe për faktin se ata janë në gjendeje që të kontrollojnë veprimet e punonjesve të tyre dhe të menjanojnë në këtë mënyrë ato sjellje që mund të bëhen shkak për shkaktimin e në demit apo disa dëmeve personave të tretë jashtë marrëdhënies së punës.

Në vitin 1911 Gjykata e Apelit të Neë York-ut, refuzoi që të vendoste përgjegjësinë mbi punëdhënësin për aksidentin që kishin shkaktuar punonjësit e tij në fabrikë .

Sipas asaj Gjykata Kushtëuese ndalonte që një qytetar të penalizohej apo të vendosej nën përgjegjësi nëse nuk kishte shkelur një dispozitë ligjore apo të kishte kryer direkt një veprim me faj.

Ky arsyetim duket se mbështeste edhe të drejtën natyrore sipas të ciles përsonei mban përgjegjësi vetëm për veprimet e kryera me faj.<sup>136</sup> Kjo pikëpamje sot konsiderohet si e papranueshme, në të gjitha sistemet ligjore moderne, kostoja e një aksidenti industrial, i kalohet në një mënyrë ose në një tjetër punëdhënësit, i cili ga ana e tij ka mundësinë që këtë kosto ta kalojë tek cmimi produktit përfundimtar duke e kaluar cmimin e kësaj kostoje të gjithë e kompanisë.

Për sa më sipër George Lloyd thotë se: *“Kostoja e një produkti duhet të përfshijë edhe gjakun e derdhur të një punëtori”*<sup>137</sup>

---

<sup>135</sup> Po aty.

<sup>136</sup> RFV Husten, Buckley RA, Salmond, Hustenon. (1992) “The Law of Torts, 20th Ed”, London: Sweet and Makwell.

<sup>137</sup> Nuni, A, Mustafaj, I, Vokshi, A. (2008) “E Drejta e Detyrimeve I”, Tiranë, fq.115.

Punëdhënësi është i detyruar të ndërmarrë masa të posacme në mënyrë që veprimet e punëmarrësve të obliguara nga natyra e punës të zbatohen me përpikmëri dhe të shmangen sa më shumë devijimet prej tyre. Duke bërë kështu të mundur shmangien e sa më shumë aksidenteve në kuadër të mbrojtjes së punëmarrësve të vet, jetës dhe shëndetit të tyre por duke mbrojtur gjithashtu një ndër arsytet bazë të krijimit të kësaj marrdhënieje vete biznesin e tyre nga cdo dëm për vete biznesin, sepse duhet theksuar që në ditët e sotme një ndër arsytet kryesore të suksesit të bizneseve kudo në botë është emri i mirë ose ndryshe reputacioni i mirë.<sup>138</sup>

Kjo është aq e vërtet sa që do të thoja se dëmi me i madh i shkaktuar një punëdhënësi në rast aksidentesh apo në cfarëdolloj forme qoftë ai, është dëmi që i shkaktohet reputacionit të kompanisë më tepër se dëmi efektiv i shkaktuar në rastin konkret dhe sidomos për kompanitë e mëdha ndërkombetare dhe të mirënjohura nga mediat televizive apo të cfarëdolloj forme qofshin.

Por përgjegjësia e punëdhënësit për demet e shkaktuara nga punëmarrësit e vet natyrisht nuk mund të jetë e pakufizuar, pra jo në cdo rast dhe domosdoshmërisht cdo punëdhënës do të ngarkohet me përgjegjësi për cdo lloj dëmi të shkaktuar nga punëmarrësit e vet dhe në cdo kohë apo në cdo rrethanë të shkaktimit të tij.

Në jurisprudencë ekzistojnë disa kushte apo kritere të cilat kufizojnë dhe orientojnë organet e drejtësisë në ngarkimin me përgjegjësi të punëdhënësve për dëmin e shkaktuar nga punëmarrësit.<sup>139</sup>

---

<sup>138</sup> Shulman , Harry , Fleming , J , Jr.OscarS.Gray , Gifford, D. (2003) ,”Cases and Materials on the Law of Torts 4thed”, New York:Foundation Press, ), fq. 205.

<sup>139</sup> Hodgson, J , Lewthwaite , J. (2004) “ Tort Law”, Oxford University Press, fq. 89.

Më poshtë po trajtoj disa nga kushtët e përgjegjësise së punëdhenësit në të cilat duhet të shkaktohet dëmi në mënyrë që ai të ngarkohet me përgjegjësi ligjore.

Për tu ndodhur përpara përgjegjësise së punëdhenësit për dëmin jashtë kontraktor të shkaktuar nga punëmarrësi duhet të plotësohen këto kushte të parashikuara shprehimisht në nenin 618 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

*“Punëdhenësi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij gjatë marrdhënies ushtrimit të detyrave që u janë besuar prej tij. Personi Juridik është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga organet e tij gjatë kryerjes së detyrave të tyre”<sup>140</sup>*

Nga neni i sipërcituar dalin në pah të gjitha kushtet në të cilat duhet të jenë prezentë në një marrdhenie punë në mënyrë që punëdhenësi të ngarkohet me përgjegjësi për demet e shkaktuara të tretëve nga punëmarrësit e vet, si më poshtë vijon:

1. Duke bërë një analizë të përmbajtjes së këtij neni rezulton se kritëri i parë dhe me i rëndësishëm është ekzistenca e marrdhënies së punës midis punëdhenësit dhe punëmarrësve në shërbim të tij, pra duhet mes këtyre dy subjekteve të ekzistojë një marrveshje kontraktore lidhur sipas legjislacionit në fuqi të vendit në të cilin ndodhet selia qendrore e punëdhenësit ose në raste të vecantë sipas parashikimeve të legjislacionit të punës për këtë veprim juridik,<sup>141</sup> në të kundërt edhe sikur personi që kryen një punë në këtë rast punëmarrësi të jetë duke punuar për një person tjetër punëdhenësi pa një marrveshje kontraktore mes tyre nuk mund ta cilesojmë si marrëdhenie pune dhe asnjëri prej tyre nuk mund të preket ligjerisht nga obligimet

---

<sup>140</sup>Neni 613 I Kodit Civil

<sup>141</sup> Michael, J. (1996) “A Text Book on Torts”, 3rd Ed, Blackstone Press Limited Great Britain, fq.204.

ligjore për këtë marrëdhënie specifike. Por ndodhemi në kushtet e asaj që quhet punë në të zeze dhe në këtë rast këta subjekte do ndiqen penalisht nga ligji përkatës.

2. Së dyti, një tjetër element shumë i rëndësishëm rezulton të jetë se në mënyrë që punëdhënësi të ngarkohet me përgjegjësi për veprimet e punëmarrësit të vet duhet patjetër që punëmarrësi në momentin e shkaktimit të dëmit të tretëve të jetë duke kryer vetëm detyrat të cilat atij i janë ngarkuar nga punëdhënësi i tij,<sup>142</sup> pra duhet të kryej vetëm ato veprime për të cilat është krijuar dhe vazhdon marrëdhënia e punës mes subjektëve të saj, ose punëmarrësi të jetë duke kryer një veprim i cili ka lidhje direkte me veprimtarinë objekt të kontratës së punës. Nëse punëmarrësi është duke kryer një veprim i cili nuk i përmbahet detyrimeve kontaktore të punëmarrësit dhe as nuk i është kërkuar nga vetë punëdhënësi si një punë shtëse e vertëtuar kjo me anë të një shtojce kontratë apo një deklaratë nëpërmjet të cilës autorizohet punëmarrësi për kryerjen e veprime të tjera jashtë asaj që është parshikuar në kontratën e punës atëhere ai në baze të ligjit do të mbajë vetë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar në këtë rast.<sup>143</sup> Në praktiken shqiptare janë shume të rralla rastet në të cilat punëdhënësit autorizojnë punëmarrësit e tyre për kryerjen e veprimeve të tjera shtëse përveç atyre që janë parashikuar në kontratë, si përsëmbull një shtojce kontratë apo një deklaratë, apo autorizim cfarëdolloj qoftë ajo, por ky është një ndër rastet me të veshtira dhe me të pasigurta për mbrojtjen e punëmarrësit nga ligji për shkak të mos pasjes së një dokumenti ligjor i cili mund të paraqitet prej tij si prove në gjykatë apo qoftë dhe vetë personit të tretë të cilit i ka shkaktuar një dëm.

---

<sup>142</sup> Tesfaye, N. (1996) "Extra Contractual Liability and Unjust Enrichment", Artist Printing Press, Addis Ababa, fq.118.

<sup>143</sup> Morbide, N., J. and Bagshaw, R. (2005) "Tort Law", 2nd ed, London, New York and Others: Pearson Longman, fq. 186.

3. Së treti, një element tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me kohën në të cilën shkaktohet veprimi i jashtëligjshëm në dëm të të tretëve, dëmi jashtëkontraktor i shkaktuar të tretëve nga një punëmarrës duhet të jetë shkaktuar gjatë kohës në të cilën punëmarrësi është në marrdhenien e punës gjithashtu, pra do të ngarkohet me përgjegjësi punëdhënësi për dëmin e shkaktuar të tretëve nga punëmarrësi i tij vetëm në rast se në momentin e shkakimit të dëmit punëmarrësi ka qenë në kohen normale të punës të lejuar nga punëdhënësi i vet. Nëse punëmarrësi pasi ka mbaruar punën apo është duke ardhur në punë apo në cfarëdolloj situatë që mund të ndodhet ai por jashtë orarit të punës, dhe ndodh që ti shkaktojë një dëm dikujt tjetër jashtë marrdhënies së punës atëherë llogjikisht ky rast nuk do të përfshihet në gamën e atyre rastëve kur detyrimisht punëdhënësi do të ngarkohet me përgjegjësi për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga punëmarrësi i tij.<sup>144</sup> Ky rast detyrimisht do të konsiderohet dëm jashtëkontraktor por përgjegjësia e bie totalisht mbi personin i cili ka shkaktuar dëmin, pra në këtë rast punëmarrësi do të mbajë vetë përgjegjësi për dëmin që i ka shkaktuar dikujt tjetër edhe pse është në një marrdhënie punë,<sup>145</sup> ky rast nuk përbën shkak për të ngarkuar me përgjegjësi dike tjetër.

Bazuar në sa më sipër arrijme në konkluzionin se përgjegjësia e punëdhënësit është përgjegjësi me faj, për shkak se punëdhënësi është personi i ngarkuar me detyrimin që të marrë të gjitha masat e parashikuara nga legjislacioni vendas dhe ai ndërkombëtar i njohur

---

<sup>144</sup> Neni 613 I Kodit Civil

<sup>145</sup> Con, M T.N, Vieceli, L. (1988), *The business of rehabilitation placement: What to understand about private employers before approaching them*, *Journal of Rehabilitation*, fq. 22.

nga legjislacioni vendas për të shmangur kryerjen e këtyre veprimeve të paligjshme nga ana e punëmarrësve<sup>146</sup>.

Edhe pse tingellon pak si absurde po të mendosh se një person nuk ka patur lidhje të drejtpërdrejt me veprimin e kryer nga dikush tjetër, gjithsesi do të konsiderohet përgjegjës dhe juridikisht do të përgjigjet përpara organeve të drejtësisë për këtë dëm të shkaktuar nga një person tjetër në këtë rast punëmarrësi i tij.<sup>147</sup>

Në përgjithësi në jurisprudence ka shumë mendimet subjektive për pothuajse cdo rast janë të pafundme dhe si e gjykon diskush një rast nuk e gjykon dikush tjetër por për rastin të cilin po diskutojmë në këtë punim realisht punëdhënësi duhet të ngarkohet me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga punëmarrësit e vet dhe kjo përgjegjësi po ashtu me të drejtë konsiderohet përgjegjësi me faj pasi gjatë marrdhënies së punës punëdhënësi është i detyruar për të mbikqyrur dhe veshguar jo vetëm sigurinë e punonjësve por edhe personat të cilët mund të preken indirekt nga ushtrimi i veprimtarisë për të cilën punëdhënësi është licensuar apo ka të drejtën ligjore që ta ushtrojë atë.

Punëdhënësi do të shkarkohet nga kjo përgjegjësi vetëm në rast se do të vërtetohet ose do të provohet përpara organeve kompetente se ai vetë i ka marrë të gjitha masat e mundshme për të mos lejuar shkaktimin e një dëmi konkret ose të disa dëmeve nga punëmarrësit e tij, por sidoqoftë dëmi është shkaktuar, për arsye të cilat nuk kanë lidhje me veprimet drejtpërdrejt të punëdhënësit apo me faktin se ai nuk mori asnjë masë për shmangien e këtij rreziku gjatë marrdhënies së punës.<sup>148</sup>

---

<sup>146</sup> *Tesfaye, N.(1996) "Extra Contractual Liability and Unjust Enrichment", Artist Printing Press, Addis Ababa, f. 717;*

<sup>147</sup> *Corkin, J.(2008 ) "Science, Legitimacy and the Law: Regulating Risk Regulation Judiciously in the European Community " , fq.33.*

<sup>148</sup> *Deakin, S, Johnston, A, Markesinis, B. (2008)" Markesinis and Deakin's Tort Law", 6th ed Oxford, Clarendon Press, fq.302.*



Ne praktikën tonë janë konstatuar shumë raste objekt i të cilave ka qënë përcaktimi i përgjegjesisë për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga punëmarrësit por asnjëri prej tyre nu ka shkuar deri tek organet gjyqësore në vend pasi dhe dëmshpërblimi përkatës është rregulluar me marrveshje të palëve. E njëta gjë ka ndodhur jo vetëm me kompani shqiptare por edhe ato të huaja të cilat janë vendosur përkohësisht këtu për zbatimin e projekteve të mëdha e me rëndësi ndërkombëtare.

#### *4.3.1. Një vështrim krahasues i përgjegjësise për këtë lloj dëmi jashtë-kontraktor*

Marrëdhënia e punës në fushën e drejtësisë është konsideruar si një marrëdhënie shumë e rëndësishme, për të cilën nevojitet një rregullim thelbësor, kjo jo vetëm për shkak të rëndësisë së saj në jetën e kujtdo, por edhe për shkak të nevojës së madhe për një rregullim ligjor të morisë së madhe të problematikave të kësaj fushe, të cilat kërkojnëmedoemos një zgjidhje ligjore.

Për shkak të kësaj rëndësie dhe njëkohësisht për faktin se parë në një vështrim krahasues legjislacioni shqiptar me atë të BE-së vihen re rregullime të posacme për të cilat në gjejmë informacion vetëm në doktrinën juridike, jam munduar ta trajtoj më gjerë dhe të nxjerr në pah ato dallime mes legjislacionit tonë, por edhe midis vendeve më të zhvilluara të Europës, të cilat i kam marrë si objekt studimi në këtë punim.

Sipas legjislacionit Francez, në marrëdhënien e punës në rast të shkaktimit të një dëmi jashtë-kontraktor, përgjegjësia do të bjerë mbi punëdhënësin, nëse dëmi i shkaktuar lidhet me faktorë objektivë (si koha, vendi, mënyra efektive e kryerjes së shërbimit), kjo bazuar edhe në nënin 1384 të Kodit Civil Francez në fuqi.<sup>149</sup>

---

<sup>149</sup>Neni 1384 I Kodit Civil Francez ne fuqi.

Sipas ligjit Anglez dhe atij Gjerman, në rast të shkaktimit të një veprimi të paligjshëm punëdhënësi përjashtohet nga përgjegjësia për sa i përket marrëdhënieve të punës, vetëm në rast se dëmi i shkaktuar është ngushtësisht i lidhur me detyrat e punonjësit, ekzekutimi i të cilave përbën objektin kryesor të kryerjes së punës, shërbimit.<sup>150</sup>

Përveç kësaj, sipas legjislacionit Gjerman, punëdhënësi është i detyruar (në varësi të rrethanave) për të mbikqyrur punonjësën gjatë kryerjes së shërbimit, për të evituar shkaktimin e një dëmi.

Bazuar në legjislacionin Francez, Gjerman, Italian dhe atë Anglez, përgjegjësia për shkaktimin e një dëmi jashtë-kontraktor nga punëmarrësit gjatë marrëdhënies së punës, gjatë ushtrimit të saj bie mbi punëdhënësin.<sup>151</sup> Dispozitat e legjislacionëve të këtyre vendeve të cilat shprehen për dëmin jashtë-kontraktor, për sa i përket marrëdhënies punëdhënëspunëmarrës, e trajtojnë këtë çështje pothuajse në mënyrë të njëjtë me ato të legjislacionit Shqiptar, prandaj kam menduar të mos ndalem gjatë në këtë pikë.

*Nga një përmbledhje e këtyre legjislacionëve dhe njëkrahësim i tyre del në pah një element i veçantë i cili në legjislacionin tonë nuk është rregulluar, pavarësisht se në doktrinë është diskutuar pak nga disa autorë.*

Është pikërisht rasti kur ndodhemi përpara një dëmi jashtë-kontraktor të shkaktuar nga një punëmarrës i një punëdhënësi me të cilin ka një marrëdhënie normale pune, por që në momentin e shkaktimit të dëmit ky punëmarrës është duke kryer një shërbim për një punëdhënësit tjetër, me autorizimin apo kërkesën e vetë punëdhënësit të parë të tij me të cilin ka një marrëdhënie kontraktore.

---

<sup>150</sup> Von Bar, C. (2009) "Principles of European Law", Non-contractual liability arising out of Damage Caused to Another, European Law Publishers, Vol, 7, fq. 259.

<sup>151</sup> Cooke, J. (2007) "Law Torts 3rd ed", London, San Francisco, Kuala Lumpur, Johanesburg, Financial Times Pitman Publishing, fq. 128.

Bazuar në legjislacionin Francez në rastin kur një punëmarrës i një punëdhënësi të caktuar është duke kryer përkohësisht një shërbim për llogari të një punëdhënësi tjetër, përgjegjës për veprimet e punëmarrësit do të jetë punëdhënësi aktual, ai për të cilin po kryhet shërbimi i kërkuar, së bashku me punëdhënësin e përgjithshëm, ai me të cilin ky i fundit ka një kontratë të rregullt punë. Pra, përgjegjësia sipas këtij legjislacioni, si rregull është e përbashkët dhe gjatë gjyqimit, bazuar në raste praktike, gjykata merr parasysh rrethanat në të cilat është shkaktuar dëmi për caktimin e përgjegjësisë së punëdhënësve.<sup>152</sup>

Qëllimi i këtij ligji, bazuar edhe në doktrinën Franceze, është evitimi sa më shumë të jetë e mundur i rastëve të shkaktimit të dëmeve të ndryshme, apo aksidentëve, gjatë marrëdhënies së punës. Në këtë rast punëmarrësi i përgjithshëm nuk mund të supërvizojë dhe të instruktojë punëmarrësin e tij edhe kur nuk është duke kryer një shërbim për vetë atë, në rastin konkret punëmarrësi është deleguar për të kryer një shërbim për llogari të një punëdhënësi tjetër, i cili ka për detyrë të mbikqyrë kryerjen e punimeve në shërbim të tij.

Ndërsa, punëdhënësit të përgjithshëm i bie barra për përzgjedhjen dhe dhënien e udhëzimeve apo instruksionëve të duhura punëmarrësit të vet për kryerjen e një shërbimi të caktuar, për të cilin edhe është punësuar.<sup>153</sup>

Ndërkohë, për të njëjtën çështje legjislacioni Gjerman dhe ai Anglez mbajnë një qëndrim të ndryshëm.

---

<sup>152</sup> *Principles of European Tort Law*, e hartuar nga “European Group on Tort Law”, paraqet përmbledhje të rregullave civile, përmes të cilave synohet që të unifikohet dhe harmonizohet “E drejta deliktore europiane”, fq 509.

<sup>153</sup> *Principles of European Tort Law*, e hartuar nga “European Group on Tort Law”, paraqet përmbledhje të rregullave civile, përmes të cilave synohet që të unifikohet dhe harmonizohet “E drejta deliktore europiane”, fq 512.

Bazuar në këto dy legjislacione punëdhënësi, i cili ka një kontratë të rregullt me një punëmarrës, do të jetë gjithmonë përgjegjës për veprimet e tij të kundërligjshme ndaj të tretëve të shkaktuara gjatë marrëdhënies së punës. Ai duhet ta mbikqyrë dhe udhëzojë punëmarrësin e tij pavarësisht faktit nëse ky punëmarrës është duke kryer një shërbim për llogari të këtij, apo të një tjetri të aprovuar nga vetë ai, me përjashtim të rastit kur dy punëdhënësit kanë lidhur mes tyre një marrëveshje e cila përcakton se cili prej tyre do të jetë përgjegjës për këtë punonjës në një kohë dhe gjatë kryerjes së një shërbimi të caktuar, por gjithmonë të aprovuar nga punëmarrësi paraprakisht.

Për sa me sipër po e ilustroj me disa raste nga praktika e këtyre vendeve si me poshtë:

*A. Cass. krim., 20 tetor 1987 5.F.7.* Sa më sipër ilustron shumë qartë me disa shembuj konkretë nga praktika ligjore e këtyre vendeve.

*Faktet:* Për t'i ardhur në ndihmë kompanisë SARELO për heqjen e qymyrgurit, kompania Carrières Gaillard i jep hua kompanisë SARELO një traktor e një rimorkio, dhe i dërgon një prej punonjësve të vet për të manovruar me mjetin e dhënë hua. Shoferi zgjedh rrugën që duhet ndjekur. Arrin një pikë në rrugë në një nivel hekurudhor, ku një sinjal rrugor paralajmëron një rrezik për automjetet me platformë të ulët. Suteau doli për të shqyrtuar kalimin dhe arriti në përfundimin se ishte e mundur të kalohej pa shkaktuar asnjë dëm. Duke ecur një tren përplasat me rimorkion e mbërthyer në mes të dy binarëve të trenit, dhe shkakton lëndime të disa personave. Shoferi, Suteau dhe Carrières Gaillard, punëdhënësi i tij i përgjithshëm, janë pala e paditur për dëmet. Çështja ishte nëse Suteau ishte në përgjegjësi të Carrières Gaillard apo të SARELO në kohën e aksidentit.

*Vendimi:* Gjykata e Apelit vendosi që Suteau do të mbetej në përgjegjësi të Carrières Gaillard në kohën e aksidentit, dhe Gjykata e Kasacionit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit.

Në këtë rast Gjykata e Kasacionit ka caktuar përgjegjës punëdhënësin e përhershëm i cili ka gabuar në përzgjedhjen e punonjësve të vet, pasi arsyeja e shkaktimit të dëmit ka qenë pakujdesia, dhe jo pamundësia e manovrimit. Carrières Gaillard duhet të kishte vënë në dispozicion një punonjës të specializuar, dhe jo dikë të paaftë për kryerjen e shërbimit, pavarësisht faktit se punëdhënësi i përkohshëm në këtë rast kompania SARELO mund të jepte disa udhëzime të nevojshme të cilat mund të shmangnin aksidentin, pasi punonjësi ishte nën survejimin e saj gjatë kryerjes së këtij shërbimi për llogari të saj.

Praktika ka njohur raste kur ndërmjet dy punëdhënësve bëhet paraprakisht një kontratë për përcaktimin e masës së përgjegjësisë për secilën prej tyre.

Është pretenduar se SARELO nuk mund të ketë fuqinë për të instruktuar Suteau në çdo moment gjatë këtij operacioni. Gjykata e Apelit nuk mund, pra, të mbajë Carrières Gaillard përgjegjës pa shkelur Nenin 1384 (5) të Kodit Civil Italian.

Dhe duke vënë një punonjës me vlerë në dispozicion të SARELO, për një operacion të vetëm dhe të vështirë të transportit, natyrisht që nuk ka transferuar tek kjo kompani fuqinë e saj të kontrollit dhe udhëzimit për pjesën teknike të ngarjes së automjetit. Prandaj, në qoftë se SARELO ishte me të vërtetë përgjegjës për funksionimin deri në nivelin e kalimit, gjendja u paraqit ndryshe në kalim. I ballafaquar me një vështirësi të veçantë që ka të bëjë me aftësitë e tij [si shofer], Suteau rimori kontrollin e operacionit dhe për këtë arsye ishte, për atë pjesë të operacionit, ende nën autoritetin e punëdhënësit të tij të zakonshëm.

Me gjetjet e mësipërme të faktit, si për marrëdhëniet e Suteau me Carrières Gaillard dhe SARELO respektivisht, Gjykata e Apelit ka justifikuar vendimin e saj. Arsyet e ankesës duhet të refuzohen.

*B. Dhoma e Lordëve, Mersey dhe Bordi Harbour v. Coggins & Griffith L5t.dE.*

*Faktet:* Docks Mersey dhe Bordi Harbour morën hua një vinç nga Coggins & Griffith Ltd. Dock Mersey dërgoi Neëall, një shofer vinçi, për të manovruar vinçin në përputhje me kërkesat e një mbikëqyrësi. U lidh një kontratë mes dy firmave ku u përaktua se Neëall duhet të konsiderohej një punonjës i Coggins & Griffith Ltd. Gjatë përdorimit të vinçit mbikëqyrësi u plagos pas një manovrimi të gabuar të kryer nga pakujdesia. Ai i hodhi në gjyq të dyja firmat. Problemi që lindi këtu lidhet me faktin se cili do të konsiderohej punëdhënësi i Neëall në kohën e aksidentit.

*Vendimi:* Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit dhe Dhoma e Lordëve vendosën që Neëall mbetej një punonjës i Mersey dhe Bordit Harbour në kohën e nddhjes së aksidentit, dhe rrjedhimisht, përgjegjësia në këtë rast do t'i ngarkohet kësaj kompanie.

*Gjykimi:* Ajo çfarë përbënte objektin e gjykimit ishte fakti se shoferi i cilit punëdhënës ishte Neëall në kohën e aksidentit. Midis dy punëdhënësve u lidh një marrëveshje për transferimin e shërbimit të punëmarrësit nga njëri punëdhënës tek tjetri, por ky veprim do të ishte i vlefshëm ligjërisht dhe do të jepte efekte juridike vetëm me pëlqimin paraprak të punëmarrësit.

Punëdhënësi i përhershëm do të mbajë përgjegjësi për vetë faktin se ky është punonjës i saj kundrejt të tretëve pavarësisht se nën përgjegjësinë e kujt ka qenë punonjësi në kohën e kryerjes së shërbimeve. Kjo është një kontratë e lidhur midis dy punëdhënësve dhe nuk prek fare pozitën dhe faktin se për kë punon punëmarrësi në këtë rast. Vetëm kontrata e punës së tij është baza juridike e përcaktimit të përgjegjësisë përpara organeve kompetente.

*C. BGH, 26 janar 1995 (Gjykata Federale Gjermane)*

*Faktet:* I padituri ishte thirrur për të dërguar punëtorë (në zbatim të një kontrate për sigurimin e fuqisë punëtore ose Dienstverschaffungsvertrag) për të ndihmuar paditësit për

rregullimin e një çatie të prishur të një stadiumi. Punëtorët nuk i kanë respektuar udhëzimet e dhëna nga kryetari i jurisë së paditësit dhe kanë dëmtuar shtyllat e strukturës së kulmit të çatisë, dhe tri ditë më vonë kulmi u shemb dhe dëmtoi stadiumin. Paditësi kërkoi të dëmshpërblehet nga pala e paditur nëpërmjet pagesës së një shume, e cila do të ishte e nevojshme për riparimin e dëmit të shkaktuar.

Në parim, legjislacioni Francez ngarkon me përgjegjësi punëdhënësin e përhershëm të punëmarrësit, si edhe atë të përkohshëm. Të dy do të jenë përgjegjës në varësi të rrethanave.

Në fakt, siç shprehet Gjykata e Kasacionit për rastin në fjalë, sipas legjislacionit Francez, nuk ka asnjë supozim që punonjësi i përkohshëm të mbetet në përgjegjësi të punëdhënësit të përgjithshëm për shmangien e dëmit në raste të veçanta, pavarësisht ndërhyrjeve që mund të ishin bërë sipas rastit nga punëdhënësi i përkohshëm për shmangien e dëmit.

Trajtimi që i bën legjislacioni Anglez: Dhoma e Lordëve merr si pikënisje faktin që punëmarrësi i cili dërgohet të punojë përkohësisht për një tjetër firmë, do të mbetet punonjës i punëdhënësit të përgjithshëm. Çdo ndryshim i punëdhënësit duhet të provohet, dhe përgjegjësia e palëve për të provuar një ndryshim të tillë është relativisht e madhe.

Bazuar ne qasjen e përgjithshme të së drejtës Angleze, theksohet se korniza ligjore e kontratës së punës (kontrata e shërbimit) parashikon se punonjësi nuk mund të kalojë në përgjegjësi të një punëdhënësi tjetër pa pëlqimin e tij të shprehur. Si rrjedhojë, marrëveshjet ndërmjet punëdhënësve se kush do të jetë punëdhënësi i një punonjësi në një kohë të caktuar kanë një vlerë të kufizuar ligjërisht.

Sipas këtij legjislacioni, për të përcaktuar se nën përgjegjësinë e kujt është punëmarrësi, duhet të bazohemi në një sërë faktorësh të tjerë të cilët duhet të merren në

konsideratë, të tilla si: kush e paguan punëtorin, cili mund ta shkarkojë atë për sa kohë zgjat detyra e përkohshme, si dhe mjetet e kujt janë përdorur.

Lidhur me rastet që u përmendën më sipër, shoferi i vinçit është nën përgjegjësi të punëdhënësit të përgjithshëm, dhe do të ishte pa kuptim nëse punëmarrësi, shoferi i vinçit, do të ndryshojë punëdhënësin e vet sa herë që ai dërgohet në një detyrë të re të përkohshme.

Ndërsa, legjislacioni Gjerman për përgjegjësinë e punëdhënësit në këtë rast kalon më tej, duke parë dhe marrë parasysh kohën e zgjatjes së shërbimit të kryer për punëmarrësin e përkohshëm. Këtë arsyetim e bazon në faktin se, nëse punon për një kohë të gjatë tek punëdhënësi i përkohshëm, ai nuk mund të marrë akoma udhëzime nga punëmarrësi i përgjithshëm, pasi ata nuk mund ta monitorojnë për një kohë të gjatë, në rastet kur shërbimi kryhet në vazhdimësi.

Në bazë të nenit 831 të Kodit Civil Gjerman, kur flasim për të drejtën për të monitoruar punonjësit e dërguar në një tjetër firmë, një element i rëndësishëm i cili duhet parë është nëse punëdhënësi i përgjithshëm ka humbur fuqinë për të mbikëqyrur.

Sipas vendeimeve të marra nga gjykatat gjermane, del se ato vendosin në bazë të faktit nëse punonjësit janë hequr ose jo përgjithësisht nga mbikëqyrja e punëdhënësit të përgjithshëm.

Për më tepër, gjykatat gjermane zakonisht i referohen dallimit mes kontratës për sigurimin e fuqisë punëtore (Dienstverschaffung), rastit që u përmend, dhe kontratës për delegim të përkohshëm (Leiharbeit), gjatë përcaktimit të përgjegjësisë. Në rast të kontratave për sigurim të fuqisë punëtore, punëmarrësit përgjithësisht mbeten në përgjegjësi të punëdhënësit të përgjithshëm. Pra, kur një firmë thjesht bie dakord për të vënë fuqinë e saj



punëtore në dispozicion të një firme tjetër, në raste të caktuara së bashku me pajisje të specializuara, punëdhënësi i përgjithshëm e ruan të drejtën për t'i mbikqyrur ata.

Ndërsa, tek rasti i kontratës së delegimit përkohësisht të një punëmarrësi, siç është edhe rasti i përmendur më sipër për dhënien në përdorim të vinçit dhe dërgimin e shoferit të tij tek një punëdhënësi i përkohshëm, në praktikë trajtohet ndryshe. Kjo pasi marrëdhënia e punës, në rastin konkret ka zgjatur në kohë dhe kjo nuk i jep mundësinë reale punëdhënësit të përgjithshëm që të mbikqyrë punonjësin e vet gjatë kësaj periudhe.

Për shembull: Në OLG Düsseldorf, më 23 dhjetor 1994, një vinç ishte marrë me qera bashkë me shoferin e tij, në një kompani ndërtimi, për një afat të papërcaktuar.

Gjykata ka vendosur në kundërshtim me dy vendimet e trajtuara më sipër dhe ka ngarkuar me përgjegjësi punëdhënësin e përkohshëm të punëmarrësit.<sup>154</sup>

*D.Cass.crim., 23 June 1988 17 5.F.16., 5.E.17., 5.G.18. SCH Atomic City and Court of Appeal. Morris v. CË Martin & Sons Ltd. And BGH, 4 November 1953*

*Faktet:* Të paditurit, R. MOIROUD Co, i ishte besuar nga paditësi, SCH Atomic City, importimi i një ngarkese me veshje nga Italia. Paditësi i kishte kërkuar të paditurit që t'i mbante mallrat në magazinën e tij për disa kohë. Bonan, një punonjës i të paditurit, përgjegjës për menaxhimin e magazinës, vodhi një numër të madh të kutive të veshjeve nga dërgesa e paditësit. Pavarësisht procedurave për ndjekjen penale, ky veprim solli edhe lindjen e përgjegjësisë civile, dhe konkretisht përgjegjësinë civile si rrjedhojë e dëmit jashtë-kontraktor të shkaktuar nga të tretët. Paditësi ka pretenduar se i pandehuri është përgjegjës në bazë të

---

<sup>154</sup>Chalmers, D, Davies, G, Monti, G. (2010) "European Union Law Cases and Materials" 2nd edn, Cambridge University Press, fq.108.

nenit 1384 (5) C.civ. Çështja ishte nëse Bonan kishte vepruar në bazë të funksioneve të tij gjatë marrëdhënies së punës, sipas kuptimit të këtij neni.

*Vendimi:* Gjykata e Apelit vendosi ta shkarkonte nga përgjegjësia punëmarrësin për faktin se ai kishte vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi gjatë kohës së punës dhe ambienteve të punës përgjegjësia bie mbi punëdhënësin, i cili nuk kishte kryer detyrën e tij për mbikëqyrje të punonjësve të vet gjatë marrëdhënies së punës dhe kryerjes së shërbimeve për të. Por, ky vendim u kundërshtua nga Gjykata e Kasacionit, e cila konstatoi se punëmarrësi për veprimin e kundërligjshëm, konkretisht vjedhjen, nuk kishte vepruar në bazë të funksioneve të tij, por në kundërshtim me to, dhe e caktoi atë përgjegjës për këtë veprim, dhe jo punëdhënësin e tij.

*E. BGH, 14 February 1995 Physician and Midwife as Verrichtungsgehilfe Organizational Fault of Hospital.*

*Faktet:* Më 26 dhjetor 1976, në mëngjes, nëna e paditësit shkoi në spitalin privat (Krankenhaus Beleg), pala e paditur, kur ajo ishte gati për të lindur. Ajo është marrë në pyetje nga gjinekologu i saj, i cili e la atë me maminë, duke mbetur në dispozicion në rast se do ta thërrisnin. Pak pas mesnatës, më 27 dhjetor, e ëma e fëmijës që lindi me problem, kishte patur dhimbje për shkak të tensionit të lartë të gjakut, gjë e cila ndikoi në shkaktimin e problemeve në tru tek fëmija.

Pala paditëse pretendoi se, nëse infermierja dhe gjinekologu do t'i kishin matur rregullisht tensionin e gjakut gruas shtatëzënë, do të ishte parandaluar shkaktimi i dëmit tek fëmija i porsalindur.

Ajo gjithashtu pretetndoi, në bazë të nenit 831 të Kodit Civil Gjerman, mbajtjen e përgjegjesisë nga spitali për shkaktimin e dëmit jashtë-kontraktor nga gjinekologu dhe infermierja, punonjës të këtij të fundit.

*Vendimi:* Gjykata e Shkallës së Parë i pranoi të gjitha pretendimet e paditësit kundër të paditurit. Gjykata e Apelit Ia në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Gjykata Federale e Gjermanisë prishi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe hodhi poshtë pretendimet e paditësit për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar nga spitali, pasi punonjësit e këtij spitali nuk kishin kryer detyrat e tyre gjatë ushtrimit të aktivitetit për të cilin ishin punësuar aty, por kishin vepruar në kundërshtim me to.

Për masat të cilat duhet të merren apo zbatohen nga subjektet e një mardhënie pune për përjashtimin e njërit apo tjetrit subjekt nga përgjegjësia janë të shumta dhe mjaft të njohura si në arenën ndërkombetare ashtu edhe në legjislaionin tonë bazat ligjore kombëtare, ndërkombetare dhe masat që duhen të merren kryesisht janë si më poshtë vijon:

Së pari, në legjislacionin Shqiptar ka legjislacione të posacme të cilat përcaktojnë masat që duhet të merren nga të dy subjektet e marrdhenies se punes dhe kryesisht punëdhënësi, përcaktimet në ndihmë të organeve vendimmarrëse të drejtësisë në legjislacionin tonë parashikohen nga Ligji Nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, ku specifikohen në menyre koncize detyrimet e punëdhënësve në një marrdhenie pune por edhe detyrimet e punëmarrësve në nenin 6 të tij e vijues ku specifikohen: - **Detyrime të përgjithshme të punëdhënësve;**

- Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit;
- Ndihma e parë, mbrojtja kundër zjarrit dhe evakuimi i punëmarrësve, rreziqet e rënda dhe të menjëhershme, Detyrime të veçanta të punëdhënësit

### **Punëdhënësi ka këto detyrime të veçanta:**

- a) kryen një vlerësim të rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë edhe grupet e punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta; b) përcakton masat mbrojtëse që duhen marrë dhe, nëse është e nevojshme, pajisjet mbrojtëse që do të përdoren; c) mban regjistër të aksidenteve në punë, për rastet kur punëmarrësit përfitojnë paaftësi të përkohshme në punë për më shumë se 3 ditë pune, për shkak të aksidenteve e të sëmundjeve profesionale; ç) harton raporte për aksidentet në punë e sëmundjet profesionale, të cilat ia vë në dispozicion autoriteteve përkatëse.

2. Ministri përgjegjës për çështjet e sigurisë e të shëndetit në punë nxjerr udhëzime për detyrimet që kanë subjektet publike dhe private për hartimin e dokumenteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

- Detyrime të punëdhënësit për hartimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë e të sëmundjeve profesionale; Detyrime të punëdhënësit për garantimin e zbatimit të masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale; Informimi i punëmarrësve; Këshillimi i punëmarrësve;

Nderkoh në nenet 20 e vijues të këtij ligji parashikohen detyrimet e punëmarrësit dhe konkretisht në vijën e përgjithshme:

- Punëmarrësi duhet që, në përputhje me formimin e tij, me instruksionet e dhëna nga punëdhënësi dhe me manualët e udhëzimit dhe rregulloret teknike:

- a) të përdorë me korrektësi makineritë, aparatat, veglat, substancat e rrezikshme, pajisjet e transportit dhe mjetet e tjera; b) të përdorë me korrektësi pajisjet mbrojtëse individuale, të vëna në dispozicion të tyre dhe, pas përdorimit, rikthimin e tyre në vendin që është planifikuar ruajtja e tyre e sigurt; c) të mos nxjerrë jashtë shërbimit, të

ndryshojë ose të zhvendosë arbitrarisht mekanizmat e sigurisë të montuara në makineri, të aparaturave, veglave, impianteve dhe ndërtesave dhe t'i përdorë si duhet këta mekanizma; ç) të njoftojë, në mënyrë të menjëhershme, punëdhënësin, punëmarrësin e ngarkuar për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit e punëmarrësve, për çdo situatë pune, për të cilën kanë një motiv të arsyeshëm për ta vlerësuar si rast që paraqet një rrezik të rëndë të menjëhershëm për sigurinë dhe shëndetin, si dhe për çdo defekt të konstatuar në sistemin e mbrojtjes; d) të bashkëpunojë me punëdhënësin, punëmarrësin e ngarkuar për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit e punëmarrësve: i) deri në kryerjen e të gjitha detyrave ose të kërkesave të përcaktuara nga inspektori i punës, me qëllim që të mbrohet siguria dhe shëndeti i punëmarrësve në punë; ii) derisa të jetë e nevojshme për t'i lejuar punëdhënësit të sigurojë që mjedisi dhe kushtet e punës të jenë të sigurta dhe pa rrezik për sigurinë dhe shëndetin, brenda fushës së tyre të veprimtarisë.<sup>155</sup>

Një tjetër akt i rëndësishëm dhe përcaktues ngarkimin me përgjegjësi ose shmangies prej saj është edhe Vendimi i Keshillit të Ministarve Nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier", qëllimi i kësaj VKM është përcaktojë kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm të përkufizuara sipas nenin 2, shkronja "a", si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.<sup>156</sup>

Vec kësaj, në fusha të ndryshme janë përcaktuar rregullore të vecanta nga institucionet përkatëse vlen të përmend këtu Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impjantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike<sup>157</sup>, në të cilën parashikohen masat që duhet të merren nga punëdhënësit dhe punëmarrësit për shmangien e dëmeve dhe për rrjedhojë

---

<sup>155</sup> Ligji Nr.10 237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"

<sup>156</sup> Vendimi i Keshillit të Ministarve Nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier"

<sup>157</sup> Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impjantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike, Ministria e Industrisë dhe energjisë, Departamenti I Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike.

mosrespektimi i tyre nga secila prej paleve sjell ngarkimin me përgjegjësi për to, anasjelltas shkarkimin e tyre nga cdo lloj përgjegjësie.

Ndërsa në arenën ndërkombëtare operon një rregullore e përgjithshme në të cilën janë përcaktuar thujtë me detaje të gjitha masat që duhet të merren nga të dyja subjektet pjesë e marrëdhënies së punës për mbarëvajtjen sa me mirë të kësaj marrëdhënie, por ajo çfarë është më e rëndësishmja kjo rregullore përcakton në një farë mënyre (pasi vendimmarrja i takon gjykates perkatese), përgjegjësine për secilën palë duke u bazuar ne rrethanat në të cilat është shkaktuar dëmi.<sup>158</sup> Në seksionin e përgjegjësise për shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor, NEBOSH (National Examination Board Occupational Safety and Health), përcakton se elementi kryesor për ngarkimin me përgjegjësi për këtë lloj dëmi është **neglizhenca**, një përkufizim shume interesant për të cilën e ka dhënë Lord Aktin ne vitin 1932 ku shprehet se:

*“Kur veproni ose mosveproni duhet të merrni masat e nevojshme për shmangien e dëmit pasi personi që mund të preket mund të jetë i afërmi juaj, i cili në fakt mund të jetë edhe gjitoni im, cka do të thotë se, nëse ju veproni duke dëmtuar nje palë të tretë pa menduar per pasojat sepse po demtoni dike qe nuk keni lidhje gjinore me të edhe per mua mund të jetë e njejta gjë per të afërmin tuaj në lidhje gjaku, por që fizikisht ndodhet afër meje dhe mund ta demtoj kurdohere qe veproj pa arsytuar qartë mbi pasojat, duke neglizhaur”<sup>159</sup>*

Një rëndësi të vecantë kësaj marrëdhënie i ka kushtuar edhe FIDIC (Federata Nderkombetare e Konsultimit te Inxhinierëve), e cila parashikon gjithashtu dhe për me teper

---

<sup>158</sup> *Introduction to Health and Safety in Construction, Second edition, Phil Huges, MBE MSC, Chairman NEBOSH 1995-2001, Ed Ferret PHD, BSC (Hons Eng), Ceng, MMechE, MIEE, MIOSHH, Deputy Chairman NEBOSH, 2007, fq.8.*

<sup>159</sup> *Po aty.*

percakton detyrimet e kontaktorëve të ndryshëm kundrejt palëve të treta në seksionin 20.1 të saj Claim, Disputes and Arbitration.<sup>160</sup>

Banka Europiane gjithashtu, në projektet që zhvillohen me fondet e veta përcakton detyrimin e kontraktoreve në një aneks të vecantë për zhdëmtimn e palëve të treta, në këtë aneks kontratë nuk parashikohen vetëm detyrimet ndaj palëve të treta por specifikohen edhe rastet konkrete në të cilat kontraktoret ngarkohen ose jo me përgjegjësi gjatë kohës së realizimit të projekteve pjesë e fondacioneve të kësaj banke.

Një rast konkret përshembull, është detyrimi i kontraktorit (zbatuesi i projektit) me përgjegjësi për të gjithë përdoruesit e sendeve të ndryshme pavarësisht faktit nëse janë pronar të këtyre sendeve ose jo (përfshihet rasti i marrjes në përdorim në mënyrë të ligjshme).<sup>161</sup>

Ajo cka përbën risi në këtë rast dhe nuk është përmendur më parë është fakti se, gjatë implementimit të projekteve të saj banka ngarkon me përgjegjësi për respektimin e palëve të treta jo vetëm pronarët e një sendi por edhe përdoruesit jo pronarë qofshin ata përdorues me të drejtë ose jo të këtij sendi të luajtshëm ose jo, mjafton që ky send të jetë burim i ardhurash dhe mjet jetësor për palët e treta dhe të prekura nga zbatimi i projekteve të kësaj banke.

#### **4.4. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga personat nën mbikëqyrje.**

Kodi Civil, në nenin 615 parashikon se: *“Mësuesit dhe personat e tjerë që kanë nën mbikëqyrje të mitur, ose personat që u mësojnë të tjerëve një mjeshteri ose profesion, janë*

---

<sup>160</sup> *European International Contractors (EIC) Contractors Guide to the FIDIC Conditions of Contract for EPC/Turnkey Projects (The EIC Silver Book Guide), 2nd Edition, 2003.*

<sup>161</sup> <http://www.ebrd.com/who-we-are/our-values/environmental-and-social-policy/performance-requirements.html%20>

*përgjegjës për dëmin e paligjshëm të shkaktuar të tjerëve nga nxënësit ose personat që kanë nën mbikëqyrje, ose personat që mësojnë mjeshhtëri apo profesion pranë tyre, të shkaktuar gjatë kohës që kanë qenë nën mbikëqyrje të tyre të drejtpërdrejtë, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.”<sup>162</sup>*

Kjo përgjegjësi duket analoge me përgjegjësinë e prindit për dëmet e shkaktuara nga i mituri. Kjo sepse mësuesi apo personi që u mëson të tjerëve një mjeshhtëri, ka detyrimin për të mbikëqyrur të miturin apo atë që mëson mjeshhtërinë përgjatë kohës që zhvillohet mësimi. Gjithashtu, ata, njësoj si edhe prindërit, mund të përjashtohen nga kjo përgjegjësi vetëm në rast se provojnë që nuk kanë patur mundësi reale për të ndaluar shkaktimin e dëmit.<sup>163</sup>

*Kushtet e përgjegjësisë.* Që të lindë përgjegjësia e parashikuar sipas nenit 615 të Kodit Civil, duhet që së pari, të ekzistojë një lidhje e posaçme ndërmjet personit përgjegjës dhe atij që ka shkaktuar dëmin. Kështu, personi përgjegjës do të jetë mësuesi për dëmet e shkaktuara nga të miturit në ngarkim të tij. Gjithashtu, përgjegjës do të jetë edhe mjeshtri për dëmin e shkaktuar nga personi që mëson prej tij. Këta duhet të kenë lidhur midis tyre një kontratë të posaçme për mësimin e mjeshhtërisë sipas parashikimit që bëhet në Kodin e Punës për një rast të tillë (neni 17 i Kodit të Punës)<sup>164</sup>.

Një kusht tjetër i domosdoshëm për lindjen e kësaj përgjegjësie është ushtrimi i mbikëqyrjes.<sup>165</sup> Kjo nënkupton se personat e lartpërmendur do të përgjigjen për dëmin e shkaktuar vetëm për sa kohë që personat të cilët kanë shkaktuar dëmin, kanë qenë nën mbikëqyrjen e tyre të drejtpërdrejtë. Vetëm gjatë kësaj kohe ekziston detyrimi për të mbikëqyrur këta të fundit, në mënyrë të atillë që të mos shkaktojnë një dëm. Mospërmbushja e

---

<sup>162</sup>Neni 615 i Kodit Civil.

<sup>163</sup> Parental Liability Laws John Howard Society of Alberta 1997

<sup>164</sup>Neni 17 i Kodit të Punës.

<sup>165</sup> Jerzy (George), K. (1977) “ The Ethiopian Law of Compensatio for Damage” ,Addis ,Ababa, Faculty of Law.



këtij detyrimi sjell si pasojë lindjen e përgjegjesisë së mësuesit apo mjeshtrit për ndonjë dëm të mundshëm.<sup>166</sup>

*Përgjashtimi nga përgjegjësia.* Neni 615 i Kodit Civil prezumon fajësinë e mësuesit apo mjeshtrit për dëmin e shkaktuar nga i mituri apo personi gjatë kohës që duhet të jetë nën mbikqyrjen e tyre. Si rrjedhim, nëse shkaktohet një dëm nga këta të fundit gjatë kohës që kanë qenë nën mbikëqyrjen e përkohshme të personave përgjegjës, do të lindë përgjegjësia për shpërblimin e dëmit.<sup>167</sup> Ky prezumim, ashtu siç cituam edhe më sipër, mund të kundërshtohet vetëm në rast se personi përgjegjës provon se nuk ka mundur të ndalonte shkaktimin e dëmit. Me këtë interpretim duhet kuptuar se, mësuesi apo mjeshtëri ka përmbushur si duhet detyrimin e tij për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e sjelljes së të miturit apo të atij që mëson një mjeshtëri. Në këtë mënyrë nuk ka patur faj (*culpa in custodiendo*), pasi nuk ka patur mundësi reale për të ndaluar dëmin e shkaktuar.<sup>168</sup>

#### **4.5. Përgjegjësia e përfaqësuesit.**

Kodi Civil në nenin 620 të tij parashikon se: “*Në qoftë se veprimtaria e përfaqësuesit në ushtrimin e pushteteve që i janë caktuar, sjell një përgjegjësi me faj ndaj një të treti, ipërfaqësuari është gjithashtu përgjegjës ndaj këtij personi.*”<sup>169</sup>

Siç dihet, përfaqësuesi vepron në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit. Kjo gjë është në interes të këtij të fundit, i cili për arsye nga më të ndryshmet nuk mund të veprojë vetë. Megjithatë, pavarësisht se të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor

---

<sup>166</sup>Humm, R. (1991) “Criminalizing poor parenting skills as a means to contain violence by and against children”, *University of Pennsylvania Law Review*, 139(4), 1123-1161, April.

<sup>167</sup>Neni 615 i Kodit Civil.

<sup>168</sup>Jaffey, A. J. E. “*Volenti Non Fit Injuria*”, *The Cambridge Law Journal*, Volume 44, f. 247.

<sup>169</sup>Neni 620 i Kodit Civil.

konsiderohen si të kryera nga vetë i përfaqësuari, përgjegjësia për shkaktimin e një dëmi gjatë veprimtarisë përfaqësuese zgjidhet nga ligji paksa ndryshe.<sup>170</sup>

Dispozita e sipërcituar parashikon se përfaqësuesi do të përgjigjet për dëmet e shkaktuara për faj të tij ndaj një të treti. Pra, që të lindë përgjegjësia e përfaqësuesit, duhet që ky të ketë vepruar me faj të tij. Po ashtu, parashikohet se përgjegjësia në këtë rast bie edhe mbi të përfaqësuarin. Këtu lindin dy pyetje:<sup>171</sup>

*Së pari*, çfarë përgjegjësie është ajo e të përfaqësuarit? Në rastin që po trajtojmë kemi të bëjmë me një dëm të shkaktuar për faj të përfaqësuesit, për të cilin detyrohet të përgjigjet edhe i përfaqësuari. Ky i fundit nuk ka lidhje direkte me dëmin, e megjithatë detyrohet ta shpërblejë atë. Duket se kemi të bëjmë me një përgjegjësi pa faj, e cila mund të jetë parashikuar në interes të të dëmtuarit.<sup>172</sup>

*Së dyti*, përgjegjësia në fjalë është individuale apo solidare? Meqenëse bëhet fjalë për shkaktimin e një dëmi të vetëm, për të cilin ligji ngarkon njëkohësisht dy persona si përgjegjës, mendoj se përgjegjësia është solidare.

Ndërsa po ti referohemi Ligjit Nr. 8510, date 15. 7. 1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, shohim që ratet e ngarkimit me përgjegjësi për shkaktimin e dëmeve jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore dhe punonjësve të tyre janë përcaktuar në mënyrë specifike, parashikuar në nenet 3 dhe 4 të këtij ligji.

Në bazë të Nenit 3, të ligjit të sipërcituar parashikohet se “*Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizike a juridike private në rastet që vijojnë:*

- a) *kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme;*

---

<sup>170</sup>Cahn, N. (1996) “Pragmatic questions about parental liability statutes”, *Wisconsin Law Review*, fq.399.

<sup>171</sup>Tutulani-Semini, M. (2006) “E drejta e detyrimeve dhe e kontratave”, pjesa e përgjithëshme, Tiranë, fq. 72.

<sup>172</sup>Po aty.

b) kur kryejnë veprime a mosveprime te ligjshme, por qe sjellin dëmtimin e interesave te ligjshme te personave fizike a juridike private;

c) kur, megjithëse kryejnë veprime a mosveprime te ligjshme, u shkaktojnë një dem te pabarabarte subjekteve te cilëve u drejtohet ky veprim a mosveprim;

ç) kur, për shkak te mosfunksionimit te mjeteve teknike me te cilat organet e administratës shtetërore ushtrojnë veprimtarinë e tyre, persona fizike a juridike private cenohen ne interesat e tyre te ligjshme;

d) kur u shkaktojnë një rrezik te vazhdueshëm personave fizike a juridike private.

dh) kur kryejnë një akt korruptiv gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre” dhe neni 4 i po ketij ligji përjashton përgjegjësinë e vetë organeve të administratës shtetërore duke përcaktuar rastet në te cilat përfaqësuesit e këtyre organeve do të mbajnë vete pergjegjesi per demet e shkaktuara nga vete ata personalisht dhe konkretisht “Ne ushtrimin e funksioneve shtetërore, punonjësit e organeve te administratës shtetërore nuk përgjigjen për demet shkaktuar personave fizike a juridike private ne rastet e parashikuara ne nenin 3.

*Punonjësit e organeve te administratës shtetërore, përjashtimisht, përgjigjen për demet qe u shkaktojnë personave fizike a juridike private, kur vërtetohet se ata kane vepruar me keqbesim.*

*Ne rastet e parashikuara ne paragrafin 2 te këtij neni, organi shtetëror punëdhënës, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka te drejte te kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit qe ka paguar.”<sup>173</sup>*

Sic është folur edhe më sipër **përgjegjësia që rrjedh nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor është përgjegjesi e kushtëzuar**, në sajë të këtij parimi edhe për këtë lloj dëmi jashtëkontraktor Ligji Nr. 8510, date 15. 7. 1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore” në nenin 9 të tij parashikon përjashtimin nga

---

<sup>173</sup>Neni 4 i Ligjit Nr. 8510, date 15. 7. 1999 “Per pergjegjesine jashte kontraktore te organeve te administrates shteterore”

përgjegjësia të organit të administratës shtetërore si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij, në qoftë se dëmi nuk do të mund të shmangej edhe nëse do të ishte treguar kujdesi i duhur gjatë ushtrimit të funksioneve shtetërore, duke marrë parasysh rrethanat. Përfundimi i mësipërm nuk zbatohet në rastin e mosfunksionimit të mjeteve teknike,<sup>174</sup> me të cilat mund të nënkuptojmë shenjat e trafikut, sinjalistikës rrugore, ajrore, detare etj.<sup>175</sup>

#### **4.6. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm ose ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme.**

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sende të rrezikshme ose nga kryerja e një veprimtarie të rrezikshme përbën një prej përgjegjësive civile sipas parimit të përgjegjësive objektive. *Sende të rrezikshme* do të konsiderohen ato sende që për shkak të pozitës së tyre, ndikimit, cilësive apo vetë ekzistencës së tyre si të tilla, përbëjnë rrezik të shtuar për mjedisin. Më së shumti përgjegjësia objektive ka të bëjë me lumenjtë, në të cilët punohet me energji elektrike, lëndë shpërthyesë, makina me avull ose me gaz, pajisje me energji nukleare, instalime për kalimin e energjisë elektrike.<sup>176</sup>

*Rrezik i shtuar* konsiderohet edhe ndezja e zjarrit në ambient të hapur, përhapja e ndotësve dhe ndotja e mjedisit, tymrat, djegia e gëlqeres. Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm ose nga kryerja e një veprimtarie të rrezikshme konsiderohet se rrjedh drejtpërdrejtë nga ai send ose veprimtari, përveçse kur provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit. Për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm përgjigjet pronari i sendit, përkatësisht

---

<sup>174</sup>Neni 9 i Ligjit Nr. 8510, datë 15. 7. 1999 "Per përgjegjësine jashte kontraktore te organeve te administrates shteterore".

<sup>175</sup>Mataj, R. (2016) "The Compensation of Non-contractual Damages Caused by Administrative Bodies in Albania", *Acta Universitatis Danubius, Juridica*, Vol 12, No 1, fq.3.

<sup>176</sup>RFV Husten, Buckley RA, Salmond, Hustenon. (1992) "The Law of Torts", 20<sup>th</sup> Ed, London: Sweet and Maxwell, fq. 189.

shfrytëzuesi i këtij sendi, ndërsa për dëmin e shkaktuar nga kryerja e një veprimtarie të rrezikshme përgjigjet personi cili e ushtron atë veprimtari.<sup>177</sup>

Kushtet që duhet të plotësohen për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sendi i rrezikshëm apo nga kryerja e një veprimtarie të rrezikshme janë: së pari, të jetë shkaktuar dëmi dhe së dyti, të ekzistojë lidhja shkakësore ndërmjet dëmit dhe përdorimit të sendit apo ushtrimit të veprimtarisë së rrezikshme, të cilat paraqesin rrezik të shtuar për mjedisin, sipas rastit. Përgjegësia e pronarit të sendit të rrezikshëm apo e atij që kryen veprimtarinë e rrezikshme për shpërbilimin e dëmit, do të shuhet nëse dëmi është shkaktuar nën ndikimin e forcës madhore, me veprimin e të dëmtuarit apo me veprimet e personave të tretë.<sup>178</sup>

Kodi Civil e parashikon atë në nenin 622 të tij, si më poshtë vijon: *“Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të dëmshpërblejë dëmin, përveç se kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit.”*<sup>179</sup>

Në këtë mënyrë, çdokush, i cili duke zhvilluar një veprimtari që krijon një rrezik për të tretët, për shkak të natyrës së saj apo të mjeteve të përdorura, është i detyruar ta shpërblejë dëmin që mund të vijë nga ushtrimi i kësaj veprimtarie ndaj personave të tjerë.

Personi përgjegjës nuk mund të pretendojë se nuk ka patur faj në shkaktimin e dëmit. Vetëm nëse ai provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit, mund të përjashtohet nga përgjegjësia për shpërbilimin e dëmit.

Lidhur me kuptimin e veprimtarisë së rrezikshme, në doktrinën e huaj është pranuar se nuk është e domosdoshme që të bëhet fjalë për një veprimtari të dallueshme nga të tjerat për nga rreziku që ajo krijon. Mjafton kështu, që të krijohet një rrezik për të tjerët, qetë aplikohet neni 622 i Kodit Civil në rast të shkaktimit të dëmit.

---

<sup>177</sup>Martin T.N., Vieceli L. (1988) “The business of rehabilitation placement: What to understand about private employers before approaching them”, *Journal of Rehabilitation*.

<sup>178</sup>Galev, G., Jadranka. (2004) “E drejta e Detyrimeve”, pjesa e përgjithshme, Beograd, fq. 124.

<sup>179</sup>Neni 622 i Kodit Civil.

Për shembull, një sipërmarrës që është duke restauruar një rrugë, nëse hap një gropë në mes të saj, ai krijon një rrezik të mundshëm për ndonjë aksident.<sup>180</sup>Për këtë arsye ai është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur dëmet, duke vënë në rrugë shenja dalluese të përshtatshme për drejtuesit e automjeteve për t'iu shmangur rrezikut.

Për të përcaktuar se cilat do të jenë masat e përshtatshme e të nevojshme, do t'u referohemi atyre që ofron teknika dhe jo ayre që mund të ketë konsideruar si të përshtatshme personi përgjegjës. Ka sisteme që përfshijnë në këtë përgjegjësi, edhe rastet e shkaktimit të dëmit nga ndërtesat, nga një send me të meta apo nga kafsha.<sup>181</sup>

*Në një vendim të saj gjykata është shprehur se është pikërisht detyrimi i të paditurit që të mirëmbajë rrjetin e veprimtarisë së tij. Mosmarrja e këtyre masave për riparimin e të metave, si masa të përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit, sjell përgjegjësinë e tij për dëmin e shkaktuar.<sup>182</sup> P.sh.: nëse nga rrjeti i energjisë elektrike ka luhatje tensioni dhe nga kjo luhatje digjen paisje elektroshtëpiake, pala që do të shpërblejë dëmin është OSHEE, e cila është pala kontraktuale furnizuese me energji elektrike tek pala kontraktuese tjetër, që është abonenti familjar apo privat që konsumon energji elektrike (konsumatori).*

Lidhja ndërmjet faktit të ndodhur dhe dëmit të ardhur është baza e kësaj përgjegjësie.<sup>183</sup>Kështu, në këtë lloj përgjegjësie subjekti që zhvillon veprimtari të rrezikshme për nga natyra e saj apo e sendeve që përdor, konsiderohet përgjegjës nëse ekziston lidhja shkakësore ndërmjet ngjarjes dhe pasojës së ardhur. Ky subjekt mund t'i shmanget përgjegjësisë vetëm në rastin kur provon se i ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të shmangur ardhjen e dëmit si pasojë e ngjarjes. Dhe për këtë, “faji” si element i domosdoshëm i përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit përmblihet në detyrimin

---

<sup>180</sup> *A factual assesement of the draft common frame of reference Edited by Luisa Antonioll Franceska fiorentini Prepared by the Common core evaluation group 'Legally Relevant Damage' and a Priori Limits to Non-Contractual Liability in the DCFR, fq 20.*

<sup>181</sup> Hetemi, M. (1998) “Detyrimet dhe kontratat”, Tiranë, fq. 184.

<sup>182</sup> Vendimi nr. 652, datë 22.06.2000 i Gjykates se Larte.

<sup>183</sup> Prof. Dr. A.K. Schnyder Herbstsemester 2013 Comparative Private Law, Materials/lectures. Prof. Schnyder October 7 and 21, November 4 and 11, 2013.

absolut të marrjes së masave të përshtatshme dhe të nevojshme që rrjedhimisht bëjnë të mundur shmangien e ardhjes së dëmit.<sup>184</sup>

Si rrethanë tjetër për lirimin e personit nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar shërben edhe rasti kur dëmi shkaktohet me fajin e personit të tretë. Në këtë rast dëmi shkaktohet nga përdorimi i sendeve të rrezikshme dhe veprimtarisë së rrezikshme dhe, përgjegjës në këtë rast nuk është pronari apo poseduesi i tyre, por personi i tretë, me fajin e të cilit ka ardhur deri tek shkaktimi i dëmit.

Personi i tretë në këtë rast nuk është në ndonjë lidhje juridike apo në ndonjë raport të caktuar juridik me pronarin e sendit apo personin që ushtron veprimtarinë e rrezikshme, por është thjesht një person, i cili në mënyrë të paautorizuar ka arritur deri në përdorimin e këtyre sendeve ose të mirave materiale, apo edhe deri në ushtrimin e veprimtarisë së rrezikshme, nga të cilat ka ardhur edhe shkaktimi i dëmit. Pronari i sendit apo ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme, sipas rastit, këtu nuk konsiderohet se është as dëmtues e as palë e dëmtuar. Prandaj raporti juridik pas shkaktimit të dëmit krijohet në mes të personit të tretë dhe palës së dëmtuar.<sup>185</sup>

Që personi të lirohet nga përgjegjësia për kompensimin e dëmit, duhet që të vërtetojë se dëmin e ka shkaktuar ekskluzivisht me fajin e personit të tretë, veprimet e të cilit nuk ka patur asnjë mundësi t'i parashikojë, si dhe se nuk ka mundur t'i evitojë as pasojat e atij dëmi. Po qe se nuk mund ta vërtetojë këtë, përgjegjësia për kompensimin e dëmit të shkaktuar do të bjerë mbi vetë pronarin e sendit të rrezikshëm, apo mbi atë që merret me veprimtari të rrezikshme.<sup>186</sup> Jeta e përditshme na sjell mjaft raste kur veprohet me sende, të cilat janë të rrezikshme si për shëndetin e njerëzve, ashtu edhe për pasurinë e tyre. Shoqëria, përveç

---

<sup>184</sup> John, H, John, L. (2004) "Tort Law", Oxford University Press, fq.248

<sup>185</sup> Von Bar, C. (2009) "Principles of European Law", Non-contractual liability arising out of Damage Caused to Another, European Law Publishers, Vol, 7, fq. 309.

<sup>186</sup> Dobbs, Dan B, Hayden, Paul T. (2005) "Torts and Compensation: Personal accountability and social responsibility for injury", fq.326.

rrezikut që paraqesin këto sende, përfiton dhe dobi prej tyre. Përparimi i teknikës dhe teknologjisë i ka afirmuar edhe më këto raste të përgjegjësisë. Si përgjegjësi të tilla njihen:

- Përgjegjësia që mund të ndodhë nga fatkeqësia automobilistike;
- Përgjegjësia për dëmin që shkaktojnë sendet me të meta;
- Përgjegjësia për dëmin që shkaktojnë kafshët;
- Përgjegjësia për dëmin nga objekti ndërtimor;
- Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga gjuajtja e sendeve apo hedhja e

materieve të lëngëta nga banesa.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 100, date 03.02.2008 "Për përcaktimin e substancave të rrezikshme"<sup>187</sup>, ka përcaktuar në mënyrë të detajuar llojet e substancave të klasifikuara si të rrezikshme.

#### **4.7. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar ndaj mjedisit.**

Kodi Civil në nenin 624 parashikon se: "*Personi që me faj ka cënuar mjedisin, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.*"<sup>188</sup> Me këtë dispozitë ligji ngarkon me përgjegjësi për shpërblimin e dëmit, çdo person, i cili i shkakton një dëm mjedisit. Problemi qëndron në faktin se, në këtë rast është e vështirë të zbatohet rregulli i përgjithshëm, i parashikuar nga neni 608 i Kodit Civil, për dëmin e shkaktuar ndaj personit apo pasurisë së tij.<sup>189</sup>

Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 Dt. 09.06.2011, " Per mbrojtjen e mjedisit" , ne nenin 12 parashikon pergjegjesine per demin e shkaktuar mjedisit duke e permbledhur ne nje parim te vetem "Ndotësi paguan"

---

<sup>187</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 100, date 03.02.2008 "Për përcaktimin e substancave të rrezikshme".

<sup>188</sup> Neni 624 i Kodit Civil.

<sup>189</sup> Neni 608 i Kodit Civil.



*“ Personi fizik apo juridik, veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen e mjedisit, mban përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimin e mjedisit. Kosto të tilla përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit të mjedisit, vlerësimit të masave të nevojshme, si dhe kostot e shmangies së dëmtimit të mjedisit, përfshirë kostot e rehabilitimit e të kompensimit të personave fizikë apo juridikë të dëmtuar”*<sup>190</sup>.

Sa me sipër, ky ligj ngarkon pa përjashtim me përgjegjësi çdo person fizik apo juridik i cili shkakton dëm mjedisit duke i detyruar të dëmshperblejnë jo vetëm dëmin e shkaktuar mjedisit por edhe personat e tretë të cilët preken nga dëmi i shkaktuar. Këto parime janë krijuar dhe operojnë në përputhje dhe në zbatim të standarteve ndërkombetare të përcaktuara në konventat e ndryshme ndërkombetare në të cilat shteti jonë ka aderuar.<sup>191</sup>

Dëmet që i shkaktohen ambientit mund të sjellin dëme edhe në shëndetin apo në pasurinë e personave të veçantë. Në një rast të tillë të dëmtuarit mund të padisin shkaktuesin e dëmit, për të shpërblyer dëmet që u janë shkaktuar atyre personalisht. Por, përtej dëmeve që u janë shkaktuar personave të veçantë, ekzistojnë edhe dëme të tjera mjaft të rënda, që u janë shkaktuar sendeve që nuk përbëjnë objekt pronësie si: atmosfera, ujërat e deteve, liqeneve e lumenjve, dhe ambientit në përgjithësi, pra, hapësira në të cilën zhvillohet jeta e të gjithëve, me karakteristikat e saj jetësore, shëndetësore, ekuilibrin ekologjik dhe vlerat kulturore të peisazhit.<sup>192</sup>

Cënimi i këtyre ekuilibrave dhe vlerave rezulton, sigurisht, në fund të fundit, në dëmet ndaj shëndetit dhe cilësisë në përgjithësi të jetës së individëve të veçantë.

---

<sup>190</sup> Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 Dt. 09.06.2011, “ Per mbrojtjen e mjedisit”

<sup>191</sup> Qendra Rajonale e Mjedisit, AKTE ndërkombetare mjedisore Biodiversiteti, Tirane 2011.

<sup>192</sup>Ligji Nr.8690, datë 16.11.2000 “Për aderimin e republikës së shqipërisë në konventën “për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të detit mesdhe, si dhe të 6 protokolleve shoqëruese”.

Shtete të ndryshme të Bashkimit Europian kanë krijuar institucione të vecanta për vlerësimin e masës së dëmit që i shkaktohet mjedisit dhe kanë hartuar gjithashtu udhëzues të cilet ndihmojnë në cënimin sa me të pakët të kategorive të mbrojtura nga një sër aktesh ndërkombëtare në këtë fushë.<sup>193</sup>

Banka Europiane është një ndër institucionet që përcakton masat që duhet të merren nga palët pjesmarrëse të projekteve të cilat ajo zhvillon për mbrojtjen e mjedisit duke parashikuar politikat që duhet të zbatohen por edhe përcaktimin e përgjegjësisë në rast të moszbatimit të tyre.

Politikat sociale dhe për mjedisin të Bankës Europiane paraqesin menyren se si Banka do te adresojë impaktin social dhe mjedisor te projekteve te saj duke:

- Përcaktuar rolet përkatëse dhe përgjegjësitë e saj por edhe te klienteve në projektimin zbatimin dhe operimin e projekteve;
- Duke përcaktuar objektiva startegjike në mënyrë që projektet te zbatohen me përfitime te larta mjedisore dhe sociale
- Integrimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale në të gjitha aktivitetet e saj.<sup>194</sup>

#### **4.8. Përgjegjësia për reklamë mashtruese.**

Kemi të bëjmë përsëri me një rast të përgjegjësisë pa faj. Kjo parashikohet nga neni 617 i Kodit Civil ku thuhet: *“Kur vërtetohet se një person ka përgjegjësi ndaj një personi tjetër, për shkak se ka publikuar të dhëna të pasakta, jo të plota ose mashtruese, gjykata me kërkesën e personit të dëmtuar, detyron personin tjetër që të publikojë një përgënjeshttrim, në mënyrën që ajo do ta quante të përshtatshme. Gjykata mund të urdhërojë publikimin e*

---

<sup>193</sup> Von Bar, C. (2009) “ Principles of European Law”, Non-contractual liability arising out of Damage Caused to Another, European Law Publishers, Vol, 7 , fq. 200.

<sup>194</sup> <http://www.ebrd.com/who-we-are/our-values/environmental-and-social-policy.html%20>

*përgënjeshtimit edhe kur vërtetohet se publikimi i të dhënave nuk është i paligjshëm dhe i kryer me faj, se autori i tyre nuk kishte dijeni për karakterin e pasaktë ose të paplotë të këtyre të dhënave.*<sup>195</sup>

Dispozita e mësipërme, më tepër se një përgjegjësi, parashikon mënyrën e shpërblimit në një rast të tillë. Për sa i përket përgjegjësisë së publikuesit, kjo do të lindë duke u bazuar në faktin e vetëm të publikimit të të dhënave të pasakta, jo të plota ose mashtruese. Me vërtetimin e një fakti të tillë, gjykata urdhëron publikimin e një përgënjeshtimi. Nuk ka rëndësi nëse personi që ka publikuar të dhënat e pasakta ka vepruar me faj ose jo. Pra, nuk ka rëndësi nëse ai ka patur dijeni ose jo për pasaktësinë e të dhënave, apo ka patur ose jo mundësi për t'i verifikuar ato.<sup>196</sup>

Provat për pafajësinë e personit përgjegjës do të vlenin vetëm për ta përjashtuar atë në rast të kërkimit nga i dëmtuari për shpërblimin e ndonjë dëmi të ardhur si pasojë e publikimit, qoftë ky pasuror, moral, apo i çdolloji tjetër.<sup>197</sup>

#### **4.9. Publikimi mashtrues**

Në rastin kur nga veprimi i paligjshëm i përcaktuar si më sipër, do t'i shkaktohet dëm një personi të caktuar, autori i publikimit do të përgjigjet për dëmin e ardhur për shkak të veprimit të tij. Kjo përgjegjësi është objektive. Fajësia e autorit të dëmit prezumohet, dhe ky do të konsiderohet fajtor derisa të provojë se nuk ka patur faj në ardhjen e dëmit.<sup>198</sup>

Shpërblimi i dëmit në këto raste, përveç shpërblimit të dëmit pasuror që mund të ketë ardhur, mund të shoqërohet edhe me një shpërblim në natyrë, sipas të cilit gjykata mund të urdhërojë ndalimin e publikimit mashtrues dhe publikimin e një përgënjeshtimi publik sipas

---

<sup>195</sup>Neni 617 i Kodit Civil.

<sup>196</sup>Po aty.

<sup>197</sup> Bergel, Y , De Baranda, S. (2012) “ Introduction to non-contractual liability under Spanish Law”, Universidad Carlos III de Madrid , ÖREBRO, MAY, fq. 86.

<sup>198</sup>Neni 636 i Kodit Civil.

mënyrës që e çmon gjykata. Kjo masë mund të merret edhe atëherë kur nga një publikim i tillë rrezikon t'i vijë dëm një personi të caktuar.<sup>199</sup>

Neni 635 i Kodit Civil parashikon “ Personi që publikon ose shkakton bërjen publike të një njoftimi lidhur me produktet ose shërbimet, që ofron vetë në rastin e një veprimtarie profesionale, ose të një ndërmarrjeje, ose të një personi për të cilin ai vepron, kryen një veprim të paligjshëm në qoftë se njoftimi është mashtrues në një ose disa drejtime të mëposhtme:

- a) natyra, përbërja, sasia, cilësia, karakteristikat ose përdorimet e mundshme;
- b) origjina, mënyra ose data e prodhimit;
- c) madhësia e prodhimit stok të tij;
- ç) çmimi ose metoda e llogaritjes së tij;
- d) arsyeja ose qëllimi i ofertës speciale;
- dh) cilësitë e atribuara, dëshmitë ose vlerësime të tjera të bëra nga të tretët, ose deklarata të lëshuara prej tyre, terminologjia shkencore ose profesionale e përdorur, të dhënat teknike ose statistikore;
- e) kushtet e livrimit të produkteve, të ushtrimit të shërbimeve ose të kryerjes së pagesës;
- f) shtrirja, përmbajtja dhe kohëzgjatja e garancisë;
- g) identiteti, cilësitë, kompetencat ose tagret e atij që fabrikon ose ka fabrikuar produktet, që ofron ato ose të atij që kryen shërbim, që drejton, mbikëqyr ose ndihmon në këto veprimtari;
- gj) krahason me produkte dhe shërbime të tjera.

---

<sup>199</sup>Neni 637 i Kodit Civil.

Neni 636 parashikon se: “Personi që ka vepruar në mënyrë të paligjshme sipas dispozitës së sipërme, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, përveç kur provon se nuk ka faj për ardhjen e tij”.

Per sa me siper specifikuar, del qartë se edhe në këtë rast përgjegjësia për këtë lloj dëmi është e kushtëzuar dhe me faj.

#### **4.10. Përgjegjësia për mjetet motorike në lëvizje**

Shtimi i numrit të automjeteve, si dhe rritja e vazhdueshme e përdorimit të mjeteve motorike, ka bërë që edhe aksidentet automobilistike të shënojnë një rritje të madhe në raste. Sipas statistikave, kjo është forma që provokon më shumë dëme, madje me përafërsi mundet të parashikohet edhe numri i aksidenteve rrugore që do të ndodhin në vitin e ardhshëm, duke përfshirë numrin e të vdekurve, si edhe të të plagosurve (do të jetë proporcionalisht më i madh se viti i mëparshëm, në qoftë se do të rritet numri i mjeteve motorike në qarkullim, duke qëndruar konstante shtrirja e rrjetit rrugor). Për siguri të trafikut në rrugë, duke iu referuar edhe praktikës gjyqësore, bëhet dallimi ndërmjet mjeteve të vogla apo të mëdhaja për nga fuqia motorike, pasi realisht, sa më e madhe fuqia motorike dhe sa më i shpejtë të jetë mjete, po aq rritet edhe burimi i rrezikut për rrethin ku qarkullon dhe për njerëzit në të, dhe rrjedhimisht edhe përgjegjësia e pronarit apo përdoruesit duhet të rritet po në këtë proporcion.<sup>200</sup>

Kështu, edhe në udhezimin Nr. 24, date 15.11.2007 "Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësine ndaj palëve të treta" sanksionon në nenin 2 pika d: "Në rast të fatkeqësisë të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje, kryesisht për faj të njërit protagonist pjesëmarrës, do

---

<sup>200</sup>Cooke, J. (2007) "Law of Torts 8<sup>th</sup> ed", London, New York and Others, Pearson Longman, fq 83.

*të zbatohen rregullat për përgjegjësi në bazë të fajit*".<sup>201</sup> Fatkeqësia në qarkullimin rrugor paraqet ngjarje të papritur dhe të padëshiruar, e cila vjen befas dhe, e cila ka për pasojë dëmin që mund t'u shkaktohet personave si ndaj jetës, shëndetit dhe pasurisë së tyre.<sup>202</sup>

Mjetet motorike në qarkullim paraqesin rrezik vazhdues për pjesëmarrësit në të, si dhe ndaj personave të tretë, nga momenti i përdorimit të tyre. Mjetet motorike, kur janë në lëvizje, nga rregullat e së drejtës, trajtohen si sende të rrezikshme gjatë përdorimit të tyre, përdorim ky i cili paraqet veprimtari vazhduese të rrezikshme. Dhe, kur shkohet deri tek shkaktimi i dëmit nga këto mjete, pronari apo përdoruesi i tyre do të përgjigjet në bazë të rregullave të përgjegjesisë objektive.

Në rastet kur dëmi shkaktohet me fajin e njërit prej pjesëmarrësve në trafik, atëherë dhe përgjegjësia për shpërblimin e dëmit do të përcaktohet mbi bazën e fajit, pra anës subjektive. Prandaj, thuhet se, sa i përket përcaktimit të bazës së përgjegjesisë për shkaktimin e dëmit nga mjete motorik në lëvizje, për pjesëmarrësit vijnë në shprehje të gjitha llojet e përgjegjesisë, si ajo objektive, subjektive dhe përgjegjësia solidare. Ekzistojnë disa lloje kategorish të mjeteve motorike, lëvizja e të cilave paraqet burim rreziku të shtuar. Ato janë: veturat, mjete për transport të mallrave (maune), mjetet tërheqëse, autobusët, tramvajët, trenat, mjetet motorike speciale, motociklet, rimorkiot, etj.<sup>203</sup>

Në dispozitat e udhezimit Nr. 24, date 15.11.2007 "Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësine ndaj palëve të treta"<sup>204</sup> përcaktohet se, personat të cilët deklarohen fajtorë për shkaktimin e dëmit, pra, përbëjnë shkak determinant për ardhjen e pasojës, dhe janë të gjithë pjesëmarrës në aksident, atëherë për shpërblimin e dëmit do të përgjigjen të gjithë solidarisht

---

<sup>201</sup>Neni 2 pika d I udhezimit Nr. 24, date 15.11.2007 "Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësine ndaj palëve të treta"

<sup>202</sup>Galgano, F. (1999) "E drejta Private", Tiranë, fq. 369.

<sup>203</sup>Neni 2 i igjit nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë".

<sup>204</sup> Udhezimi Nr. 24, date 15.11.2007 "Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësine ndaj palëve të treta".

në bazë të shkallës së fajit të secilit. Edhe në rastin kur nga një aksident personat e tretë pësojnë dëmtime, por asnjëri nga pjesëmarrësit brenda mjetit motorik nuk është fajtor për dëmin e shkaktuar, ata do të përgjigjen të gjithë në mënyrë solidiare të barabartë, me përjashtim të rasteve kur rregullat e parimit të drejtësisë parashikojnë diçka tjetër. Prandaj, thuhet se kur nga një aksident pësojnë dëm persona të tretë, do të zbatohen rregullat e përgjegjësisë solidare, pavarësisht fajit të pjesëmarrësve.

Kështu, duke iu referuar nenit 626 të Kodit Civil, për përgjegjësinë solidare ku parashikohet se *“Kur dëmi është shkaktuar nga shumë persona së bashku, këta përgjigjen ndaj të dëmtuarit Solidarisht”*, për dëmin që do ta shkaktojnë më shumë persona bashkarisht, të gjithë pjesëmarrësit përgjigjen solidarisht, dhe kur nuk ka dyshim se dëmin e ka shkaktuar dikush nga dy apo më shumë personat e përcaktuar, të cilët në një mënyrë janë të lidhur ndërmjet tyre dhe nuk mund të vërtetohet se cili nga këto e ka shkaktuar dëmin, ata persona përgjigjen solidarisht”.<sup>205</sup>

Personatë tretë, në kuadër të asaj çka u trajtua më lart, do të konsiderohen të gjithë ata persona të cilët pësojnë ndonjë dëm material apo jomaterial nga mjete motorik në lëvizje, qoftë kur gjenden brenda mjetit motorik, apo jashtë tij (kur mjete aksidenton këmbësorin).<sup>206</sup>Personi i tretë gjithmonë do mund të realizojë të drejtën e shpërblimit të dëmit në rrugë gjyqësore, qoftë prej njërit apo prej të gjithë pjesëmarrësve të tjerë të përfshirë në aksident, me kushtin që ky vet të mos jetë shkaku i ardhjes së pasojës. Që personat e tretë të mund të realizojnë të drejtën e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga mjete motorik, ligjvënësi ka paraparë sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë.<sup>207</sup>

Edhe pse këtu kam trajtuar vetëm situatën kur mjete motorik është në lëvizje, ai mund të paraqitet si burim rreziku edhe kur është i parkuar apo kur qëndron në pozitë të

---

<sup>205</sup> Dauti, N. (2001) *“E drejta e Detyrimeve”*, Prishtinë, fq. 154.

<sup>206</sup>Shulman, Harry, James, F, Jr.OscarS.Gray, Gifford, D. (2003) *“Cases and Material son the Laë of Torts 4<sup>th</sup>ed”*, New York:Foundation Press.

<sup>207</sup>Dauti, N. (2001) *“E drejta e Detyrimeve”*, Prishtinë, fq. 160.

palëvizshme, por ka motorin e ndezur (rastin e motorit mund të jetë i parkuar dhe ka pësuar ndonjë difekt). Kjo situatë mund të paraqitet veçanërisht kur automjeti në gjendje të palëvizshme, por me motor të ndezur, gjendet në ambiente të mbyllura, kryesisht në garazh apo bodrum, duke përbërë rrezik veçanërisht për jetën dhe shëndetin e njerëzve, nëse ata qëndrojnë në atë ambient për një kohë relativisht të gjatë.

Këto janë raste të shpeshta në praktikë, ndër të cilat mund të përmendim rastin e ndodhur në *Toledo të Ohio-s në SHBA, më 12.11.2012, ku humbën jetën pesë persona, S.F. 54 vjeç, djali i madh A.F. 32 vjeç, mbesa P.H. 10 vjeç, L.H. 6 vjeç dhe M.H. 5 vjeç, nga gazi i dioksidit të karbonit, të lëshuar nga vetura e ndezur në një garazh të mbyllur.*<sup>208</sup> Prandaj, duhet të theksojmë se autovetura mund të konsiderohet send i rrezikshëm, jo vetëm në momentin kur është në lëvizje, por edhe në rrethana të caktuara kur është në gjendje të palëvizshme, me motor të ndezur. Edhe në këtë situatë, me rastin e shkaktimit të dëmit, baza e përgjegjësisë së pronarit apo përdoruesit të sendit do të jetë objektive.

Për të pasqyruar më mirë përgjegjësinë e mjeteve motorike në lëvizje kam marrë si shembull çështjen *A. Cass. krim., 20 tetor 1987 5.F.7.*<sup>209</sup>

*Faktet:* Për t'i ardhur në ndihmë kompanisë *SARELO* për heqjen e qymyrgurit, kompania *Carrières Gaillard* i jep hua kompanisë *SARELO* një traktor e një rimorkio, dhe i dërgon një prej punonjësve të vet për të manovruar me mjetin e dhënë hua. Shoferi zgjedh rrugën që duhet ndjekur. Arrin një pikë në rrugë në një nivel hekurudhor, ku një sinjal rrugor paralajmëron një rrezik për automjetet me platformë të ulët. *Suteau* doli për të shqyrtuar kalimin dhe arriti në përfundimin se ishte e mundur të kalohej pa shkaktuar asnjë dëm. Duke ecur një tren përplasat me rimorkion e mbërthyer në mes të dy vagonave të trenit, dhe shkaktonte lëndime të disa personave. Shoferi, *Suteau* dhe *Carrières Gaillard*, punëdhënësi i tij

---

<sup>208</sup>Seewer, J. "5 Bodies In Ohio Garage: Police In Toledo Suspect Murder-Suicide", 12.11.2012 pp 204-212.

<sup>209</sup>A. Cass. krim., 20 tetor 1987 5.F.7



i përgjithshëm, janë pala e paditur për dëmet. Çështja ishte nëse Suteau ishte në përgjegjësi të *Carrières Gaillard* apo të *SARELO* në kohën e aksidentit.

*Vendimi:* Gjykata e Apelit vendosi që *Suteau* do të mbetet në përgjegjësi të *Carrières Gaillard* në kohën e aksidentit, dhe Gjykata e Kasacionit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit.

Në këtë rast Gjykata e Kasacionit ka caktuar përgjegjës punëdhënësin e përhershëm i cili ka gabuar në përzgjedhjen e punonjësve të vet, pasi arsyeja e shkaktimit të dëmit ka qenë pakujdesia, dhe jo pamundësia e manovrimit. *Carrières Gaillard* duhet të kishte vënë në dispozicion një punonjës të specializuar, dhe jo dikë të paaftë për kryerjen e shërbimit, pavarësisht faktit se punëdhënësi i përkohshëm në këtë rast kompania *SARELO* mund të jepte disa udhëzime të nevojshme të cilat mund të shmangnin aksidentin, pasi punonjësi ishte nën survejimin e saj gjatë kryerjes së këtij shërbimi për llogari të saj.

Praktika ka njohur raste kur ndërmjet dy punëdhënësve bëhet paraprakisht një kontratë për përcaktimin e masës së përgjegjësisë për secilën prej tyre.

Është pretenduar se *SARELO* nuk mund të ketë fuqinë për të instruktuar *Suteau* në çdo moment gjatë këtij operacioni. Gjykata e Apelit nuk mund, pra, të mbajë *Carrières Gaillard* përgjegjës pa shkelur Nenin 1384 (5) të KCI.

Dhe, duke vënë një punonjës me vlerë në dispozicion të *SARELO*, për një operacion të vetëm dhe të vështirë të transportit, natyrisht që nuk ka transferuar tek kjo kompani fuqinë e saj të kontrollit dhe udhëzimit për pjesën teknike të ngarjes së automjetit. Prandaj, në qoftë se *SARELO* ishte me të vërtetë përgjegjës për funksionimin deri në nivelin e kalimit, gjendja u paraqit ndryshe në kalim. I ballafaquar me një vështirësi të veçantë që ka të bëjë me aftësitë e tij [si shofer], *Suteau* rimori kontrollin e operacionit dhe për këtë arsye ishte, për atë pjesë të operacionit, ende nën autoritetin e punëdhënësit të tij të zakonshëm.

Me gjetjet e mësipërme të faktit, si për marrëdhëniet e *Suteau* me *Carrières Gaillard* dhe *SARELO* respektivisht, Gjykata e Apelit ka justifikuar vendimin e saj. Arsyet e ankesës duhet të refuzohen.

Mbi bazën e këtyre fakteve pretendohet që të realizohet plani për vrasjen e harabelave që ishin tepriçë në zonën ekzistuese e që ka qenë shkak për ndodhjen e aksidentit. Prania e tufës së harabelave e konfirmuar edhe nga një dëshmitarë, bën që të konstatohet se ngjarja ka ndodhur. Dëmi i shkaktuara nga kafshë të egra, i takon kategorisë së pasurisë shtetërore. Gjykata ka vlerësuar se sjellja e një kafshe të egër - dhe fluturimi i një zogut në veçanti - është një aksident, përkatësisht ngjarje jo e parashikueshme e as e parandalueshme.

Ne shembullin e mesiper nuk është trajtuar por ka një ndërthurje të subjekteve të cilët ngarkohen me përgjegjësi në këtë rast të shkaktimit të dëmit. Kompani të ndryshme në rast të implementimit të një projekti duke u bazuar apo zbatuar rregullat dhe standartet ndërkombetare të investitoreve, sigurimin për dëmet e shkaktuara paleve të treta e kanë të detyruar, në këtë mënyrë në rast të zbatimit të këtij standarti ndërkombetar nga kompani të ndryshme përgjegjësia për dëmshperblim bie mbi shoqërinë e sigurimit drejtpërdrejt, pasi kompania ka bërë sigurimin e dëmeve të shkaktuara paleve të treta nga punonjësit apo mjetet (sendet e rrezikshme) në pronësi të tyre.

Përveç rasteve kur përgjegjës për shkaktimin e aksidenteve janë personat kemi edhe raste kur persona të tretë përgjigjen për aksidentet motorike të shkaktuara nga kafshët. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme e Italisë, Seksioni Civil III, në çështjen nr. 80, 8 Janar 2010, ka shqyrtuar përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga përplasja e mjetit motorik me një dre. Gjykata ka fajësuar shtetin, me arsyetimin se drejtuesi i mjetit motorik ka vazhduar me një shpejtësi të moderuar, ndërkaq kafsha ka dalë befasisht në rrugë. Për këtë qëndrim gjykata ka marrë parasysh edhe ndodhjen e shumë incidenteve brenda kohës kur edhe është shkaktuar ngjarja.

Në këtë drejtim gjykata ka mbajtur qëndrimin se për rrethanat ku është shkaktuar aksidenti, dëmi është i parashikueshëm. Si rezultat i kësaj, shteti është dashur që të ngrëjë masa mbikqyrëse, për çka edhe ka vendosur shenja adekuate rrugore. Ndërkaq, për aksidentet e shkaktuara me pjesmarrjen e një kafshe shtëpiake, pronari i tyre do të gjykohet në bazë të kritereve të përgjegjësisë së rreptë që i takon ndaj kafshës. Në lidhje me përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar me pjesmarrjen e kafshës, Gjykata Supreme e Italisë, Seksioni Civil III, në çështjen nr. 27673 i datës 21 nëntorit 2008, duke gjykuar përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar në aksident trafiku, ka konstatuar shkakun e shkaktimit të aksidentit. Shkaktimi i aksidentit nga drejtuesi i saj është pretenduar se ka rezultuar nga humbja e kontrollit të mjetit motorik për shkak se një zog është mbërthyer në kabinë nga ana e dritares së hapur.

Në procedurën e marrjes së provave, ky fakt i është nënshtruar provave. Dëshmia e dëshmitarit e dhënë para gjykatës i është referuar se si pasojë e të shtënave të një gjuetari ishte ngritur një tufë zogjesh, ku njëri prej tyre kishte hyrë në veturen që është përfshirë në aksident. Ky fakt, megjithatë, u vlerësua si i parëndësishëm nga ana e gjykatës për shkak të përjashtimit të ekzistencës së lidhjes shkakësore mes ngjarjes së dëmshme dhe turmës së shpendëve në zonën e ndodhjes së aksidentit. Për këtë proces gjyqësor janë parashtruar pretendime për provimin e fakteve që i referohen menaxhimit të mrojtjes dhe kontrollit të kafshëve të egra, planifikimit të kafshëve të egra, stabilizimit të çerdheve dhe dendësisë optimal të tyre në zonën përkatëse.

#### **4.11. Përgjegjësia nga të metat e produkteve.**

Produkti me të meta që vihet në qarkullim përbën një rrezik shumë serioz të shtuar për shkaktimin e një dëmi të mundshëm ndaj njerëzve dhe sendeve.<sup>210</sup> Për këtë arsye ligjie ka

---

<sup>210</sup>Cooke, J. (2007) "Law of Torts 8<sup>th</sup> ed", London, New York and Others; Pearson Longman, fq. 103.

parashikuar rregullimin e çështjes së përgjegjësisë së prodhuesit të sendeve me të meta. Prodhuesi, i cili vë në qarkullim një send, që për shkak të ndonjë të mete që ka, për të cilën ai vetë nuk ka patur dijeni, paraqet rrezik për njerëzit apo objektet e tjera, do të jetë përgjegjës për shpërblimin e dëmit të ardhur si pasojë e asaj të mete.<sup>211</sup>

Ligji Nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, në nenin 6 të tij parashikon se “Prodhuesi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga të metat e mallit të tij, sipas dispozitave të Kodit Civil dhe ligjeve në fuqi”, nga parashikimet e këtij ligji rezulton se detyrimi kryesor i prodhuesit është **informimi** i personave tek të cilët kalon produkti pa kufizim.<sup>212</sup>

Prodhuesi do të përgjigjet edhe për cilësitë e rrezikshme të sendit, në qoftë se nuk ka ndërmarrë të gjitha veprimet që kërkohen (p.sh., përdorimi i një ambalazhimi të sigurt) në mënyrë që të pengojë ardhjen e dëmit. Prodhuesi i sendit me të meta, për dëmin e shkaktuar si rezultat të kësaj të mete, do të përgjigjet mbi bazën e përgjegjësisë objektive, pasi sendet me të meta përbëjnë sende të rrezikshme si pasojë e cilësive të tilla që kanë.<sup>213</sup>

Që prodhuesi i sendit me të meta të mund të detyrohet të përgjigjet për shpërblimin e dëmit të sjellë prej tij, ndaj personit tjetër, duhet të plotësohen disa kushte, të cilat janë: së pari, të ketë ardhur dëm ndaj një personi; së dyti, dëmi të jetë shkaktuar si pasojë e të metave të sendit, dhe së treti, sendi me të meta të jetë vënë në qarkullim.

Përgjegjësia e prodhuesit të sendit me të meta paraqet një lloj të veçantë të përgjegjësisë që lind për shkak të përdorimit të sendeve të rrezikshme. Kjo sanksionohet edhe në Kodin Civil, ku parashkohet se, ai që do të lëshojë në qarkullim ndonjë send që e ka prodhuar, i cili për shkak të ndonjë të mete për të cilën ai nuk dinte, paraqet rrezik për ardhjen e ndonjë dëmi për personat apo për sendet, përgjigjet për dëmin që do të shkaktohet për shkak

---

<sup>211</sup>Hodgson, J, Lewthwaite, J. (2004) “Tort Law”, Oxford University Press, fq. 254.

<sup>212</sup> Ligji Nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”

<sup>213</sup> Pop Georgiev, D. (1985) “E drejta e Detyrimeve” ,Shkup, fq. 211.

të asaj të mete. Pikërisht nënenin 628 të Kodit Civil thuhet shprehimisht se: “*Prodhuesi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga të metat e produkteve të tij.*”<sup>214</sup>

Që të lindë përgjegjësia e prodhuesit për të metat e sendit, dhe e drejta e konsumatorit për shpërblim të dëmit, duhet të provohet se prodhuesi e ka prodhuar sendin me të meta dhe se e ka lëshuar në qarkullim. Prodhues, sipas rastit që po trajtojmë, do të konsiderohet: prodhuesi i një materiali të papërpunuar; prodhuesi i një produkti përfundimtar ose i një pjese përbërëse të tij; importuesi i produktit; çdo person që vendos emrin e vet, markën e vet tregtare ose veçori të tjera dalluese të produktit; çdo person që është furnizuar me një produkt për të cilin prodhuesi apo importuesi nuk dihet apo nuk mund të identifikohet.<sup>215</sup>

Sipas Direktivës BE-së2007/31/EC “*Mbi prodhimin dhe etiketimin e produkteve*”, me shprehjen *produkt*, do të nënkuptohen të gjitha sendet e luajtshme apo sendet e përfshira në një send të luajtshëm apo të paluajtshëm, duke përfshirë këtu energjinë elektrike, produktet bujqësore (produktet e tokës, prodhimet bujqësore dhe të peshkimit, duke përjashtuar produktet të cilat kanë pësuar përpunimin fillestar) dhe lojërat.<sup>216</sup>

Në jetën e përditshme janë të shpeshta rastet të tilla. Këtu mund të përmendim rastin e prodhimit të bombolave të gazit me ndonjë të metë, të cilat paraqesin rrezik të vazhdueshëm për shpërthim, nga i cili do të pësonte dëm si pasuria, ashtu edhe vetë njerëzit, në shëndetin apo jetën e tyre.

Reziku i shkaktimit të dëmit nga produktet me të meta, kryesisht vjen nga sendet e prodhuara në seri. Sot, ky është një fenomen mjaft i përhapur kudo në botë. Përgjegjësia e prodhuesit mund të zgjerohet edhe më shumë kur ky i fundit prodhon sende, të cilat për nga natyra përmbajnë karakteristika që mund të paraqesin rrezik të shtuar për njerëzit dhe sendet e tjera, në qoftë se ai nuk ndërmerret të gjitha masat e duhura, siç mund të jetë përdorimi

---

<sup>214</sup>Neni 628 i Kodit Civil.

<sup>215</sup>Po aty.

<sup>216</sup>Direktiva e BE-së2007/31/EC “*Mbi prodhimin dhe etiketimin e produkteve*”

ambalazhimit adekuat për to, ose paralajmërimii të tjerëve për rrezikun e mundshëm, në mënyrë të atillë që të mos shkohet deri tek shkaktimi i dëmit.<sup>217</sup> Prandaj, detyrim i prodhuesit mbetet, jo vetëm që sendi të përmbajë të gjitha karakteristikat për të cilat dhe destinohet, por duhet gjithashtu të japë udhëzimet e nevojshme e të mjaftueshme, për të shmangur shkaktimin endonjë dëmi. Sa u tha më lart mund të konstatohet më së miri, p.sh., në rastin e përdorimit të barërave të importuara, ku për prodhuesin apo importuesin, me dispozitë ligjore është paraparë detyrimi që të përkthehet fleta udhëzuese, edhe në gjuhën e vendit ku do të shiten për të bërë të mundur një përdorim sa më të drejtë nga konsumatorët; Apo gjatë përdorimit të kontrceptivëve pa rekomandim nga mjeku, gjë e cila mund të shkaktojë deri edhe vdekjen e personit që i përdor në qoftë se vuan nga ndonjë sëmundje e zemrës, apo edhe kur e tepron me dozën e përdorimit.<sup>218</sup>

Një rast i tillë është edhe ai, kur një person paraqet publikime mashtruese në lidhje me produktet e tij, atëhere kur një produkti në etiketë apo fletën udhëzuese i shkruan karakteristika të ndryshme nga ato që në të vërtetë ka sendi apo produkti, apo edhe në rastin kur ia ndërron datën e afatit tëskadencës. Duhet bërë dallimi kur këto gabime, reklamime apo udhëzime për përdorim nuk i bën prodhuesi, por sipas rastit tregtari ambulator. Kjo pasi, në rast se këto ndodhin pa dijeninë e prodhuesit, por nga vetë tregtarët, atëherë edhe përgjegjësia që lind nga ky veprim nuk mund t'i atribuohet prodhuesit, por vetëm tregtarit. Sipas këtij fakti, e pandërgjegjshme do të konsiderohet edhe dispozita e kontratës për konsum me të cilën tregtari për vete e rezervon të drejtën e njëanshme të ndryshojë karakteristikat e prodhimit që duhet t'i dërgojë apo për shërbimin që duhet të kryhet, në qoftë se karakteristikat e tilla janë të natyrës esenciale për konsumatorin apo për destinimin për të cilin konsumatori ka planifikuar ta përdorë prodhimin apo shërbimin e caktuar, përderisa

---

<sup>217</sup>Stephen O'Halloran BCL, LLM(Commercial), *Liability for Defective Products*, fq.4, marrë nga: Toledo, Ohio, SHBA, "The Huffington Post", 2 December 2012.

<sup>218</sup>Légier, G. (2008) "E Drejta Civile-Detyrimet," botimi i 19-të, fq. 158. Profesori në Universitetin "Paul-Cézanne" (Aix-Marseille III).

konsumatori e ka njoftuar tregtarin për destinim, kurse nga ana tjetër tregtari është pajtuar me këtë edhe kur nuk ekziston specifikacioni i tillë, që të mund me bazë të parashihet një destinimi tillë.<sup>219</sup>

Nga kjo shihet se përveç prodhuesit, për dëmin e shkaktuar nga sendi i lëshuar në qarkullim me të meta, mund të përgjigjen edhe tregtari ambulator apo shitësi i atij sendi. Ndërsa, kur dëmin e shkakton një produkt me të meta i prodhur nga më shumë persona, atëherë edhe përgjegjësia do të ndahet bashkërisht në mënyrë solidare ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve në prodhim, apo nëse kjo s'është e mundur, atëherë secili nga këta persona do të jetë përgjegjës për tërë dëmin.

Që të lindë përgjegjësia kontraktore për prodhuesin, duhet të plotësohen disa kushte thelbësore: së pari, duhet të ekzistojë e meta e sendit; së dyti, marrësi i sendit apo shërbimit të mos ketë dijeni për këtë të metë në momentin e marrjes apo blerjes; së treti, sendi me këtë të metë duhet të paraqesë rrezik të shtuar për njerëzit dhe sendet e tjera; së katërti, duhet të vijë pasoja e dëmshme nga ai send. Prodhuesi nuk mban përgjegjësi për faktin se ai është pronari i atij sendi në cilësinë e të parit, por për shkakun se ka prodhuar dhe lëshuar në qarkullim një send me të meta, i cili paraqet rrezik për njerëzit dhe sendet.<sup>220</sup>

Në rast të shkakimit të dëmit nga produktet, prodhuesi do të përgjigjet mbi bazën e rregullave të përgjegjësive objektive, ky i fundit përjashtohet nga përgjegjësia kur provon se nuk ka faj.

Kur jemi tek shitja e sendeve me garanci duhet të dallojmë dy lloje të përgjegjësive: përgjegjësinë e shprehur dhe atë të nënkuptuar. Kur jemi tek përgjegjësia e shprehur, shitësi në mënyrë të shprehur tregon se sendi i përmban kualitetet e caktuara. Ndërsa, tek përgjegjësia e nënkuptuar, për shitësin lind përgjegjësia, duke ofertuar një produkt për shitje me një garanci, përmes kontratës për shitjen e mallrave. Kur shitësi është një tregtar në një

---

<sup>219</sup>Neni b 56 i ligjit Nr. 04/L-121 "Per Mbrojtjen e Konsumatoreve", date 19 Tetor 2012 Kosovw.

<sup>220</sup>Đorđević, Ž., Stanković, V. (1974) "E drejta e Detyrimeve", Beograd, fq. 300.

biznes të rregullt, konform ligjit për shitjen e mallrave në fjalë, ato duhet të jenë të përshtatshme për përdorim të zakonshëm, t'i kenë cilësitë dhesasitë brenda variacioneve të lejuara me marrëveshje, dhe të jenë të rregulluara, të paketuara dhe me etiketa, ashtu siç e kërkon marrëveshja.

Shpërblimi i dëmit në këtë rast përfshin në tërësi të gjitha pasojat e ardhura, si jetën, lëndimet trupore dhe pasurinë e individit. Nëse shkaktimi i dëmit nga sendi me të meta ka ardhur edhe për faj të personit të dëmtuar apo të ndonjë individi tjetër që është në një lidhje të caktuar me personin përgjegjës, atëherë sipas rastit konkret edhe përgjegjësia e prodhuesit do të hiqet apo do të zvogëlohet, në proporcion me fajin e personit të dëmtuar.

Blerësi, i cili në kohë dhe me rregull e ka njoftuar shitësin për të metat e sendit, mund të kërkojë që shitësi t'i mënjanojë të metat apo t'i dorëzojë një send tjetër pa të meta (përmbyshja e kontratës). Në rastin konkret blerësi mund të kërkojë edhe zvogëlimin e çmimit, apo të deklarojë se e zgjidh kontratën. Sendi do të quhet se është me të meta në rastin kur nuk jep sigurinë që pritet prej tij, duke patur parasysh të gjitha rrethanat, e në veçanti:

- a) paraqitjen e produktit;
- b) përdorimin e arsyeshëm që pritet prej produktit;
- c) kohën e vënies në qarkullim të produktit dhe skadencës së tij.<sup>221</sup>

Përveç rasteve të lartpërmendura, blerësi ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit, që eventualisht ka pësuar. Kështu ndodh edhe me lëshimin në qarkullim të sendeve teknike me të meta, siç është parashikuar edhe në Kodin Civil. Kur shitësi i ndonjë makine, motori, aparati apo ndonjë sendi tjetër të ngjashëm me të (të cilët bëjnë pjesë në të ashtuquajturat mallëra teknike), ia ka dorëzuar blerësit fletë-garancinë, me të cilin prodhuesi ka garantuar funksionimin e rregullt të sendit për një periudhë të caktuar, duke e llogaritur nga koha e dorëzimit tek blerësi, blerësi mundet që, nëse sendi nuk funksionon në rregull, të

---

<sup>221</sup> Neni 630 i Kodit Civil.



kërkojë si nga shitësi, ashtu edhe nga prodhuesi, që ta rregullojnë sendin në afat të arsyeshëm, dhe në qoftë se ata nuk e bëjnë një gjë të tillë, ai mund të kërkojë që në vend të tij t'i dorëzohet një send tjetër i të njëjtit lloj që funksionon në rregull. Të metën për produktin, si dhe dëmin e shkaktuar, duhet ta dëshmojë i dëmtuari.

Nga rastet e praktikës gjyqësore po përmendim qëndrimin e Gjykatës së Apelit të Distriktit të katërt të Kalifornisë, i cili në një vendim shprehet se: *“Ai, i cili promovon një produkt për përfitimin e tij ekonomik, dhe ka për qëllim inkurajimin dhe nxitjen e publikut për ta blerë atë, mund të jetë përgjegjës për një blerës, i cili duke u mbështetur në promovimin, blen produktin dhe pëson dëm prej tij për shkak se produkti është me të meta, dhe nuk përputhet me promovimin”*.<sup>222</sup>

#### **4.12. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët.**

Gjatë gjithë zhvillimit të shoqërisë njeriun me kafshën e ka karakterizuar një marrëdhënie e veçantë, marrëdhënie kjo e cila ka ndryshuar dita-ditës duke u evoluar. Ajo është shfaqur në forma nga më të ndryshmet, si p.sh., përdorimi i tyre nga njeriu për përfitime dhe deri tek dëmet që mund t'u shkaktoheshin personalitetit të njeriut apo pasurisë së tij. Edhe mundësia e shkaktimit të dëmit nga kafshët ka ndryshuar mjaft që nga e kaluara, veçanërisht duke marrë për bazë rrezikun e madh që paraqesin në rastin e përhapjes së sëmundjeve të rënda, të cilat mund të jenë me pasoja vdekjeprurëse, apo në rastin e përhapjes së viruseve me pasoja të rënda për njerëzimin.<sup>223</sup>

Me rastin e shkaktimit të dëmit nga kafshët, lindin marrëdhënie juridike ndërmjet subjektit përgjegjës dhe palës së dëmtuar, marrëdhënie këto të cilat nuk ekzistojnë para

---

<sup>222</sup>O'Halloran S, BBCL, LLM(Commercial), *Liability for Defective Products*, fq. 4, marrë nga: [http://homepage.eircom.net/ucdtutorials/Products Liability.pdf](http://homepage.eircom.net/ucdtutorials/Products%20Liability.pdf).

<sup>223</sup>Ward A, *Judicial Review and the Rights of Private Parties in EU Law (2nd edn, Oxford University Press 2007)*, fq. 126.

shkaktimit të dëmit. Rregullat e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga kafshët, që lind për pronarin apo ndonjë subjekt tjetër, janë njësoj si ato për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme apo nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme, përkatësisht kemi të bëjmë me përgjegjësi objektive, por me një bazë edhe më të zgjeruar.

Praktika gjyqësore, kur merren për bazë sendet e rrezikshme apo veprimtaritë e rrezikshme, zbaton parimin e përgjegjësisë objektive. Bazë e përgjegjësisë për pronarin apo shfrytëzuesin e sendit nuk është faji i tij, por reziku që rezulton nga mbajtja apo përdorimi i këtyre sendeve si dhe pa aftësia për të mbajtur nën kontroll qenie apo objekte të rrezikshme. Përgjegjësia objektive bazohet në ekzistencën e lidhjes shkakësore midis sjelljes së njeriut dhe pasojës së krijuar. Për dëmin e ardhur nga sendet e rrezikshme, përgjigjet pronari i tyre, ndërsa për dëmin e ardhur nga një veprimtari e rrezikshme përgjigjet personi i cili e ushtron atë.<sup>224</sup>

Kjo ka bërë që përgjegjësia subjektive të konsiderohet e pamjaftueshme në procesin gjyqësor të realizimit të kompensimit të dëmit të shkaktuar prej kafshëve. Prandaj, një vend të rëndësishëm në këto çështje zë përgjegjësia objektive, sipas të cilës për realizimin e së drejtës për kompensim të dëmit nuk kërkohet që të vërtetohet faji i shkaktuesit të dëmit. Shtrirja e sferës së përgjegjësisë objektive lidhet me karakterin e civilizimit industrial, të bazuar mbi përdorimin e mjeteve të prodhimit që në vetvete janë burime rreziku, si për personat, ashtu edhe për sendet (impianetet industriale, mjetet motorike, etj), rrezik ky i cili shoqërisht është pranuar si një komponent i paevitueshëm i civilizimit tonë.<sup>225</sup>

Përgjegjësia objektive kërkon që t'i përgjigjet nevojave të jetës, duke marrë në konsideratë teknologjitë e avancuara, mjetet moderne të prodhimit, mjetet e komunikacionit, apo sjelljet e paparashikueshme të kafshëve shtëpiake, rrethanat të cilat mund të krijohen ndaj

---

<sup>224</sup> O'Halloran S, BCL, LLM(Commercial), *Liability for Defective Products*, fq.4, marrë nga: Toledo, Ohio, SHBA, "The Huffington Post", 2 December 2012, fq. 84.

<sup>225</sup> Galgano, F. (1999) "E drejta Private", Tiranë, fq. 366.

kafshëve të egra qofshin këto të mbrojtura ose jo, e të tjera. Sa i përket përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga kafshët, baza nuk është unike. Disa Kode Civile të vendeve të ndryshme si bazë të përgjegjësisë parashikojnë fajin e supozuar (Kodi Civil i Gjermanisë, i Austrisë, dhe i Francës). Kurse, disa legjislacione të tjera parashohin përgjegjësinë objektive (Kodi Civil i Hungarisë, i Maqedonisë dhe Kosovës).<sup>226</sup> Edhe Kodi ynë përmban një zgjidhje të njëjtë, duke parashikuar se *“Pronari i një kafshe, ose ai që e ka në posedim atë, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj, përveçse kur provon se ka patur kontrollin e sjelljes së kafshës nga e cila është shkaktuar dëmi, dhe përsëri nuk ka mundur ta mënjanonte atë”*.<sup>227</sup>

Subjekti përgjegjës ka detyrimin që të marrë të gjitha masat për parandalimin e shkaktimit të dëmit nga kafsha shtëpiake ose nga kafsha e egër, pasi pasojat e kësaj të fundit mund të marrin përmasa shumë të mëdha. Në bazë të prirjeve që kanë, është e pamundur që të parashihet në çdo situatë sjellja e kafshës ose të mendohet se sjellja e saj do t’i bindet përherë dëshirës së pronarit. Prandaj, kafshët konsiderohen gjallesa të rrezikshme që në çdo moment mund të paraqesin rrezik për mjedisin. Edhe pse ka kafshë apo shpezë shtëpiake, që drejtëpërdrejtë nuk paraqesin rrezik për mjedisin, siç është pula, qengji, lopa apo delja, përsëri mund të jenë të infektuara duke përbërë rrezik për përhapjen e sëmundjes tek njerëzit apo kafshët e tjera shtëpiake apo të egra, prandaj parimisht të gjitha konsiderohen si gjallesa me burim rreziku të shtuar.

Rregullat e së drejtës Romake kafshët e egra, shpezët dhe peshqit që jetonin të lira në natyrë i konsideronin si *“res nullius”* dhe, çdokush në çdo kohë mund t’i përvetësonte. Kurse sot shumica e të drejtave kombëtaree kanë hequr ose e kanë zvogëluar në maksimum mundësinë që kafshët e egra të trajtohen si *“pa zot”*, kjo pasi në rastin e një dëmi të mundshëm tëardhur prej tyre, viktimia apo pala e dëmtuar nuk do të mund të realizonte

---

<sup>226</sup>Dauti, N. (2001) *“E drejta e Detyrimeve,”* Prishtinë, fq. 179.

<sup>227</sup>Neni 621 i Kodit Civil.

zhdëmtimin e tij. Kjo mund të interpretohet kështu duke u bazuar edhe në parimin kushtetues me anë të të cilit sigurohet integriteti i njeriut dhe pasuria e tij, çka nënkupton se pala e dëmtuar gati çdoherë fiton të drejtën për shpërblimin e dëmit,<sup>228</sup> edhe në rastin kur dëmi është shkaktuar nga kafshët e egra.

Në çdo rast të shkaktimit të dëmit nga kafshët, problemi që lind është se cilido të jetë subjekti përgjegjës për shpërblimin e të dëmtuarit, pasi ky i fundit ka cilësinë e viktimës, dhe në çdo rast është i njohur. Pronari i kafshës përgjigjet për dëmin që e shkakton prej saj, sepse ai në raport me të tjerët ka pozitë juridike të caktuar ndaj kafshës, ka dobi prej saj, e njeh më së miri atë me të gjitha mangësitë dhe përparsitë e saj, pra, ka një interes legjitim në mbajtjen e kafshës. Përgjegjësia e pronarit të kafshës buron edhe nga fakti se ai në të shumtën e rasteve gëzon pushtetin juridik dhe faktik mbi kafshën. Poseduesi, si bartës i pushtetit faktik ndaj kafshës përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga ajo, si kur gjendet tek ai, ashtu edhe në rast se kafsha ka ikur apo ka humbur.<sup>229</sup> Nga ky parashikim ligjor vërehet një përgjegjësi e zgjeruar e poseduesit të kafshës, pasi edhe në rastin e largimit të kafshës nga poseduesi apo pronari, nëse vjen një dëm prej saj, ky i fundit, sipas rastit, nuk do të mund të lirohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar.

Madje, pronari i kafshës do të përgjigjet edhe atëherë kur kafsha shkakton një dëm në situatën kur ajo është e shqetësuar, e frikësuar apo diçka të ngjashme. Ndërsa, në bazë të Kodit Civil kjo përgjegjësi e pronarit do të lindë edhe kur pala është dëmtuar duke u ofruar me qëllim të mirë për të mbajtur dhe qetësuar kafshën. Si posedues i kafshës do të konsiderohet pronari, blerësi, huapërdorësi, marrësi i uzufruktit, etj.

Rregullat e njëjta të përgjegjësisë zbatohen edhe në ato raste kur dëmi shkaktohet nga kafsha, tek e cila pushtetin faktik e ka shfrytëzuesi apo personi që e ka marrë për ruajtje, e jo

---

<sup>228</sup> *Evolution of auditor liability to non contractual third parties: balancing the equities and weighing the consequences*, JODI B. SCHERL, *Extra-Contractual Liability, Teaching Material Prepared by: Abdulmalik Abubeker & Desta G/Michael*.

<sup>229</sup> Neni 165, pika 1, i Ligji për marrëdhëniet e detyrimit, *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, numër 18/01.

pronari i kafshës. Në këto raste, sipas rregullave juridike të së drejtës Civile, për dëmin që e shkakton kafsha, përgjigjet shfrytëzuesi i kafshës.<sup>230</sup> Kjo ndodh për faktin se shfrytëzuesi i kafshës realizon një interes legjitim me mbajtjen e kafshës, i cili buron nga autorizimi i pronarit të kafshës. Në rastet kur kafsha shkakton një dëm, pronari apo shfrytëzuesi i tokës bujqësore ka të drejtë që ta kapë dhe ta mbajë atë të mbyllur, por duke u përkujdesur për të derisa t’i kompensohet dëmi nga pronari i kafshës. Por, në këtë rast, nga mbajtësi i kafshës që është në cilësinë e palës së dëmtuar, kërkohet domosdoshmërisht që ta njoftojë pronarin e kafshës për rastin në fjalë, e në qoftë se kjo është e pamundur, atëherë njoftimin duhet ta bëjë në institucionet kompetente të pushtetit lokal.

Në kuadër të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, do të trajtoj përgjegjësinë e disa subjekteve, në lidhje me dëmin e shkaktuar nga kafshët, si: përgjegjësia e përcjellësit të kafshëve, përgjegjësia e spitalit apo veterinerit, përgjegjësia e hanxhiut, përgjegjësia e shoqatës së gjuetarëve, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar gjatë organizimit të veprimtarive të ndryshme me kafshë e të tjera.

Që të ekzistojë përgjegjësia e ndonjërit prej subjekteve të lartpërmendura, përveç kushteve të përgjithshme lidhur me lindjen e përgjegjësisë, duhet të ndodhë njëkohësisht edhe dorëzimi faktik i kafshës tek ndonjëri prej tyre dhe shkaktimi i dëmit ndërkohë që gjendet tek ata.

***Përgjegjësia e përcjellësit të kafshës.*** Shpeshherë në praktikë lind nevoja e lëvizjes apo transportimit të kafshëve të buta, apo edhe atyre të egra, nga një vend në një tjetër. Përcjellja e tyre mund të bëhet në këmbë ose me mjete të ndryshme transporti. Në këtë rast është detyrim ligjor i transportuesit që t’i ndër marrë të gjitha masat preventive, që gjatë transportimit të tyre deri në vendin e destinacionit përfundimtar, të mos i shkaktohet dëm ndonjë personi të tretë. Situata të tilla paraqiten më së shumti atëherë kur kafsha apo kopeja

---

<sup>230</sup> Glenn D. West , W. Benton Lewis , Jr. (2009) “Tracting to Avoid Extra-Contractual Liability—Can Your Contractual Deal Ever Really Be the “Entire” Deal?”, *The Business Lawyer* Vol. 64, August , fq.18.

përcillen në këmbë. Gjithashtu, edhe gjatë transportit të kafshëve me mjete motorike, të njëjtat mund të bien nga mjeti dhe të shkaktojnë dëm ndaj individëve apo mjeteve të tjera në qarkullim.

Për shkak të detyrimit të mbikqyrjes së kafshëve nga ana e transportuesit apo përcjellësit, nëse ndodh që të shkaktohet ndonjë dëm, përgjegjësia për këtë të fundit bie mbi përcjellësin. Një rast i tillë mund të paraqitet, p.sh., kur gjatë transportimit të kafshëve të mëdha me kamion apo ndonjë mjet tjetër transporti rrugor, ndodh që ndonjëra prej tyre të kërcejë nga automjeti, duke shkaktuar një aksident mes kafshës dhe ndonjë veture, e cila mund të jetë duke ecur pas kamionit, apo mes disa veturave së bashku. Në këtë rast mund të shkaktohen edhe lëndime trupore tek drejtuesi i mjetit. Në bazë të rregullave të përgjegjësive, përgjegjësia për shpërblimin e dëmit material dhe jomaterial këtu bie mbi personin që ka organizuar transportin e kafshëve.

Në këto raste baza e përgjegjësive mund të jetë në bazë të fajit të supozuar ose pa faj, ku në rastin e parë supozohet se transportuesi apo përcjellësi nuk e ka kryer siç duhet mbikqyrjen e kafshëve që ka qenë duke përcjellë, ndërsa në rastin e dytë ekziston mendimi se është shumë e vështirë të vërtetohet fajti i përcjellësit për dëmin që ka shkaktuar, sipas rastit, kafsha ose kafshët së bashku.<sup>231</sup> Kjo pasi përgjegjësia subjektive e transportuesit ose e përcjellësit, jo që përjashtohet, por janë shumë të vogla gjasat që kafsha dëmin ta shkaktojë me vullnetin e vetë përcjellësit, ndërsa nëse i referohemi përgjegjësive me faj të supozuar apo asaj objektive, atëherë ekzistojnë të gjitha gjasat për zhdëmtimin e palës së dëmtuar.

***Përgjegjësia e spitalit apo veterinerit.*** Në praktikë ndonjëherë ndodh që pronari të ketë nevojë që kafshën shtëpiake ta çojë tek veterineri për vizitë mjekësore apo ndonjë nevojë tjetër, dhe kafsha ndërkohë që gjendet aty të shkaktojë ndonjë dëm. Në këtë rast lind pyetja se

---

<sup>231</sup> Alishani, A. (2001) "Studime nga e drejta e Detyrimeve I," Prishtinë, fq. 496-497.

cilido të jetë subjekti përgjegjës për zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar nga kafsha, dhe për atë që mund t'i shkaktohet vetë asaj.

Në rastet kur kafsha shkakton dëm duke qenë tek veterineri, apo kur nga pakujdesia ose lëshimet eventuale të këtij të funditi shkaktohet dëm vetë kafshës, parimisht përgjegjësia për dëmin e shkaktuar i mbetet veterinerit, si për vetë dëmin e kafshës, ashtu edhe për shkaktimin e dëmit nga kafsha tek të tretët. Kurse, në rastet kur kafsha i shkakton dëm të tretëve, apo vetë asaj i shkaktohet dëm, kur gjendet në një klinikë, atëherë përgjegjësia për kompensim të dëmit bie mbi klinikën, bazuar në rregullat e përgjegjësive për të tjerët. Kjo pasi pronari që i ka dorëzuar kafshën një individ apo institucioni për shfrytëzim, respektivisht ia ka besuar këtij të fundit për ruajtje dhe përkujdesje, dhe në rast të shkaktimit të dëmit do të përgjigjet tjetri apo institucioni, ashtu siç i leverdis dhe pronarit. Por, në këtë rast, që pronari të lirohet tërësisht nga përgjegjësia, duhet që personit që i aka dorëzuar kafshën për shfrytëzim apo për ta ruajtur, t'i ketë treguar për të metat e saj, kur ajo ka, sepse në të kundërt do të përgjigjet mbi bazën e rregullave të përgjegjësive solidarë.

*Përgjegjësia e hanxhiut.* Kjo përgjegjësi konsiderohet se i përket më shumë periudhave më të hershme, pasi vllente kryesisht për kohërat kur transporti i njerëzve dhe sendeve organizohej kryesisht me kafshë. Gjatë rrugës shpesh ndodhte që këto transportues bashkë me kafshët e tyre, ose vetëm kafshët, të ndaleshin dhe të sistemoheshin nëpër hane (bujtina) për të pushuar. Përderisa kafsha gjendej tek hanxhiu (pronari i hanit), baza e përgjegjësive për dëmin e shkaktuar në këtë rast, duhet të ishte sipas fajit, sepse konsiderohej se kishte munguar kujdesi, kontrolli ose mbikqyrja e duhur ndaj kafshës nga hanxhiu ose personeli i tij.<sup>232</sup>

Mirëpo, përkundër këtij fakti, për këto raste, në doktrinën juridike u arrit në konkluzionin apo mendimin se baza e përgjegjësive duhet të ishte objektive, pasi shpeshherë

---

<sup>232</sup> Alishani, A. "Studime nga e drejta e Detyrimeve I," fq. 496.

ishite e pamundur të vërtetohej fajti i hanxhiut, kështu që pala e dëmtuar rrezikonte të ngelej pa kompensim.

***Përgjegjësia e Shoqatës së Gjuetarëve.*** Shoqatat e Gjuetarëve janë persona juridikë të themeluar konform rregullave ligjore, të cilëve qeveria shpeshherë u jep në administrim hapësira të caktuara të pasura me kafshë të egra. Në këto terrene organizojnë gjuetarët gjuetinë ndaj kafshëve të caktuara, sipas ligjit, në kohën e lejuar për gjueti. Kështu, gjatë këtij organizimi mund të ndodhë që pjesëmarrës të caktuar të dëmtohen nga ndonjë kafshë e egër, ose nga gjuajtja e pakujdesshme e ndonjë gjuetari. Lind pyetja se kush do të përgjigjet në rast se ndodh shkaktimi i një dëmi gjatë këtyre organizimeve. Meqë bëhet fjalë për dëme të shkaktuara nga veprime të organizuara, pa dyshim që përgjegjësia për shpërblimin e dëmit bie mbi vetë organizatorët. Shoqata e gjuetarëve do të përgjigjet në bazë të përgjegjësisë objektive, bazuar në të gjitha rregullat e përgjegjësisë për ushtrimin e veprimtarisë së rrezikshme. Nëse gjykata vërteton se dëmi është shkaktuar për fajin e të dëmtuarit, atëherë shoqata do të lirohet nga përgjegjësia.

Mirëpo, Ligji Nr. 02/L-53 “*Për gjuetinë*”, e zgjeron edhe më shumë përgjegjësinë e Shoqatës së Gjuetarëve, në rastet kur të njëjtës i është dhënë e drejta e shfrytëzimit të kafshëve të egra nëpër këto hapësira shtetërore, duke u shprehur si më poshtë: “*Për dëmin që shkakton kafsha e egër për të cilën është paraparë ndalimi i gjuetisë, do të përgjigjet shfrytëzuesi i kafshëve të egra për atë zonë të gjuetisë*”<sup>233</sup>. Gjthashtu, edhe në rastet e përhapjes së ndonjë sëmundjeje infektive nga këto kafshë, ligji kërkon nga shfrytëzuesi apo pronari i tyre, të ketë marrë masa të përshtatshme për parandalimin e sëmundjes në kafshët e tjera ose në njerëz, pasi në të kundërt do të përgjigjet.

***Përgjegjësia e nallbanit.*** Nisur nga nevoja që kanë disa kafshë me thundra për t’u mbathur, siç janë kuajt, qetë, buajt për tërheqje, lopët për tërheqje, devetë, mushkat, gomerët,

---

<sup>233</sup>Neni 49 e vijues I Ligjit Nr. 02/L-53 “*Për gjuetinë*”, 16 Dhjetor 2005, Kosovv.



dhe me qëllim që të mund të shfrytëzohen si dhe sa duhet, pronarët i dërgojnë tek nallbani.<sup>234</sup>

Nga ky çast, mes pronarit të kafshës dhe nallbanit lind një marrëdhënie juridike në lidhje me kafshën. Në momentin kur gjenden tek nallbani mund të ndodhë që të njëjtat t'i shkaktojnë dëm vetë nallbanit, kafshëve të tjera që janë aty apo personave të tjerë.

Lind pyetja: *Kush do të përgjigjet për pasojat e dëmit?* Në parim, kur kafsha dëmin e shkakton duke qenë tek nallbani, për to duhet të përgjigjet vetë nallbani. Mirëpo, nëse ndodh që eventualisht kafsha të ketë pasur ndonjë ves të keq, si psh të kafshuarit, të shqelmuarit apo dhe ndonjë ves tjetër, për të cilin pronari nuk e ka njoftuar nallbanin, dhe ndërkohë kafsha t'i ketë shkaktuar dëm vet nallbanit, atëherë padyshim që duhet të përgjigjet pronari i kafshës.

Barra e të provuarit për të metën e kafshës në këtë rast bie mbi vetë nallbanin. Gjithashtu, mund të ndodhë që kafsha, e cila është sjellë për t'u mbathur, t'i shkaktojë dëm një personi të tretë, i cili nuk e provokon vetë dëmin. Përsëri: *Kush do të përgjigjet për këtë rast?* Në bazë të rregullave të përgjegjësisë, nëse pronari e ka njoftuar nallbanin për ndonjë mangësi eventuale të kafshës, edhe këtu përgjigjet nallbani, përderisa kafsha gjendet në dorëzim të tij. Në rastin kur kemi të bëjmë me një kafshë që mbart ndonjë sëmundje infektive, e cila përhapet tek ndonjë njeri apo kafshë tjetër, përgjegjësia do të biemi pronarin e kafshës, nëse ky i fundit ka patur dijeni për llojin e sëmundjes dhe nuk e ka paralajmëruar nallbanin për këtë fakt. Nëse nga rrethanat e rastit, gjykohet që dëmi të jetë shkaktuar nga lëshimi apo me fajin e pronarit, atëherë ky do të përgjigjet në bazë të përgjegjësisë subjektive, kurse, në rast se duhet ta zhdëmtojë nallbani, atëherë, i njëjti do të përgjigjet në bazë të rregullave të përgjegjësisë pa faj, pasi vetë ushtrimi i veprimtarisë së mbathjes së kafshëve, konsiderohet si një lloj veprimtarie që mbart rrezik. Për të përcaktuar nëse do të përgjigjet pronari apo nallbani, duhet që me shumë vëmendje të analizohen rrethanat e çdo rasti

---

<sup>234</sup>Alishani, A. (2001) "Studime nga e drejta e detyrimeve I", Prishtinë, fq. 495.

konkret. Për të dëmtuarin e rëndësishme është që të zhdëmtohet në tërësi për dëmin material edhe atë jomaterial.

*Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar gjatë organizimit të aktiviteteve të ndryshme me kafshë.* Sikurse në të kaluarën, edhe në ditët e sotme, janë të shpeshta rastet e organizimit të veprimtarive të ndryshme me kafshë. Më herët, vlen të theksohet se kafshët më së shumti janë përdorur për qëllime pune, e më pak për qëllime argëtuese. Kurse sot, shohim se janë më të shpeshta rastet e organizimit të lojërave të ndryshme me kafshë apo edhe të ndonjë veprimtarie tjetër, siç janë: garat me kuaj (rodeo), garat me vrapim ose dyluftim qensh, luftërat me dema (matadorët), organizimi i cirkut me kafshë, organizimi i qendrave për trajnimin e kafshëve, pjesëmarrja e kafshës në role të caktuara gjatë xhirimit të filmave, etj. Nëse ndodh që gjatë këtyre organizimeve t'i shkaktohet dëm ndonjërit prej pjesëmarrësve apo dikujt nga publiku, atëherë, lind pyetja se kush do të përgjigjet për këtë dëm.

Kur jemi tek *garat me vrapim të kuajve (rodeo)*, në rastet kur kali dëmton kalorësin apo i shkakton vdekjen këtij të fundit, atëherë përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie mbi vetë organizatorin, në bazë të kontratës së lidhur para fillimit të këtyre lojërave, ose në bazë të rregullave mbi sigurimin, nëse personi në fjalë nuk ka lidhur një kontratë të tillë. Përgjegjësia e organizatorit për këtë rast është objektive. Kjo pasi për dëmin e shkaktuar nga organizimi i veprimtarive të tilla të rrezikshmëndodh shpesh që faji të mos arrihet të vërtetohet, për shkak të mospasjes së provave të mjaftueshme. Kurse, kur dëmi shkaktohet ndaj personelit, ose personave të tretë nga publiku, baza e përgjegjësisë është sipas fajit të supozuar ose pa faj.

*Lojërat me dema* janë karakteristike për shtetet si: Spanja, Portugalia dhe vendet e Amerikës Latine. Gjatë zhvillimit të këtyre lojërave mund të ndodhë lëndimi trupor ose vdekja e vetë matadorit, apo që kafsha të dalë nga arena dhe t'iu shkaktojë dëm personave në publik. Si tek garat në rodeo, ashtu edhe tek lojërat me dema vlejné rregullat e njëjta të

përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit eventual të ndodhur. Pra, duhet të përgjigjet organizatori i lojërave. Personi i dëmtuar në këtë rast duhet vetëm të vërtetojë se këtij të fundit i është shkaktuar dëmi, dhe se ky i fundit ka ardhur si rezultat i veprimit të kafshës apo veë organizimit të eventit (lidhja kauzale).<sup>235</sup> Po ashtu, edhe gjatë organizimit të *cirkut me kafshë të egra apo kafshë shtëpiake* ekziston mundësia e shkaktimit të dëmit, qoftë gjatë transportit të tyre, ashtu edhe gjatë zhvillimit të cirkut. Dëmi mund t'iu shkaktohet pjesëmarrësve në cirk, apo edhe dikujt nga publiku, nëse kafsha del nga arena e cirkut. Kur dëmi i shkaktohet trajnerit ose dreserit të kafshëve, atëherë, për këtë të fundit do të përgjigjet pronari i cirkut ose ndërmarrja që merret me trajnimin e kafshëve.<sup>236</sup>

Ndërsa, në rastin kur dëmi u shkaktohet personave të tretë, përgjegjësia bie mbi organizatorin e manifestimit, i cili do duhet të përgjigjet në bazë të rregullave të përgjegjësisë pa faj, e cila është përgjegjësi më e ashpër (strict liability), pasi organizimi i cirkut konsiderohet veprimtari me rrezik të shtuar për rrethin.

Për të ilustruar sa më lart, lidhur me dëmin e shkaktuar gjatë organizimit të lojërave të cirkut me kafshë (kuaj për kalërim) po sjellim qëndrimin e mbajtur në Itali nga Gjykata e Kasacionit, Seksioni Civil, më 23 nëntor 1998, ku ka rekomanduar zgjidhjen e rastit si më poshtë vijon. Në rastet kur aktiviteti brenda cirkut nuk kryhet apo monitorohet nga instruktori, por nga ndihmësi i tij, i cili nuk i ka njohuritë e mjaftueshme për një veprimtari të tillë, atëherë, përgjegjësia për dëmin eventual që do të mund të shkaktohet nga kafsha, i ngarkohet vetë instruktorit. Kjo ndodh pasi instruktori nuk duhet që ta lejojë ndihmësin ta kryejë atë, duke e ditur se ky i fundit akoma nuk i ka arritur njohuritë e mjaftueshme për këtë lloj prezantimi. Ushtrimi i kësaj veprimtarie në bazë të nenit 2052 të Kodit Civil të Italisë konsiderohet si një veprimtari tejet e rrezikshme, prandaj instruktori në këtë rast do të

---

<sup>235</sup>Alishani, A. (2001) "Studime nga e drejta e Detyrimeve I," Prishtinë, fq. 498.

<sup>236</sup>Po aty, fq. 498.

përgjigjet në bazë të përgjegjësisë objektive për ushtrimin e veprimtarisë së rrezikshme.<sup>237</sup> Në qoftë se vërtetohet se kafsha dëmin e ka shkaktuar duke qenë e provokuar, atëherë pronari i cirkut do të lirohet nga përgjegjësia.<sup>238</sup>

Gjithashtu, të drejtat e brendshme të vendeve të ndryshme përmbajnë rregulla të shumta dhe të larmishmenë lidhje me përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit në përgjithësi, ndërsa po t'i referohemi përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit nga kafshët, shumë pak prej tyre e kanë të rregulluar në dispozitat e tyre me *Lex Specialis*. Kështu, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë ka vetëm nenin 621, Kodi Civil i Italisë ka vetëm nenin 2052, Kodi Civil i Francës ka nenin 1385, Kodi Civil i Gjermanisë ka nenet 833-834, Kodi Civil i Austrisë ka nenet 1320-1322, kurse legjislacioni i Maqedonisë nenet 165/zh, 165/z, 165/x dhe 165/i.

Duke iu referuar doktrinë juridike dhe praktikave gjyqësore të ndryshme që shprehen se për dëmin e shkaktuar nga kafshët subjekti përgjegjës duhet të përgjigjet sipas bazës së përgjegjësisë për fajin e supozuar, shohim se Kodet Civile që e parashohin bazën e përgjegjësisë për pronarin sipas fajit të supozuar janë Kodi Civil i Gjermanisë, ai i Austrisë, ai i Francës, etj.

Në Kodin Civil të Gjermanisë dallohet lloji i përgjegjësisë në rastin kur dëmin e shkaktojnë vetëm kafshët shtëpiake. Sipas këtij kodi, nëse dëmin e shkaktojnë kafshët shtëpiake, të cilat pronari i ruan për kryerje të punëve apo të ndonjë veprimtarie tjetër me interes komercial (lopa, kali, qeni për roje, etj), baza e përgjegjësisë për pronarin është sipas fajit të supozuar. Kurse, kur bëhet fjalë për kafshë të cilat pronari i ruan për argëtim, përkatësisht kafshët luksoze, atëherë baza e përgjegjësisë së pronarit është e njëjtë si edhe tek kafshët e egra, pra kemi përgjegjësi pa faj, objektive. Që pronari të përgjigjet sipas fajit të supozuar, është e nevojshme që pala e dëmtuar të provojë se dëmi nga kjo kafshë shtëpiake

---

<sup>237</sup>Neni 2052 i Kodit Civil të Italisë.

<sup>238</sup>Rekomandime të Gjykatës së Kasacionit në Romë, Sez.III civile, mbajtur më 23.11.1998 dhe 04.12.1998.

ka ardhur si rezultat i lëshimeve nga vetë pronari, rrethanë kjo që është shumë vështirë për t'u vërtetuar nga ana e të dëmtuarit.

Gjithashtu, duhet patur parasysh se dëmin, si kusht për lindjen e përgjegjësisë, mund ta shkaktojnë si kafshët shtëpiake, ashtu edhe ato të egra. Pra, dëmi mund të vijë si prej kafshëve që janë nën pushtetin e njeriut (kafshët shtëpiake), ashtu edhe prej kafshëve që janë jashtë pushtetit të njeriut (kafshët e egra).<sup>239</sup> Mirëpo, sot, në të drejtat pozitive të vendeve bashkëkohore, kafshët e egra nuk konsiderohen më si “*res nullius*“, ku çdokush mund të vendosë pushtetin mbi to kur të dojë, pasi dhe këto janë nën mbikqyrje të ndonjë organi të caktuar shtetëror apo vetë shtetit dhe, përvetësimi i tyre lejohet vetëm nën kushte të caktuara nga ligji.

*Kafshët shtëpiake.* Kafshët shtëpiake janë gjë e gjallë, që ruhet, kultivohet dhe shumohet nën kontrollin e faktorit njeri. Në grupin e kafshëve shtëpiake bëjnë pjesë: lopa, kali, delja, derri i butë, dhia e butë, qeni, macja e shtëpisë, shpezët që i ruan dhe kultivon njeriu, etj. Për vetë faktin që kafshët paraqesin dobi pasurore apo ndonjë interes tjetër për njeriun, midis individëve që i zotërojnë këto dhe të tjerëve krijohet një marrëdhënie e caktuar juridike. Praktika gjyqësore dhe shkenca juridike përsa i përket kafshëve shërbehen me fiksionin juridik, me të cilin të njëjtat i trajtojnë si sende, përkatësisht të njëjtat llogariten si sende të rezikshme, për shkak të rrezikut që mund të paraqesin për mjedisin.<sup>240</sup>

Kafsha mund ta shkaktojë dëmin nën ndikimin e rrethanave të ndryshme, të cilat mund të jenë: si rezultat i frikës të shkaktuar nga sirenat e ndryshme, nga zhurma e bubullimës ose mjeteve të ndryshme; kur është e shqetësuar; kur ngacmohet nga elementë apo faktorë të jashtëm, qoftë edhe nga vetë faktori njeri; kur pickohet nga grerëza ose insekte të tjera; kur infektohet me sëmundje që paraqesin rrezik për njerëzit apo kafshët e tjera; kur ikën apo lëviz në vendet që paraqesin rrezik për rrethin, etj.

---

<sup>239</sup> Vukovic, M. (1971) “Përgjegjësia Për Dëmin”, Zagrep, fq. 241.

<sup>240</sup> Po aty, fq. 242.

Në të gjitha këto raste të shkaktimit të dëmit, zakonisht shkaktohet dëm material, por përjashtimisht mund të shkaktohet edhe dëm jomaterial. Por, duhet pranuar se në të shumtën e rasteve të shkaktimit të dëmit, më prezent është dëmi material. Si i tillë ai mund të shkaktohet kur: kafsha dëmton kultura të ndryshme bujqësore si, p.sh., misrin, grurin, perimet e ndryshme, kullotat, apo drurët e ndryshëm frutor; kafsha sulmon një kafshë tjetër, ose njeriun, siç mund të jetë kur kau me bri shpon lopën tjetër ose kaun tjetër, kur qeni kafshon qenin e tjetrit, apo kur qeni kafshon njeriun; i shkakton lëndim trupor deri në vdekjenjë individi, etj.<sup>241</sup>

Pas shkaktimit të dëmit lind detyrimi për kompensimin e tij. Në disa raste, kur kafsha ka shkaktuar dëmtimin e sendeve të dikujt tjetër ekziston mundësia që të bëhet kthimi në gjendjen e mëparshme, p.sh., të kthehen sendet në gjendjen në të cilën kanë qenë para shkaktimit të dëmit, pra, të zëvendësohen me sende të llojit të njëjtë, të sasisë së njëjtë apo të kualitetit të përafërt (nëse është shkaktuar dëmtimi i misrit, atëherë për të njëjtin jepet po aq misër sa është dëmtuar, pasi sendi është lehtësisht i përcaktuesëhm në natyrë (i njëjtë)). Mirëpo, përkundër kësaj, nëse nuk mund të bëhet *restitutio in integrum*, atëherë kompensimi i dëmit bëhet me të holla, si p.sh., i paguhet shpenzimet për shërim të kafshës apo të njeriut të dëmtuar nga vet kafsha, apo paguhet vlera e sendeve të dëmtuara. Siç thamë, përveç dëmit material kafsha mund të shkaktojë edhe dëm jomaterial.<sup>242</sup> Kjo mund të ndodhë në rastet e shkaktimit të frikës apo vuajtjeve të intensitetit të lartë, apo dhimbjeve shpirtërore të pësuar nga frika apo nga pasojat në deformime që mund t'i mbesin trupit të njeriut pas kurimit, etj. Ky shpërblim përveç rolit të kompensimit të dëmit, gjithashtu është edhe një satisfaksion moral për të dëmtuarin.

---

<sup>241</sup> Ward, A. (2007) "Judicial Review and the Rights of Private Parties in EU Law", 2nd edn, Oxford University Press.

<sup>242</sup> Po aty, fq. 489.

*Kafshët e egra.* Me kafshë të egra kuptojmë ato lloje të kafshëve dhe shpezëve, të cilat jetojnë të lira në natyrë apo në hapësira të tjera të përshtatura dhe, që nuk janë nën ruajtjen apo përkujdesjen e njeriut. Kafshët e egra konsiderohen si të mira me interes të përgjithshëm të njerezimit, të cilat gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore dhe janë në pronësi të shtetit, për dallim edhe nga rregullat e së drejtës Romake, e cila kafshët e egra, shpezët dhe peshqit që jetonin të lira në natyrë i konsideronte si *res nullius*, dhe çdokush në çdo kohë mund t'i përvetësonte si sende pa pronar.

Meqë kafshët e egra konsiderohen në pronësi të shtetit, atëherë i njëjti duhet të përgjigjet për dëmet që do të shkaktohen nga këto të fundit. Sipas ligjit: “*Për dëmin e shkaktuar nga kafsha e egër do të përgjigjet shfrytëzuesi i hapësirës së hapur apo të mbyllur të gjuetisë.*” Ndërsa, lidhur me dëmin e shkaktuar nga kafsha e egër ndaj të cilës është paraparë ndalesë e përhershme e gjuetisë përgjigjet shteti, përderisa nuk është e mundur të dëshmohet se dëmi është shkaktuar për faj të të dëmtuarit.<sup>243</sup>

Sipas Ligjit Nr. 02/L-53 “*Për gjuetinë*”, dallojmë kafshë të egra të cilat janë të mbrojtura dhe kafshë të egra që nuk janë të mbrojtura. Mbrojtja e një kategorie të kafshëve të egra, sipas dispozitave të ligjit, bëhet duke ndaluar përgjithmonë gjuetinë e tyre, apo duke kufizuar zonën dhe kohën gjuetisë për një kategori tjetër. Në bazë të kësaj ndarjeje, përcaktohet qartë përgjegjësia e shtetit për dëmin e shkaktuar nga këto kafshë.<sup>244</sup>

Kemi disa lloje kafshësh të egra ndaj të cilave ndalohet gjuetia e tyre. Këtu mund të përmendim: ariun, luqerbullin, ketrin, çakallin, lejlekun, pulëbardhën, mjellmën, pelikanin, sokolin, shqipen, etj. Ndërsa, kufizohet gjuetia, ndjekja apo trazimi për kohë të caktuar ekafshëve të egra si: dreri i zakonshëm, dhia e egër, kaprolli, cjapi i egër, derri i egër, lepuri i egër, thëllëza, pëllumbi i egër, etj. Konkretisht gjuetia ndalohet në kohën dhe periudhën e riprodhimit apo çiftimit të tyre. Ndërsa, kafshët e egra që nuk gëzojnë mbrojtje sipas ligjit

<sup>243</sup>Legier, G. (2008) “*Civil Law, Obligations,*” Edition 19, fq. 158.

<sup>244</sup>Neni 13 e vijues I Ligjit Nr. I Ligjit Nr. 02/L-53 “*Për gjuetinë*”, 16 Dhjetor 2005, Kosove.

dhe ndaj të cilave lejohet gjuetia në çdo kohë, janë: ujku, dhelpra, macja e egër, laraska, etj.

245

Të shpeshta janë rastet në praktikë kur dëmin e shkaktojnë kafshët e egra. Me dëm të shkaktuar nga kafsha e egër kuptojmë atë lloj dëmi, të cilin kafsha e egër mund ta shkaktojë ndaj kulturave bujqësore, ujërave, kafshëve shtëpiave, pyjeve, kafshëve të egra, njerëzve, etj.<sup>245</sup>

Zakonisht qeveria zonat e caktuara me prani të kafshëve të egra, përmes konkursit, ua jep në koncesion për t'i shfrytëzuar për gjueti, subjekteve të caktuara juridike apo shoqatave të gjuetarëve, të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore përkatëse, dhe të cilat janë të licensuara nga shteti. Nëse eventualisht konstatohet prania e ndonjë sëmundjeje infektive tek kafshët nëpër këto zona, atëherë është detyrim ligjor i subjektit përgjegjës, që ka fituar të drejtën për gjueti ndaj këtyre kafshëve të egra, të ndërmarrë të gjitha masat që ajo sëmundje të mos përhapet. Në të kundërt, subjekti përgjegjës do të përgjigjet penalisht ose për kundërvajtje.

Në qoftë se ndodh që t'i shkaktohet dëm personalitetit të njeriut apo pasurisë së tij nga kafshët e egra që janë të mbrojtura, apo edhe nga kafshët që kanë mbrojtje sezonale (gjatë kësaj periudhe), përgjegjësia për shpërblimin e dëmit i ngarkohet vetë shtetit, Republikës së Shqipërisë, i cili përgjigjet në bazë të rregullave të përgjegjësisë pa faj-objektive, për sendet e rrezikshme ose veprimtari të rrezikshme, pasi si të tilla konsiderohen edhe kafshët e egra. Kurse, në qoftë se ndodh që dëmi të shkaktohet nga kafshët që nuk janë të mbrojtura, apo nga kafshët që gëzojnë mbrojtje sezonale dhe dëmi të shkaktohet jashtë këtij sezoni, atëherë kjo do të jetë pengesë për palën e dëmtuar që të zhdëmtohet.

Këtu nuk është e qartë baza e përgjegjësisë. Problemi paraqitet për faktin se cili do të përgjigjet lidhur me dëmin që shkaktohet nga këto kafshë që s'janë të mbrojtura. Mirëpo,

---

<sup>245</sup>Neni 5 e vijues I Ligjit Nr. 02/L-53 "Për gjuetinë", 16 Dhjetor 2005, Kosove.

<sup>246</sup>Neni 13 I Ligjit Nr. 02/L-53 "Për gjuetinë", 16 Dhjetor 2005, Kosove.



edhe këtu ekziston mundësia për palën e dëmtuar që t'ikërkojë gjykatës që në bazë të dispozitave kushtetuese me të cilat garantohet pasuria dhe integriteti fizik i njeriut, të mund të bëjë zhdëmtimin.<sup>247</sup>

---

<sup>247</sup>Alishani, A. (2001) "Studime nga e drejta e detyrimeve I," Prishtinë, fq. 491.

## KAPITULLI V

### FAJI SI BAZË E PËRGJEGJËSISË

#### 5. Faji si bazë e përgjegjësisë civile

Përgjegjësia civile është një moment mjaft i rëndësishëm që lidhet me përcaktimin e subjektit përgjegjës për shkaktimin e dëmit dhe pastaj për detyrimin për shpërblimin e tij. Si arsye për përgjegjësinë civile mund të jetë faji i shkaktuesit të dëmit, por ka raste kur personi detyrohet ta shpërblejë dëmin edhe kur nuk ka faj direkt, për shkak të rrezikut të krijuar. Raste kur faji nuk merret parasysh janë ato kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme ose veprimtaria e rrezikshme, si dhe kur dikush duhet të përgjigjet për fajin e tjetrit.<sup>248</sup>

Përgjegjësia civile në rastin e detyrimeve jashtëkontraktore, që lindin nga shkaktimi i dëmit, ka vend të zbatohet kur ekziston jo vetëm lidhja shkakësore midis sjelljes së paligjshme të një personi dhe pasojës së ardhur, por edhe kur ekziston elementi *faj*.<sup>249</sup>

Përgjegjësia civile është si rregull një përgjegjësi me faj, megjithëse në raste perjashtimore e krejt të veçanta, mund të ekzistojë edhe përgjegjësia pa faj. Kjo lloj përgjegjësie mund të ekzistojë vetëm në raste të parashikuara shprehimisht në ligj.<sup>250</sup>

Shkaktimi i dëmit mund të paraqitet në forma nga më të ndryshmet, dhe është pikërisht kjo arsyeja dhe rëndësia e studimit të këtij instituti të së drejtës Civile. Kjo pasi në mjaft raste kemi perjashtim nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar. Parimi i prezumimit të fajësisë është kusht thelbësor i përgjegjësisë civile, qoftë ajo kontraktore apo

---

<sup>248</sup>Harris, D. (1988) “ Remedies in Contract and Tort ”, London, fq. 68

<sup>249</sup>Evolution of auditor liability to non contractual third parties: balancing the equities and weighing the consequences, JODI B. SCHERL, Extra-Contractual Liability, Teaching Material Prepared by: Abdulmalik Abubeker & Desta G/Michael pp 68

<sup>250</sup>Tutulani-Semini, M. (2006) “E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave”, pjesa e përgjithshme, Tiranë, fq. 181.

jashtëkontraktore. Ky parim prezumohet si në përgjegjësinë e debitorit për mospërmbushjen e detyrimit, ashtu edhe për shkaktimin e dëmit.<sup>251</sup>

Fajësia e debitorit prezumohet edhe në detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit. Sipas nenit 608 të Kodit Civil, personi që me faj dhe në mënyrë të paligjshme i ka shkaktuar dëm pasuror një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se dëmi nuk ka ardhur për faj të tij.<sup>252</sup>

Në praktikë, në mjaft raste ka ndodhur që për shkaktimin e dëmit subjekti përgjegjës të jetë çliruar nga përgjegjësia për shpërblimin e tij. Një nga rastet më të njohura të çlirimit të subjektit përgjegjës nga përgjegjësia, është ajo kur dëmi shkaktohet për fajin e vet personit të dëmtuar. Që të jemi para kësaj situate të çlirimit nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, duhet që të plotësohen këto kushte: *së pari*, të jetë shkaktuar një dëm konkret dhe *së dyti*, ky dëm të jetë shkaktuar me fajin e të dëmtuarit. Në një rast të tillë barra e të provuarit të fajit të palës së dëmtuar, bie mbi personin që prezumohet se ka shkaktuar dëmin.<sup>253</sup>

Subjekti përgjegjës për dëmin mund të lirohet nga përgjegjësia, tërësisht, në rastin kur kjo e fundit vërtetohet se dëmi është shkaktuar ekskluzivisht për faj të palës së dëmtuar, ndërsa mund të çlirohet pjesërisht në rast se faji i palës së dëmtuar ka qenë i pjesshëm. Ndarja në çlirimin e plotë dhe të pjesëshëm nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, varet nga shkalla e fajit dhe sjellja që ka mbajtur në momentin e dëmtimit subjekti i dëmtuar.<sup>254</sup>

Një rast tjetër kur personi mund të çlirohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, është kur dëmi shkaktohet me fajin e një personi të tretë. Në një rast të tillë dëmi shkaktohet nga përdorimi i sendeve të rrezikshme apo ushtrimi i veprimtarisë së rrezikshme, dhe shkaktar nuk është pronari apo poseduesi i sendeve, por personi i tretë. Personi i tretë në këtë

---

<sup>251</sup>Tutulani-Semini, M. (2006) "E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave", pjesa e përgjithshme, Tiranë, fq. 183.

<sup>252</sup>Po aty.

<sup>253</sup>John, H , John , L. (2004) " Tort Law" , Oxford University Press, pp 148.

<sup>254</sup>Krzecunowicz , J, George . (1977) " The Ethiopian Law of Compensation for Damage", Addis Ababa, Faculty of Law, fq. 207.

rast nuk është në ndonjë marrëdhënie juridike me pronarin e sendit apo ushtruesin e veprimtarisë së rrezikshme, por është thjesht një person, i cili pa qënë i autorizuar ka ardhur deri tek përdorimi i këtyre sendeve, apo deri tek ushtrimi i veprimtarisë së rrezikshme, nga të cilat dhe është shkaktuar dëmi.

Pronari i sendit apo ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme tashmë në këto kushte nuk konsiderohet se është dëmtues. Në një rast të tillë të shkaktimit të dëmit, marrëdhënia juridike pas shkaktimit të dëmit krijohet mes personit të tretë dhe palës së dëmtuar.

Në mënyrë që personi i cili prezumohet si shkaktar i dëmit të çlirohet nga përgjegjësia për kompensimin e dëmit, duhet të vërtetohet se dëmin e ka shkaktuar ekskluzivisht me fajin e personit të tretë, sjelljet e të cilit nuk ka mundur t'i parashikojë, e rrjedhimisht nuk ka mundur t'i shmangë as pasojat e atij dëmi. Në rast të kundërt, përgjegjësia për kompensimin e dëmit të shkaktuar do të bjer mbi pronarin e sendit të rrezikshëm apo atij që merret me veprimtari të rrezikshme.<sup>255</sup>

Si persona të tretë në kuadër të këtij parashikimi nuk konsiderohen: i mituri ndaj prindërve, i mbrojturi ndaj kujdestarit, personi i zhveshur nga zotësia për të vepruar nga organi i kujdestarisë, punëtori ndaj ndërmarrjes së vet, personi në punë ndaj punëdhënësit, pasi në raste të tilla prindi duhet të mbikqyrë të miturin, kujdestari personin nën kujdestari, punëdhënësi punëmarrësin, dhe në rast të shkaktimit të dëmit prezumohen me faj për shkak të mospërbushjes së këtij detyrimi.<sup>256</sup>

Lidhur me shkaktimin e dëmit dhe përgjegjësisë për shkaktimin e tij, legjislacioni shqiptar parashikon edhe raste të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga persona të tjerë, që nënkupton ato raste të përgjegjësisë që rrjedhin nga shkaktimi i një dëmi, por jo si rezultat i

---

<sup>255</sup>Shulman, Harry, James, F., Jr. Oscar S. Gray, Gifford, D. (2003) "Cases and Materials on the Law of Torts 4th ed", New York: Foundation Press.

<sup>256</sup>Krzeczunowicz, J( George). (1977) *The Ethiopian Law of Compensation for Damage*, Addis Ababa, Faculty of Law, fq. 209.

veprimeve të vetë personit përgjegjës. Në këto raste dëmi është shkaktuar nga një i tretë për të cilin përgjigjet civilisht personi i caktuar nga dispozitat e Kodit Civil.

Shkaktimi i dëmit krijon përgjegjësinë juridiko-civile, nga e cila vjen si pasojë detyrimi i shpërblimit të këtij të fundit, dhe në këtë moment përcaktohet dhe personi shkaktues dhe përgjegjës për dëmin. Qëllimi i përgjegjesisë juridiko-civile është rikthimi i subjektit dhe pasurisë së tij në gjendjen e mëparshme, duke zbutur pasojat e veprimeve të dëmshme dhe të kundërligjshme të personave që janë përgjegjës.

### **5.1. Baza juridike e përgjegjesisë për dëmin sipas fajit në qarkullimin juridik.**

Baza juridike e përgjegjesisë për dëmin sipas fajit, ose e thënë ndryshe, përgjegjesisë subjektive, nuk është e vetmja bazë e përgjegjesisë për të tretët, por është bazë juridike e cila në fushën e vet të zbatimit nuk përjashton bazat e tjera juridike të përgjegjesisë për dëmin. Ajo nuk konsideron se bazat e tjera të përgjegjesisë për dëmin janë plotësuese në suazat e përgjegjesisë civile, por se edhe bazat e tjera të përgjegjesisë për dëmin kanë vendin e vet të zbatimit, pavarësinë dhe efektet e veta. Për këtë arsye edhe thuhet se kjo bazë juridike e përgjegjesisë për dëmin ka organizimin e vet juridik, pandaj edhe ka grupin e rregullave që rregullojnë përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar në raste të ndryshme dhe fusha të ndryshme. Kjo e fundit as nuk vuan nga kompleksi për shkak të ekzistimit të bazave të tjera të përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar.

Madje, këtu duhet thënë se kjo bazë juridike e përgjegjesisë për dëmin ka zbatimin e vetë juridik, organizimin rregullativ dhe bazueshmërinë e vetë shkencore. Në këtë kuptim, ajo ka një themel të fortë për ekzistencën e vet, sepse ka rregulla themelore të vetat për sajimin e përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar në bazë të fajit. Pra, te kjo bazë juridike e përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar kemi bazën e përgjegjesisë, bazën juridike si dhe përgjegjësinë për

dëmin e shkaktuar. Sipas bazës juridike të përgjegjësisë për dëmin, dëmtuesi përgjigjet për dëmin sepse është fajtor për dëmin e shkaktuar.

Faji i dëmtuesit në shumë raste provohet. Ka gjithashtu raste kur ai supozohet (presumptio iuris tantum), mirëpo në këtë rast ky faj mund të rrëzohet duke vërtetuar se faji i supozuar nuk ka ekzistuar. Sipas nenit 608/2 të Kodit Civil, i dëmtuari nuk është i detyruar që të provojë fajin e dëmtuesit sepse konsiderohet se rëndohet pozita e tij, dhe gati bëhet e mjerueshme, nga fakti se edhe është dëmtuar edhe duhet të provojë fajin e dëmtuesit për dëmin e shkaktuar. Pra, në këto parashikime është paraparë si detyrë e dëmtuesit që të provojë rrethanat që e lirojnë atë nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar.<sup>257</sup>

Këtu duhet thënë se kodifikimet e mëdha të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, si Kodi Civil Italian, Fancez, Gjerman, gjithashtu përkrahin bazën juridike të përgjegjësisë për dëmin sipas fajit,<sup>258</sup> duke u nisur dhe nga tradita shekullore që kanë në rregullimet, në mësimet e shkencës juridike, në praktikën gjyqësore dhe në mendjen e profesionistëve të këtij lloji të përgjegjësisë civile. Kuptohet se dëmtuesi mund të provojë se nuk ka qenë fajtor për dëmin e shkaktuar. Këtë rregull nuk mund ta mohojë askush. Dispozita ligjore sipas së cilës, ai qëi shkakton tjetrit dëm ka për detyrë që ta shpërblejë atë, përvec rastit kur vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, duhet të kuptohet si relative ngase nuk është konsekuente, sepse në dispozitat e tyre të gjitha këto ligje që kemi përmendur parashikojnë plotë raste përjashtimore, ku kërkohet që i dëmtuari të provojë fajin e dëmtuesit për dëmin e shkaktuar.<sup>259</sup>

Baza subjektive e përgjegjësisë për dëmin gjithsesi bazohet në elementin faj, dhe jo në shpërblimin e dëmit, sepse shpërblimi i dëmit është rezultat i ndikimit të fajit në shkaktimin e këtij të fundit. Këtu roli i të dëmtuarit është aktiv, ngase ai kërkon që të zhdëmtohet, kurse

---

<sup>257</sup>Neni 608/2 i Kodit Civil.

<sup>258</sup>Zweigert, K., Kotz, H. (1999) "An Introduction to Comparative Law", Second editions, fq. 201.

<sup>259</sup>Hetemi, M. (1998) "Detyrimet dhe kontratat", Tiranë, fq. 165.

roli i dëmtuesit është pasiv sepse nën kushtet e caktuar ai duhet atë dëm të paguaj. Këto rregulla janë përkrahur në dispozitat e Kodit Civil Italian, Francez, Gjerman, Hollandez e Shqiptar, çka shihet si diçka normale dhe e nevojshme, sepse kjo bazë juridike e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar ka vendin e vet, fushën e vet, pavarësinë e vet dhe arsyen e vet juridike dhe filozofike.

Baza juridike e përgjegjësisë sipas fajit shprehet tek faji, për shkak të të cilit obligohet dëmtuesi të japë llogari për sjelljen e fajshme në shkaktimin e dëmit. Andaj edhe thuhet se kush është fajtor për dëmin, do të përgjigjet për zhdëmtimin e tij. Ky lloj i përgjegjësisë civile paraqet rëndësi të madhe. Në bazë të saj (ipso iure) dëmtuesi do të përgjigjet për dëmin, gjë e cila dëshmon elementin e së drejtës që është sanksioni. Mund të themi se këtu kemi një drejtshmëri të lartë, ngase fajtori po përgjigjet për dëmin e shkaktuar.<sup>260</sup>

## **5.2. Fusha e zbatimit të kësaj baze juridike të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.**

Rregullat e bazës juridike të përgjegjësisë subjektive (sipas fajit ose të përgjegjësisë për veprimet e veta) kanë një fushë të gjërë zbatimi. Këtë e themi sepse kjo bazë e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, zbatohet si për demet jashtekontraktore, ashtu edhe ato Kontraktore (droit delictuelle et droit contractuel). Por, duhet vënë në dukje se përgjegjësia sipas fajit realizohet si rregullim themelor dhe dominues i përgjegjësisë jashtekontraktore, (responsabilite delictuelle) dhe rrjedhimisht aplikohet në raste dhe situata të ndryshme.<sup>261</sup>

Kuptohet se kjo bazë e përgjegjësisë zbatohet edhe në të drejtën Kontraktore (droit contractuelle), por deri në një masë të caktuar. P.sh., tek faji i kreditorit për dëmin e shkaktuar,

---

<sup>260</sup>Reinhard , Z. (1996) "The law of obligations: Roman Foundations of the Civilian Tradition", Published in the United States by Oxford University Press Inc , New York , fq. 254.

<sup>261</sup>Po aty, fq. 258.

faji i të siguruarit te kontrata mbi sigurimin ose siguruesit në këtë lëmi, ose te caktimi i lartësisë së dëmit, si dhe në rastin e vështirësimit të pozitës së debitorit, përgjigjet ai që ka shkaktuar këtë përgjegjësi.<sup>262</sup>

Dispozitat ligjore, mësimet e shkencës juridike, qëndrimet e praktikës gjyqësore kanë afirmuar dhe afirmojnë bazën juridike të përgjegjësisë sipas fajit (përgjegjësisë subjektive), çka si duket është normale si për të drejtën Kontinentale (Civil Laë), ashtu edhe për të drejtën Anglosaksone (Common Laë), duke qenë se zë një vend të dukshëm në llojet e përgjegjësisë civile (responsabilite civil, civil liability, fault liability).<sup>263</sup>

Duke patur parasysh vlerën dhe aktualitetin që kanë këto çështje në këtë lloj të bazës së përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, më poshtë do të mbarështrijmë dhe analizojmë këto çështje dhe më gjerë. Sipas rregullit themelor, kush me fajin e vet shkaktonte dëm, ai është i detyruar që atë dëm ta shpërblejë. Këtë vërteton dhe sanksionon edhe neni 608/1 i Kodit Civil, i cili thotë: "*Personi i cili në mënyrë të kundërligjshme dhe me faj i shkaktonte tjetrit dëm në personalitetin e tij ose pasurisë së tij, është i detyruar që të shpërblejë dëmin e shkaktuar.*" Mirëpo, në fraksionin e 2-të të këtij neni sanksionohet se: "*Personi i cili ka shkaktuar dëm nuk përgjigjet nëse provon se nuk është fajtor.*" Kodi Civil Italian në nenin 1382 sanksionon përgjegjësinë sipas bazës së fajit, vetëm se në këtë dispozitë nuk thuhet se dëmtuesi nuk përgjigjet për dëmin nëse provon se për dëmin e shkaktuar nuk është fajtor.<sup>264</sup>

Dispozitat e lartpërmendura (sidomos neni608/1) përkrahen edhe në praktikën gjyqësore (në jurisprudencë). Kështu, në një rast thuhet ndër të tjera se: "*Kush tjetrit i*

---

<sup>262</sup>Dobbs, Dan B , Hayden, Paul T. (2001) " Torts and Compensation: Personal Accountability and Responsibility for Injury 4<sup>th</sup> ed ",St.Paul,Minn; West Group , pp 247.

<sup>263</sup>Po aty, fq. 260.

<sup>264</sup> Saggese F, L , Pepe , I. ( 2006) " Kodi Civil Italian " , ilustruar me doktrine dhe jurisprudencë, skema, harta dhe materiale , botim i shtëpisë botuese Tribuna, Piacenza , fq 823



*shkakton dëm është i detyruar që ta shpërblejë atë, nëse nuk provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.*"<sup>265</sup>

Madje në të vërtetohet edhe dispozita e nenit 608/2 e Kodit Civil ku caktohet se çfarë është faji: "*Faji për dëmin e shkaktuar ekziston kur dëmtuesi ka shkaktuar dëmin me qëllim (dolus) ose nga pakujdesia e rëndë (culpa lata)*".<sup>266</sup>

Me siguri të madhe mund të themi se baza e përgjegjësisë për dëmin sipas fajit (përgjegjësia subjektive, përgjegjësia për veprimet e veta) është prezente sa duhet, si një lloj i veçantë i përgjegjësisë civile (responsabilite civil, civil liability). Me këtë plotësohen të gjitha kërkesat e kësaj baze të përgjegjësisë për dëmin.<sup>267</sup>

Këtë e themi duke u nisur nga fakti që sipas rregullimit të përgjithshëm, ai i cili është fajtor për dëmin, ai edhe përgjigjet për të, kurse ai që ka kontribuar në shkaktimin e dëmit, do të përgjigjet për të sipas shkallës së fajit të vet. Në kuadër të shpërblimit të dëmit, kur dëmi është rrjedhim i veprimit me dashje (dolus) ose nga pakujdesia e rëndë (culpa lata) lind përgjegjësia e plotë për dëmin, kurse shkallët tjera të fajit sjellin përgjegjësi më të ulët të shpërblimit të dëmit.

Duke analizuar praktikën gjyqësore shohim se shpeshherë kjo e fundit dëshmon të kundërtën, pasi ndodh që fajtori për shkaktimin e një dëmi të mos përgjigjet. Raste të tilla në gjyqësinë tonë shfaqen më së shumti, p.sh., tek përgjegjësia e ndarë ku mund të kemi çmuarjen e gabuar në rastet e ndryshme. Për ta ilustruar këtë sjellim rastin e OSSHE-së, i cili për nevoja të veta hap një gropë, e cila mbushet me kalimin e kohës me ujë. Në këtë gropë bie një fëmijë dhe mbytet. Gjykata konstaton përgjegjësinë e OSSHE-sëdhe prindërve të fëmijës, edhe pse OSSHE duhet të kishte siguruar gropën të cilën e hapi për nevojat e veta. Pra, këtu nuk duhet të lindë përgjegjësia e ndarë, por përgjegjësia objektive e OSSHE-së,për

---

<sup>265</sup>Neni 608/1 i Kodit Civil.

<sup>266</sup>Neni 608/2 i Kodit Civil.

<sup>267</sup>RFV Husten ,Buckley RA, Salmond ,Hustenon. (1992) " The Law of Torts", 20<sup>th</sup> Ed,London:Sweet and Makwell , fq.69.

shkak të hapjes së gropës dhe mospagimit të saj, duke përbërë rrezik të shtuar për rrethin, sikurse edhe ka ndodhur.<sup>268</sup>

Një rast tjetër është edhe ai kur, për ndërtimin e një shtëpie pronari i saj hap një gropë për shkrirjen e gëlqeres, por nuk e siguronatë. Një fëmijë duke luajtur aty përreth, bie dhe vdes. Përgjegjësia e pronarit që ka hapur gropën me gëlqere ka qenë formale dhe shumë simbolike. Edhe këtu vendoset për lindjen e përgjegjësisë ndarë, edhe pse pronari i që po ndërtonte shtëpinë nuk e ka siguruar gropën e hapur, e cila si e tillë ka krijuar rrezik të shtuar për rrethin.

### **5.3. Llojet e fajit në fushën e të drejtës Civile.**

Në Kodin Civil parashikohet përgjegjësia e personit që ka shkaktuar dëmin me faj, por në përkufizimin e tij fajin nuk e parashikon si element të anës subjektive të përgjegjësisë. Duke qenë se në Kod jepet një përkufizim i cunguar i fajit, i jemi drejtuar përkufizimit që i bën doktrina e së drejtës Penale. E drejta Penale e përkufizon fajin si qëndrim psikik të autorit të dëmit ndaj veprimit të tij dhe pasojës së ardhur.

Qëndrimi i autorit paraqitet në dy momente të tij: në momentin intelektual dhe momentin volitiv.<sup>269</sup> Momenti i parë ka të bëjë me mundësinë subjektive për të parashikuar ose jo pasojat që mund të vijnë nga një veprim i caktuar. Kurse momenti i dytë lidhet me dashjen ose mosdashjen e ardhjes së këtyre pasojave të parashikuara. Në të drejtën Pozitive të Detyrimeve ekzistojnë dy baza themelore të përgjegjësisë dhe një bazë plotësuese për shpërblimin e dëmit: përgjegjësia sipas fajit dhe përgjegjësia objektive ose pa faj, si dhe baza plotësuese e përgjegjësisë sipas parimit të drejtshmërisë.

---

<sup>268</sup>Tutulani-Semini, M. (2006) "E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave", pjesa e përgjithshme, Tiranë, fq. 57.

<sup>269</sup>Semini, M. (1998) "E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave," Tiranë, fq. 85.

*Përgjegjësia për dëmin sipas bazës së fajit.* Që të ekzistojë përgjegjësia për shpërblimin e dëmit duhet të plotësohen këto kushte: së pari, të ekzistojë dëmi; së dyti, dëmi të jetë shkaktuar me veprim ose lëshim të kundërligjshëm të dëmtuesit; së treti, të ekzistojë faji i dëmtuesit; së katërti, të ekzistojë lidhja shkakësore mes veprimit dëmtues dhe pasojave të ardhura-dëmit.<sup>270</sup>

Veprimi është i kundërligjshëm kur kryhet në kundërshtim me normat juridike, moralin shoqëror, dhe prej të cilit cënohet ndonjë e drejtë subjektive e të dëmtuarit. Megjithatë, ekzistojnë veprime të njeriut të cilat edhe pse sjellin dëm, nuk janë të kundërligjshme, por megjithatë, dëmtuesi do të jetë përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Një përgjegjësi e tillë ekziston kur: dëmtuesi e shkakton dëmin duke ushtruar ndonjë të drejtë që i takon; dëmi shkaktohet me pëlqimin e të dëmtuarit; dëmi shkaktohet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, në kuadër të autorizimeve të veta; dëmi shkaktohet në kushtet e Mbrojtjes së Nevojshme; dëmi shkaktohet në kushtet e Nevojës Ekstreme; dhe në rastin kur dëmi shkaktohet në kushtet e vetëndihmës së lejuar.

Faji ekziston kur dikush bën diçka që nuk duhet ta bëjë dhe që nuk do ta bënte një njeri i arsyeshëm. Sipas së drejtës Penale, faji ekziston kur dëmtuesi e shkakton dëmin me dashje (dolus) ose nga pakudësia (culpa). Pra, ky parashikim njihet shkallët e fajësisë: dashjen dhe pakujdesinë. Dashja ekziston atëherë kur dëmtuesi ka qenë i vetdijshëm për veprimet e veta dhe ka dashur ardhjen e pasojave, ose kur ka qenë i vetdijshëm që, për shkak të veprimeve të tij mund të vinin pasoja dhe ka pranuar ardhjen e tyre.<sup>271</sup> Pakujdesia ekziston kur dëmtuesi nuk ka vepruar me kujdesin e njeriut mesatarisht të kujdesshëm, ose nuk ka vepruar me kujdesin e njeriut shumë të kujdesshëm.<sup>272</sup>

---

<sup>270</sup>Deakin, S, Johnston, A, Markesinis, B. (2008) "Markesinis and Deakin's Tort Law", 6th ed, Oxford, Clarendon Press.

<sup>271</sup>Morbide N, J, Bagshaw, R. (2005) "Tort Law", 2<sup>nd</sup> ed, London, New York and Others: Pearson Longman, fq. 207

<sup>272</sup>Cooke, J. (2007) "Law of Torts 8<sup>th</sup> ed", London, New York and Others; Pearson Longman, fq. 84.

Kur personi nuk ka patur as detyrimin objektiv dhe as mundësinë subjektive të parashikonte pasojat, ai ka vepruar pa faj dhe bëhet fjalë për “*dëmin e rastit*”, rrethanë kjo që e përjashton personin nga detyrimi për shpërblimin e dëmit, pra nga përgjegjësia civile.

Në rastin e pakujdesisë në formën e neglizhencës, lind problemi lidhur me çështjen e vlerësimit të kujdesit të treguar nga personi përgjegjës, për të parashikuar mundësinë e ardhjes së pasojave të dëmshme. Doktrina jonë juridike ka pranuar vlerësimin *in abstracto*, duke e krahasuar sjelljen e autorit të dëmit më atë të një njeriu normal. Ky qëndrim duket i drejtë nëse do të pranojmë dhe filozofinë se njeriu është arbitër i vetvetes, dhe si i tillë është i lirë të zgjedhë dhe të veprojë midis së mirës dhe së keqes.

*Culpa levis in abstracto* (pa dashje e lehtë abstrakte) ekzistonte atëherë kur debitori kishte menduar të ndërmerre ato masa për evitimin e dëmit, që do të kishte ndërmarrë shtëpiaku i mirë.

*Culpa levis in concreto* (pa dashje e lehtë konkrete) ekzistonte atëherë kur debitori kishte menduar të ndërmerre masa për evitimin e dëmit dhe nuk ishte kujdesur për to, si do të kujdesej për punët e tij me interes personal. Nëse moskryerja e prestimit obligator ishte kryer pa fajin e debitorit, debitori lirohej nga detyrimi ndaj kreditorit (kjo moskryerje duhej t'i vishej fuqisë madhore (vis major).

Si fuqi madhore konsideroheshin të gjitha rrethanat që nuk mund të parashikoheshin, pasojat e të cilave nuk mund të evitoheshin edhe sikur të ishin paraparë.

Zhdëmtimi paguhej, ose si zhdëmtim i thjeshtë, ose si shpagim i shumëfishtë i vlerës së sendit të dëmtuar ose të shkatërruar krejtësisht.

Lidhja kauzale (shkakësore) është një ndër kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar. Lidhja kauzale përbën lidhjen mes veprimeve për të cilat pala është përgjegjëse dhe pasojave të ardhura, dëmit. Një person përgjigjet për dëmin e shkaktuar vetëm

në rast se ekziston lidhja kauzale mes veprimeve të tij dhe pasojës së ardhur, dëmit. Veprimi do të konsiderohet si shkak i dëmit, në qoftë se paraqet kusht të drejtëpërdrejtë dhe të pandërprerë dhe nëse, sipas efektit të tij të rregullt, është shkaktuar dëmi.<sup>273</sup>

Për sa u përket sistemeve të huaja, ato kanë operuar më së shumti nëpërmjet jurisprudencës dhe interpretimeve që u janë bërë prej sajdispozitave ekzistuese. Kështu mund të përmendim përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara nga kafshët apo nga ndërtesat, të cilat megjithëse janë dispozita tepër të hershme, janë interpretuar si raste të përgjegjësisë objektive (në Francë dhe në Itali).

Në rregullimet ligjore aktuale vazhdon ende të mbizotërojë parimi tradicional i përgjegjësisë me faj. Gjatë hartimit të Kodit Civil janë futur rishtazi disa dispozita, si edhe janë shtuar raste të reja të përgjegjësisë civile. Nëse kemi të bëjmë me raste të përgjegjësisë me faj apo të përgjegjësisë objektive, mendoj ta trajtoj konkretisht në çdo rast konkret në kapitullin përkatës.

---

<sup>273</sup>Cooke, J. (2007) “*Law of Torts 8<sup>th</sup> ed*”, London, New York and Others; Pearson Longman, fq.89.

## KAPITULLI VI

### PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN MATERIAL DHE ATË MORAL

#### 6.1. Shpërblimi i dëmit material dhe atij moral.

Qëllimi i shpërblimit të dëmit është rivendosja e gjendjes së mëparshme të pasurisë së të dëmtuarit, rikthimi i saj siç ka qenë para se të ndodhte ngjarja dëmtuese. Ky qëllim, sipas Kodit Civil, mund të arrihet në dy mënyra: në natyrë dhe në të holla. Në qoftë se të dëmtuarit i është marrë ose dëmtuar një send, rikthimi i gjendjes së mëparshme në natyrë arrihet me kthimin e sendit, përkatësisht riparimin e sendit të dëmtuar apo zëvendësimine tij me një send tjetër të të njëjtit lloj dhe me vlerë të njëjtë.<sup>274</sup>

Mirëpo, kjo formë nuk mund të realizohet gjithmonë. Në këto raste dhe kur gjykata e çmon të nevojshme, përcaktohet që të dëmtuarit t'i paguhet një shumë e caktuar të hollash, në emër të shpërblimit të dëmit. Ligji e lejon shpërblimin e dëmit në të holla, edhe në rastet kur këtë e kërkon i dëmtuari dhe e lejojnë rrethanat e rastit konkret.<sup>275</sup>

Shpërblimi i dëmit në të holla i bëhet të dëmtuarit edhe kur sendi i është marrë në mënyrë të palejuar nga ligji atij dhe është asgjësuar nga forca madhore.<sup>276</sup>

Nëse përgjegjësia penale ka për qëllim dënimin e autorit të veprës penale, përgjegjësia civile e gjen qëllimin e saj në shpërblimin e dëmit. Detyrimi për dëmshpërblim lind në të njëjtën kohë me shkaktimin e dëmit, por kredia që rrjedh nga ky dëm do të mbetet e tillë në potencial, përderisa ajo nuk është njohur vullnetarisht ose konstatuar në rrugë gjyqësore. Dhe duke qenë se për nga natyra e tij, njeriu e ka të vështirëtë pranojë gabimete tij, shpesh një

---

<sup>274</sup> Dobbs, Dan B., Hayden, Paul T. (2001) "Torts and Compensation: Personal Accountability and Responsibility for Injury 4th ed", St. Paul, Minn; West Group fq.57.

<sup>275</sup> Biondi, A., Farley, M. (2009) "The Right to Damages in European Law", Kluwer, fq.98.

<sup>276</sup> Dobbs, Dan B., Hayden, Paul T. (2001) "Torts and Compensation: Personal Accountability and Responsibility for Injury 4th ed", St. Paul, Minn; West Group, fq.56

proces gjyqësor është i nevojshëm për t'i dhënë shpërblim të dëmtuarit. Por, nuk është e thënë që çdo rast për shpërblim të një dëmi të shkaktuar të kalojë nëpër një proces gjyqësor. Zgjatja në kohë e procedurave dhe kostoja e gjykimit, në të shumtën e rasteve nxit interesin e palëve për të arritur një zgjidhje jashtëgjyqësore me marrëveshje.

Përveç dhe pavarësisht dëmit material, mund të shkaktohet edhe dëm jomaterial. Një dëm i tillë mund të vijë nga cënimi i integritetit të njeriut, icilikatëbëjëmshkaktimine dhimbjeve fizike, dhimbjeve shpirtërore, uljen e aktivitetit jetësor, shëmtimin, cënimin e prestigjit, nderit, lirive apo të drejtave themelore, meshkaktimin e vdekjes së personit të afërm apo shkaktimin e frikës. Qëllimi i shpërblimit të dëmit është që të rivendoset gjendja e mëparshme e pasurisë së të dëmtuarit, para se të shkaktohej dëmi.<sup>277</sup>

Në rastin e dëmit material, parimisht, shpërblimi mund të realizohet në natyrë. Për dallim nga kjo, tek shpërblimi i dëmit moral rivendosja e gjendjes së mëparshme realizohet në varësi të formës së dëmit. P.sh.: Në rast të cënimit të së drejtës së personalitetit, zhdëmtimi mund të arrihet në përmjet publikimit të aktgjykimit me shpenzime të dëmtuesit, ose me revokimin e deklaratës me të cilën është shkaktuar dëmi, nga ana e dëmtuesit, ose në një mënyrë tjetër, me anë të së cilës të arrihet qëllimi i shpërblimit të dëmit (neni 199). Ndërsa, në raste të tjera, gjykata cakton për të dëmtuarin shpërblimin e drejtë në të holla, i cili ka karakter të satisfaksionit moral.<sup>278</sup>

Gjykata mund të caktojë shpërblimin e dëmit, për shkak të dhimbjeve shpirtërore, për personin, i cili me anë të mashtrimit, shtrëngimit ose të keq përdorimit të ndonjë raporti, të nënshtrimit ose vartësisë, është shtrënguar të ketë marrëdhënie seksuale, ose ka pësuar ndonjë vepër tjetër kundër personalitetit dhe moralit të tij (neni 203 LMD).<sup>279</sup>

Në rast të vdekjes së personit të afërm, të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla

---

<sup>277</sup>Shulman, Harry, Fleming J, Jr. *Oscars. Gray, Gifford, D. (2003) "Cases and Material on the Law of Torts 4<sup>th</sup>ed"*, New York: Foundation Press, fq. 54.

<sup>278</sup>Neni 199 i Kodit Civil.

<sup>279</sup>Neni 203 i Ligjit Nr. 2359, datë 15. 11. 1956 "Mbi Veprimet Juridike dhe mbi Detyrimet"

e kanë anëtarët e ngushtë të familjes (bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit e të vdekurit).Kjo e drejtë mund t'ju përkasë edhe vëllezërve e motrave të të vdekurit, në rast se mes tyre dhe të vdekurit ka ekzistuar bashkësia e përhershme jetësore.

Për dhimbjet e pësuar shpirtore,gjykata mund të caktojë shpërblime drejtë të anëtarëve të ngushtë të familjes, edhe në rast të invaliditetit të rëndë të ndonjë personi. Si kriter për vërtetimin e masës së dëmit merret parasysh shkalla e intensitetit të dhimbjeve fizike,frikës, si dhe kohëzgjatja e tyre.

Siç u tha edhe më lart, dëmi ekzistencial është shfaqje e jashtme e cënimit të interesave të ligjshme lidhur me cilësinë e jetës. Si rezultat, është objektivisht i vërtetueshëm dhe nuk mund të provohet vetëm me anë të prezumimeve të thjeshta.<sup>280</sup>

Gjykata duhet të pranojë vetëm rastet e cënimeve konkrete të të drejtave të personalitetit, për të cilat ka bërë kërkim dhe që pretendohen nga i dëmtuari si dëm ekzistencial i pësuar prej tij. Për caktimin e dëmshpërblimit të dëmit ekzistencial, gjykata çmon mbi rrethana që vërtetojnë ndryshim të dukshëm e të rëndësishëm përkeqësues të jetës së përditshme,si dhe impaktin aktual e të ardhshëm të këtyre ndryshimeve në interesat jopasurore dhe marrëdhëniet e të dëmtuarit me botën e jashtme.

Në rastin e dëmit ekzistencial, të shkaktuar në veçanti nga vdekja apo dëmtimi i rëndë i shëndetit të të afërmit, për caktimin e masës së dëmshpërblimit, Gjykata e Lartë ka dhënë kritere konkrete që duhet të mbahen parasysh nga gjykatat e tjera, si më poshtë vijon:

- afërsia gjinore me të dëmtuarin apo viktimën;
- mosha e viktimës dhe e të dëmtuarit
- përbërja dhe gjendja e bashkëjetesës në familje.

---

<sup>280</sup>Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Nr. 12, dt. 13.09.2007 dhe 14.09.2007.



## 6.2. Dëmi material, kuptimi, llojet dhe shpërblimi i tij.

Dëmi material është cënim i vlerave materiale të ndonjërit prej subjekteve të së drejtës (person fizik ose person juridik). Në rastet kur një send dëmtohet pjesërisht ose plotësisht, apo kur i shkaktohet lëndim trupor deri edhe vdekja dikujt, atëherë themi se është shkaktuar dëm material. Njerëzve u shkaktohen dëme materiale të llojeve të ndryshme. Ekzistojnë kriteret të caktuara në bazë të të cilave bëhet ndarja e dëmit. Ne do të analizojmë rastet më të rëndësishme e që më së shpeshti trajtohen në teorinë juridike, ato që më së shumti përmenden në legjislacion dhe në qëndrimet e praktikës gjyqësore, siç janë: dëmi vërtetë dhe fitimi i munguar.

Shkaqet juridike të cilat sjellin për pasojë shkaktimin e dëmit jashtë-kontraktor ose edhe nga kontratat, mund të paraqiten në forma të ndryshme. Dëmi jashtë-kontraktor mund të shfaqet në forma të ndryshme, si dëm ndaj pasurisë, apo edhe si dëm ndaj personalitetit. Duke u nisur nga kriteret që merren për bazë, dallojmë disa lloje të dëmit jashtë-kontraktor, pasi në praktikë mund të ndodhë që në të njëjtin rast të shkaktimit të dëmit të konkurrojnë paralelisht disa lloje syresh.<sup>281</sup>

Doktrina juridike dhe shumica e legjislacioneve të huaja si lloje kryesore të dëmit njohin: dëmin material dhe dëmin jomaterial; dëmin e vërtetë (*damnum emergens*) dhe fitimin e munguar (*lucrum cessans*); dëmin konkret dhe atë abstrakt; dëmin e drejtëpërdrejtë (direkt) si dhe atë indirekt (tërthortë); dëmin e parashikueshëm dhe atë të paparashikueshëm; dëmin e tanishëm, si dhe atë të ardhshëm; dëmin pozitiv dhe atë negativ. Rëndësia e kësaj ndarjeje lidhet me arsye teorike dhe praktike, pasi duke ditur kuptimin e dëmit mund ta përshtatësh lehtësisht ndër situata të ndryshme që ndodhin në praktikë.

---

<sup>281</sup>Shulman, Harry, Fleming J, Jr. *Oscars. Gray, Gifford, D. (2003) "Cases and Material on the Law of Torts 4<sup>th</sup>ed", New York: Foundation Press, fq. 54.*

Dëmi që mund t'i shkaktohet një individit drejtëpërdrejtë apo pasurisë së tij, mund të jetë i natyrave të ndryshme. Dëmi material si koncept konsiston në cënimin e të mirave materiale të personit, të drejtave pronësore apo ndonjë interesi tjetër pasuror. Autorë të ndryshëm shpeshherë në vend të dëmit pasuror, për të specifikuar apo mirëpërcaktuar llojin e dëmit të shkaktuar, përdorin emërtimin *dëm material*. Kemi ardhjen e një dëmi edhe kurnjë personi i merret një sendi i caktuar, me apo pa kontratë, për një periudhë të caktuar apo të pacaktuar kohore, i cili nga pakujdesia apo dashja e marrësit dëmtohet ose zhduket, apo edhe kur cënohet nderi apo dinjiteti i një individit mepërhapjene fakteve apo rrethanave të pavërteta.<sup>282</sup>

Dëmi material shkaktohet dhe në rastin e mospërmbushjes së ndonjë detyrimi që lind nga marrëdhëniet kontraktuale (kur kemi të bëjmë me mospërmbushje të detyrimeve kontraktore). Dëmi material vjen edhe në rastin kur një personi të caktuar i shkaktohen lëndime trupore, apo dëmtime të shëndetit që shkojnë deri edhe në vdekje. Individëve në jetën juridike mund t'u shkaktohen disa lloje të ndryshme të dëmit material.<sup>283</sup> Teoria juridike së bashku me praktikën gjyqësore, i kanë krijuar këtyre llojeve të dëmit material një vend të rëndësishëm. Ato i ndajmë në:

- a. dëm i vërtetë (*damnum emergens*),
- b. fitim i munguar (*lucrum cessans*),
- c. dëm abstrakt,
- d. dëm konkret,
- e. dëm i drejtëpërdrejtë,
- f. dëm i tërthortë,
- g. dëm ekzistues,
- h. dëm i ardhshëm,

---

<sup>282</sup> Sallabanda, A. (1962) "E drejta e detyrimeve", Tiranë, fq.302.

<sup>283</sup> Po aty..

- i. dëm i parashikuar,
- j. dëm i paparashikuar, etj.

Më poshtë do të japim një përkufizim dhe analizë të shkurtër për secilin nga dëmet e lartpërmendura:

a) *Dëmi i vërtetë (damnum emergens)*. Ky i fundit nënkupton zvogëlimin e pasurisë së personit të dëmtuar. Për këtë lloj dëmi përdoren koncepte të ndryshme, sikurse janë: *dëm real*, *dëm i thjeshtë*, *dëm pozitiv* etj. Dëmi mund të paraqitet në situatat kur shkaktohet si nga delikti, ashtu dhe nga shkelja e detyrimeve kontraktore. Dëmi shkaktohet në të vërtetë kur zvogëlohet pasuria apo çdo e mirë tjetër materiale e subjektit tjetër. D.m.th., dëmi i vërtetë konsiston në cënimin e të drejtës pasurore ose interesit pasuror të të dëmtuarit. Vlerësimi i dëmit bëhet në mënyrë të thjeshtë, pasi vetëm bëhet dallimi i vlerës së pasurisë së të dëmtuarit para dhe pas shkakimit të dëmit. Këtu paraqitet dallimi në kuptimin negativ, varfërimi apo pakësimi i pasurisë së palës së dëmtuar, pasi zvogëlimi i pasurisë me rastin e shkakimit të dëmit të vërtetë bëhet duke zvogëluar vlerën e pasurisë për aq sa është vlera e sendit të vjedhur apo dëmtuar. Pjesë të dëmit të vërtetë janë edhe shpenzimet e bëra nga ana e të dëmtuarit në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve dhe masave të caktuara me qëllim që të shmangë rrezikun nga shkaktimi i dëmit.<sup>284</sup>

Raste të këtilla paraqiten ndaj personit kur i vidhet automjeti, i dëmtohet shtëpia, kopshti me lule, kur përhapen fakte të pavërteta duke shpifur, kur i shkaktohet vdekja apo lëndime trupore, etj. Këtu mund të përmendim rastin, ku gjykata nuk ia njeh të drejtën për shpërblim të dëmit jomaterial palës, por vendos vetëm lidhur me shpërblimin e dëmit material, *dëmit të vërtetë*, duke u bazuar në rregullat e CISG.<sup>285</sup>

---

<sup>284</sup>Galev, G., Jadranka. (2004) "E drejta e detyrimeve", Pjesa e përgjithshme, Beograd, fq. 215.

<sup>285</sup>Po aty.

b) *Fitimi i munguar (lucrum cessans)*. Është një lloj dëmi material që shkaktohet, jo me cënimin e vlerave ekzistuese pasurore, por në rastet kur i dëmtuari pengohet për rritjen e vlerës së pasurisë së tij nëpërmjet veprimeve të ndryshme. Për këtë lloj dëmi përdoren terma të ndryshme, si *fitim i lëshuar, dobi e lëshuar, fitim i humbur, dobi e munguar*, që kanë po të njëjtin kuptim. Fitimi i munguar nënkupton atë fitim të cilin është e sigurt se i dëmtuari, sipas rrjedhës së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta të rastit, do ta realizojë, në qoftë se debitori do ta përmbush detyrimin e vet ashtu sikundër duhet.<sup>286</sup>

Kjo mund të konstatohet qartë dhe nga ndarja që bën ligji kur jep kuptimin e dëmit në llojin e zvogëlimit të pasurisë së dikujt tjetër (dëmi i vërtetë) dhe pengimin e rritjes së pasurisë (fitimi i munguar), si dhe shkaktimin apo dëmtimin fizik dhe shpirtëror (dëmi jomaterial). Në këtë kuptim, veprimi i dëmshëm tek tjetri nuk ka për pasojë dëmtimin e të mirave materiale aktuale, por pengimin e rritjes të pasurisë për të ardhmen. Edhe në detyrimet kontraktore mund të shkaktohet ky lloj dëmi, pasi nëse debitori e përmbush detyrimin kontraktor me vonesë, atëherë kreditorit mund t'i shkaktohen humbje të fitimit, si pasojë e kësaj vonese.<sup>287</sup>

Vlerësimi i fitimit të munguar bëhet vetëm mbi bazën e kritereve objektive dhe provueshmërisë. Kështu e përcakton edhe ligji, duke u shprehur se “*gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të munguar merret parasysh fitimi të cilin mundet që realisht të pritët ta realizojë sipas rrjedhës normale të punëve apo sipas rrethanave të veçanta, realizimi i të cilave është penguar nga veprimet e dëmtuesit apo lëshimet e dëmtuesit*”. Raste të ngjashme janë të shpeshta në praktikë. Një rast i tillë do të jetë ai kur, p.sh., një personi i dëmtohet mjete me të cilin ai punon si taksist. Në këtë rast përveç dëmit të vërtetë, dëmtuesi është i detyruar që të shpërblejë edhe fitimin e munguar, për shkak të defektit të veturës.

---

<sup>286</sup> Galgano, F. (2003) “E drejta private” Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë, fq. 285.

<sup>287</sup> Hodgson, J., Lewthwaite, J. (2004) “Tort Law”, Oxford University Press, fq.134.

c) *Dëmi konkret.* Konsiderohet ai lloj dëmi që realisht është evident, si dhe që mund të vërtetohet e provohet në bazë të rregullave konkrete të tregut, të cilat ekzistojnë në momentin e shkakimit të dëmit. Lartësia e tij përcaktohet për çdo rast, veç e veç, në bazë të rrethanave dhe fakteve konkrete, dhe duhet të vlerësohet me para. Dëmi konkret është vetëm ai dëm të cilin mundet me saktësi ta vërtetojë pala pretendente. Konkretizimi dhe vlerësimi i lartësisë së dëmit konkret mund të bëhet duke i përdorur të gjitha mjetet e provës, siç janë: kqyrja në vendin e ngjarjes tek sendi i dëmtuar; dëshmitarët; ekspertin; dokumentet, qoftë publike qoftë private; pranimin nga vet shkakuesi i dëmit, etj.

d) *Dëmi abstrakt.* Është ai lloj i dëmit material, i cili përcaktohet në mënyrë abstrakte, duke mos e marrë për bazë dëmin e vërtetë të shkakuar. Për të bërë dallim nga dëmi konkret ku vështirë përcaktohet vlera e shpërblimit të tij, dëmi abstrakt është një lloj dëmi, ku vlera e detyrimit për kompensim mund të përcaktohet në mënyrë më të lehtë, kjo pasi e njëjta dihet paraprakisht, dhe nuk varet nga vlera reale e dëmit të shkakuar. Mund të marrim si shembull, rastin e thyerjes së xhamit të një automjeti, ose vjedhjes së lavatriçes apo orendive të tjera shtëpiake, ku është e lehtë për të përcaktuar vlerën e dëmit, pasi në bazë të çmimeve konkrete apo çmimit aktual të tregut përcaktohet lehtë lartësia e kompensimit që duhet të paguajë në formën e dëmshpërblimit dëmtuesi. Në këto raste detyrimi për zhdëmtim zakonisht është i një lartësie më të madhe se sa vlera reale e dëmit.<sup>288</sup>

e) *Dëmi drejtëpërdrejt.* Është ai lloj dëmi pasojat e të cilit kanë ardhur drejtëpërdrejtë nga veprimi i kundërligjshëm i dëmtuesit, apo nga lëshimet eventuale të tij, të cilat nëse do t'i kishte ndërmarrë në kohë, nuk do të vinin efektet e dëmshme të sendit. Nga dëmi i drejtëpërdrejtë paraqitet njëkohësisht edhe veprimi i dëmshëm, edhe efektet e dëmit. Në këtë lloj dëmi, veprimi i dëmshëm paraqitet si motiv apo shkak i drejtëpërdrejtë i shkakimit të dëmit. P.sh., rast i tillë është ai kur nga lyerja e godinës me bojë thyhet xhami i dritares. Kjo

---

<sup>288</sup>, Shulman , Harry , Fleming J, Jr.Osc Shulman , Harry , Fleming J, Jr.Oscars.Gray, Gifford,D. (2003) "Cases and Material son the Law of Torts 4<sup>th</sup>ed", New York:Foundation Press , fq. 61.

ndarje kualifikohet në dëm të drejtëpërdrejtë dhe në dëm të tërthortë, dhe është e përafërt me ndarjen në dëm të vërtetë dhe fitim të munguar. Prandaj në praktikë është parë e nevojshme dhe e domosdoshme kjo ndarje.

*f) Dëmi i tërthortë.* Është ai dëm që vjen si rezultat jo i drejtëpërdrejtë i veprimit të dëmshëm me të cilin çënohet pasuria apo ndonjë interes tjetër juridik i të dëmtuarit. Tek ky lloj dëmi paraqitet veprimi i dëmshëm apo lëshimi eventual si rrethanë e tërthortë, ku shkaktohen pasoja refleksive në më shumë dëme. P.sh., raste të tilla janë ato kur nga përkujdesja jo e duhur e bariut (çobanit) ndodh largimi i tufës së dheneve, të cilat mund të dëmtojnë të mbjellat e drithërave, apo mund të humbasin; ose kur nga hedhja e cigares së ndezur të shkaktohet zjarr. Në këto raste fakti i shkakimit të dëmit ekziston si rrjedhojë e tërthortë e veprimit të dëmshëm.<sup>289</sup>

*g) Dëmi efektiv.* Është ai lloj dëmi material, i cili ekziston apo është shkaktuar sëbashku me pasojat e tij që në momentin e lindjes së shkakimit të dëmit. Zakonisht, ky lloj dëmi lind kur dikujt i dëmtohet apo i humbet ndonjë send; kur i shkaktohen dëmtime apo lëndime trupore; kur icënohet nderi, dinjiteti apo reputacioni, si rezultat i të cilave personit mund t'i shkaktohet humbje materiale, dhimbje fizike, vuajtje shpirtërore apo frikë.

*h) Dëmi i ardhshëm.* Është ai lloj dëmi, i cili ende nuk është shkaktuar, por mendohet me siguri se do të shkaktohet, edhe pse nuk dihet saktë se kur do të vijë pasojat ekzaktësisht dhe sa do të jenë ato. Paraqitja e sigurt e pasojave është e lidhur me veprimin e dëmshëm që ka shkaktuar dëmin momental ndaj një të mire materiale apo jomateriale. Dhe, sipas llojit të dëmit, besohet në ardhjen e dëmtimeve shtesë në të ardhmen. Kështu, një rast i tillë është ai kur nga përplasja e automjetit dëmtohet një person, i cili nga lëndimet e marra, përveç dëmit ekzistues (dhimbjeve fizike, frikës, shpenzimeve mjekësore), do të ketë nevojë të domosdoshme të bëjë edhe ekzaminimetë tjera në të ardhmen. Mund të ndodhë gjithashtu që

---

<sup>289</sup> *Shulman, Harry, Fleming J, Jr. Oscars. Gray, Gifford, D. (2003) "Cases and Material on the Law of Torts 4<sup>th</sup>ed", New York: Foundation Press, f.65*

nga goditja personi në fjalë të mbetet me pasoja edhe për të ardhmen, të cilat mund të konsistojnë në humbjen e përkohshme ose të përhershme të aftësisë për punë. Në këtë rast pasojat duhet të vijnë në një periudhë të mëvonshme, pas kryerjes së veprimit të dëmshëm, i cili po ashtu mund të jetë me natyrë materiale, ose jomateriale.

*i) Dëmi i parashikuar.* Është ai lloj dëmi, të cilin personi që e shkakton, ka patur mundësi ta parashikojë në momentin e ndërmarrjes së veprimit të dëmshëm. Ky lloj dëmi mund të paraqitet si dëm ekzistues ose si dëm i ardhshëm. Të shpeshta janë rastet në praktikë të shkakimit të dëmit të paraparë. Këtu mund të përmendim si shembull: shitjen e qumshtit të papasterizuar në temperatura të larta, kur dihet shkencërisht se një veprim i tillë shkakton helmimin e njerëzve. Shembull tjetër janë: rastet e ndezjes së qëllimshme, apo nga pakujdesia, të zjarreve në pyje gjatë temperaturave të larta, kur dihet me siguri se një veprim i tillë në fund mund të ketë për pasojë djegien e të gjithë pyllit. Ky lloj dëmi, përveç se nga deliktet, mund të shkaktohet edhe në rastin e mospërbushjes së kontratës apo përmbushjes së parregullt të saj.

Kjo ndodh edhe atëherë kur debitori e di saktësisht se me rastin e mospërbushjes së prestimit obligator, do të sjellë pasojatë dëmshme për kreditorin. P.sh.: nëse furnizuesi i ndonjë restoranti, për një lloj ushqimi të rëndësishëm, nuk e dërgon porosinë në kohë, p.sh., para ditëve të festave, pronarit të restorantit do t'i shkaktohet një dëm i konsiderueshëm, që ka për pasojë humbjen e imazhit të mirë, gjë e cila do t'i reflektohet në humbjen e klientelës. Të gjitha këto janë pasoja që mund të parashikohen lehtë nga njeriu i zakonshëm.

### **6.3. Dëmi jomaterial (moral)**

Duke u bazuar në të dhënat, studimet si dhe informacionet e marra në literatura të ndryshme dhe në internet, rezulton se disa sisteme juridike të Europës vonë e kanë njohur

shpërblimin e dëmit jomaterial, ky koncept fillimisht në Shqipëri ka qenë i njohur që nga e drejta zakonore, më vonë e parashikuar dhe në ligjet në vijimësi. Bazueshmëria e shpërblimit të dëmit jomaterial kanë qenë të njohura që në kohëra të lashta duke filluar që nga e drejta romake, ku i dëmtuari përveçse shpërblimit të dëmit material, i lindje e drejta të realizonte edhe të drejtën e kompensimit atë të dëmit jomaterial mbi bazën e një vlerësimi të lirë të të gjitha provave nga ana e gjykatës, duke marr për bazë të gjitha rrethanat, provat, pretendimet të rastit. Një e drejtë e tillë realizohej përmes përdorimit të padisë actio iniuriarum, që aplikohet jo vetëm në rastet e shkeljeve të dinjitetit dhe reputacionit të individit, por edhe me rastin e cënimit apo dëmtimit të integritetit fizik, sa herë që personi që ishte shkaktari i sjelljes së dëmit sillet në mënyrë të gabuar dhe me faj.<sup>290</sup>

Për të bërë dallimin nga dëmi material që vjen si rezultat i dëmit të të mirave materiale, si dhe dëmit jomaterial rezulton si rezultat i cënimit i të drejtave jomateriale, siç janë: cënimi i lirisë, privatësisë, nderit, shkaktimi i dhimbjeve fizike, psiqike apo të frikës, përkatësisht nga cënimi i të mirave personale të njeriut që i garanton rendi juridik. Që nga shekulli i XIX, legjislacionet dhe praktika gjyqësore e shumicës së vendeve pranojnë shpërblimin e dëmit jomaterial, në bazë të rregullës së përgjithshme se çdo dëm duhet të shpërblehet, nëse në vetvete ka disa karakteristika të dëmit. Disa autorë, gjatë shek XX mendonin se dëmi jomaterial ekziston gjithmonë kur kompensimi me para nuk është në gjendje ta kompensojë në mënyrë adekuate dëmin dhe ta vlerësoj objektivisht, pasi paratë në raport me dëmin e shkaktuar nuk mund të plotësojnë funksionin e tyre si ekuivalent.<sup>291</sup>

Përsa i përket emërtimit të dëmit jomaterial, autorë të ndryshëm kanë emëtuar dhe konkretizuar emërtime të ndryshme, si dëmi jopasuror, dëm për shkak të vdekjes, dëm për shkak të lëndimit trupor apo shëndetit, dëm jo në para, dëm ideal apo dëmi moral, por duhet

---

<sup>290</sup>Zimmermann, R. (1996) "THE LAW OF OBLIGATIONS: Roman Foundations of the Civilian Tradition", Published in the United States by Oxford University Press Inc., New York, fq.1050-1052

<sup>291</sup>François, G. "La Reparation du prejudice moral" I thèse pour le doctorat présentée et soutenue le lundi 14 novembre 1938, à 14 h. Université de Grenoble, Dalloz, Paris



pasur parasysht edhe gjendjen shpirtërore apo edhe çekuilibrimin ku nuk i përfshin as termi dëm pasuror e as ai moral, pasi është me element thjesht subjektiv dhe më i saktë do të ishte termi dëm jomaterial.

Dëmi jomaterial është i sanksionuar në të gjitha legjislacionet nacionale. Kështu në ligj sanksionohet që për shkaktimin e dhimbjeve fizike, apo edhe vuajtjet shpirtërore për shkak të uljes së aktivitetit jetësor, shëmtimit, cënimit të reputacionit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, vdekjen e ndonjë të afërmi si dhe frikës,<sup>292</sup> gjykata nëse vëren se rrethanat e rastit, veçanërisht forca e dhimbjeve dhe frikës dhe kohëzgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykoj kompensim të arsyeshëm me para, pavarësisht kompensimit të dëmit material, bile edhe në mungesë të tij. Në nenin 625 i KC sanksionohet se *“Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cënuar në nderin e personalitetit të tij, është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për fyerjen e bërë. Në gjitha vendet e Europës dhe vendet e tjera me demokraci në zhvillim ka një tendencë të zgjerimit të konceptit të dëmit jomaterial, duke përfshirë shkeljen e çdo të drejte subjektive, nisur nga të drejtat themelore të njeriut, siç është e drejta për jetë, reputacion dhe emër të mirë, nderin, pacënueshmërin e shëndetit fizik dhe psikik dhe privatësin”*.<sup>293</sup>

Dëmi material mund të përlloraget në mënyrë objektive dhe me saktësi të plotë me përdorimin e metodave shkencore dhe matematikore, për dallim nga dëmi jomaterial i cili nuk mund saktësisht t'i përcaktohet vlera dhe lartësia e tij, sepse në vetëvehte ndërthen ndryshime të brëndshme dhe subjektive që dallojnë, varësisht nga personi.

---

<sup>292</sup> Nicholas , M , J.and Bagshaw, R. (2005) “ Tort Law”, 2nd ed, London, NewYork and Others: Pearson Longman.

<sup>293</sup> Neni 625 I kodit civil

Dëmi moral, cënon të mirat personale të të dëmtuarit duke zvogëluar ndjeshëm aktivitetin njerëzor, duke i shkaktoar shëmtim, frikë, vdekje të të afërmeve e të tjera. Rrethanat e rastit të shkaktoimit të dëmit, veçanërisht lartësia (*intensiteti*) e dhimbjeve dhe frikës dhe kohëzgjatja e tyre janë vendimtare në përcaktimin e llojit të dëmit moral dhe vëllimit të tij.

Me fjalë të tjera, mund ta specifikojmë se dëmi moral shkaktohet si pasojë e cënimit të integritetit psikofizik të personit që gëzon në vetvete një mbrojtje juridike, me cilësinë e një të mire materiale, pavarësisht nga zotësia e personit për të krijuar pasuri, ose vlera shkëmbimi.

#### **6.4. Mënyra e shpërblimit të dëmit.**

Lidhur me këtë çështje është i njohur parimi i shpërblimit në natyrë. Kjo do të ishte edhe mënyra më e përshtatshme e shpërblimit të dëmit. Shpërblimi në natyrë ka si qëllim rivendosjen e të dëmtuarit në gjendjen e mëparshme "*statu quo ante*". Por kjo mënyrë ideale e shpërblimit nuk është shumë e përdorur. Në shumicën e rasteve shpërblimi konsiston në derdhjen, pagimin e një shumë të hollash, të përbërë nga humbja dhe fitimi i munguar në favor të të dëmtuarit. Ky është shpërblimi ekuivalent. Kodi Civil nuk parashikon ndonjë dispozitë të veçantë lidhur me mënyrën e shpërblimit të dëmit. Kjo çështje zgjidhet rast pas rasti nga gjykata, duke pasur parasysh që mënyra e shpërblimit të jetë në funksion të vetë qëllimit, domethënë të kthimit të të dëmtuarit në gjendjen e mëparshme.

Në rastin e dëmit jo pasuror, praktika jone gjyqësore ka krijuar dhe lejuar disa mundësi të shpërblimit të dëmit: "*Është e vërtetë që pas ngritjes së padisë (date 16.09.2003) pala e paditur ka bërë përgënjeshttrimin dhe ka kërkuar ndjese (date 10.10.2003), por ky veprim i saj nuk e shkarkon nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit moral. për me tepër, kjo nuk mund të shërbejë edhe si justifikim për të pakësuar në mënyrë të ndjeshme masën e*

*dëmshpërblimit, sepse përgënjeshtimi dhe kërkimi i ndjesës është bërë me shume vonese dhe pas depozitimit të padisë në gjykate..”<sup>294</sup>*

Megjithatë ka raste kur vetë lloji i dëmit imponon si mënyrë shpërblimi atë në natyrë. Në rastin e një publikimi mashtrues apo të pasaktë, gjykata mund të detyrojë personin përgjegjës që të publikojë një përgënjeshtim me shpenzimet e tij. Po kështu gjykata mund të marrë edhe masa të tjera si shkatërrimin e botimeve që përmbajnë publikimin mashtrues. Një shpërblim i këtij lloji mund të vendoset krahas një shpërblimi në të holla, edhe në rastin e dëmit moral të cenimit të nderit të personit.<sup>295</sup> Në të tilla raste shpërblimi në natyrë përshtatet me natyrën e dëmit, duke qenë i domosdoshëm për një shpërblim të plotë të dëmit.

#### **6.5. A duhet trajtuar dëmi ekzistencial, si dëm jopasuror i pavarur në legjislacionin tonë?**

Ekziston një debat juridik sidomos në Itali, në ekzistencën e dëmit ekzistencial si dëm jopasuror i pavarur. Sipas juristëve që përkrahin idenë se ky dëm duhet të jetë pjesë e dëmit moral argumentojnë se jo çdo humbje në cilësinë e jetës së individit duhet të dëmshpërblehet. Duhet të ekzistojë një kriter përzgjedhës në bazë të të cilit të kualifikohen demet ekzistenciale që meritojnë të shpërblehen, sepse jo të gjitha mund të jenë objekt dëmshpërblimi. Në këtë rast, është e lehtë për t’u evidentuar që humbjet ekzistenciale që meritojnë të dëmshpërblehen janë ato të lidhura me parimet kushtetuese dhe ligjore.<sup>296</sup>

Argument tjetër kundër është dublikimi i shpërblimit që vjen si nga dëmi moral ashtu edhe nga dëmi ekzistencial. Pasojat si vështërsia, pamundësia për të pasur të njëjtën cilësi jetese, për të kryer veprimet e përditshme të jetës, për të përjetuar kenaqësitë që sjell zakonisht jeta një individi, rritjes së mundësisë së zhvillimit (zvoglimi i stresit, ankthit,

---

<sup>294</sup> Vendim Nr.1230, datë 12.11.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

<sup>295</sup> François Givord, “La Reparation du prejudice moral” I thèse pour le doctorat présentée et soutenue le lundi 14 novembre 1938, à 14 h. Université de Grenoble, Dalloz, Paris, fq. 198.

<sup>296</sup> Deliaj, H , Mitrushi, F. (2009) “Dëmi ekzistencial”, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca , faqe 8.

varfërisë shpirtërore) konsiderohen të njëjta me atë çfarë përbën dëmin moral, turbullim psikologjik, pagjumësi etj.<sup>297</sup>

Në Shqipëri, me qëndrimin e vendimit Unifikues Nr.12/2007 të KB të G.J.L. pranohet se dëmi ekzistencial është autonom, i pavarur nga dëme të tjera të jopasurore si ai moral a biologjik. Madje, Kolegjet e Bashkuara kanë argumentuar edhe diferencën mes këtyre lloj dëmësh pra dëmi ekzistencial është një dëm objektiv ndryshe nga ai moral që ka karakter subjektiv, së dyti dëmi ekzistencial duhet të provohet nga paditësi për shkaktimin e tij, masën e përjetuar etj. Ndërsa dëmi moral prezumohet se ekziston që në momentin kur ndodh një paligjshmëri në personalitet, shëndetin e të dëmtuarit a një të afërmi dhe e kundërta duhet të provohet nga i padituri.

Po ashtu një dallim tjetër që vihet re mes dy dëmeve është se dëmi moral është një turbullim i përkohshëm psikologjik, shoqëron momentin e afërt pas ndodhjes së dëmit ndërsa dëmi ekzistencial e shoqëron të dëmtuarin gjatë gjithë jetës së tij dhe ka karakter të përhershëm (përveç rasteve kur provohet ndërprerja e tij dhe fillimi i një jete të re për të dëmtuarin më e mirë se e mëparshmeja). I dëmtuari pretendon shpërblimin se pas ndodhjes së dëmit ekzistencial është cënuar apo ka humbur ekzistenca e tij si një person me karrierë, aktivitete, me impenjime familjare, solidaritet shoqëror etj.

#### **6.6. Trajtimi i dëmit jopasuror në disa shtete.**

Neni 6:106 i **Kodit Civil Hollandez** është tepër i ngjashëm me neni 625/a i K.C. në Shqipëri pasi dëmshpërblehet dëmi fizik, dëmi në nder a reputacion, personalitet ose kujtimi i një të afërmi, shpenzimet e funeralit etj. Aktualisht, Kodi Civil Hollandez (1992) nuk

---

<sup>297</sup> Po aty, faqja 9.

legjitimon të afërmit të kërkojnë dëmshpërblim për humbjen e një familjari të tyre, pasi ajo nuk përbën një të drejtë kushtetuese të shkelur.<sup>298</sup>

Në vitin 2010 Dhoma e Lartë e Parlamentit Hollandëz rrëzoi nismën e disa avokatëve, për të lëgjitimuar personat për dëmin e pësuar nga humbja e të afërmit. Megjithatë pranohet se kur një e drejtë kryesore si shëndeti mendor çënohet, pala mund të shpërblehet në kushte të veçanta.<sup>299</sup>

Shumica e shteteve të BE e njohin të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim për vdekjen e të afërmit. Kjo e drejtë nuk është njohur vetëm në Kodin Civil Hollandez dhe Gjerman duke u bërë pjesë e kritikave për shkak të argumentave dhe qëndrimit moral që mbizotëron. Sipas këtyre shteteve, vdekja nuk mund të përkthehet në shuma parash, mund të ketë një lumërkerkesash nga të afërmit e të dëmtuarit, pa pasur një limit se kush legjitimohet, gjykata mund të jap vendime arbitrare e të zhvilloj procese të pakëndshme, mund të komercializohen gjykimet etj.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut me vendimin datë 17 Mars 2005, në rastin Nr. 50196/99 Bubbin kundër Mbretërisë së Bashkuar çmoi se përbën shkelje të nenit 2 dhe 13, humbja e pësuar nga vdekja e një të afërmi. E duke qënë se ligji ndërkombëtar i prevalon nga ligji kombëtar kur ai bie në kundërshtim, aktualisht në gjykatat kombëtare Hollandeze legjitimohen për të kërkuar shpërblim dëmi jo pasuror edhe të afërmit e viktimës.<sup>300</sup>

Në **Australi**, ndryshe nga vendet e tjera të Commonëalth-it, njihet ekzistenca e disa tarifave që konverton në të holla, dëmet jopasurore duke ndihmuar gjyqtarët në vlerësimin

---

<sup>298</sup>Rijnhout ,R , Emaus, J M. (2014) “Damages in wrongful Death Cases in the Light of European Human Rights Law: Towards a Rights-Based Approach to the Law of Damages”, *UtrechtLawReview*,Volumi 10, Seksioni 3,Qershor, faqe 101.

<sup>299</sup> Po aty fq. 102.

<sup>300</sup> Rijnhout ,R , Emaus, J M. (2014) “Damages in wrongful Death Cases in the Light of European Human Rights Law: Towards a Rights-Based Approach to the Law of Damages”, *UtrechtLawReview*,Volumi 10, Seksioni 3,Qershor, faqe 91.

objektiv. Paçka se kjo praktikë e konsolidur e gjykatave të faktit është krituar nga Gjykata Supreme, konkretisht në çështjen Hirsch v. Bennett, gjyqtarët Travers and Ëalters në pakicën e tyre u shprehën se është e rëndësishme që gjyqtarët në raste të ngjashme të shikojnë praktikën gjyqësore dhe masat e dëmshpërblimit të dhënë duke e individualizuar sipas rastit.<sup>301</sup>

Në **Gjermani**, në nenin 253 të Kodit Civil parashikohet se shpërblimi për dëmin jopasuror jepet kur paditësit dëmtohet në shëndet, në liri personale ose seksuale. Gjykata Federale e Drejtësisë në Gjermani ka argumentuar se të afërmit e të ndjerit nuk legjitimohen për të kërkuar dëmin jopasuror për shkak të shkeljes së të drejtave personale pasi nëse një person është ndarë nga jeta bashkë me të ka humbur edhe rëndësia e pretendimeve.

Në **Shtetet e Bashkuara të Amerikës** u përcaktua në mënyrë unanime se masa e shpërblimit për dëmet jopasurore (përfshi këtu dëmshërblimet me karakter ndëshkuese dhe kompensuese) të mos jetë më tepër se 100.000 \$. Ndërsa në Ligjin “Për aksidentet nga mjetet motorike” u vendos një marzh shpërblimi për dëmet jopasurore nga 15 000 \$-180 000 \$. Në SHBA konsiderohen dëmtime të rënda : një dëmtim që zgjat në kohë, ose humbje e një funksionit të një pjesë të trupit, shëmtimi i përhersëm, dëmtim mendor i rëndë, ose çrregullime në sjellje të rënda e të shtrira në kohë, humbja e fetusit etj.

Në **Australi** llogaritja e shpërblimit për dëmin jopasuror kalon në disa shkallë: caktimi i përqindjes së paaftësisë për çdo tip dëmi, caktimi i kufijve ligjor minimal dhe maksimal për çdo tip dëmi, evidentimi i shifrës minimale dhe maksimale të dëmshpërblimit të dhënë nga praktika për çdo tip dëmi si dhe caktimi i një mesatare për to. Gjykata më pas individualizon masën duke shtuar rrethanat të veçanta që ka pala paditëse<sup>302</sup>.

---

301 Mullany, N. (1990) “A new approach to compensation for non-pecuniary loss in australia”Melbourne University LawReview ,Vol. 17, December , faqja 716 .

302 Crowe Horwath, “Managing Third Party Relationship Risk”November 2011

Megjithatë së fundmi, në Francë, Gjermani, Itali, Zvicër, Hollande dhe në vëndet e Common Laë synohet që kërkesa e të dëmtuarit për shpërblim të dëmit jopasuror të jetë sa më e kufizuar, proporcionale dhe në masa racionale.<sup>303</sup>

#### **6.7. Dëmi jopasuror dhe shpërblimi i tij sipas jurisprudencës së GJEDNJ.**

GJEDNJ nuk e trajton konceptin e dëmit jopasuror dhe shpërblimin e tij nisur nga e drejta e detyrimeve pasi i takon vetë shtetit, palë e lartë kontraktuese, që të përcaktojnë kuadrin ligjor dhe gjykatave kombëtare të krijojnë praktikën e tyre kombëtare. Dëmshpërblimi jopasuror që atribuon GJEDNJ jepet kur pretendohet nga palët dhe kur provohet se ka pasur shkelje të një ose disa të drejtave fundamentale që mbrohet nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

Megjithatë, çdo vlerësim qoftë i përciptë, tangencial që GJEDNJ jep për institute të së drejtës së brëndshme penale, civile, administrative etj., për shtetet anëtare kanë rëndësi të veçantë pasi orienton palët se si duhet interpretuar një institut dhe cilat mund të jenë pritshmëritë e vendimarrjes së GJEDNJ kur trajton të tilla raste. Në vendimin e datës 29 Mars 2006 të çështjes Nr. [64886/01](#) Cocchiarella v. Italisë, ruan statutin e viktimës së dëmit jashtëkontraktor, çdo person i cili nuk shpërblehet drejt nga shtetet antare.

Dy janë nenet që në KEDNJ parashikojnë në mënyrë indirekte dëmin jopasuror dhe shpërblimin e tij, neni 13 dhe neni 41 i saj.

Në nenin 13 parashikohet se : *“Çdokush, të cilit janë shkelur të drejtat dhe liritë e për-cakuara në këtë konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para organit kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona, që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”*

---

<sup>303</sup>Av. Clément Dupoirier « La victime d'un dommage n'est pas tenue de limiter son préjudice : la Cour de cassation persiste et signe ». <http://www.village-justice.com/articles/victime-dommage-est-pas-tenue,17823.html>

Ndërsa në nenin 41 “Shpërblimi i drejtë” parashikohet se: “Gjykata kur konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës apo të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brëndëshme e Palës së Lartë Kontraktuese, lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.” Ndërsa rregullim të mëtejshëm gjendet tek neni 60 i Rregullores së GJEDNJ ku parashikohet se: “Nëse një aplikues dëshiron një shpërblim vetëm për sadsifaksion sipas nenit 41 të Konventës kur konstatohet shkelje e të drejtave të Konventës, duhet të bëj një pretendim të veçantë për të.

2. Aplikuesi duhet të përcaktoj në mënyrë të detajuar çdo pretendim të veçantë bashkangjitur me dokumentat porvues brënda kohës së caktuar për paraqitjen e pretendimeve të aplikuesit, përveç kur Kreytari i Kolegjit ka vendosur ndryshe.

3. Nëse aplikuesi nuk arrin të përmbush kërkeat e mëspërme, Dhoma mund ta refuzoj pretendimin e tij pjesërisht ose plotësisht.”

Të dy këto nenet 13 dhe 41 të Konventës nuk mund të aplikohen të veçuar por të lidhur me një nen tjetër siç ndodh zakonisht me nenin 2 të KEDNJ”E drejta për jetën” apo edhe me nene të tjera siç tregon së fundmi jurisprudenca:me nenin 3 “Ndalimi i torturës”,nenin 4 “Ndalimi i sigurisë dhe i punës së detyruar”, nenin 5 “E Drejta për liri dhe siguri”, nenin 6 “E drejta për një proces të rregullt”, nenin 8 “E drejta për respektimin e të drejtës private dhe familjare”, nenin 14 “Ndalimi i diskriminimit.”

GJEDNJ njeh parimin që udhëheq institutin e dëmshërblimit, pra shpërblimin e plotë të të dëmtuarit (*restitutio integrum*).Shërblimi nuk ka karakter ndëshkues, rëndues për shtetet antare. Dëmet pasurore dhe shpenzimet gjyqësore i atribuon në atë masë sa provohen objektivisht me prova shkresore etj., Si *damnum emerges* (humbja e pësaur) ashtu edhe *lucrum seccans*(fitimi i munguar). Ndërsa për dëmet jopasurore duke qënë se matet subjektivisht, GJEDNJ bazohet kryesisht tek praktika e saj gjyqsore pavarsisht masës së dëmit të kërkuar nga palët. Megjithatë palëve gjithnjë u mëshohet detyrimi për ti përcaktuar



në vlerë konkrete shpërblimin për dëmin përkatës që kërkojnë dhe faktit se shtetet e dinë më mirë nivelin e tyre të jetesës dhe bëjnë një vlerësim të masës në mënyrë më objektive sesa vetë GJEDNJ.

Në çështjen nr.1513/03, **Draon kundër Francës**, datë vendimi 6 Tetor 2005 prindërit e një djali me prapambetje mendore dhe paaftësi fizike paditën Qendrën Spitalore të cilët nuk kishin konstatuar këto anomali gjenetike, kromozomike që në fetus. Në 29 Mars 1999, kërkuesit iu drejtuan Gjykatës Administrative të Parisit me padi ndaj AP-HP (qendra spitalore) për shpërblim për dëmin e pësuar. Gjykimi përfundoi me datë 2 Shtator 2003 për shkak të hyrjes në fuqi të një ligji të ri material, interpretimit të këtij ligji nga Këshilli i Lartë i Shtetit dhe pezullimit disa herë të çështjes në Gjykatën Administrative. Prindërit pretendonin shkelje të të drejtës së tyre të pronësisë sipas nenit 1 protokolli 1 i KEDNJ për shkak të mosmarrjes së dëmshpërblimit pasuror dhe jopasuror në kohë. Vlen të përmendet për këtë temë se si palët ndan në zëra dëme dhe shpërblimet:

- 38,701.32 euro dhe 6,922.40 euro për dëmtim të kohës në punë të vuajtur nga Znj. dhe Z. Draon gjatë kohës së kujdesies për fëmijën;
- 22,867.35 euro për ndërhyrje në gezimin e pasurisë së tyre të paluajtshme;
- 91,469.40 euro për dëmin jo pasuror;
- 45,734.70 euro për ndërhyrje në jetët e tyre;
- 365,499 euro shpenzime për punime të veçanta të shtëpisë për ta përshtatur për fëmijën;
- 42,779 euro përshtatje të tjera jo të domosdoshme të shtëpisë;
- 5,092,588 euro për kujdestarin jo-specialist të fëmijës;
- 52,567.47 euro për shpenzime të veçanta të parimbursueshme;
- 35,940.99 euro për pajisje të veçanta motorike.

Në çështjen **Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar**, Gjykata me vendimin e datës 21 Prill 2005<sup>304</sup> vendosi një gur themeli mbi konceptin e dëmit jopasuror në lidhje me nenin 3 të KEDNJ. Mark Keenan, 28 vjeç, i sëmurë mendor (psikopati) u vetvar gjatë kohës që po kryente një dënim në burgun e Exeter, Britani. Kërkuesja pretendoi se i biri ishte vetëvrasë në burg për shkak të mosmarrjes së masave për mbrojtjen e jetës së tij nga ana e autoriteteve të burgut. Kërkuesja pretendoi se i biri kishte vuajtur trajtim çnjerëzor dhe degradues për shkak të kushteve të izolimit në të cilat ishte detyruar të rrinte dhe se ajo nuk kishte pasur mjet efektiv në lidhje me pretendimet e saj.

Në ligjin britanik “Mbi aksidentet e rënda” nuk parashikohet e drejta e nënës për tu dëmshpërblyer për dëmin jopasuror që pëson nga vdekja e fëmijës prandaj kërkuesja Susan Keenan pretendoi se ishin shkelur nenet 2,3 dhe 13 nga ana e Mbretërisë së Bashkuar.<sup>305</sup>

Para gjykatës u shtruan dy çështje: nëse i ndjeri Mark Keenan kishte pasur mjete efektive për të kundërshtuar izolimin e tij para se të vetvritej dhe nëse nëna e tij kishte mjete të mjaftueshme ankimi për tu ankuar për dëmet shkaktuar të birit para vetvrasjes dhe për dëmet e shkaktuar asaj vetë nga kjo vetvrasje?

Gjykata vlerësoi se : “ *Mark Keenan kishte qënë dënuar në rrethana që sipas saj, të bënë të mendoje për një shkelje të nenit 3 dhe për këtë arsye ai, në bazë të nenit 13 kishte të drejtën për një mjet ankimor që do të kishte qënë në gjendje të shfuqizonte dënimin e tij përpara se ai të kishte qënë ekzekutuar.*

*Kërkuesja duhet të kishet pasur mundësi që të kërkonte kompensim për dëmin e saj jopasuror dhe për atë që i biri kishte vuajtur përpara vdekjes. Gjykata në të tilla rastesh njeh dëmshpërblimin jopasuror për shkak të dhimbjes, stresit, ankthit, frustrimit të pësuar. Në*

---

<sup>304</sup>Çështja Nr. 27229/95 Keenan k.Mbretërisë së Bashkuar, www, akses më 27 Janar 2015.

*rastet e shkeljes së nenit 2 dhe 3 të KEDNJ, dëmi jopasuror i pësuar duhet të jetë në vazhden e dëmshpërblimeve të mundshme”.*

Megjithatë zbatimi i argumentit të gjykatës se aty ku ka shkelje të të drejtave themelore të KEDNJ, një nga shpërblimet është edhe ai jopasuror, nuk mund të pranohet kur pretendimet për dëm jopasuror shfaqen në çështje të mirfilltë civile. Në ato raste ku palët nuk kanë qënë dakort me masën e dëmshpërblimit jopasuror të akorduar nga gjykatat kombëtare, faktit se nuk i kanë njohur një lloj dëmi jopasuror bazuar në ligjin e brëndshëm, GJEDNJ nuk e ka vlerësuar si çështje në juridiksion të saj porse janë çështje të mirfillta të shteteve të cilat duhet të rishikojnë legjislacionin e tyre të brëndshëm.

Në çështjen Keenan K. Britanise së Madhe Gjykata akordoi 7 000 £ për ankuesen, nënën e tij duke interpretuar se përpara vetvrasjes në qeli Mark Keenan ka pësuar në mënyrë të konsiderueshme stres, ankth, pasiguri për shkak të dënimit disiplinor e për këtë vlerësohet se ka pësuar dëm jopasuror ndërsa kërkuesja u shpërblye me 3000 £ për dhimbjen, vuajtjen e pësuar nga vdekja e djalit, rrethanat e ndalimit të tij dhe pamundësisë së saj për tu ankuar.

Çështja nr. 35582/97, **Comingersoll s.a. kundër Portugalisë**, në vendimin e datës 6 Prill 2000, GJEDNJ argumentoi se zgjatja e një proçesi gjyqësor deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë prej 17 vjet e pesë muaj (pa u konsideruar ekzektuimi) përbën një cënim të nenit 6 §1 i KEDNJ mbi gjykimin në kohë të arsyeshme.

Sipas nenit 41 të KEDNJ parashikohet se *“Kur Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brëndshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.* Gjykata nisur nga praktika argumentoi se shoqëritë tregtare mund të dëmshpërblehen financiarisht për dëme jopasurore pasi nenet e Konventes duhet të jenë praktike dhe efektive për të gjithë. Ndër të tjera në dëmin jopasuror duhet të llogariten reputacioni i shoqërisë, pasiguria në vendimarrje, përçarja në manaxhimin

e shoqërisë si dhe në masën më të vogël të shpërblehen drejtuesit e shoqërisë për ankthin dhëshqetësime përjetuar.<sup>306</sup> Po ashtu kur administrimi i shoqërisë është në dorën e një personi i cili është edhe ortaku i vetëm i shoqërisë ose përbën pjesën më të madhe të ortakërisë, ankthi, shqetësimet e përjetuar si person fizik është e pamundur të mosreflektojnë edhe në manaxhimin e shoqërisë.

Po ashtu GJEDNJ në disa raste ka njohur pësimin e dëmin jopasuror të personave juridik si rezultat i cënimeve të të drejtave të tyre themelore si p.sh në rastin e çështjes **Immobiliare Saffi kundër Italisë** ku shpërblen kërkuuesin për ankthin e pësuar, në çështjen **Shoqata e Ushtarakëve Demokratik të Austrisë dhe Gubi kundër Austrisë** gjykata njohu dëmin jopasuror të Shoqatës për shkak të shkeljes së lirisë së shprehjes dhe të drejtës për zgjidhje efektive, po ashtu në çështjen e **Partisë “Liri dhe Demokraci” (ÖZDEP) kundër Turqisë** u njoh dëmi jopasuror për shkak të frustimit të antarëve dhe themeluesve të partisë si rezultat i shkeljes së lirisë së tubimit

---

<sup>306</sup> Gjykata argumenton se: “Fakti se procesi gjyqësor zgjati përtej një afati të arsyeshëm duhet ti ketë shkaktuar drejtorëve dhe aksionerëve të Comingersoll sh.a , një shqetësim dhe pasiguri të zgjatur jo vetëm në punët e përditshme të drejtimit të shoqërisë.”

## KAPITULLI I VII

### VËSHTRIM KRAHASUES NË DISA NGA VENDET E BASHKIMIT

#### EUROPIAN MBI PËRGJEGJËSINË E DËMIN JASHTË-

#### KONTRAKTOR TË SHKATUAR NGA TË TRETËT

Një vështrim i përgjithshëm mbi mënyrën se si legjislacione të vendeve të ndryshme Europiane trajtojnë përgjegjësinë për dëmin jashtë-kontraktor të shkatuar nga të tretët, duke u bazuar kryesisht në rastet praktike më të shpeshta.<sup>307</sup>

Një analizë e përgjithshme sipas parashikimeve të legjislacioneve të shteteve të ndryshme:

#### 7.1. Legjislacioni francez

Problemet e shumta që hasen gjatë përgjegjësisë së dëmit jashtëkontraktor të nxisin vetvetiu në hulumtimin e jurisprudencës dhe doktrines më të fundit, brenda dhe jashtë vendit.

Kodi civil francez bashkë me ligjet e posacme parashikojnë përgjegjësinë jashtëkontraktore për dëme të ndryshme sinë shëndet, dëme pasurore, dëme nga produktet, dëme morale etj.

Sipas Kodit Civil Francez përgjegjësia jashtëkontraktore ose përgjegjësia akuliane është një përgjegjësi që rrjedh nga rastet e parashikuara në të drejtën private, me kushtin e vetëm se mes palëve nuk duhet të egzistojë përgjegjësi të mëparshme kontraktuale pasi në të kundërt do të ndodheshim para përgjegjësise që rrjedh nga mospërmbushja apo shkelja e detyrimeve kontraktore.

---

<sup>307</sup> Chalmers, D, Davies, G , Monti, G. (2010) “ European Union Law Cases and Materials” ,2nd edn, Cambridge University Press , fq.98.

Parimet e lex aquliane, në të drejtën romake egzistojnë sot e kësaj dite në të gjitha legjislacionet ndërkombëtare mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore. Nocioni deliktet njihet në të drejtën franceze nga doktrina si gërshetim i përgjegjësive.

Përgjegjësia jashtëkontraktore është parashikuar në librin e tretë tek “ Mënyrat e ndryshme të përfitimit të pasurisë”, titulli IV “ detyrimet jashtëkontraktore” Kapitulli II deliktet dhe Quasi-Delikte. Ka tre dispozita baze nenet 1382-1384.

Në Kodin Civil Francez përgjegjësia jashtëkontraktore parashikimet janë tepër parimore dhe rastet bazike të përgjegjësisë duke e lënë kështu në “dorë të lirë” jurisprudencës për zhvillimin dhe interpretimin e mëtejshëm të normave.

Legjislacioni Francez, dhe konkretisht neni 1384 i Kodit Civil, i cili trajton raset e përgjegjësisë së personave për dëmin jashtë-kontraktor të shkaktuar ndaj të tretëve, parashikon se:

*“Çdo person është përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar nga vetë ai, ose nga personat që gjenden nën përgjegjësinë e tij”.*<sup>308</sup> Personi i cilit i shkakton dëm një tjetërit, i atribuohet në mënyrë të ligjshme detyrimi për të shpërblyer atë dëm qofte edhe kur nuk e ka kryer vete por personat nën përgjegjësine e tij, ketu mund te përmendim përgjegjësinë e punëdhënësit, përgjegjësinë e prindërve për fëmijët e mitur ose personat me aftësi të kufizuar, përgjegjësinëe kujdestarit etj...

*“Çdo person pronar i një pasurie të paluajtshme ose të luajtshme, në të cilën ka ndodhur një zjarr, do të jetë përgjegjës kundrejt palëve të treta për dëmet e shkaktuara nga zjarri, pavarësisht faktit se faji për shkaktimin e këtij dëmi ka qenë i tij apo i personave të tretë për të cilët ai është përgjegjës ”.*<sup>309</sup>

---

<sup>308</sup> Neni 1384/1 i Kodit Civil Francez

<sup>309</sup> Neni 1384/2 i Kodit Civil Francez

“Babai dhe nëna, kur ata ushtrojnë autoritetin prindëror, janë bashkërisht përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga fëmijët e tyre të mitur që jetojnë me ta”.<sup>310</sup> Një person i cili është i ngarkuar me një tjetër që është i mitur ose subjekt me aftësi mendore është përgjegjës për dëmin e shkaktuar të tjerëve, përveç nëse personi përgjegjës provon se ekziston përputhja e mbikqyrjes me standardet e sjelljes së kërkuar. Prindërit janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga fëmijët të cilët janë në kujdestarinë e tij. Tutorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga fëmijët me aftësi të kufizuara ose që janë nën autoritetin e tyre dhe që jetojnë me to.

“Personat përgjegjës të një institucioni, përfaqësuesit e institucionit, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga punonjësit e tyre gjatë kryerjes së shërbimit në pozicionet në të cilat janë caktuar”.<sup>311</sup>

“Mësuesit dhe mjeshtrit janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga nxënësit dhe praktikantët e tyre gjatë kohës që ata janë nën mbikëqyrjen e tyre”.<sup>312</sup>

“Personat e ngarkuar me përgjegjësi për rastet e parshikuara nga neni i mësipërm shkarkohen nga përgjegjësia nëse vërtetojnë se bazuar në rrethanat e shkaktimit të dëmit ata nuk mund ta pengonin dot ngjarjen dhe as pasojat, dhe se për këtë ata i kanë marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të domosdoshme për evitimin e tij”.<sup>313</sup> Faji i supozuar është baza e përgjegjësisë për tjetrin, sepse dëmi duhet të jetë shkaktuar nga lëshimet e subjektit tjetër. Ky faj në disa raste mund të jetë relativ – *presumptio iuris tantum*, kurse në disa raste absolut – *presumptio iuris et de jure*. Kur bëhet fjalë për përgjegjësinë e prindërve për fëmijët dhe përgjegjësinë e kujdestarit apo organeve të kujdestarisë për personat e zhveshur tërësisht nga aftësia për të vepruar, arsyeja kryesore e përgjegjësisë për tjerët mbështetet në mbykqyrjen e nevojshme të disa subjekteve – *culpa in inspiciendo*, për përgjegjësinë e punëdhënsit për

---

<sup>310</sup> Neni 1384/3 i Kodit Civil Francez

<sup>311</sup> Neni 1384/4 i Kodit Civil Francez

<sup>312</sup> Neni 1384/5 i Kodit Civil Francez

<sup>313</sup> Neni 1384/6 i Kodit Civil Francez

punëtorët e vet dhe për përgjegjësinë e organizatës ekonomike për punëtorët e vet, arsyeja kryesore e përgjegjësisë mbështetet në mungesën e instruksioneve të nevojshme – *culpa in instruendo*, në zgjedhjen e gabuar të punëtorit të cilit i janë besuar punët – *culpa in eligendo* dhe në mungesën e mbykqyrjes së duhur për punët që i janë besuar punët – *culpa in eligendo* dhe në mungesën e mbykqyrjes së duhur për punët që i janë besuar – *culpa in incipiendo*, kurse për përgjegjësinë e personit juridik për organet e veta, arsyeja kryesore e përgjegjësisë për të tjerët mbështetet në zgjedhjen e gabueshme të bashkëpunëtorit tjetër ose punëtorit – *culpa in eligendo*.

## **7.2. Legjislacioni italian**

Trajtimi në mënyrë të përmbledhur i përgjegjësisë për dëmin e shaktuar për të tretët sipas Kodit Civil italian mendoj se është i domosdoshëm, kjo për faktin se një pjesë e madhe e dispozitave të Kodit tonë Civil që rregullojnë përgjegjësinë jashtëkontraktore, janë marrë pikërisht nga Kodi Civil italian. Në këtë mënyrë do të kishim mundësi që të konstatojmë disa nga problemet që paraqesin formulimet e dispozitave të Kodit tonë Civil, duke konkluduar nëse këto paqartësi në formulim, kanë të bëjnë me gabime në shtyp, me përkthimin jo të përshtatshme apo me një zgjedhje të ligjvënësit tonë. Po ashtu, duke trajtuar përgjegjësinë për dëmin e shaktuar për të tretët sipas ligjit italian, mund të bëj edhe një studim krahasues, ndërmjet mënyrës së rregullimit të kësaj përgjegjësie sipas ligjit shqiptar dhe atij italian, duke nxjerrë në pah edhe të përbashkëtat dhe dallimet që kanë këto dy legjislacione në lidhje me dëmin jashtëkontraktor. Kodi Civil italian, po ashtu, si Kodi Civil shqiptar, në dispozitat e tij e jep në mënyrë të shprehur kuptimin e përgjegjësisë për dëmin e shaktuar për të tretët; shkaktimin e dëmit, fajësinë, përgjegjësinë për të tjerët, bazat e kësaj përgjegjësie.



Nga përkufizimi që Kodi Civil italian i bën përgjegjesisë për dëmin jashtë kontraktor konstatohet se ky përkufizim është i njëjtë me përkufizimin që Kodi Civil i yni i bën përgjegjesisë për të tjerët, duke u bërë nga ana e ligjvënësit tonë vetëm disa rregullime në pikëpamje të teknikës legislative, duke e ndarë dispozitën në paragrafe, si dhe duke përmendur shprehimisht bazat e kësaj përgjegjësie, gjë që ligjvënësi italian nuk e ka bërë. Por, në thelb duhet të pranojmë se, konceptet mbi kuptimin e përgjegjesisë për të tretët si në ligjin italian dhe në ligjin shqiptar janë të njëta dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe, përderisa Kodi Civil shqiptar këtë rregullim ligjor e ka marrë tek Kodi civil italian.

Kështu tek të dy ligjet bëhet dallimi ndërmjet përgjegjesisë (edhe pse në Kodin Civil shqiptar në mënyrë të shprehur dhe në atë italian në mënyrë të heshtur dhe të nënkuptuar), ku tek përgjegjësia për të tretët, personi i tretë duhet të shpërblejë dëmin e pësuar, brenda kufijve të fajësisë.

Kodi Civil Italian ka bërë një trajtim më të zgjeruar lidhur me rastet e përgjegjesisë për këtë lloj dëmi, duke bërë një rregullim të përgjithshëm të të gjitha rasteve në nenet e poshtëcituar.

Neni 2046: *“Nuk përgjigjen për pasojat që vijnë nga akti i dëmshëm ose veprimi i kundërligjshëm, ata të cilët nuk kanë patur aftësinë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tyre në kohën e kryerjes së tyre (përjashtim bën rasti kur personi e ka shkaktuar vetë gjendjen e paaftësisë, p.sh. ka pirë alkool.)”*<sup>314</sup>

Neni 2047: *“Dëmet e shkaktuara nga të paaftët”*<sup>315</sup>. Në rast të dëmit të shkaktuar nga një person i paaftë për të kuptuar, përgjegjës për dëmin e shkaktuar do të jetë mbikëqyrësi i caktuar me detyrën për mbikëqyrjen e të paaftit, përveç rastit kur ai provon se pavarësisht se i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për mosardhjen e pasojave të dëmshme, nuk ka mundur t’i parandalojë ato.

---

<sup>314</sup> Neni 2046 i Kodit Civil Italian.

<sup>315</sup> Neni 2047 i Kodit Civil Italian.

Neni 2048: “Përgjegjësia prindërore, e kujdestarëve, e tutorëve dhe mjeshtrave të artit”<sup>316</sup>. Babai, nëna, apo kujdestari, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nëpërmjet një akti të paligjshëm të fëmijëve të vegjël e të paemancipuar (neni 314 dhe vijues; nenet 301, 390 dhe në vijim), ose të personave të cilët duhet të mbikqyren apo kërkojnë përkujdesje (neni 343 dhe në vijim, neni 414 dhe në vijim), të cilët jetojnë me ta.

Tutorët dhe ata që mësojnë një zanat ose një art, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e nxënësve të tyre gjatë kohës, kur ata janë nën mbikëqyrjen e tyre.

Personat e përmendur në paragrafët e mësipërm shkakrohen nga përgjegjësia vetëm nëse dëshmojnë se kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e shkaktimit të demit, por rrethanat nuk e kanë lejuar këtë.

Neni 2050: “Përgjegjësia që lind nga ushtrimi i aktiviteteve të rrezikshme”.<sup>317</sup>Kushdo që sjell një dëm për të tjerët gjatë kryerjes së një aktiviteti të rrezikshëm për nga natyra e tij ose për nga natyra e mjeteve me të cilat e ushtron këtë veprimtari, do të jetë përgjegjës për dëmet e ardhura të tretëve, nëse nuk mund të vërtetojë se i ka marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme për të shmangur dëmin.

Neni 2052: “Dëmet e shkaktuara nga kafshët”<sup>318</sup> Pronari i një kafshe, ose ai që e përdor atë, për aq kohë sa ky person e ka në përdorim, është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga kafsha. Shkaktimi i demit me pjesmarrjen e kafshës ka ngritur nevojën për të përcaktuar kriteret e përgjegjësisë juridike civile. Për të pasur një gjykim meritor të përgjegjësisë juridike civile për dëmin e shkaktuar me pjesmarrjen e kafshës është bërë dallimi midis pjesmarrjes së kafshës shtëpiake dhe kafshës së egër në shkaktimin e demit. Në kuadër të kafshëve shtëpiake bëjnë pjesë: qentë, macet, kuajt, gomarët e racës së brendshme, derrat, devet, viçat, dhitë, delet, etj. Këto kafshë mund të jenë pronë e dikujt. Ndërkaq,

---

<sup>316</sup> Neni 2048 i Kodit Civil Italian.

<sup>317</sup> Neni 2050 i Kodit Civil Italian.

<sup>318</sup> Neni 2052 i Kodit Civil Italian.

kafshët e egra në aspektin juridik janë "res nullius". Pra, pronari apo personi që kujdeset për kafshën qoftë ajo të jetë e egër por që është në përdorim të tij është përgjegjës për dëmin që shkaktohet nga kafsha.

Neni 2053: Pronari i një ndërtese ose i llojeve të tjera ndertimesh, si godina me shërbime të ndryshme, është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga shkatërrimi i tyre, përveç rastit kur ai provon se kjo nuk ka ardhur si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes apo defektit të ndërtimit.<sup>319</sup>

### **7.3. Legjislacioni Gjerman**

Përgjegjësia civile sipas Kodit Civil Gjerman do të thotë përgjegjësi për shkaktimin e pasojës personit të dëmtuar. Shkaktimi i pasojës duhet të bëhet me veprim të kundërligjshëm si rezultat i cënimit të detyrimit ligjor: askujt të mos i shkaktohet dëm. Në qoftë se parimi i ndalimit të shkakimit të dëmit shkilet, atëherë sanksioni për të është vet shpërblimi i dëmit të shkaktuar. Kur ndodhë një gjë e tillë, atëherë për të drejtën civile gjermane paraqitet një fakt i ri sipas të cilit krijohen detyrimet midis palëve në raportin juridik civil.

Për ekzistencan e përgjegjësive civile është me rëndësi të shkaktohet dëmi dhe ai të jetë shkaktuar nga veprimi i ndaluar dhe i kundërligjshëm. Nuk themi që pasoja e shkaktuar të jetë rezultat i veprimit të fajshëm të kryersit të dëmit, sepse faji i kryersit të dëmit nuk kërkohet përherë të vërtetohet, por se ai mund të supozohet apo të mos kërkohet fare – karakteristikë e përgjegjësive pa faj (përgjegjësive objektive).

Ne kodin civil gjerman përmenden të gjitha llojet e përgjegjësive për të tretët, duke qenë se hapësira e studimit është e kufizuar do të marrim në analizë ato më të rëndësishmet

---

<sup>319</sup> Neni 2053 i Kodit Civil Italian.

Kur flasim për përgjegjësinë për të tjerë referohemi përgjegjesisë së punëdhënësit, përgjegjesisë së prindërve, përgjegjesisë për kafshët, përgjegjesisë për produktet etj... Në nenin 494 të kodit civil Gjerman sanksionohet përgjegjësia e prindërve për fëmijën e tyre të mitur, me rëndësi është përcaktimi i pozitës juridike të fëmijës në zgjidhjet ligjore.<sup>320</sup> E drejta gjermane ka përcaktuar përgjegjësinë e të miturëve duke marrë për kriter moshën e fëmijës. Sipas nenit 828 të Kodit Civil të Gjermanisë një person që nuk ka mbushur moshën shtatë vjeçare nuk është përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj palës tjetër.<sup>321</sup> Po ashtu, personi i cili e ka rritur moshën shtatë, por jo moshën dhjetë vjeçare nuk është përgjegjës për shkaktimin e dëmit ndaj palës tjetër nëse nuk e ka shkaktuar dëmin me dashje. Ndërkaq, një person i cili ka rritur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, ai përgjigjet për dëmin e shkaktuar ndaj palës tjetër.

Duke u ndërlidhur me këtë dispozitë, ligjvënsi gjerman ka përcaktuar rrethanat që prindërit i bëjnë të përgjegjeshëm për dëmin e shkaktuar nga fëmija që e kanë në mbikqyrje.

Në drejtim të kësaj, neni 832 i Kodit Civil të Gjermanisë ka përcaktuar se një person i cili është i detyruar në bazë të ligjit për mbikqyrjen e një personi të cilit duhet ti ofrohet mbikqyrja qoftë për shkak se ai është i mitur apo për shkak të gjendjes së tij mendore ose fizike, është përgjegjës për dëmet e shkaktuara personave tjerë nga personi në mbikqyrje. Ai do të përjashtohet nga kjo përgjegjësi nëse do të provohet se dëmi është shkaktuar pavarësisht plotësimin të detyrave dhe kërkesave për mbikqyrjen.<sup>322</sup>

Kodi civil i Gjermanisë në nenin 833 ka përcaktuar përgjegjësinë e mbajtësit të kafshëve. Sipas të drejtës gjermane, në të gjitha rastet kur një person ka përjetuar vdekje, cënim të shëndetit apo dëmtime trupore dhe dëmtime tjera nga një kafshë, personi i cili e mban kafshën është përgjegjës për të shpërblyer dëmin personit të dëmtuar.<sup>323</sup> Kjo përgjegjësi do të përjashtohet nëse provohet se dëmi është shkaktuar gjatë shërbimit të një kafshe

---

<sup>320</sup> Neni 494 I Kodit Civil Gjerman.

<sup>321</sup> Po aty.

<sup>322</sup> Po aty.

<sup>323</sup> Po aty.

shtepiake si profesion ose aktivitet ekonomik dhe se ndaj kafshës në momentin e shkaktimit të dëmit është ushtruar kujdes i arsyeshëm. Ndërkaq, në rastet kur kafshën e ka marrë në mbikqyrje një person i caktuar mbi bazën e një kontrate, atëherë përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafsha bie mbi të, nëse nuk ka ushtruar një kujdes të arsyeshëm në mbikqyrje. Poronari i një kafshe, ose ai që e përdor atë, është përgjegjës për dëmin që do ta shkaktojë kafsha, edhe kur kafsha arratiset ose humbet.

Për trajtimin e përgjegjesisë që rrjedh nga produktet jam bazuar në legjislacionin Gjerman dhe konkretisht në ligjin “Për përgjegjësinë që rrjedh nga produktet”, datë 15 dhjetor 1989, ndryshuar në 31 gusht 2015, i cili në mënyrë të përmbledhur parashikon:<sup>324</sup>

Neni 1: “Përgjegjësia”(1) Nëse dikush ka vdekur për shkak të përdorimit të një produkti, ka dëmtime të organeve të tij apo ka dëmtime të përgjithshme në shëndetin e tij, prodhuesi i këtij produkti do të jetë përgjegjës për dëmin e shkaktuar, dhe do të jetë i detyruar të dëmshpërblejë personat e dëmtuar. (2) Kjo vlen edhe për rastin e dëmtimit të pronës nga përdorimi i produktit me të meta, rast i cili është më i lehtë për t’u regulluar, pasi dëmi riparohet me dëmshpërblimin e pronarit e pronës për dëmin e shkaktuar dhe fitimin e munguar.<sup>325</sup>

Neni 2: “Prodhuesi i produktit përjashtohet nga përgjegjësia nëse: 1. Ai nuk e ka vënë produktin në qarkullim. 2. Nga të metat që ka pasur produkti nuk kishte se si të dilte në qarkullim, pasi të metat kanë qenë të dukshme. 3. Nëse e meta e produktit ka ardhur në kohën kur prodhuesi e ka nxjerrë produktin në qarkullim sipas legjislacionit në fuqi, dhe nuk ka mundur ta shmangë dot dëmin pavarësisht përpjekjeve të tij. 4. E meta e produktit në bazë të njohurive të shkencës dhe teknologjisë në kohën në të cilën është prodhuar produkti, ishte i panjohur si defekt apo e metë e tij. 5. Prodhuesi përjashtohet nga përgjegjësia edhe kur dëmi

---

<sup>324</sup> Ligji “Për përgjegjësinë që rrjedh nga produktet”, datë 15 dhjetor 1989, ndryshuar në 31 gusht 2015

<sup>325</sup> Neni i Ligjit “Për përgjegjësinë që rrjedh nga produktet”, datë 15 dhjetor 1989, ndryshuar në 31 gusht 2015, i Gjermanisë.

ka ardhur për arsye se përdoruesit nuk kanë zbatuar rregullat e përdorimit të specifikuar në udhëzuesin e produktit.

Përgjegjësia e prodhuesit nuk pakësohet kur dëmi i shkaktuar nga një defekt në produkt është shkaktuar nga veprimi i një pale të tretë. Bazuar në këtë ligj, barra e provës për këtë lloj dëmi jashtë-kontraktor bie mbi prodhuesin.

Pas një analize të dispozitave të këtyre legjislacioneve duhet theksuar se përgjegjësia civile për dëmet e shkaktuara nga të tretët nuk është e pakushtëzuar, përkundrazi në secilin prej neneve të mësipërme theksohet se personi mbi të cilin bie përgjegjësia për dëmshpërblimin e palës së dëmtuar, shkarkohet nga kjo përgjegjësi duke vërtetuar se i ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të domosdoshme për shmangien e demit, por rrethanat në të cilat është shkaktuar dëmi nuk e kanë lejuar evitimin e tij. Ky parashikim është bazë për shmangien nga të qënit pala e cila duhet të dëmshpërblejë personin e dëmtuar nga një veprim i jashtëligjshëm i konsideruar ligjërisht si dëm jashtë-kontraktor.<sup>326</sup>

Autorë të ndryshëm argumentojnë se parimet bazë të cilat lidhen me përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara të tretëve por jo vetëm duhet të gjejnë zbatim dhe të rregullohen nga e drejta ndërkombëtare.<sup>327</sup>

#### **7.4. Kuptimi i dëmit jashtëkontraktor dhe përgjegjësisë që rrjedh prej tij në Shqipëri, Itali dhe Francë.**

Përgjegjësia jashtëkontraktore ose përgjegjësia akuiliane është një përgjegjësi që rrjedh nga rastet e parashikuara shprehimihst në ligjin civil por jo vetëm. Nëse në të drejtën penale prokurori a i dëmtuari akuzues ngre akuze për veprën penale të kryer, të njëjtën kuptim për analogji merr edhe kur i dëmtuari padit dëmtuesin për dëmin e shkaktuar,

---

<sup>326</sup>Neni 2 I Ligjit “Për përgjegjësinë që rrjedh nga produktet”, datë 15 dhjetor 1989, ndryshuar në 31 gusht 2015, i Gjermanisë.

<sup>327</sup> Powell, S.J. (2007) “Should or Must?: Nature of the Obligation of States to Use Trade Instruments for the Advancement of Environmental, Labour, and Other Human Rights”, University of Florida Levin College of Law, UF Law Scholarship Repository, Faculty Publications Faculty Scholarship, fq.443.

përgjithësisht në të drejtat që ligji ia mbron. Mes palëve nuk duhet të ketë përgjegjësi të mëparshme kontraktuale pasi në të kundërt do të mbahej përgjegjësi që rrjedh nga kontrata.

Pra në të dy rastet ka dëm të ardhur, porse në të drejtën penale dëmi ka karakter sa individual aq edhe publik për sa kohë merren në mbrojtje nga shteti të drejtat e ligjshme, ndërsa në të drejtën civile, dëmi ka karakter civil dhe vetëm pala e dëmtuar drejtëpërdrejt apo jo, ndjek rrugën gjyqësore për të rivënë në vënd të drejtën.

Parimet e *lex aquiliane*, në të drejtën romake ekzistojnë edhe sot e kësaj dite në të gjitha legjislacionet ndërkombëtare mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore. Praktika gjyqësore është zhvilluar dhe zgjeruar si koncepte por principet janë po ato. Nocioni deliktet njihen në të drejtën italiane dhe franceze ndërsa në të drejtën anlgo-saksone njihet nocioni *tort laë*, e cila vjen nga fjala latine *tortus* që do të thotë gërshetim.

Siç e përmëdem më sipër, praktika gjyqësore është ajo që ka zgjeruar konceptet ligjore të përgjegjësisë jashtëkontraktore duke “nxjerrë ” nga norma minimaliste, norma të reja, këndvështrime të reja të ligjit.

Kështu, Kodi Civil i Francës mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore( Libri i Tretë “Mënyrat e ndryshme të përfitimit të pasurisë”, Titulli IV “Detyrimet jashtëkontraktore” Kapitulli II Deliktet dhe Quasi-deliktet) ka tre dispozita bazë, nenet 1382-1384.

Kodi Civil Italian mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore (Libri i katërt “Mbi detyrimet” Titulli IX “Faktet e jashtëligjshme”) ka 16 dispozita nga neni 2043-2059.

Kurse në Kodin Civil Shqiptar aktual, përgjegjësia jashtëkontraktore njihet me titullin “Detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit”(në titullin IV të Pjesës së Pestë të Kodit, “Detyrimet”) ka nene 41, nga nenet 608- 747/a.

Vihet re se në Kodin tonë përgjegjësia jashtëkontraktore shfaqet më e detajuar. Ndryshe nga Kodi Civil Francez dhe ai Italian ku parashikimet janë më tepër parimore dhe

rastet më bazike të përgjegjësisë duke i lënë kështu “dorë të lirë” jurisprudencës për zhvillimin dhe interpretimin e mëtejshëm të normave.

Diferencat mes tre legjislacioneve të sipër përmëndur po i përmbledhim në një tabelë.

	<b>Shqiperia</b>	<b>Franca</b>	<b>Italia</b>
	<b>Kuptimi i përgjegjësisë jashtëkontraktore</b>		
	<i>“Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.”(608 §1)</i>	<i>“Çdo fakt i shkaktuar nga njeriu që passjell dëmnjë tjetri, e detyron atë për faj të të cilit erdhi dëmi, ta riparoj”.”(1382)</i>	<i>“Çdo fakt me dashje ose me qëllim, që i shkakton një tjetri një dëm të padrejtë, detyron atë që të shpërblej dëmin.” (2043)</i>
	<b>Kushte të tjera mbi përgjegjësinë</b>		
<b>4.1</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkelje ose cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik, nga zakonet e mira. (608§2)</li> <li>• Fajësia e autorit prezmohet përveç kur kemi dëm pa faj(608§1)</li> <li>• Dëmi duhet të jetë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëmi i shkaktuar jo vetëm me faj por edhe për shkak të neglizhencës ose vetbesimit të tepruar. (1383).</li> <li>• Mban përgjegjësi jo vetëm për dëmin e shkaktuar vetë por edhe kur shkaktohet nga personi që e ka në përgjegjësi ose nga gjëra</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mos jetë shkaktuar për mbrojtien të nevojshme të tij ose të një tjetri (2044)</li> <li>• Mospërgjegjësia e subjektit, që nuk ka aftësi të kuptonte a të dëshironte pasojën veç kur kryhet me dashje(2046).</li> <li>• Nëse dëmtuesi është nën</li> </ul>



	<p>vijë drejtpërdrejtë dhe me -njëherë nga veprimi/ mosveprimi i paligjshëm (609§1)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkarkimi nga përgjegjësia në mbrojtjen e nevojshme(611),rasti faktor,forca madhore (613-615)</li> <li>• Përfshihen nga përgjegjësia i mituri nën 14 vjeç dhe të pazotë për të vepruar.(613 § 1)</li> </ul>	<p>që duhet të jenë në vëzhgimin e tij.(1384)</p>	<p>kujdestari mban përgjegjësi ky i fundit. (2047§1).</p>
--	--	---	---

## KAPITULLI VIII

### KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

#### 8.1. Konkluzione

Ndërmarrja ime për të trajtuar “Përgjegjësinë për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga të tretët”, në termat e një punimi shkencor më përfshiu në kërkime që i përkasin një fushë shumë delikate, të pashkelur tërësisht dhe, për këtë shkak po aq interesante, të së drejtës civile. Tërheqja ndaj këtij objekti ishte rrjedhojë e mishërimit në të, thuajse të të gjithë parimeve të së drejtës civile.

Pretendimet e mia në formimin teorik, gjejnë në këtë fushë, lëndë për të eksploruar, për të kundërshtuar, për të krijuar, së fundi, për të shfaqur opinione vlerësuese. Koncepti dhe interpretimi i përgjegjësisë civile në rastin e shkaktimit të dëmit nga të tretët ka qenë i njohur që nga kohërat e lashta, e cila është shprehur në forma të caktuara gjatë historisë.

Në përgjithësi, rregullat e shkaktimit të dëmit, nga karakteri primitiv, konservativ dhe abstrakt që kanë pasur kanë evoluar janë zhvilluar mjaftë, të cilat janë përsosur dhe specializuar, me qëllim që t’i përshtaten raporteve konkrete në shoqëri.

Shkaktimi i dëmit, si element apo fakt juridik, paraqet rrethanë të caktuar e cila sjell deri te krijimi, ndryshimi apo ndërprerja e marrëdhënies së detyrimeve, sipas rastit.

Dëmi si kusht i përgjithshëm, është në marrëdhënie korrelative me veprimin e dëmshëm, pasi në marrëdhënien detyrimore si shkak paraqitet veprimi i dëmshëm, kurse fakti i dëmit paraqitet si pasojë e shkakut të ardhur.

Veprimi i kundërligjshëm paraqet kushtin e domosdoshëm për lindjen e përgjegjësisë juridike civile.

Përfundimi i veprimit të kundërligjshëm. Në disa prej rasteve mund të ndodhë në praktikë që të shkaktohet dëmi, por të mos lind përgjegjësia për subjektin, autorin e dëmit. Kjo ndodh për faktin se veprimi ose mosveprimi i palës nuk konsiderohet si veprim i kundërligjshëm, element që duhet të ekzistojë si kusht thelbësor dhe i domosdoshëm në rastin e shkakimit të dëmit.

Lindja e përgjegjësisë civile për shpërblimin e dëmit, kërkon që dëmi të jetë shkaktuar në mënyrë të paligjshme. Kundërligjshmëria përbën një kategori objektive dhe ka të bëjë me faktin, se akti që ka shkaktuar dëmin vjen në kundërshtim me normat juridike të së drejtës objektive.

Lidhja shkakësore, ndërmjet veprimit të kundërligjshëm dhe pasojës së ardhur (dëmit) është një element i rëndësishëm që kushtëzon përgjegjësinë civile nga shkaktimi i dëmit.

E drejta civile dhe doktrina juridike kanë pranuar si bazë të përgjegjësisë civile fajin e personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar.

Për të lindur përgjegjësia civile e personit i cili ka shkaktuar dëmin, duhet që ky të ketë vepruar me faj.

Personat që mund të jenë në raport të caktuar juridik që ngarkohen ta shpërblejnë dëmin mund të jenë në cilësinë e prindërve të shkaktesit të dëmit, kujdestarit apo organit të kujdestarisë, personi juridik kur dëmin e shkakton punëmarrësi në lidhje me punën që kryen tek punëdhënësi, organi shtetëror kur dëmin e shkakton nëpunësi publik apo shtetëror përsonave të tretë.

Shkaku kryesor i përgjegjësisë për të tjerët/tretët, mbështetet në mungesën e mbikqyrjes së nevojshme të disa subjekteve (*culpa in inspiciendo*), në mungesën e instruksioneve të nevojshme (*culpa in instruendo*) si dhe zgjedhjen e gabueshme të personit tjetër ose të punëtorit (*culpa in eligendo*).

Personi përgjegjës përgjigjet për veprimet e tjetrit mbi bazën e fajit të supozuar, pasi besohet se nuk ka ushtruar mbikqyrjen e nevojshme ndaj fëmijës, të kujdesurit apo punëtorit. Po, nëse dëshmon se i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për mbikqyrje, ai edhe mund të lirohet nga përgjegjësia, nëse vërtetohet se edhe përkundër këtyre masave dëmi do të mund të shkaktohej.

Që personi të lirohet nga përgjegjësia për kompensimin e dëmit, duhet që të vërtetohet se dëmin e ka shkakuar ekskluzivisht me fajin e personit të tretë, veprime të cilat nuk ka mundur t'i parashikojë, si dhe nuk ka mundur t'i evitohet as pasojat e atij dëmi.

Në të drejtën e detyrimeve ekziston një rregull i përgjithshëm sipas së cilit, çdokush është përgjegjës për veprimet e tij dëmtuese lidhur me shpërblimin e dëmit të shkakuar ndaj personit tjetër.

Përgjegjësia civile është një moment mjaft i rëndësishëm që lidhet me përcaktimin e subjektit përgjegjës për shkaktimin e dëmit dhe pastaj për detyrimin për shpërblimin e tij. Baza e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, gjithmonë është arsyeja që dikush duhet të përgjigjet për këtë dëm.

Në Kodin Civil është sanksionuar se kusht për lindjen e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor është faji në të gjitha format e shfaqjes së tij. Ky përkufizim përbën sot për sot edhe bazën e kësaj përgjegjësie. Parimi i fajësisë qëndron në themel të teorisë tradicionale të shkaktimit të dëmit.

Për të përcaktuar dëmin ekzistencial nuk ka një njësi matëse për të vlerësuar se sa është humbja e pësuar në këtë rast si dhe vuajtjet që pësojnë personat e dëmtuar. Doktrina dhe praktika gjyqësore ka evidentuar kritere të tillë, disa prej të cilëve janë edhe shumë të debatuar. Por, dimensionin “njerëzor” i dëmit nuk mund të lihet pas dore dhe të konsiderohet si i shpërblyeshëm, i zhdëmtueshëm në mënyrë të përshtatshme. Çdo mbartës i dëmit e përjeton atë ndryshe. Të mohohet ky fakt do të thotë të mohohet vetë kuptimi i dëmit ekzistencial, një koncept që i referohet njeriut dhe vuajtjes së tij, që është një vuajtje individuale, specifike, subjektive dhe mbi të gjitha nuk mund të mohohet që çdonjëri është unik, i ngjashëm vetëm me vetveten.

Me shpërblimin e dëmit ndaj të dëmtuarit, gjen zgjidhje shkaktimi i një dëmi të paligjshëm. Por që të arrihet deri këtu duhet që paraprakisht të plotësohen kushtet për lindjen e detyrimit dhe të konsumohen procedurat civile.

Shpërblimi i dëmit material nënkupton kthim në gjendje të mëparshme me anë të restitutia natyralis, nëse një gjë e tillë është e mundur. Në të kundërtën shpërblimi bëhet në të holla duke u shpague vlera e dëmit të shkaktuar. Realizimi i të drejtës në shpërblim të dëmit bëhet vetëm në bazë të parashtrimit të kërkesës nga personi i dëmtuar.

## 8.2. Rekomandime

**Së pari-** Mendoj që neni 625 i KC të formulohet në mënyrë sa më të saktë pasi natyra, vlerësimi i dëmeve që pëson një i dëmtuar në të drejtat e tij themelore ndryshon vazhdimisht dhe aq dinamike paraqitet edhe jurisprudenca. Përkundrazi një rënditje e llojeve të dëmit jopasuror në ligj, i kufizon format e shpërfaqjes së tij dhe shteron mundësitë e llojeve të reja.

**Së dyti-** Rastet e përjashtimit nga përgjegjësia kur dëmi nuk mund të ndalohe nga ardhja e tij nuk është e parashikuar në Kodin tonë Civil. Referuar edhe Kodit Civil francez dhe atij italian do kuptohen:1) rastet e papritura, fatkeqe (*faut foteur*) të cilat janë të befasishme dhe të pamundura për tu ndaluar me çfardo lloj përpjekie ndërsa 2) forcat madhore përfshihen forcat e natyrës si orteke, rrebeshe, përmbytje, tërmet, vullkan dhe ato të shkaktuara nga njeriu si kryengritje, protesta që pengojne personin të realizoj një detyrë.

**Së treti-** Në nenin 616 të KC parashikohet se mban përgjegjësi personi i cili nuk ka pasur ndërgjegjen e kryerjes se veprimeve të tij. Në të drejtën penale, mospasja e ndërgjegjies për të kryer veprime paraqitet kur personi vuan nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik dhe i pandehuri përjashtohet nga përgjegjësia penale (neni 17 i Kodit Penal).

Mendoj se në Kodin Civil koncepti i ndërgjegjies së veprimeve që kryhen, duhet riparë. Sipas neni 10 të K.C. parashikohet se personit madhor për shkak të sëmundjes psikike a zhvillimit të metë mendor mund ti hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar, kjo në varësi të shkallës së sëmundjes. Ashtu siç është sot neni 616 i K.C. duhet interpretohet në favor të

palës me nivel më të ulët intelektualisht. Pra nëse provohet se në momentin e shkaktimit të dëmit, personi nuk ka ndërgjegjie për ngjarjen e ndodhur të mos ketë përgjegjësi për pasojat.

**Së katërti-** Në legjislacionin tonë përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga të tretët rezulton të jetë përgjegjësi me faj dhe e kushtëzuar, ky formulim del qartë nga një interpretim i drejtpërdrejtë që iu bëhet dispozitave të Kodit Civil në fuqi nga neni 613 e vijues ku specifikohet se personat të cilët në bazë të ligjit janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve, *“përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit”*, por masa e provës, veprimet apo mosveprimet që duhet të ndërmerren janë të papërcaktuara në këtë kod, edhe pse akte të ndryshme nënligjore në zbatim të tij përcaktojnë për disa raste masat konkrete që duhet të mërren për shmangien e përgjegjësise, mendoj se këto dispozita duhet të riformulohen duke dhënë një shpjegim më të gjerë dhe më të qartë në përcaktimin e atij limiti që këta persona i shkarkon nga përgjegjësia.

**Së pesti,** Në kodin tonë Civil llojet e dëmit jashtëkontraktor për sa i përket përgjegjësise mendoj se duhet të trajtohen të ndara në dy kategori të ndryshme:

**Kategoria e pare,** janë ato lloje të dëmit jashtëkontraktor për të cilat masat që duhet të merren nga personat përgjegjës për shkaktimin nga përgjegjësia duke u bazuar tek lloji i marrdhënies apo fenomenit konkret janë pothuajse të parashikueshme, në këtë kategori mund të përfshihen: Përgjegjësia e punëdhënësit; e prodhuesit; përgjegjësia për sende të rrezikshme; përgjegjësia e atyre që mesojnë një profesion, mjeshëri, etj.

**Kategoria e dytë,** duhet të përbehet nga ato lloje të dëmit jashtëkontraktor ku veprimet ose mosveprimet që duhet të ndërmerren për shmangien nga përgjegjësia nuk janë lehtësisht të përcaktueshme pasi edhe shkaqet që mund të cojnë në ngarkimin me përgjegjësi janë përgjithësisht të pa parashikueshme.

Në këtë kategori përfshihen përgjegjësia për fëmijët, për personat e pazotë për të vepruar, për kafshët etj.

Një dallim i tillë në kodin tonë mendoj se është i nevojshëm për caktimin e masës së ndëshkimit pak më të ulët për kategorinë e dytë krahasuar me të parën pasi për këtë kategori marrja e masave për shmangien e dëmit është e pa përcaktuar dhe e pa paparashikuar definitivisht dhe kufijtë e mbikqyrjes janë gjithashtu të papërcaktuar.

Ne asnjëherë nuk mund të paramendojmë në mënyrë koncize se çfarë veprimesh mund të kryejë një fëmijë apo një person me aftësi të kufizuara për shkak të pandërgjegjshmërisë së tij.

Ndërkohë ne duke njohur dhe studjuar mirë një fushë të caktuar, psh., mënyrën e funksionimit të një makinerie e kemi shumë të lehtë të përcaktojmë fushën e veprimit apo të mosveprimit të drejtuesit të kësaj makinerie duke përcaktuar në këtë mënyrë bazat e përgjegjësisë në këtë marrdhënie, nisur nga fakti nëse drejtuesi i makinerisë/mjetit i ka zbatuar apo jo instruksionet e duhura dhe të detyrueshme të njohura nga shkenca apo kërkesat e teknologjisë në këtë fushë.

**Së gjashti**, Lidhur me kategorinë e parë kam hartuar një listë udhëzimesh të cilat mendoj se duhet të zbatohen nga subjektet mbi të cilët bie përgjegjësia kryesisht institucionet duhet ti kenë pjesë të rregullores së tyre.

Prindrit, mësuesit, kujdestarët, administratorët duhet:

- Të jenë të vetëdijshëm se shumia e shkeljeve ndodhin në ambjentet të tilla si korridore të mbushura me njerez, tualet, sheshe lojrash, autobuzët e shkollave; telefonave celularë, kompjutera ku mbikqyrja është e kufizuar ose mungon, për rrjedhojë kujdesi i tyre duhet të jetë më serioz dhe më i përqëndruar në këto vende. Nëse vërehen ngacmime apo sjellje të tjera që cojnë në cënim të të drejtave të personave nën përgjegjësi të tyre këta të fundit janë të detyruar të raportojnë menjëherë personat apo organet përkatëse për shmangien



dhe parandalimin e dëmeve, që mund të jenë prindrit, psikologët apo çfarëdolloj strukture e ngritur poscaërisht për mbrojtjen e fëmijëve.

- Shkollat dhe instituionet e arsimit duhet t'ju ofrojnë nxënësve një ambjent gjithmonë e më të sigurt, t'ju kujtojnë gjithmonë e më shpesh se cilat janë sjelljet që mund të sjellin pasoja negative si në jetën e tyre ashtu edhe në jetën e të tjerëve rreth tyre.

- Perpilimin e një dokumenti ku të specifikohen të gjitha veprimet të cilat nuk duhet të kryhen si në ambjentet e shkollës ashtu edhe jashtë saj, ripërsëritja sa më shumë të jetë e mundur e këtyre rregullave në mënyrë që fëmijët të fiksojnë sa më mirë ato që duhet dhe nuk duhet të bëjnë.

- Për atë kategori fëmijësh të cilët gjenden në pozitën e më të dobët duhet të ndërmerren dhe të nxiten politika të ndryshme nga shkolla në mënyrë që ata të jenë sa më të angazhuar me punë në grup dhe sjellje pozitive për të ndihmuar në psikologjinë e tyre, duke ndikuar kështu jo vetëm në formimin e tyre personalisht por duke hedhur një hap shumë të madh përpara edhe për mos cënimin e asaj që i përket tjetrit.

- Prindrit dhe vetë fëmijët mund të ndihmojnë në shmangien e dëmeve duke orientuar fëmijët drejt sjelljeve pozitive dhe në përvetësimin e aftësive për mos cënimin e të tjerëve qoftë nëpërmjet sjelljeve të tyre të përditshme, qoftë nëpërmjet përdorimit të teknologjive të ndryshme pjesë e programit të studimit. Një sugjerim është edhe nxitja e nxënësve më të rritur për përkujdesjen, mbrojtjen dhe orientimin e duhur të atyre më të rinj në moshë.

- Prindi në rast të një problematike që mund të jetë duke ndodhur me fëmijën e vetë ka shumë mundësi për të shmangur dëmin e mundshëm pasi është personi më i afërt që vëren sjelljen e fëmijës në rast ngacmimi apo çfarëdolloj sjellje negative që mund të jetë duke ndodhur me të përshembull, kur fëmija heziton të dalë nga shtëpia apo sjellje të tjera jo të zakonshme. Në këtë rast mendoj se përgjegjësia për shkaktimin e një dëmi lidhet zinxhir me

disa persona duke filluar që nga prindi i pari që është personi më i afërt me fëmijën dhe që njeh më së miri sjelljet e fëmijës së vet, mësuesit, kujdestarët, organet e caktuara për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla, etj.

- Dëmi i shkaktuar i shkaktuar nga fëmijet mund të jetë material por edhe moral si kërcënime nëpërmjet rrjeteve sociale që në ditët e sotme është një fenomen shumë i përhapur dhe në forma nga më të ndryshmet, për këtë arsye është akoma më e vështirë shmangia e tyre dhe kontrolli i drejtpërdrejt prind – fëmi, mësues – nxënës, prandaj hartimii disa politikave standarte dhe të mirnjohura nga të gjithë mendoj se do të ishte shumë efektiv.

**Së shtati**, si rezultat i globalizimit të ekonomisë dhe kompleksitetit të marrdhënieve të biznesit mendoj se institucione të vecanta (përfshi këtu cdo person juridik privat apo publik i cili në varësi të fushës së veprimtarisë që ai zhvillon) duhet të krijojë dhe formulojë politikat e veta për mbulimin e përgjegjësise për dëmet e shkaktuara të tretëve, jo duke dhënë udhëzime për legjislacionin por duke njohur dhe studjuar mire fushën e vet të veprimit dhe duke nxjerrë rregullore të vecanta për zbatim duke përcaktuar në mënyre koncize veprimet që duhen dhe nuk duhen kryer nga ky institucion dhe personat në shërbim të tij gjatë implementimit të veprimtarisë për të cilën ai subjekt është krijuar dhe operon. Këto politika duhet të jenë në përputhje të plotë me standartet e mirënjohura ndërkombëtare në fushën e tij të veprimit.

**Së teti**, për të konkretizuar atë çfarë kam trajtuar më sipër kam hartuar një pyetësor i cili mendoj se vjen në ndihmë të cdo personi fizik apo juridik, privat apo publik i cili mund të ngarkohet me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga të tretët. Shtrimi i këtyre pyetjeve dhe ngritja e organeve në zbatim të tyre mendoj se do të jetë një zgjidhje shumë e mirë sidomos për biznest, për menaxhimin e riskut dhe shmangien nga përgjegjësia për të tretët.

1. A ka kompania një inventar të plotë të marrëdhënieve me të tretët dhe marrëveshjeve të saj?

2. A e kemi kryer një vlerësim të rreziqeve të biznesit për secilën nga marrëdhëniet që kemi?
3. Kush e bën vlerësimin e rrezikut?
4. Cilat janë rreziqet kryesore në këto marrëdhënie dhe cilat janë proceset që kemi për të menaxhuar ato? Kush është përgjegjës për menaxhimin e riskut dhe monitorimin?
5. A janë krijuar marrveshjet tona në përputhje me standartet ligjore të mirënjohura kombëtare dhe ndërkombëtare?
6. Cilat janë politikat e kompanisë në lidhje me marrëveshjet e auditimit për pajtim?
7. Si mund të kuptohet se marrëdhëniet e një subjekti janë në përputhje me ligjet dhe rregullat?
9. Çfarë procedurash duhet të realizojmë në mënyrë që të ndjekim dhe të rivlerësojmë rreziqet që lidhen me një marrëdhënie të mëparshme për rinovimin e kontratës?
10. Cilat rreziqe duhet të konsiderohen në përzgjedhjen ose rinovimin e Kontratës faktike dhe ligjore?
11. Standartet aktuale të marrveshjeve adresojnë në rrisqe të parashikuara ose jo dhe cilat janë ato?
12. Si mund ta kuptojmë se marrëdhëniet mes përfaqësuesve tanë dhe palëve të treta janë korrekte ose jo?
13. A janë testuar në vazhdimësi marrëdhëniet tona me palët e treta?
14. Sa të varur janë palët e treta nga nënkontraktorët dhe supervizorët tanë, cilat rrisqe u adresohen këtyre subjekteve?

## **Bibliografia**

### **Burime Parësore**

1. Alishani, A. (2002) "*E drejta e detyrimeve, pjesa e posacme*", Prishtinë.
2. Alishani, A. (2002) "*E drejta e detyrimeve*", pjesa e përgjithshme, Prishtinë.
3. Alishani, A. (2002) "*Studime nga e drejta e detyrimeve II*", Prishtinë, 2006.
4. Brati, A. (2008) "*Procedura Civile*", Botimet Dudaj, Tiranë.
5. Alishani, A. (2002) "*E drejta e detyrimeve*", Prishtinë, fq.487.
6. Alishani, A. (2001) "*Studime nga e drejta e detyrimeve I*", Prishtinë.
7. Lamani, A. (1962) "*Procedura Civile e RPSSH*", Botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Tiranë .
8. Lamani, A. (1962) "*Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë*", Tiranë.
9. Sallabanda, A. (1962) "*E drejta e detyrimeve*", Tiranë.

10. Sallabanda, A. (1962) *“E Drejta E Detyrimeve”*, pjesa e përgjithshme, Tiranë.
11. Nuni, A. (2009) *“Edrejta Civile”*, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë.
12. Nuni, A. , Mustafaj, I. ,Vokshi, A. (2008) *“E Drejta e Detyrimeve I”*,Tiranë.
13. Grupçe, A. , Strezovski, S. (1985) *“E drejta e Detyrimeve”*, Shkup.
14. Biondi, A. and Farley, M. (2009) ” The Right to Damages in European Law”, Kluwer.
15. Chalmers, D. ,Davies, G. , Monti, G. (2010) ” European Union Law Cases and Materials 2nd edn “, Cambridge University Press.
16. Principles of European Tort Law”, e hartuar nga “European Group on Tort Law”, paraqet përmbledhje të rregullave civile, përmes të cilave synohet që të unifikohet dhe harmonizohet “E drejta deliktore europiane”;
17. John, C. (2007) “Law of Torts 3<sup>rd</sup> ed” London, San Francisco, Kuala Lumpur, Johanesburg, Financial Times Pitman Publishing.
18. John, C. (2007) “Law of Torts 8<sup>th</sup> ed”, London, New York and Others ,Pearson Longman.
19. Corkin, J. (2008) “Science, Legitimacy and the Law: Regulating Risk Regulation Judiciously in the European Community” , 33 ELRev 359.
20. Craig, P. and de Búrca, G. (2011) ” EU Law Text, Cases, and Materials 5th edn “, Oxford University Press.
21. Dauti, N. (2001) *“E drejta e detyrimeve”*, Prishtinë.
22. Delory, Anne M. (1987) *“Joint Legal Custody: A revision to Patriarchal Power”*.
23. Pop Georgiev, D. (1985) *“E drejta e detyrimeve”*, Shkup.
24. Dobbs, Dan B. and Hayden, Paul T. (2001) “Torts and Compensation: Personal Accountability and Responsibility for Injury 4<sup>th</sup> ed”, St. Paul, Minn, West Group.
25. Harris, D. (1988) “Remedies in Contract and Tort”, London.

26. Nathanaili, A. , Biçoku, N. (1987) “*E Drejta Civile, Pjesa e Pergjithëshme I*”, Tirane , faqe 126.
27. Olldashi, E. (2011) “*E drejta romake*”, Mediaprint ,Tiranë .
28. Galgano, F. (2003) “*E drejta private*” ,Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë.
29. Laviano, F. , Saggese , Pepe, I. (2006) ,” *Kodi Civil Italian*”, ilustruar me doktrine dhe jurisprudencë, skema, harta dhe materiale, botim i shtëpisë botuese Tribuna, Piacenza.
30. Galgano, F. (1999) “*E Drejta Private*”, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë.
31. Givord, F.(1938) “*La Reparation du prejudice moral*” *I thèse pour le doctorat présentée et soutenue le lundi à 14 h. Université de Grenoble, Dalloz,Paris,14 novembre.*
32. Galev, G. , Jadranka. (2004) “*E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme*” Beograd.
33. Floqi, G. (1951) “*Mbi Përgjegjësinë e shpërblimit të dëmit nga një veprim I paligjshëm në të drejtën civile*”, Drejtësia Popullore, nr.5.
34. Légier, G. (2008) “*E Drejta Civile-Detyrimet*” *Profesor në Universitetin “Paul-Cézanne” (Aix-Marseille III), botimi i 19-të.*
35. Ponzanelli, G. (2009) “*Danno e Responsabilita*”, Casa editrice IPSOA Roma.
36. Hervey, T K. , Kenner, J. (2003) “*Economic and Social Rights under the EU Charter of Fundamental Rights*” , A Legal Perspective Hart Publishing.
37. Heukels, T , Mc.Donnell, A (eds). (1997) “*The Action for Damages in Community Law*”, The Hague/London/Boston.
38. Hodgson, J. , Lethwaite, J. (2004) “*Tort Law*”, Oxford University Press.
39. Bergel, Y. , Sainz de, B. (2012) “*Introduction to non-contractual liability under Spanish Law*”, Universidad Carlos III de Madrid , ÖREBRO ,MAY.
40. Vasili, J. (2005) “*Procedura Civile e republikës së Shqipërisë*”, Tiranë.

41. Kidner, R. , Case, B. (2002) “ Torts7<sup>th</sup> ed”, Oxford,NeëYork: Oxford University Press.
42. Çavdar, K. , Mr. Çavdar, K. (2008) “*Ligji për marrëdhënie të Detyrimeve*”, komente, sqarime, praktik gjyqësore dhe regjistri i lëndëve, Shkup.
43. Jerzy, K. (1977) “ The Ethiopian Law of Compensatio for Damage”, AddisAbaba, Faculty of Law.
44. Çela, K. (2010) “*E Drejtë e Punës*”, Botimi i XII, Tiranë.
45. Tutulani-Semini, M. (2006) “*E drejta e detyrimeve dhe e kontratave*”, pjesa e përgjithëshme, Tiranë.
46. Semini, M. (1998) “*E drejta e detyrimeve dhe e kontratave*”, pjesa e përgjithshme, Tiranë .
47. Hetemi, M. (1998) “*Detyrimet dhe kontratat*”, Tiranë.
48. Hetemi, M. (1998) “*Detyrimet dhe Kontratat*”, Tiranë.
49. Vukovic, M. (1971) “ *Pergjegjesia Per Demin*”, Zagrep.
50. Von Bar, C. (2009) “Principles of European Law”, “Non-contractual liability arising out of Damage Caused to Another”,” European Law Publishers” , Vol 7.
51. Nicholas, M, J. and Bagshaw, R. (2005) “Tort Law,2<sup>nd</sup> ed” , London, New York and Others: Pearson Longman.
52. Tesfaye, N. (1996) “Extra Contractual Liability and Unjust Enrichment”, Artist Printing Press, Addis Ababa.
53. Dauti, N.(2001) “*E drejta e detyrimeve*”, Prishtinë.
54. Dauti, N. (2004) “*E drejta e detyrimeve*”, Prishtinë.
55. *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i miratuar dhe i hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 2200 A (XXI), të datës 16 dhjetor, 1966, ka hyrë në fuqi: Më 23 mars, 1976;*

56. Pannet, A. (1995) "Law of Torts 7<sup>th</sup> ed", London: The M&E Hand Book Series.
57. Zimmermann, R. (1996) "The Law of Obligations: Roman Foundations of the Civilian Tradition", Published in the United States by Oxford University Press Inc., New York.
58. RFV Husten, Buckley RA, Salmond, Hustenon. (1992) "the Law of Torts, 20<sup>th</sup> Ed" London: Sweet and Maxwell.
59. Shulman, Harry, James, F, Jr. Oscar S. Gray, G. Gifford, D, Cases, Materials. (2003) "the Law of Torts 4<sup>th</sup> ed", New York: Foundation Press.
60. Živković, S. "Shpërblimi i dëmit material dhe jomaterial", Beograd.
61. Çeço, S., Maldini, Y., Hasani, S. (1986) "E Drejta Procedurale Civile e RPSSH", Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë.
62. Stephen O'Halloran BCL, LL.M (Commercial), Liability for Defective Products, fq. 4, marrë nga: Toledo, Ohio, SHBA, "The Huffington Post", 2 December 2012;
63. Kondi, Th. (1989) "Disa probleme të detyrimeve që lindin nga shkaktimi i dëmeve jashtëkontraktore", Drejtësia Popullore, nr. 3.
64. Kondili, V. (2003) "E drejta civile", Pjesa e përgjithëshme, Tiranë.
65. Ward A, Judicial Review and the Rights of Private Parties in EU Law (2nd edn, Oxford University Press 2007).
66. Tony, W. (1996) "A Case Book on Tort, 8<sup>th</sup> Ed", London: Sweet and Maxwell.
67. Đorđević, Z, Stanković, V. (1974) "E drejta e detyrimeve", Beograd.
68. Zweigert, K. and Kötz, H. (1999) "An Introduction to Comparative Law", Second editions.
69. Harris, D. (1988) "Remedies in Contract and Tort", London.
70. Hodgson, J., Lewthwaite, J. (2004) "Tort Law", Oxford University Press.
71. Jerzy (George), K. "The Ethiopian Law of Compensation for"



72. Damage. (1977) ,Addis Ababa, Faculty of Law.
73. John, M. ( 1996) “A Text Book on Torts”, 3rd Ed, Blackstone Press Limited Great Britain.
74. John, C. (2007) “ Law of Torts 8th ed”, London, New York and Others, Pearson Longman.
75. John, C.(2007) “ Law Torts 3rd ed”, London, San Francisco, Kuala Lumpur, Johanseburg, Finacial Times Pitman Publishing.
76. Dobbs, Dan B , Hayden ,Paul T. (2005) “Torts and Compensation”, Personal accountability and social responsibility for injury.
77. St. Paul, Minn , West Group. (2001) “Accountability and Responsibility for Injury 4th ed”.
78. Morbide, N. , J.and Bagshaw, R. (2005) “ Tort Law, 2nd ed”,London, New York and Others: Pearson Longman.
79. Shulman , Harry ,Fleming James , Jr. Oscar S. Gray, Gifford, D. (2003) “Casesand Materials on the Law of Torts 4th ed” ,New York: Foundation Press.
80. Deakin, S. , Johnston, A. , Basil, M. (2008) “Markesinis andDeakin’s Tort Law,6th ed”, Oxford, Clarendon Press.

**Burime Dytësore**

1. A factual assesement of the draft common frame of reference Edited by Luisa Antonioll Franceska fiorentini Prepared by the Common core evaluation group 'Legally Relevant Damage' and a Priori Limits to Non-Contractual Liability in the DCFR;
2. Cahn, N. (1996) “Pragmatic questions about parental liability statutes” “Wisconsin Law Review”, 399.
3. Con, Martin T.N. , Vieceli, L. (1988) “The business of rehabilitation placement”: What to understand about private employers before approaching them, Journal of Rehabilitation.
4. Glenn, D. , West , W. Benton Lewis , Jr. (2009) “ The Business Lawyer”, Tracting to Avoid Extra-Contractual Liability—Can Your Contractual Deal Ever Really Be the “Entire” Deal? , Vol. 64, August.
5. Evolution of auditor liability to non contractual third parties: balancing the equities and weighing the consequences, JODI B. SCHERL, Extra-Contractual Liability, Teaching Material Prepared by: Abdulmalik Abubeker & Desta G/Michael.
6. J CEZAR S. SANGCO. (1994) “ Philippine Law on torts and damages (revised edition)” , Vol 2, JMC PRESS.
7. Goetting, A. (1992) “ Parenthood factors in delinquency and crime: A review of research”, November.
8. Gate, G. ( 2010) “Èhere Are the Parents? Parental Criminal, Responsibility For the Acts of Children”, University Law Review, Volume 30, Article 4, Lisa Lockwood.
9. Humm, R. (1991) “Criminalizing poor parenting skills as a means to contain violence by andagainst children”, University of Pennsylvania Law Review, 139(4), April.
10. Mante, M. (1995) “New Jersey takes aim at gun violence by minors: Parental criminal liability”, “Rutgers Laë Journal” 26(2), Winter.

11. Michigan parents convicted for kid's crimes. (1996, May 10). American Civil Liberties Union News and Events.
12. Paper presented at the meeting of the American Society of Criminology, New Orleans, Louisiana.
13. Parental liability laws John Howard Society of Alberta. (1997).
14. Parental responsibility young children and health care law. (2007) , JO Bridgeman, Chambridge University Press.
15. Polauck, M. (1993) “ The International Year of the Family from the view point of crime prevention and criminal justice (preliminary draft)”, United Nations Office at Vienna, Centre for Social Development and Humanitarian Affairs, Social Development Division, Crime Prevention and Criminal Justice Programme.
16. Prof. Dr. A.K. Schnyder Herbstsemester. (2013) “Comparative Private Law”, Materials/lectures. Prof. Schnyder October 7 and 21, November 4 and 11.
17. Punishing Parents for the Crimes of their Children, Raymond Arthur, Lecturer in Law, The Centre for Law, The Open University, The Howard Journal Vol 44 No 3. July 2005 ISSN 0265-5527.
18. Sins of Their Children: Parental Responsibility for Juvenile Delinquency, Gilbert Geis, Arnold Binder 2012, Notre Dam Journal of Law, Ethic and Public policy, Volume 5.
19. Summer 2012 Culpa in Contrahendo in European Private International Law: Another Look at Article 12 of the Rome II Regulation Najib Hage-Chahine.
20. The Parental Responsibility Act, Legislative Assembly of Manitoba, Winnipeg, MN: Queen's Printer.
21. Wells, L. , Rankin, J. (1988) “ Direct parental controls and delinquency”, Criminology.

22. Wilson, H. (1980) “ Parental supervision: A neglected aspect of delinquency”, the British Journal of Criminology.
23. Deliaj, H. , Mitrush, F. (2009) “Dëmi ekzistencial”, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca, faqe 8.
24. John, C, North. (1977) “ Responsibility of Employers for the Actions of Their Employees”, the Negligent Hiring Theory of Liability, Volume 53, Article 8.
25. Bardhi, A. (2015) “Parental Liability for Damages Resulting from a Child’s Acts”, Journal of Educational and Social Research, MCSER Publishing, Rome-Italy Vol. 5 No.3.
26. Bardhi, A. (2015) “ Employer Responsibility for damages caused by their employees”, Journal of Educational and Social Research, MCSER Publishing, Rome-Italy Vol. 3 No.3.
27. Negatu, T. (1996) “ Extra Contractual Liability and Unjust Enrichment”, Artist Printing Press, Addis Ababa.
28. Van Dersmissen, B. “Legal Concepts related to youth responsibility”, University of Journals, Vol. 13.3.
29. J. Powell, S. ( 2007) “Should or Must?: Nature of the Obligation of States to Use Trade Instruments for the Advancement of Environmental, Labour, and Other Human Rights”, University of Florida Levin College of Law, UF Law Scholarship Repository, Faculty Publications Faculty Scholarship.
30. Mataj, R. (2016) “The Compensation of Non-contractual Damages Caused by Administrative Bodies in Albania”, Acta Universitatis Danubius. Juridica, Vol 12, No 1;
31. Introduction to Health and Safety in Construction, Second edition, Phil Huges, MBE MSC, Chairman NEBOSH 1995-2001, Ed Ferret PHD, BSC (Hons Eng), Ceng, MMEchE, MIEE, MIOSSH, Deputy Chairman NEBOSH, 2007;
32. European International Contractors (EIC) Contractors Guide to the FIDIC Conditions of Contract for EPC/Turnkey Projects (The EIC Silver Book Guide), 2nd Edition, 2003;

33. Janna Lahe, “Meaning of fault with regard to liability for damage caused by the unlawful action of another person”, judica International, 2006;
34. Crowe Horwath, “Managing Third Party Relationship Risk” November 2011.

### **Legjislacioni Kombëtar**

1. Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër, 1998.
2. Kodi Civil, viti 1929
3. Kodi Civil, viti 1984.
4. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr.7850, datë 29.7.1994, ndryshuar me ligjin Nr.8536, datë 18.10.1999 ligjin Nr.8781, datë 3.5.2001 dhe ligjin Nr.17/2012.Kodi I procedures Civile i Republikes se Shqiperise.
5. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.
6. Ligji nr. 2350, datë 15.11.1956 “*Mbi zbatimin e ligjës mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet.*”
7. Ligji Nr.9121, datë 28.7.2003 “*Për mbrojtjen e konkurrencës*” (I përditësuar) Ndryshuar me ligjin nr. 9499, datë 3.4.2006, nr. 9584, datë 17.7.2006, nr. 10317, datë 16.9.2010;
8. Ligji Nr.8690, datë 16.11.2000 “*Për aderimin e republikës së shqipërisë në konventën “për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të detit mesdhe, si dhe të 6 protokolleve shoqëruese*”.
9. Ligji Nr. 8510, date 15. 7. 1999 “*Per pergjegjesine jashte kontraktore te organeve te administrates shteterore*”;
10. *LIGJI Nr.10 237, dt 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”;*

11. *Vendim Nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”;*
12. *Ligji Nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.*
13. *Qendra Rajonale e Mjedsit, AKTE nderkombetare mjedisore Biodiversiteti, Tirane 2011;*
14. *Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 Dt. 09.06.2011, “ Per mbrojtjen e mjedisit.*

### **Legjislacioni i Huaj**

1. Direktiva e BE-së 2007/31/EC “*Mbi prodhimin dhe etiketimin e produkteve*”.
2. Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, e Këshillit të Europës.
3. Kodi Civil i Austrisë.
4. Kodi Civil i Francës.
5. Kodi Civil i Gjermanisë.
6. Kodi Civil i Italisë.
7. Ligjit Nr. 04/L-121 “Per Mbrojtjen e Konsumatoreve”, date 19 Tetor 2012 Kosove.
8. Ligjit Nr. 02/L-53 “Për gjuetinë”, 16 Dhjetor 2005, Kosove.
9. *Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Gazeta zyrtare e RM, nr. 38/04, datë 17.06.2004 .*
10. Ligji për marrëdhëniet e detyrimit, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 18/01.

### **Vendime**

1. Vendim Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
2. Vendim Nr.1230, datë 12.11.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
3. Vendimi Nr. 7713 të vitit 2000 Gjykata e Kasacionit Itali.

4. Vendimi nr. 652, datë 22.06.2000 i Gjykates se Larte.
5. Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Nr. 12, dt. 13.09.2007 dhe 14.09.2007.
6. Vendim, 14 shkurt 2003, Gjykata e Apelit, Milano.
7. Gjykata Italiane e Kasacionit në bazë të vendimit Nr. 7713 të vitit 2000.
8. Cështja A. Cass. krim., 20 tetor 1987 5.F.7.
9. Cështja Cass.crim, 23 June 1988 17 5.F.16., 5.E.17., 5.G.18. SCH Atomic City and Court of Appea. Morris v. CË Martin & Sons Ltd. And BGH, 4 November 1953.
10. Cështja BGH, 26 janar 1995 (Gjykata Federale Gjermane).
11. Cështja Dhoma e Lordëve, Mersey dhe Bordi Harbour v. Coggins & Griffith L5t.De.
12. Cështja BGH, 14 February 1995 Physician and Midëife as Verrichtungsgehilfe  
Organizational Fault of Hospital.
13. Case Mersey dhe Bordi Harbour v. Coggins & Griffith L5t.dE.

## **Faqe Ëeb**

1. (<http://homepage.eircom.net/ucdtutorials/Products Liability.pdf>)
2. <http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/damage> Principles of European Tort Laë”, e hartuar nga “European Group on Tort Laë”, paraqet përmbledhje të rregullave civile, përmes të cilave synohet që të unifikohet dhe harmonizohet “E drejta deliktore europiane”. “Encyclopædia Britannica, Inc.”, faqe elektronike me informacione për promovimin e njohurive dhe informacioneve tjera arsimore.
3. <http://ëëë.scribd.com/doc/92816462/Latinski-citati>.
4. [ëëë.foxneës.com/photoessay/0,4644,1636,00.html](http://ëëë.foxneës.com/photoessay/0,4644,1636,00.html) .
5. <http://ëëë.ebrd.com/ëho-ëe-are/our-values/environmental-and-social-policy.html%20>

